

Synimet/qëllimet e fesë islame

1- Realizimi i interesave të robërve në këtë dhe në botën tjetër

Pa dyshim se qëllimet e fesë islame ashtu si i konfirmojnë ajetet dhe hadithet janë arritja e realizimit të interesave të robërve dhe mënjanimi i të këqijave prej tyre si në këtë botë ashtu edhe në botën tjetër. Me të gjitha këto arrihet realizimi i lumturisë së tyre, si në këtë jetë, ashtu edhe në jetën tjetër. Këtë e kanë shpjeguar shumë prej dijetarëve myslimanë si: Imam Izz Abduselami i cili ka thënë: “Sheriati islam i tëri është në interes të njerëzve, ose i mënjanon të këqijat, ose i sjell të mirat”¹. Dijetari i madh Ibn Tejmije radijAllahu anhu ka thënë: “Vërtet sheriati islam ka sjellë atë që është në interes të njerëzve dhe e plotëson atë, njëkohësisht i mënjë anon të këqijat, por dhe i pakëson ato”.² Nxënësi i Ibn Tjemijes radijAllahu anhu, imami Ibn Kajim el-Xhevzije, ka thënë: “Bazat e shariatit kanë për qëllim që t’i realizojnë intreresat e robërve si në këtë botë ashtu edhe në botën tjetër; ky shariat tërësisht është drejtësi, është mëshirë, është në dobi të njerëzve dhe krejtësisht urtësi”.³ Imam Shatibiju, në librin e tij “El-Muvafekat”, ka thënë: “Sheriati islam është vendosur për t’ua realizuar të mirat robërve”.⁴

Realiteti është se ajo që e kanë përmendur këta dijetarë të mëdhenj, është e vërtetë dhe përshkrim faktik i fesë islame, e të cilën e argumentojnë tekstet (ajetet dhe hadithet), këtë e kemi përmendur më herët. Mjafton që për këtë të përmendim një ajet që arsyeton shkakun e shpalljes së Muhamedit salAllahu alejhi ue sel-lem, Allahu i Lartësuar ka thënë: ***“E Ne të dërguam ty (o Muhamed) vetëm si mëshirë për të gjitha krijesat.”*** (Kurani, Enbija: 107)

Pra, zbritja e të Dërguarit të Allahut salAllahu alejhi ue sel-lem është mëshirë për të gjitha krijesat, ngase në të përfshihen të gjitha interesat e robërve, si në këtë botë ashtu edhe në Ahiret dhe në të njëjtën kohë i mënjanon të këqijat e dëmet nga njerëzit.

¹ Izz ibn Abduselam: el-Kavaidu, vol. I, fq. 9

² Ibn Tejmije: Minhaxh Sunneti Nebeveijeti, vol. I, fq. 147, vol. II, fq. 240, vol. III, fq. 118

³ l'lamul Mu'ki'ine. vol. III, fq. 1

⁴ Esh-Shatibiju: El-Muvafekatu vil. II, fq. VI

2- Llojet e interesave të robërve

Interesat e robërve, të cilat islami përpqet t'i realizojë dhe t'i ruajë, janë tri llojesh:

- 1- Ed-darurijat (interesat vitale të domosdoshme);
- 2- El-haxhijat (interesat që kanë të bëjnë me gjërat e nevojshme feja islame ka përcaktuar lehtësime në raste të mbingarkesave);
- 3- Et-tahsinijat (interesat që kanë të bëjnë me komoditetet e jetës së njeriut, si në aspektin fizik dhe atë moral, për këto interesa sheriati islam ka përcaktuar që të pastrohet trupi, rroba, të mbulohen pjesët e turpshme, të zbukurohet njeriu me rroba sa herë të shkojë në xhami etj).

Feja islame ka përcaktuar dispozita me të cilat realizohen interesat e robërve, ruhen ato dhe me të cilat njerëzit arrijnë të kenë lumturi në këtë botë dhe në botën tjetër (ahiret).

3- Kriteri vlerësues i interesave dhe të këqijave

Kriteri vlerësues i interesave dhe i dëmeve të këqijave është islami. Për atë që dëshmon feja islame se është e dobishme ajo është e dobishme dhe për atë që dëshmon se është e keqe ajo konsiderohet e keqe. Dalja jashtë këtij instrumenti matës nënkupton ndjekjen e hamendjes-pasionit dhe tëipavërtetës që nuk është e vlefshme për t'u përcaktuar se çka është e dobishme e çka është e dëmshme. Allahu i Lartësuar ka thënë: *“O Davud: Ne të kemi bërë sundimtar në tokë, e ti pra gjyko me drejtësi mes njerëzve, e mos shko pas dëshirave se ato të shmangin prej rrugës së Allahut...”*

Këtu nuk ka tjetër pos të vërtetës dhe të pavërtetës: e vërteta është ajo që është nga Allahu i Lartësuar se çka është e dobishme e çka është e dëmshme, ndërsa të gjitha të tjerat janë të pavërteta dhe në to janë të gjitha gjërat e dëmshme për njerëzit. Pra, e dobishme dhe e mirë është pasimi i asaj që e ka zbritur Allahu dhe braktisja e të gjitha gjërave të tjera.

4- Paaftësia e njeriut që të kuptojë se çka është e dobishme dhe çka është e dëmshme

Njeriu, sipas natyrshmërisë së tij, është i paaftë që të arrijë të kuptojë se çka është e dobishme në të vërtetë dhe se si të arrihet deri tek ajo si në këtë botë ashtu edhe në botën tjetër. Nëse njeriu arrin t'i kuptojë disa prej të dobishmeve në këtë botë, ai është i paaftë t'i kuptojë dobitë që kanë të bëjnë me botën tjetër dhe rrugët e realizimit të tyre. Njeriu do të mund t'i arrijë të mirat, nëse ai vepron sipas sheriatit dhe sipas shpjegimeve që i sjell ky sheriat.

5- Interesat e vërteta të njeriut janë në ndjekjen e asaj që e ka zbritur Allahu

Interesat e vërteta të njeriut janë në ndjekjen e asaj që e ka zbritur Allahu dhe në konsolidimin e çështjeve të kësaj bote në përputhje me sistemin islam. Kjo është ngase në këtë mënyrë realizohen interesat e vërteta të njeriut dhe realizimi i lumturisë në këtë botë. Me realizimin e lumturisë në këtë botë arrihet edhe lumturia më e madhe në botën tjetër, duke shijuar kënaqësitë e Allahut dhe duke hyrë në xhenet. Kjo, pra, është njëra prej veçorive madhështore të fesë islame, ngase me zbatimin e dispozitave të kësaj feje dhe me ndjekjen e mësimave dhe programit të saj në këtë njeriu e realizon një jetë të mirë në këtë botë e jo siç mendojnë disa injorantë një jetë larg telasheve e problemeve. Tjetra është se jeta e konsoliduar mbi konceptet islame e lehtëson rrugën për ta pasur një jetë të lumtur në botën tjetër (ahiret), ndërsa nëse jeta është konsoliduar mbi koncepte të tjera joislame, atëherë kjo jetë bëhet e palumtur në këtë botë dhe po ashtu në botën tjetër nuk ka vend tjetër pos futjes në zjarr.

6- Dobitë e kësaj bote konsiderohen si mjet për t'i arritur të mirat e botës tjetër

Imam Shatibiju thotë: “Interesat e pranuar me sheriat dhe të këqijat e refuzuara nga sheriat konsiderohen si plotësuese për ta fituar jetën e botës tjetër, kurse këto interesa nuk bazohen në hamendjen, pasionet e njerëzve se çka është e dobishme dhe se çka është e dëmshme në jetën e tyre të rëndomtë”.

Kuptimi i kësaj fjale është se feja islame i përcakton interesat-dobitë e robërve, i ka ligjësuar dispozitat dhe mënyrat e realizimit të këtyre interesave dhe synimi i të gjitha këtyre është përgatitja e njerëzve për arritjen e lumturisë në botën tjetër-ahiret. Interesat e dobishme të kësaj bote, në fakt nuk janë të kërkuara vetë për realizimin e interesave të kësaj bote, por që këto të jenë mjete për të arritur dobirë të mirat e botës tjetër ahiretit. Çfarëdo që i kundërvihet arritjes së lumturisë në botën tjetër duhet braktisur e mënjeluar, ndërsa çdo gjë që shpie deri te lumturia në botën tjetër duhet vepruar dhe duhet dhënë përparësi. Po ashtu nuk duhet lënë mangët diç që ka të bëjë me botën tjetër për shkak të dobive kalimtare të kësaj bote: ***“E për sa i përhet atij që ka tepruar. Dhe i dha përparësi jetës së kësaj bote, xhehenemi do tëjetë vendi i tij. E kush iu fihësua paraqiq'es para Zotit të vez dhe e ndaloj veten prej epsheve, xheneti është vendi i tij”***.⁵⁶² Mu për këtë imam Shatibiju në librin e tij “El-Muvafekat” ka thënë: “Interesat dhe synimet e botës tjetër duhet të jenë gjithmonë parësore përballë interesave dhe synimeve të kësaj bote, ky është mendim unanim. Pra, nuk duhet dhënë pas interesave të kësaj bote duke i lënë anash interesat e botës tjetër, ngase është e qartë se çdo veprim që është kundër interesave të ahiretit është i papranueshëm nga synimet e Ligdhënësit, andaj edhe veprimet e tilla janë të kota”.

Pra, është e ndaluar që t’i jepet përparësi kësaj bote ndaj botës tjetër, ndërsa lejohet të shfrytëzohet kjo botë për ta fituar ahiretin. Allahu i Lartësuar ka thënë: ***“Dhe me atë që të ha dhënë Allahu, kërko (ta fitosh) botën tjetër, e mos lër mangët atë që të takon nga kjo horë... ”*** Kjo botë është punishte e ahiretit dhe të mirat e saj janë mjet për të arritur deri në fitimin e ahiretit, andaj nuk lejohet të shkatërrohet kjo punishte, nuk duhet dalë prej saj duke ikur, ngase njeriu ka ardhur që të bëjë në të punë të mira, të furnizohet me devotshmëri dhe ta kalojë jetën me devotshmëri. Mirëpo, njeriu nuk duhet ta harrojë këtë detyrë dhe t’i bëhet atij kjo botë synimi dhe qëllimi kryesor, ngase Allahu ka dashur që kjo botë të jetë mjet për ta fituar ahiretin e jo t’i bëhet rivalitet asaj. Kur të vijnë në mospajtim të mirat e kësaj bote me të mirat e botës tjetër, atëherë duhet dhënë përparësi interesave të botës tjetër, pa kurrfarë keqardhjeje, ngase në këtë nuk ka kurrfarë të keqe dhe kurrfarë humbjeje. Vërtet interesat e mëdha gjithmonë kanë përparësi ndaj interesave të vogla, sipas këndvështrimit islam dhe të atyre që janë të mençur, andaj interesat e botës tjetër janë më të mëdha sesa ato të kësaj bote. Pa dyshim, se interesat vlerësohen sipas masës së kënaqësisë, qetësisë dhe dobisë në aspektin e kualitetit e kuantitetit dhe sipas masës së jetëgjatësisë së të mirave. Andaj, pa dyshim, se interesat e ahiretit janë më madhështore se të kësaj bote që në të dyja këto aspekte

të vlerësimit, ngase kënaqësitë, qetësia dhe dobitë e kësaj bote nuk mund të krahasohen me ato të botës tjetër as në aspektin e kualitetit e as të kuantitetit, tjetra është se kënaqësitë e kësaj bote janë të përziëra me gjëra të pista dhe të parëndësishme as në aspektin e kualitetit e as të kuantitetit. E sa i përket botës tjetër-ahiretit, kënaqësitë e saj janë të pastra nga çdo mangësi, të vetme në aspektin e llojit dhe formës, në të ka kënaqësi që nuk i ka parë syri, e as nuk i ka dëgjuar veshi dhe as që i ka përjetuar zemra e njeriut, në të është kënaqësia e Allahut, shikimi në Fytyrën e Tij Fisnike, të afruarit afër Tij në xhenetit e begatshme. Të gjitha këto begati të mëdha kurrsesi nuk mund të krahasohen me begatitë e kësaj bote. Ndërkaq në aspektin e përjetësisë së begatitë, dihet se lumturia dhe kënaqësitë e botës tjetër janë të përhershme, ndërsa kënaqësitë e kësaj bote janë të përkohshme të cilat përfundojnë me përfundimin e jetës së njeriut. Nëse supozojmë ne duke thënë se njeriu gjatë gjithë jetës së tij në këtë botë ka qenë i kënaqur me kënaqësitë e kësaj jete të shkurtër, atëherë me çfarë proporcioni mund ta vlerësojmë lumturinë e kësaj bote të shkurtër me botën tjetër të përhershme dhe të pafund? Myslimani i mençur nuk mund t'i japë përparësi jetës së kësaj bote ndaj botës tjetër asnjëherë, ngase feja e urdhëron që t'i japë përparësi botës tjetër, llogaria i përcakton këtë dhënie të përparësisë dhe se interesat e njeriut janë ato që ftojnë për një përparësi të atillë. Kjo, pra, është vërteta, e pos kësaj çdo gjë është humbje, injorancë dhe shkatërrim i haptë.

Përkufizimi i thirrësit në fenë e Allahut (Da'iu).

1- Thirrësi parë

Thirrësi parë për në fenë e Allahut, pasi që Allahu i Lartësuar na begatoi me fenë islame, është i Dërguari ynë fisnik, Muhamedi salAllahu alejhi ue sel-lem Allahu i Lartësuar ka thënë: ***“O ti Pejgamber, Ne të dërguam ty dëshmuës, sihariqtar e qortues. Dhe me urdhrin e Allahut, thirrës për në rrugën e Tij dhe pishtar ndriçues”***. Kurani Fisnik e ka përsëritur urdhrin drejtuar të Dërguarit salAllahu alejhi ue sel-lem që të thërrasë në rrugën e Allahut vazhdimisht, e të mos largohet prej kësaj detyre asnjëherë. Allahu i Lartësuar ka thënë: ***“E ti thirri te Zoti yt, se pa dyshim ti je në një rrugë të drejtë”***. ***“Dhe ti thirr te Zoti yt e kursesi mos u bëj pasues i dëshirave të idhujtarëve ”***. ***“Thuaj: Unë jam urdhëruar që ta adhuroj vetëm Allahun, e të mos i bëj shok Atij. Unë vetëm tek Ai thërras (njerëzit) dhe vetëm tek Ai është kthimi im”***. I Dërguari i Allahut salAllahu alejhi ue sel-lem ka thirrur tek Allahu i Lartësuar derisa ka vdekur dhe ka shkuar te Krijuesi i tij i kënaqur me Të, Allahu e pastë shpërblyer për punën e tij që e ka bërë për besimtarët myslimanë.

2- Thirrja tek Allahu është misioni detyra e të dërguarve të Allahut

Thirrja tek Allahu është misioni i të gjithë të dërguarve të Allahut, ata janë dërguar te njerëzit për shkak të këtij misioni. Që të gjithë të dërguarit salAllahu alejhi ue sel-lem i kanë thirrur popujt e tyre në besimin e vetëm tek Allahu në mënyrë që vetëm Ai të adhurohet. Allahu i Lartësuar përmend atë që i ka thënë Nuhu a.s. popullit të tij: ***“Ne e patëm dërguar Nuhun te populli i vet, ndërsa ai tha: O populli im, adhurojeni Allahun, nuk keni zot tjetër por Tij. Unë kam frikë për dënimin tuaj në një ditë të madhe.”*** Po ashtu përmend atë që i ka thënë Hudi a.s. popullit të tij: ***“Edhe tek (populli) Adi (dërguam) nga mesi tyre Hudin që tha: O populli im adhuroni Allahun. ju nuk keni zot tjetër pos Ti ', ju vetëm po hutoheni me trillime ”***. Përmend Salihin a.s.: ***“Edhe te (populli) Themud ua dërguam vëllanë e tyre, Salihun, e ai u tha: “O populli im, besojeni Allahun (Nje) nuk keni zot tjetër pos Tij.”; e përmend Shuajbin a.s.: “E në Medjen (dërguam) vëllanë e tyre Shuajbin. Ai tha: O populli im, adhurojeni Allahun (Një), ju nuk keni zot tjetërpos Tij ”***.

Kështu që të gjithë të dërguarit kanë thirrur tek Allahu, që vetëm Ai të adhurohet dhe për largimin nga adhurimi i kujtdo tjetër pos Allahut. Allahu i Lartësuar ka thënë: ***“Ne dërguam në çdo popull të dërguar që t’u thonë: Adhurojeni vetëm Allahun, e largojuni Tagutit (adhurimit të tij)”***. Që të gjithë të dërguarit janë thirrës tek Allahu dhe se Allahu këta i ka zgjedhur që t’i ftojnë njerëzit për në rrugën e Allahut të Lartësuar.

3- Umeti janë bashkëmisionorë të të dërguarit të tyre në thirrjen për tek Allahu

Kemi përmendur në paragrafët e mëhershëm se thirrësi i parë tek Allahu i Lartësuar është i Dërguari ynë salAllahu alejhi ue sel-lem dhe po ashtu kemi përmendur *ajetet* fisnike, të cilat e urdhërojnë të Dërguarin salAllahu alejhi ue sel-lem që të ftojë tek Allahu dhe në normën e këtyre ajeteve hyjnë që të gjithë myslimanët, ngase në parim çdo urdhër qëi drejtohet të Dërguarit salAllahu alejhi ue sel-lem i përfshin edhe myslimanët vetëm në rast të ndonjë përjashtimi, por urdhri për të thirrur tek Allahu është gjithëpërfshirës, d.m.th. Allahu i Lartësuar e ka nderuar umetin islam dhe e ka respektuar atë duke e bërë bashkëmisionar të të Dërguarit salAllahu alejhi ue sel-lem në obligimin e thirrjes për tek Allahu. Ky nderim dhe respektim nuk kuptohet vetëm nga urdhrat hyjnorë që i drejtohen të Dërguarit salAllahu alejhi ue sel-lem, por ky respekt shihet nga *ajetet* e shumta kuranore. Allahu i lartësuar ka thënë: ***“Ju jeni populli më i dobishëm, i ardhur për të mirën e njerëzve, të urdhëroni për mirë, të ndaloni nga veprat e këqija”***. Ky ajet i shpreh dy kuptime: kuptimi i parë është se ky umet është më i miri, ndërsa kuptimi i dytë është se ky umet është më i dobishmi për shkak se i fton njerëzit në të mira dhe i pengon prej të këqijave. E kjo detyrë është misioni i të Dërguarit të Allahut salAllahu alejhi ue sel-lem dhe e të gjithë të dërguarve të Allahut. Çështja e parë që ka të bëjë me institucionin e urdhërimit në të mira dhe të pengimit prej të këqijave është thirrja tek Allahu dhe largimi nga të gjitha llojet e idhujtarisë. Jo vetëm kaq, por Kurani Fisnik, si njëri prej cilësive të besimtarëve, e konsideron thirrjen për tek Allahu, ndërsa në të kundërtën hipokritët janë ata që pengojnë për të ecur në rrugën e Allahut dhe thërrasin në rrugë tjetër. Allahu i Lartësuar ka thënë: ***“Hipokritët dhe hipokritet janë si njëri-tjetri; urdhërojnë për të keqen dhe ndalojnë nga e mira ”***, e më pastaj Allahu i Lartësuar ka thënë:

“...besimtarët dhe besimtare janë të dashur për njëri-tjetrin, urdhërojnë për të mirë e ndalojnë nga e keqja... ”.

Kurtubiju në komentimin e këtij ajeti thotë: “Allahu i Lartësuar ka bërë urdhërimin në të mira dhe pengimin prej të këqijave një tipar që i dallon besimtarët nga hipokritët dhe në mënyrë të veçantë argumenton atë se njëra prej cilësive të veçanta të besimtarëve është urdhërimi në të mira dhe pengimi prej të këqijave dhe se kulmi i kësaj është thirrja për në fenë islame’. Kësaj mund t’ia shtojmë atë se Allahu i Lartësuar me këtë ajet i përshkruan cilësitë e umetit islam, ashtu si është cilësuar edhe i Dërguari i Allahut salAllahu alejhi ue sel-lem Allahu i Lartësuar për të Dërguarin e Tij thotë: “E që i urdhëron ata për çdo të mirë dhe i ndalon nga çdo e keqe, na lejon ushqimet e këndshme dhe ua ndalon ato të pakëndshme.

4- Kush është i ngarkuar që të thërrasë tek Allahu

Nga ajo gjithë që u përmend bëhet e qartë se ai që është i ngarkuar të thërrasë tek Allahu është çdo mysliman dhe myslimane që ka hyrë në moshën madhore, por edhe që është i aftë psikikisht ngase këta janë ajo pjesë e umetit që ngarkohet me këtë mision. Pra, umeti islam është i obliguar me këtë detyrë pavarësisht gjininë nëse është fjala për mashkull apo për femër. Kjo nuk është e nderlidhur në mënyrë të veçantë me dijetarët ose -klerikët siç quhen të krishterët -, ngase ky obligim është për të gjithë. Dijetarët mund të veçohen në kumtimin e disa detajeve dhe koncepteve të thella të fesë për shkak të horizonteve të gjera të dijes së tyre. Atë se ky obligim është si për mashkullin ashtu edhe për femrën e bën shumë më të qartë fjala e Allahut: ***“Thuaj: “Kjo është rruga ime, e vënë në fakte të qarta e që unë thërras tek Allahu, unë dhe ai që vjen pas meje. Larg të metave është Allahu, e unë nuk jam nga idhujtarët”.*** Ithtarët e të Dërguarit salAllahu alejhi ue sel-lem besimtarët janë ata që thërrasin tek Allahu me fakte të qarta, sikurse ishte i Dërguari i Allahut salAllahu alejhi ue sel-lem që gjithmonë ka thirrur për tek Allahu me fakte të qarta. Nga kjo kuptohet se prej çështjeve të domosdoshme të besimit është që myslimani të thërrasë tek Allahu, e nëse ai tregon neglizhencë për këtë thirrje është një argument se tek ai ka mangësi të besimit imanit, andaj i tilli duhet të mendojë për zbatimin e këtij obligimi, d.m.th. obligimin për të thirrur tek Allahu. Imam Ibn Kethiri, në komentimin e këtij ajeti, ka thënë: “Allahu i Lartësuar në këtë ajet i ka thënë të Dërguarit të Tij që t’i informojë njerëzit se kjo rrugë është thirrja që të dëshmohet se nuk ka Zot tjetër pos të vetmit Allah që nuk ka rival dhe se ky i thërret njerëzit në bazë të fakteve të qarta dhe po kështu

veprojnë edhe ata që i ndjekin ata besimtarët, d.m.th. edhe këta thërrasin për tek Allahu mbi bazën e fakteve të qarta, qofshin ato fakte të sheriatit apo logjike”.

Gjithashtu, në hadithin e të Dërguarit s.a.v.s, të cilin e transmeton imam Buhariu nga Ibn Abasi radijAllahu anhu, është transmetuar se i Dërguari salAllahu alejhi ue sel-lem ka thënë: *“Le t’ia transmetojë dijen ai që është prezent atij që nuk është prezent”*. Në hadith me fjalën “ai që është prezent” nënkuptohet çdo mysliman që di diçka për islamin.

Thirrja për tek Allahu është obligim për çdo mysliman dhe myslimane. Kjo thirrje mund të bëhet në mënyrë individuale dhe kolektive, apo më fjalë të tjera: ky obligim mund të kryhet në dy mënyra: në atë individuale duke u angazhuar secili mysliman në mënyrë individuale dhe e dyta është kur dikush në suaza të kolektivit thërret për tek Allahu i Lartësuar. Këtë e argumenton fjala e Allahut të Lartësuar: ***“Nga ju le tëjetë grup që thërret në atë që është e dobishme, urdhëron për punë të mbara dhe ndalon nga e heqja. Të tillët janë ata të shpëtuarit.”***

Ibn Kethiri, në komentimin e këtij ajeti, ka thënë: “Qëllimi i këtij ajeti është që një grup prej umetit të jetë që merret me këtë çështje (*davet*) edhe nëse kjo është detyrë për çdo pjesëtar të umetit në mënyrë të veçantë. Sikundër përmendet në Sahihun e Muslimit nga Ebu Hurejra radijAllahu anhu se si i Dërguari i Allahut salAllahu alejhi ue sel-lem ka thënë: *“Kush sheh prej jush ndonjë të keqe, le ta ndryshojë me dorë (forcë) , e nëse nuk mundet me dorë atëherë le ta ndryshojë me gjuhë e nëse edhe kështu nuk mund, atëherë le të reagojë vetëm me zemër, por ky është besimi më dobët”*. Në fakt bashkimi i thirrëseve për ta kryer detyrën e thirrjes në mënyrë kolektive është diçka e domosdoshme sa herë që shtohet nevoja e domosdoshme për të bërë thirrje për tek Allahu. Sikur të dëshirohej që të përhapej thirrja në Allahun nëpër shoqëritë idhujtare, në të cilat ka bërë strofëllin e vetë shejtani dhe ka lëshuar vezë në të duke penguar banoret e atij vendi që të ndjekin rrugën e Allahut dhe i ka kthyer ata në gjërat e ndyta të idhujtarisë, ashtu sikurse është vepruar nëpër shumë vise të Afrikës e të ngjashme. Shembujt e këtyre vendeve kanë nevojë për një angazhim shumë të madh me qëllim të përhapjes së thirrjes islame dhe të përhapjes së mësimave të saj. E gjithë kjo kërkon angazhim të madh sa që individi i vetëm s’mund ta përballojë, por edhe një grup individësh nuk mund t’i bëjnë ballë gjithë kësaj. Thirrja islame kërkon që të veprohet në mënyrë kolektive dhe këtë e argumenton vetë suneti i të Dërguarit të Allahut s.a.v.s, i cili e urdhëronte secilin mysliman që e pranonte fenë islame të shkonte në Medinë me qëllim që ta bashkojë mundin-angazhimin e tij me

angazhimin e të gjithë myslimanëve dhe që të orientohet në drejtim të saktë, ashtu siç i orientonte i Dërguari i Allahut salAllahu alejhi ue sel-lem

Po ashtu këtë veprim kolektiv e gjejmë të sqaruar edhe në fjalën e Allahut të Lartësuar: **“Ndihmohuni mes vete me të mira dhe në të mbara, e mos ndihmoni në gjynahe e armiqësi ”** Pra, ky është një argument tjetër që argumenton legalitetin e zbatimit të *da'ves* në mënyrë kolektive, por ka raste kur është i domosdoshëm ky veprim kolektiv, sidomos kur nuk mund të arrihet mirësia e plotë pos me përkrahje kolektive. Sipas asaj që transmeton El-Xhesasi, Ebu Hanifeja radijAllahu anhu ka pasur në konsideratë atë që doemos duhet bashkuar në mënyrë kolektive për të urdhëruar në të mirë dhe për të penguar nga e keqja dhe duhet orientuar për angazhim kolektiv me qëllim të realizimit të këtij synimi (*daves*).

5- Dyshimet dhe kundërshtimet

Disa supozojnë se thirrja në rrugë të Allahut nuk është obligim për secilin mysliman, ngase të gjithë nuk janë dijetarë të fesë dhe ky obligim është *farzi kifaje* (obligim që nëse dikush e kryen të tjerët lirohen), andaj për këtë janë të obliguar vetëm dijetarët e jo të gjithë myslimanët. Këtë e argumenton fjala e Allahut të Lartësuar: **“Nga ju le të jetë një grup që thërret në atë që është e dobishme, urdhëron për punë të mbara dhe ndalon nga e keqja. Të tillët janë ata të shpëtuarit”**.

Përgjigjja për këtë është sipas asaj që transmetua prej Ibn Kethirit, ku u pa se komenti i këtij ajeti është: “Që një grup nga ky umet duhet të merret me çështjen e thirrjes tek Allahu (*daveti*), edhe nëse ky obligim është për çdo individ të këtij umeti”. Mirëpo, për komentimin e këtij ajeti dijetari Rraziu komenton kështu: në këtë ajet për kuptimin e pjesëzës “prej jush- منكم” shprehen dy mendime: mendimi i parë është se nuk e ka kuptimin e shkëputjes, e kjo argumentohet me dy argumente: i pari, është ai se Allahu i Lartësuar e ka obliguar urdhërimin në të mira dhe pengimin prej të këqijave për secilin individ të umetit: **“Ju jeni populli më i dobishëm, i ardhur për të mirën e njerëzve, të urdhëroni për mirë dhe të ndaloni nga veprat e keqja”**.

Ndërkaq, argumenti i dytë është se nuk ka asnjë një njeri që është mukel-lef (i ngarkuar me obligime fetare) e që nuk është i obliguar me detyrën e urdhërimit në të mira dhe pengimit nga këqijat, pavarësisht nëse kjo detyrë kryhet me dorë (forcë), apo me gjuhë, apo me zemër, andaj çdonjëri e ka për obligim ta pengojë

çdo të keqe që e dëmton jetën. Kur kjo të vërtetohet ne themi: Pra, kuptimi i këtij ajeti është ky: bëhuni umet që ftoni në të mira duke urdhëruar në të mira dhe duke penguar prej të këqijave. E sa i përket pjesës (prej jush) këtu në këtë ajet e ka kuptimin e sqarimit e jo të shkëputjes-participimit, sikurse është ajeti: ***“Pra, largohuni prej ndyrësirave të idhujve”***.

E pastaj Rraziu përmend mendimin e dytë “se pjesëza “prej - من” se e ka kuptimin e shkëputjes -participimit të kuptimit dhe ngushtimit të obligimit, ngase në mesin e popullit ka të tillë që nuk kanë aftësi që të urdhërojnë në të mira dhe të pengojnë prej të këqijave. Më pastaj për këtë mendim ai thotë: vërtet ky obligim është i posaçëm për dijetarët, ngase thirrja për vepra të mira kushtëzohet posedimi i diturisë për të se çka është e mirë e çka është e keqe. Është e vërtetuar se ky obligim u është drejtuar dijetarëve e jo injorantëve, ndërsa dijetarët janë pjesë e umetit.” Po me të njëjtin kuptim përmenden edhe dy mendime në komentimin e këtij ajeti. Në tefsirin e Kurtubijut dhe të Xhesasit përmendet ajo se mendimi që e ka përmendur Rraziu është më i saktë pasi që ky mendim argumentohet. Po ashtu, ajo që përmend Ibn Kethiri e të cilin mendim e kemi përmendur më lart, i cili konsideron se detyra e thirrjes tek Allahu është obligim i çdo individit duke qenë obligim që të ekzistojë një grup që do të merren me çështjen e thirrjes për në punë të mira. E vërteta këtu është se mospajtimi rreth kuptimit të fjalës “dijetar” që komentohej në pjesën e ajetit ***“le të jetë prej jush një grup”*** duke pasur në konsideratë atë se ai që thërret në vepra të mira kushtëzohet që të jetë i ditur. Shkaku i dytë i paqartësisë është në atë se kjo ka të bëjë në kuptimin e *farzit kifaje* (obligim kolektiv). Andaj, është më së e domosdoshme që të shpjegohen këto dy çështje, ndërsa ne për këtë themi:

Pa dyshim se thirrja për në vepra të mira është shkalla më e lartë e thirrjes tek Allahu dhe se kushtëzohet që të kihet dituri, por dituria nuk është diçka që nuk mund të ndahet në disa degë, ngase vetë natyrshmëria e diturisë është që jetë e degëzuar dhe e ndarë në disa pjesë. Pra, ka mundësi që diçka të dihet e diçka të mos dihet, e në këtë rast njeriu për çështjen e parë është dijetar, ndërsa për çështjen e dytë injorant. Kuptimi i kësaj është se në çështjen e parë është ajo e dijetarëve, ku njeriu është i obliguar të ftojë në atë për të cilën ka njohuri e jo për atë që është injorant, për këtë janë unanimitë të gjithë juristët myslimanë. Duke u bazuar në këtë, na del se çdo mysliman thërret për tek Allahu sipas asaj sa ka dituri, ndërsa këtë do ta shpjegojmë më vonë. Ky kuptim i kësaj çështjeje është synimi i fjalës së atyre që thonë: thirrja për tek Allahu është obligim vetëm për dijetarët e jo për të tjerët, d.m.th. është obligim për atë që e njih çështjen dhe dispozitën e saj për të cilën

thërret, por pavarësisht nëse ky që thërret është prej myslimanëve të rëndomtë apo individ që ka arritur gradë të lartë të diturisë. Me këtë hidhet poshtë mendimi i atyre që thonë se me dijetarët nënkuptohen vetëm ata që janë studiues të çështjeve fetare, apo siç emërohen ata njerëz të fesë. Ky emërtim mund ti jepet çdo myslimani, duke ditur se çdo mysliman është prej njerëzve të fesë islame e nuk duhet përkufizuar vetëm për një grup të caktuar. Çështja e dytë, e cila e shkakton këtë paqartësi është kuptimi i farzi kifajes, ku me këtë farz synohet ajo që nëse dikush e kryen obligimin të tjerët lirohen prej atij obligimi edhe nëse obligimi i përfshin që të gjithë myslimanët. Rraziu ka thënë: “Pastaj kanë thënë d.m.th. atë që kanë thënë se thirrja tek Allahu është obligim për secilin dhe se pjesëza “prej tyre” e ka kuptimin e shpjegimit edhe nëse kjo është obligim për secilin, por nëse këtë detyrë e kryen dikush, të tjerët lirohen nga ajo detyrë. Kjo kuptohet kur krahasohet çështja me ajetin: “Dilni në luftë , le tju vijë lufta e lehtë ose e rëndë” dhe me ajetin: 'Nëse nuk dilni (në luftë) Ai do tju dënojë me një dënim të rëndë". Urdhri në këto ajete është i përgjithshëm, që nëse dikush e kryen të tjerët lirohen nga ky obligim. Xhesasi kur flet për komentimin e e ajetit: ***“Nga ju le të jetë një grup që thërret në atë që është e dobishme, urdhëron për punë të mbara dhe ndalon nga e keqja. Të tillët janë ata të shpëtuarit”***. thotë: ky ajet ka dy kuptime: i pari është obligimi i urdhërimit në të mira dhe pengimit prej të këqijave, ndërsa kuptimi i dytë është se urdhërimi në të mira dhe pengimi prej të këqijave është fatzi kifaje, që nëse dikush e kryen tjetri lirohet prej obligimit. Shprehja e këtij dijetari-Xhesasit: se urdhërimi në të mira dhe pengimi prej të këqija nuk është obligim për secilin nëse dikush e kryen këtë detyrë, me këtë shpjegohet qëllimi i *farzi kifajes* që nëse dikush e kryen të tjerët lirohen nga ky obligim, e që është krejtësisht ndryshe me *farzi ajnin* (obligimin e prerë individual), ngase ky obligim duhet doemos të kryhet nga secili individualisht. Atëherë, sipas kësaj thirrje tek Allahu, e cila është thirrja më e mirë, është obligim për çdo mysliman, sipas mundësive që i ka, ngase detyra e thirrjes tek Allahu është njëra prej cilësive të besimtarëve. Tjetra është se edhe hadithi i të Dërguarit salAllahu alejhi ue sel-lem urdhëron çdo mysliman dhe myslimane që të mënjanojë të keqen sipas mundësive që i ka, e kur nga dikush eliminohet e keqja, atëherë s’ka nevojë që të tjerët prapë të angazhohen për mënjanimin e të keqes dhe se për këtë nuk do të merren në përgjegjësi të tjerët. Mirëpo, puna është se çdo mysliman duhet të nxitojë për zbatimin e detyrës së urdhërimit në të mira dhe pengimit prej të këqijave, duke mos pritur që tjetri ta kryejë këtë detyrë, ngase ka mundësi të mos e kryejë tjetri e ai më pas të bjerë në gjynah. Po ashtu, myslimani thërret tek Allahu duke pasur në konsideratë se ai është mysliman dhe besimtar në Allahun dhe në të Dërguarin e Tij, gjë që ne e

kemi përmendur. Allahu i Lartësuar ka thënë: ***“Thuaj: Kjo është rruga ime, e vënë në alete të qarta, e unë thërras tek Allahu, unë dhe ai që vjen pas meje. Larg të metave është Allahu, e unë nuk jam nga idhujtarët”.***

Pra, patjetër, myslimani duhet të thërrasë tek Allahu, e po qe se myslimani ka mundësi për të thirrur tek Allahu, por nuk e thërret asnjë person dhe në asnjë kohë duke ia lënë këtë detyrë ndonjë myslimani tjetër, atëherë ai që e kryen këtë detyrë merr shpërblim, ndërsa ky jo, e nëse ky e braktis thirrjen për tek Allahu përgjithmonë me paramendim, atëherë ky nuk përfshihet në kuptimin e fjalës së Allahut: ***“Thuaj: .Kjo është rruga ime, e vënë në alete të qarta, e unë thërras tek Allahu, unë dhe ai që vjen pas meje. Larg të metave është Allahu, e unë nuk jam nga idhujtarët ”***, ngase ata që e pasojnë të Dërguarin e Allahut salAllahu alejhi ue sel-lem thërrasin për tek Allahu.

Prej asaj se si konceptohet *farzi kifaje* u është përcaktuar detyra të gjithëve për ta kryer këtë farz dhe se ai që i ka mundësitë duhet menjëherë të angazhohet për ta kryer këtë obligim. Pra, kuptimi i ajetit: “Nga ju le tëjetë grup që thërret në atë që është e dobishme, urdhëron për punë të mira dhe ndalon nga e keqja. Të tillët janë ata të shpëtuarit”. Myslmani duhet të angazhohet për të përgatitur një grup prej tyre që të kryejnë detyrën e thirrjes tek Allahu, që t’iu ndihmojnë atyre me të gjitha mjetet për ta realizuar qëllimin e detyrës së tyre, zbatimin e fesë dhe përhapjen e thirrjes islame. E nëse këtë nuk e bëjnë myslimanët, atëherë që të gjitha këta do të jenë gjynahqarë, pavarësisht nëse ky mysliman është i aftësuar profesionalisht për thirrje tek Allahu apo jo”

Gjithashtu thuhet: vërtet thirrja te Allahu është një obligim i caktuar për disa nga shoqëria duke pasur në parasysh faktin se ky obligim është *farzi kifaje* dhe se në *farzin kifaje* është kusht që dikush ta kryejë këtë detyrë, ashtu që të tjerët të je në të lirë nga ky obligim, e po qe se askush nuk angazhohet për ta kryer këtë detyrë. atëherë secili mysliman sipas mundësive duhet ta kryejë këtë obligim. Veçanërisht. në kohën tonë, kur idhujtaria dhe ateizmi i ka përfshirë shumë shoqëri në Afrikë. Amerikë dhe në shumë vise të tjera, vërtet përhapja e thirrjes tek Allahu në këto shoqëri kërkon angazhim të madh, duke marrë pjesë në këtë çdo mysliman, sipas mundësive që ka, qoftë me pasuri, me shpjegime, me ide dhe me fuqi.

Ka disa që pretendojnë të justifikojnë iluzionin e tyre duke arsyetuar me ajetin: ***“O ju që besuat, ruajeni veten tuaj! Ai që ka humbur, nuk ju dëmton juve kur jeni në rrugë të drejtë... ”***. Duke u bazuar në këtë ajet, sipas iluzionit të tyre, mundohen të lirohen nga obligimi i thirrjes tek Allahu dhe për të arsyetuar mosangazhimin,

duke bërë iluzione se ky ajet fisnik kuptohet se ata janë të liruar nga obligim i thirrjes tek Allahu, përderisa ai të jetë i mirë dhe i udhëzuar në rrugën e Allahut. Ky iluzion ishte infiltruar edhe te disa në kohën e Ebu Bekrit radijAllahu anhu, atëherë Ebu Bekri ua mbajti një fjalim njerëzve duke u thënë: “O ju njerëz, ju po e lexoni këtë ajet dhe po e kuptoni gabimisht: Oju që besuat, ruajeni veten tuaj! Ai që ka humbur nuk ju dëmton juve kur jeni në rrugë të drejtë... , se unë e kam dëgjuar të Dërguarin e Allahut salAllahu alejhi ue sel-lem duke thënë: vërtet njerëzit kur shohin tiraninë dhe nuk e pengojnë atë, atëherë pritet që të gjithë t’i përfshijë dënimi i Allahut.

Këtu duhet pasur parasysh atë se vetë ajeti e përcakton detyrën e thirrjes tek Allahu i Lartësuar për çdo mysliman dhe në të njëjtën kohë e hedh poshtë iluzionin-pretendimin e atyre që nuk e kryejnë këtë detyrë. Kur Allahu i Lartësuar thotë në këtë ajet: “kur ju jeni në rrugë të drejtë”, e të qenët në rrugë të drejtë, sipas Ibn Tejmijes, është kështu: “Të qenët në rrugë të drejtë realizohet duke e kryer obligimin. Prandaj, kur myslimani e kryen detyrën e tij për të urdhëruar në të mira dhe për të penguar prej të këqijave dhe të gjitha obligimet e tjera, atëherë atë nuk e dëmton devijimi i të tjerëve”.

Po ashtu disa kapen për një dyshimi tjetër se kinse e keqja është përhapur kudo në tokë dhe më nuk bën kurrfarë dobie thirrja në rrugë të Allahut, andaj myslimanit nuk i ka mbetur tjetër pos të preokupohet vetëm për vetveten e tij.

Përgjigjja ndaj këtij dyshimi është se myslimani e ka për obligim që ta kryejë detyrën e thirrjes tek Allahu, pavarësisht nëse e arrin qëllimin dhe nëse i përgjigjen njerëzit. Ky dyshim ka qenë edhe të popujt e mëhershëm për të cilët na ka treguar dhe se si thirrësit tek Allahu e kanë larguar këtë dyshim. Allahu i Lartësuar ka thënë: ***“Dhe kur një grup prej tyre thanë: Përse këshilloni një popull që Allahu do ta shkatërrojë ose dënojë me një dënim të ashpër? Thanë (këshilluesit): Arsyetim para Zotit tuaj dhe me shpresë që t’u largohen gabimeve. E kur e braktisën atë për të cilën ishin këshilluar, Ne i shpëtuam ata që pengonin nga të këqijat, ndërsa ata që kundërshtuan i kapëm me një dënim të fortë, ngase ishin të shfrenuar”***. Ajeti fisnik përmend se banorët e këtij vendi ishin ndarë në tre grupe: grupi që kanë bërë të këqija, grupi që i ka këshilluar ata dhe grupi që kanë heshtur, duke mos vepruar as që kanë penguar por që u kanë thënë: Përse këshilloni një popull që Allahu do ta shkatërrojë ose dënojë me një dënim të ashpër?”d.m.th. nuk i keni penguar dhe e keni ditur se ata janë të shkatërruar dhe që kanë merituar dënimin e Allahut, andaj nuk ka dobi pengimi i tyre nga ana juaj,

ndërsa ata që këshillonin për të penguar të keqen janë përgjigjur saktë: “Arsyetim para Zotit tuaj ” e që d.m.th. ne e kryejmë detyrën tonë të urdhërimit në të mira dhe pengimit prej të këqijave dhe këtë e kemi si arsyetim para Zotit tonë, ne nuk kemi tjetër mundësi pos që të thërrasim tek Allahu këta gjynahqarë që të largohen prej gjynahut të tyre dhe që të pendohen tek Zoti i tyre. “Dhe me shpresë që do t’u largohen gabimeve” d.m.th. ne shpresojmë që me thirrjen tonë ata do të pendohen dhe do t’i përgjigjen thirrjes“. Këtu jepet qartë sinjali se vazhdimisht ka mundësi të pranohet thirrja, andaj vazhdimisht duhet këshilluar, udhëzuar dhe thirrur për tek Allahu për ta shpëtuar atë që i pranon argumentet dhe për t’u shkatërruar ai që i mohon faktet e qarta.

E ka disa të tjerë që marrin si pretekst një dyshim tjetër duke e kuptuar gabimisht ajetin fisnik: ***“Allahu nuk e obligon asnjë njeri përtej mundësisë së tij”***.

Këta arsyetohen se thirrja në fenë e Allahut po shkakton lodhje dhe mundim që ata nuk po mund ta përballojnë. Në fakt ky është një argument se besimi i tyre është i dobët. ngase krahasuar me lodhjen për të cilën supozojnë, ata kanë më shumë lodhje në angazhimin e tyre të fitimit për nevojat e jetës, e cila është kalimtare sesa që kanë lodhje në thirrjen tek Allahu, e që në këtë lodhje ka shpërblim të madh për ta. Realisht lodhja e pretenduar është e lehtë dhe e thjeshtë, vallë a është lodhje e madhe që injorantit t’i mësohen mësimet islame, apo në prezantimin e mësimëve islame atij që është jobesimtar, i cili nuk ka dëgjuar për fenë islame? Vallë a ndihet lodhje në lëvizjen e gjuhës për të shprehur fjalë të mira, apo në të medituarit për fenë islame? Vallë, a ndien lodhje të madhe kur lehtësohet udhëtimi deri të shoqëritë pagane që të thërrasin në fenë e Allahut? A nuk shikojnë këta se si veprojnë klerikët e krishterë, të cilët shkojnë në këto shoqëri dhe atje kalojnë vite të tëra? Pa dyshim se myslimani është më meritator që të përhapë thirrjen për tek Allahu në mesin e këtyre paganëve dhe se ai e ka për obligim që kur shejtani të hedhë tek ai vesvesen e lodhjes dhe mundimit duhet ta rikujtojë fjalën e Allahut të Lartësuar: ***“Mos u tregoni të dobët në ndjekjen e armikut, pse nëse ndieni dhembje edhe ata ndiejnë dhembje sikur ju, e ju shpresoni nga Allahu, çka ata nuk shpresojnë”***.Pra, në këso cytje prej shejtanit, myslimani duhet të përkujtojë shokët e të Dërguarit të Allahut salAllahu alejhi ue sel-lem sesi ata i kanë përballuar sfidat e shumta për thirrjen tek Allahu dhe xhihadin e tyre që e kanë bërë për këtë rrugë (thirrjen tek Allahu). Ne po përmendim këtu si shembull ndodhitë dhe xhihadin e shokëve të Dërguarit salAllahu alejhi ue sel-lem Përmendet në librat e biografisë së të Dërguarit salAllahu alejhi ue sel-lem se i Dërguari i Allahut s.a.v.s, pasi ishte kthyer prej betejës së Uhudit në Medinë, i

kishte ardhur lajmi se Ebu Sufjani dhe idhujtarët që ishin me të kishin vendosur që t’ia mësyjnë Medinës, me qëllim që t’i shfarosin myslimanët. E pasi e fali i Dërguari i Allahut salAllahu alejhi ue sel-lem namazin e sabahut, e urdhëroi Bilalin radijAllahu anhu që të thërrasë kështu: vërtet i Dërguari i Allahut salAllahu alejhi ue sel-lem ju urdhëron që ta ndiqni armikun tuaj dhe të mos na bashkohet askush pos atij që ka qenë me ne në betejën e djeshme. Në këtë moment doli Sead ibn Muadhi dhe e urdhëroi fisin e tij që të dalin në luftë, por që të gjithë ishin të plagosur, duke u thënë: i Dërguari i Allahut salAllahu alejhi ue sel-lem ju urdhëron që të dilni e të ndiqni pas armikun tuaj. Usejd ibn Hudajri, i cili i kishte shtatë plagë e të cilat dëshironte t’i shëronte tha: e dëgjoj dhe e respektoj urdhrin e Allahut dhe të të Dërguarit të Tij, e mori armën dhe nuk u ndal për t’u shëruar, pra në këtë gjendje iu bashkëngjiti të Dërguarit salAllahu alejhi ue sel-lem Më pastaj erdhi Sead ibn Ubadeh te fisi i tij dhe Ebu Katade të një grup i myslimanëve dhe që të gjithë dolën për t’iu bashkëngjitur të Dërguarit të Allahut salAllahu alejhi ue sel-lem Nga fisi Beni Seleme dolën dyzet veta të plagosur, siç ishte Tufejl ibn Numani me trembëdhjetë plagë, Harith ibn Samti kishte dhjetë plagë dhe që të gjithë iu përgjigjen ftesës së të Dërguarit salAllahu alejhi ue sel-lem, e kur i pa këta i Dërguari i Allahut salAllahu alejhi ue sel-lem tha: “O Zoti ynë, mërshiroje fisin Beni Selimeh.

Kështu, pra, ishin shokët e të Dërguarit të Allahut a.s., kështu ishte xihadi i tyre për ta ngritur lart fjalën e Allahut! Vallë, a do t’i duket myslimanit se ka vepruar shumë kur të lodhet pak në thirrjen tek Allahu dhe në përhapjen e mësimëve e të moralit islam te njerëzit? A nuk i Vjen turp prej vetes kur t’i duket shumë një angazhim modest që e ka bërë për thirrje në fenë e Allahut, ndërsa shokët e të Dërguarit salAllahu alejhi ue sel-lem të plagosur kanë dalë në luftë duke thënë: dëgjojmë dhe i nënshtrohemi Allahut dhe të Dërguarit të Tij.

6- Arsyeja e obligimit të myslimanit që të thërrasë në rrugë të Allahut

Në paragrafët e mëhershëm i kemi përmendur argumentet e sheriatit, të cilat argumentojnë obligueshmërinë e thirrjes tek Allahu për çdo mysliman e myslimane. Kjo d.m.th. se nuk është e mjaftueshme që myslimani vetë të jetë i mirë dhe i udhëzuar, por ajo që dëshirohet prej tij është se ai duhet t’i përmirësojë të tjerët dhe t’i udhëzojë ata. Mirëpo, cila është arsyeja e gjithë kësaj? Arsyetimi i kësaj bëhet nga disa aspekte.

Aspekti i parë: vërtet Allahu i Lartësuar e dërgoi të Dërguarin e Tij për të gjithë njerëzit: *“Thuaj (Muhamed): O ju njerëz, unë jam i dërguari i Allahut te të gjithë ju”* dhe mesazhi i të Dërguarit salAllahu alejhi ue sel-lem do të qëndrojë deri në ditën e kiametit. Synimi i misionit të të Dërguarit salAllahu alejhi ue sel-lem është udhëzimi i të gjithë njerëzve, me qëllim që ata ta arrijnë lumturinë në këtë botë dhe në borën tjetër. Pa dyshim, se i Dërguari i Allahut është dërguar mëshirë për gjitha krijesat: *“E Ne të dërguam ty (Muhamed) vetëm si mëshirë për të gjitha krijesat”*.

Pa dyshim, i dërguari i Allahut salAllahu alejhi ue sel-lem e kreu misionin e tij dhe u shpërngul i kënaqur te Krijuesi i tij. andaj myslimanët patjetër duhet ta vazhdojnë misionin e tij duke e përcjellë thirrjen islame te banorët e tokës, që të udhëzohen në të dhe që të dalin nga errësira (mosbesimi) në dritë (në fenë islame). Allahu i Lartësuar ka thënë: *“Eli, lam, Ra. (Ky është) Libër Ne ta shpallëm ty që me urdhrin e Zotit t'i nxjerrësh njerëzit prej errësirave në dritë; në rrugë të Fuqplotit, të Falënderuarit.”*

Ata që thërrasin në rrugën e Allahut do të jenë dëshmitarë të Allahut ndaj krijesave të Tij dhe transmetues së mesazhit të Tij pas të Dërguarit të tyre (Muhamedit salAllahu alejhi ue sel-lem) *“Dhe ashtu (siç u udhëzuam në fenë islame) Ne ju bëmë juve një popull të drejtë (një mes të zgjedhur) për të qenë ju dëshmitarë (në ditën e gjykimit) ndaj njerëzve dhe për të qenë i dërguari dëshmitar ndaj jush..”*. Vërtet myslimani me kryerjen e detyrës së thirrjes tek Allahu, e kryen detyrën e cila e bën dobinë më të madhe për robërit e Allahut, ngase ai me këtë ua zgjat njerëzve dorën fisnike, e cila i shpëton ata nga ndytësitat e idhujtarisë dhe paganizmit, duke i vendosur në rrugën e drejtë në rrugën e Allahut, që këta t'i kryejnë detyrat që i kanë ndaj Krijuesit të tyre dhe që të realizojnë synimin për çka janë krijuar: *“Unë nuk i krijova xhinët dhe njerëzit për tjetër pos që të më adhurojnë”*.

Aspekti i dytë: ekzistimi i politeizmit dhe i mosbesimit në tokë e ka ndikimin të shpejtë apo të mëvonshëm kundër koncepteve islame në cilëndo pjesë të tokës. Andaj, për këtë feja islame e pengon myslimanin që të qëndrojë në vendin e ateizmit dhe e urdhëron atë që të drejtohet kah vendet islame me të vetmin qëllim që të mos provokohet, që të mos i dobësohet besimi, apo edhe t'i humbë krejtësisht.

Allahu i Lartësuar ka thënë: *“Engjëjt që ua morën shpirtin e atyre që ishin mizorë të vetvetes u thanë. Në çka ishit ju? -Ata thanë: Ne ishim te paaftë në atë tokë! (engjëjt) u thanë. A nuk ishte e gjerë toka e Allahut e të migronit në të? (e*

të praktikonit lirisht fenë e Zotit). Vendi i tyre është xhehenemi dhe sa vend i keq është ai!" Komentuesit e Kuranit për komentin e këtij ajeti kanë thënë: “Ky ajlet flet për secilin që është duke jetuar në vendin e politeistëve, ku nuk mund t’i zbatojë obligimet fetare, por në të njëjtën kohë ky ka mundësi të migrojë prej aty, atëherë ky është tiran i vetes dhe veprues i haramit sipas konsensusit të dijetarëve (*ixhma*)”

Imam Maliku radijAllahu anhu ka thënë: “Duhet migruar nga ai vend ku e keqja bëhet haptas dhe askush nuk e fsheh”.

Duke u bazuar në këtë na del se angazhimi i myslimanit për t’i thirrur idhujtarët dhe ateistët që të besojnë në Allahun dhe ta pranojnë fenë e Tij do të kihet dobi dhe mbrojtje prej të këqijave të ateizmit.

Aspekti i tretë: evitimi i shkatërrimit dhe dënimit ndaj myslimanëve. Allahu i Lartësuar ka thënë: ***"Ruajuni nga e keqja (nga dënimi) që nuk i godet vetëm ata që bënë mizori prej jush (por edhe të mirët) dhe ta dini se Allahu është ndëshkues i rreptë"***. Ibn Abbasi r.a. për komentin e këtij ajeti ka thënë: Allahu i ka urdhëruar besimtarët që të mos e pranojnë zbatimin e të keqes para syve të tyre, ngase dënimi i përfshin të mirët dhe të këqijtë. Në Sahihun e Muslimit transmetohet se Zejneb bint Xhahshi e kishte pyetur të Dërguarin e Allahut, duke i thënë. o i Dërguari 1 Allahut, a do të shkatërrohem edhe kur në mesin tonë ka njerëz të mirë? Ai u përgjigj: *Po, kur të shtohet e keqja*”.

7- Thirrja tek Allahu sipas gjendjes dhe aftësive të thirrësit

Pasi që u shpjegua se thirrja tek Allahu është obligim për çdo mysliman dhe se ky obligim përcaktohet sipas gjendjes dhe aftësive të thirrësit, ngase aftësia është kushti thelbësor i obligimit se ai i cili nuk ka aftësi-mundësi nuk obligohet, ndërsa ai që ka mundësi-aftësi obligohet sipas masës së aftësive-mundësive, në kuptimin e aftësive bëjnë pjesë dituria dhe fuqia.

Dijetari obligohet me diçka që nuk mund të obligohet injoranti, ai që ka forcë-pushtet obligohet me diçka që nuk mund të obligohen masa e rëndomtë e myslimanëve. Mu për këtë Allahu i Lartësuar, në mënyrë të veçantë, ua ka tërhequr vërejtjen dhe u është kërcënuar dijetarëve, po qe se ata e fshehin të

vërtetën që e njohin. Allahu i lartësuar ka thënë: ***“Ata, të cilët i fshehin argumentet dhe aktet që Ne i shpallëm, e pasi që ato ua sqaruar njerëzve në librin, të tillët i mallkon Allahu, i mallkojnë edhe ata që mallkojnë. Përveç atyre që pendohen, që përmirësohen dhe që ua shpjegojnë njerëzve të vërtetën), të tillëve ua pranoj pendimin, sepse Unë e pranoj shumë pendimin, jam mëshirues.”***

Allahu i Lartësuar i ka obliguar dijetarët që t’ua shpjegojnë njerëzve atë që kanë mësuar prej koncepteve islame, t’i shpërndajnë ato mësimë në mesin e njerëzve, me qëllim të shpëtimit të njerëzve nga mbeturinat e politeizmit. Secili që di diçka prej koncepteve islame e ka për detyrë t’ia shpjegojë tjetrit që nuk e di, ngase ditura nuk është diçka që nuk degëzohet dhe ndahet, por ajo ndahet në pjesë-pjesë. Andaj, çdo mysliman e di se Allahu është i Vetmi dhe se Muhamedi është i Dërguari i Tij, se llogaria është e vërtetë në ditën e kiametit, se Kurani është fjalë e Allahut, se Muhamedi është i Dërguari i Allahut, se namazi, agjërimi, haxhi e zekati janë prej obligimeve islame, andaj ai e ka për detyrë t’ia shpjegojë tjetrit ato, ndërsa sa u përket çështjeve që nuk i di për to nuk është i obliguar, ngase ai që nuk ka për vete ska si t’u japë të tjerëve.

Lloji i dytë i mundësisë është ajo e aspektit të pushtetit dhe forcës në tokë.

Për këtë ka dhënë sinjal Kurani Fisnik dhe i ka urdhëruar ata që e kanë këtë mundësi ta përdorin atë për të përhapur thirrjen tek Allahu i Lartësuar dhe gjallërimin e tokës me punë të mira dhe me adhurim të shprehur ndaj Allahut të lartësuar. Allahu i Madhëruar ka thënë: ***“(Ai ndihmon) Ata të cilët kur Ne u mundësojmë vendosjen në tokë, e falin namazin, japin zeqatin, urdhërojnë për të mirë dhe largojnë prej të keqes. Allahut i takon përfundimi i çështjeve”***.

Komentuesit e Kur' anit, lidhur me atë se kush janë ata që u është mundësuar vendosja në tokë, thonë: se këta janë prijësit-udhëheqësit, e disa prej dijetarëve në këtë i fusin edhe dijetarët.“

Mendimi se këta janë prijësit është mendimi më i saktë, andaj atij që i Allahu i ka dhënë pushtet dhe sundim duhet që të gjallërojë tokën me adhurim ndaj Allahut në krye të së cilës është zbatimi i namazit dhe urdhërimi në të mira e pengimi prej të këqijave, e në krye të urdhërimit në të mira është thirrja tek Allahu, ndërsa në krye të pengimit prej të këqijave është mënjanimi i politeizmit me të gjitha llojet. Ky, pra, është qëllimi i pushtetit. Dijetari i madh Ibn Tejmije ka thënë: “Vërtet detyra e

prijësit është që të urdhërojë në të mira dhe të pengojë prej të këqijave. Ky, pra, është qëllimi i pushtetit.

Një koncept të tillë të pushtetit e kanë kuptuar prijësit myslimanë në të kaluarën dhe e kanë përdorur pushtetin e tyre për të zbatuar fenë e Allahut dhe thirrjen tek Allahu.

Umer ibn Abdul Azizi u kishte shkruar funksionarëve të tij këtë shkresë: “Prej nënshtrimit ndaj Allahut është thirrja e të gjithë njerëzve në enë islame, andaj thirr në islam dhe urdhëro në të. Allahu i Lartësuar lea thënë: E hush është në rrugë më të mirë se ai që thërret në rrugën e Allahut, që bën vepra të mira dhe që thotë: Unë jam prej myslimanëve.” Në fakt, angazhimi i prijësit në zbatimin e thirrjes tek Allahu sjell shumë suksese të mëdha, ngase ai ka pushtetin dhe forcën, se në dorë të tij është urdhri dhe pengimi. Atë që ka mundësi ta bëjë prijësi për thirrje tek Allahu nuk mund të bëjë asnjëri prej myslimanëve që nuk kanë pushtet. Për këtë përmendet në ethet-fjalë të çmueshme të gjeneratës së parë se: “Allahu e pengon me forcë atë që nuk pengohet me Kuran”. Me aq sa ka mundësi myslimani për të bërë thirrje tek Allahu me aq edhe është i ngarkuar për kryer detyrën e thirrjes tek Allahu dhe për aq mundësi është përgjegjës para Tij.

8- Thirrësi për tek Allahu thërret në çdo kohë, në të gjitha gjendjet dhe rrethanat.

Ne kemi thënë se thirrja te Allahu është obligim për çdo mysliman, por obligimi i thirrjes tek Allahu nuk ka kohë të caktuar sikurse kanë namazi, agjërimi dhe se kjo detyrë duhet të kryhet në gjitha rrethanat, momentet dhe në çdo kohë kur mundësohet të kryhet kjo detyrë. Allahu i Lartësuar lajmëron për atë që ka thënë Nuh i a.s: *"Ai tha: O Zoti im, unë e thirra popullin tim natën e ditën. Mirëpo, thirrja ime vetëm sa ua shtoi ikjen. Dhe sa herë që unë i thërritja ata për t'ua falur Ti atyre gjynaheve, ata i vënin gishtat e tyre në veshë dhe mbulonin kokat me teshat e tyre dhe vazhdonin në të tyren me një mendjemadhësi të fortë. Pastaj, unë i ham thirrur ata haptazi. Pastaj unë thirrjen ua drejtoja atyre haptazi, e shumë herë dhe fshehurazi."*

I Dërguari i Allahut, Muhamedi s.a.v.s, ishte njeri që ditë e natë e thërriste popullin e tij në fe dhe nuk merrej me asgjë tjetër pos me thirrje tek Allahu i Lartësuar. Thirrësi tek Allahu, nëse është i sinqertë në kryerjen e detyrës së thirrjes tek Allahu, ai duhet të jetë i preokupuar vetëm me të, nuk duhet të mendojë asgjë pos

thirrjes tek Allahu dhe çdo lëvizje që ta bëjë duhet ta bëjë vetëm për shkak të saj. nuk duhet t'i dhimbsen as mundi e as koha dhe se nuk duhet të ndalen në asnjë moment e gjendje qoftë edhe në raste të rënda e të vështira. Kështu, ka vepruar i Dërguari i Allahut, Muhamedi salAllahu alejhi ue sel-lem, kur është shpërngulur në Medinë bashkë me Ebu Bekrin radijAllahu anhu, ku e kishte takuar Burejdetë ibn el-Hasibin el-Eslemijun bashkë me fisin e tij e të cilët i kishte ftuar që të bëheshin myslimanë, e ata kishin pranuar islamin. Kjo argumenton se i Dërguari i Allahut salAllahu alejhi ue sel-lem nuk e kishte lënë anash thirrjen tek Allahu, edhe kur ishte në rrugë për në Medinë dhe kur atë e kërkonin atë mekasit, Jusufi a.s. kur hyri në burg pa të drejtë, atë nuk e pengoi hyrja në burg që ta braktiste obligimin e thirrjes tek Allahu, por e shfrytëzoi rastin e dytë burgosurve, kur i parashtruan pyetje për shpjegimin e ëndrrave që i kishin parë. Jusufi a.s. ende pa iu përgjigjur atyre u tha: ***“O ju dy shokët e mi të burgut, a është më mirë të adhurohen zota të ndryshëm ose Allahu, i vetmi ngadhënjimtar? Ata qëju adhuroni përveç Allahut, nuk janë tjetër veçse emra që i pagëzuarju dhe prindërit tuaj. Allahu nuk shpalli ndonjë fakt për ta, vendimi (në çesht'en e adhurimit) nuk i takon kujt, pos Allahut, e Ai urdhëroi të mos adhuroni tjetër vetëm Atë. Kjo është feja e drejtë; por shumica e njerëzve nuk e dinë.”***

Kërkohet prej thirrësit të Allahu që ta kryejë detyrën e thirrjes e këtë e ka obligim, por nuk kërkohet prej tij nëse i përgjigjen njerëzit thirrjes. Allahu i Lartësuar ka thënë: ***“E të dërgurit nuk i takon tjetër pos komunikimi të kuptueshëm”***. Kur i Dërguari i Allahut salAllahu alejhi ue sel-lem nuk është i ngarkuar me tjetër, pos komunikimit të kuptueshëm, atëherë edhe pjesëtarët e umetit janë të ngarkuar vetëm me komunikim të kuptueshëm. Arsyesimi i kësaj bëhet në dy mënyra:

E para, është se rregulli i usuli fikhut, përcakton se njeriu nuk është i ngarkuar - nuk përgjigjet për veprimin e tjetrit, d.m.th. nuk është përgjegjës për atë se a e bën apo e braktis dikush ndonjë obligim, ngase kjo është prej ngarkesave që nuk mund të përballohen nga njeriu. Mirëpo, njeriu është i obliguar që ta kryejë detyrën e caktuar që mund t'i ndihmojë tjetrit, si: thirrja tek Allahu, urdhërimi në të mira dhe pengimi prej të këqijave. Pra, myslimani është i obliguar që të urdhërojë në të mira dhe ka mundësi që i urdhëruari t'i përgjigjet thirrjes dhe thirrësi të bëhet shkak për veprimin e të urdhëruarit, por edhe mund të ndodhë që i urdhëruari të mos i përgjigjet thirrjes. Mu për këtë Allahu i Lartësuar e ka lavdëruar njërin prej të dërguarve të Tij për shkak se ***“Ai e urdhëronte familjen e vet me faljen e namazit”***.

Myslimanit i mbetet që ta urdhërojë tjetrin në punë të mira dhe ta thërrasë atë që të adhurojë vetëm Allahun, e kurrësi nuk ngarkohet për veprimet e tjetrit.

E dyta, është ajo se përgjigjja e thirrjes dhe e udhëzimi janë në Dorë të Allahut dhe se Ai është i Vetmi udhëzues: ***“Dhe ashtu, Allahu e lë të humbur atë që e do dhe e udhëzon atë që do”***.

Allahu e ka argumentin më të plotë dhe sikur të donte Ai do t’ju vinte në rrugë të drejtë të gjithëve, Ai nuk pyetet se çfarë vepron, por ata (njerëzit) do të pyeten se çfarë veprojnë. Ndërkaq, sa i përket udhëzimit, komunikimit të qartë dhe shpjegimeve janë detyra e të dërguarve të Allahut dhe e të gjithë thirrëseve, pra këta janë të obliguar vetëm të bëjnë thirrje tek Allahu. Allahu i Lartësuar i ka thënë të Dërguarit të Tij: ***“Në të vërtetë, edhe ti udhëzon për në rrugën e drejtë”***, po ashtu edhe me një ajet tjetër: ***“Është e vërtetë se ti nuk mund ta udhëzosh atë që do ti, por Allahu e udhëzon kë të dojë”***.

9- Thirrje e vazhdueshme në rrugë të Allahut, edhe nëse askush nuk përgjigjet

Pasi që kërkohet prej myslimanit që të thërrasë për tek Allahu dhe nuk kërkohet prej tij që t’i udhëzojë njerëzit, andaj për të është obligim që vazhdimisht të thërrasë në fenë e Allahut, pa kurrfarë plogështie e lodhjeje, ngase obligim i tij është komunikimi i qartë dhe shpjegimi. Pra, kjo është detyrë e tij dhe se i tilli duhet ta kryejë këtë detyrë sikurse i kryen që të gjitha adhurimet, edhe po qe se askush nuk i përgjigjet thirrjes së tij. A nuk e di se Nuhu a.s. ka qëndruar në mesin e popullit të tij duke i thirrur në fenë e Allahut nëntëqind e pesëdhjetë vjet?

Ja kështu ishin të dërguarit e Allahut s.a.v.s, e thërrisnin popullin e tyre nefe gjatë tërë jetës së tyre, e ka pasur prej popullit që u përgjigjshin atyre, por ka pasur që nuk i është përgjigjur askush. Imam Neveviu ka thënë: “Nuk lirohet myslimani prej obligimit të urdhërimit në të mira dhe pengimit prej të këqijave, për shkak se ai mendon se nuk ka efekt thirrja, por ai është i obliguar të veprojë, ngase rikujtimi i çështjeve u bën dobi besimtarëve, pasi që në dorë të tij është që të urdhërojë në të mira dhe të pengojë të keqen, e nuk është përgjegjës nëse pranohet thirrja e tij apo jo. Ky mendim argumentohet me atë se thirrja tek Allahu është çështja kulmore e urdhërimit në të mira dhe e pengimit nga të këqijat. I këtij mendimi është edhe Sujuti, i cili e shpreh këtë mendimin në librin e tij "El-Eshbahu ve Nedhair" Ajo që vërteton obligimin e vazhdimin të thirrjes tek Allahu është fakti se ndalohej

pesimizmi gjatë thirrjes dhe gjithnjë ekziston mundësia e përgjigjes së njerëzve ndaj thirrjes. Arsyeja e kësaj është se çështjet janë në Dorë të Tij dhe se zemrat e robërve i Gjithëmëshirshmi i transformon me dy gishtat e Tij, ashtu si do Ai, andaj thirrësi nuk mund ta ndërpresë thirrjen tek Allahu për shkak se askush nuk i përgjigjet, andaj ai është i obliguar që të vazhdojë thirrjen, këshillën dhe udhëzimin e tjerëve derisa Allahu ta zbatojë çështjen e kryer tani.

10- Shpërblimi ndaj thirrësit është tek Allahu e jo të robërit

Thirrësi për tek Allahu e kryen detyrën e tij dhe e adhuron Allahun, duke e zbatuar urdhrin e Allahut, shpërblimin për adhurim robi e merr prej Krijuesit të Madhërisëm. Andaj, mbi këtë bazë thirrësi për tek Allahu nuk kërkon shpërblim nga asnjë njeri për thirrjen e tij, nuk kërkon as pasuri, as falënderim, as prestigj e as kurrfarë kompensimi material e moral. Allahu i Lartësuar tregon për Nuhun a.s. kështu: *“E nëse prapësoheni (nga mësimet e mia), unë nuk ju kërkoj ndonjë shpërblim, se shpërblimi im është vetëm prej Allahut. Unë jam i urdhëruar të jem njëri prej myslimanëve”*.

Për të Dërguarin tonë ka thënë: *“Thuaj: Unë nuk kërkoj prej jush ndonjë shpërblim për thirrjen time, veçse respektin e dashurisë për hatër të farefisnisë (akraballëkut)”*. D.m.th. që të ruhet afërsia ime me ju, të më lejoni të bëj thirrje për në fenë e Allahut, të mos më pengoni nga kjo detyrë dhe të mos i pengoni njerëzit prej kësaj thirrjeje. Kështu ishte çështja me të gjithë të dërguarit e Allahut, të cilët i kanë thirrur njerëzit në fenë e Allahut dhe nuk kanë kërkuar Prej tyre kurrfarë shpërblimi e falënderimi, ngase ata e kanë pritur shpërblimin prej Allahut Bujar. Allahu i Lartësuar ka thënë: *“Dhe prej skajit më të largët të qytetit erdhi një njeri që ngutçj e tha: O populli im, dëgjoni të dërguarit! Dëgjoni atë që nuk kërkon prej jush ndonjë shpërblim dhe janë udhërrëfyes!”*

11- Pozita e thirrësit në islam

Thirrësi në rrugën e Allahut ka pozitë të lartë në islam, fjala e tij që thërret tek Allahu është prej fjalëve më të mira në peshoren e Allahut, e cila është peshorja më e saktë. Allahu i Lartësuar ka thënë: "E kush është në rrugë më të mirë se ai që thërret në rrugën e Allahut, që bën vepra të mira dhe që thotë: Unë jam prej myslimanëve?" Ky ajet, ashtu si thonë komentuesit e Kuranit, është me kuptim të përgjithshëm që përfshin secilin që thërret për në fenë e Allahut, e që ky thirrës, në të njëjtën kohë, është i udhëzuar, bën vepra të mira dhe i zbaton obligimet e ndalohet prej haramit.

Fjala e thirrësit që thërret tek Allahu -posaçërisht në momentet kur mohohet Allahu dhe përhapet rebelimi ndaj ligjit të Allahut është fjala më e mirë që thuhet në tokë dhe ai që e thotë këtë tregon se e ka cilësinë e përmirësimit dhe se i është dorëzuar tërësisht Allahut, Zotit të të gjitha botëve. Ndërkaq, sa i përket shpërblimit të thirrësit në rrugën e Allahut, ai e ka shpërblimin e madh prej Allahut. I Dërguari i Allahut salAllahu alejhi ue sel-lem ka thënë: "*Kush thërret në udhëzim, atij i përket shpërblimi i njëjtë sikur i atij që e ndjek atë pa u pakësuar shpërblimi atyre (që e ndjekin atë)*". Në një hadith tjetër, i Dërguari i Allahut a.s. i ka thënë Aliut radijAllahu anhu "*Pasha Allahun, nëse Allahu e udhëzon dikë për shkak teje, dije se ajo është më mirë për ty sesa ti kesh devetë e kuqe (të mirat e gjithë kësaj bote)*". Apo në hadithin tjetër: "*Ai që udhëzon në punë të mira e ka shpërblimin e njëjtë me të atij që e bën veprën e mirë*".

Përgatitja e thirrësit

Hyrje

Thirrësi për në rrugën e Allahut ka nevojë që të jetë i përgatitur për ta kryer detyrën e tij, e cila në bazë është mision i të dërguarve të Allahut. Andaj, ai duhet të ketë përgatitje të fortë në këto pika: të jetë i aftë për ta kuptuar me përpikëri misionin e tij, të ketë besim të thellë dhe të jetë i lidhur fuqishëm me Allahun e Lartësuar. Pra, këto janë bazat kryesore të përgatitjes së thirrësit dhe se për këto gjithmonë ka nevojë, andaj kur ndodh që ndonjë dobësi në njërin prej këtyre ai duhet të angazhohet për t'u forcuar në këto çështje. Andaj patjetër duhet t'i shpjegojmë këto në vijim.

Të kuptuarit e përpiktë

Dituria para veprimit:

Dituria gjithnjë është para veprimit, Allahu i Lartësuar ka thënë: *"Atëherë, dije se nuk ka zot tjetër pos Allahut, kërko falje për gjynahun tënd..."*, pra këtu dituria i ka paraprirë veprës. Fakt është që dituria duhet t'i paraprijë doemos çdo pune të punëtorit me qëllim që ta dijë punëtori se çfarë do me atë veprim dhe se çka do të arrijë. Pasi që është domosdoshmëri që dituria të paraprijë në çdo punë, atëherë për thirrësin tek Allahu është më së e domosdoshme që t'ia paraprijë diturinë veprimit, ngase e gjithë puna e tij është e lidhur fenë e Allahut, Krijuesit të të gjitha botëve. Andaj doemos thirrësi tek Allahu duhet të jetë i zgjuar dhe të ketë ditur për atë që po thërret dhe di për ligjshmërinë e asaj që e thotë, vepron apo e braktis, ngase po qe se nuk ka njohuri që kërkohet prej tij dhe se nuk di se çfarë dëshiron, atëherë ky do të gabojë dhe do t'i përziejë gjërat e që më pas mund të flasë për Allahun dhe të Dërguarin e Tij pa kurrfarë diturie. E në këtë rast dëmi i tij është më i madh se dobia, e keqja e tij është më e madhe se e mira e tij. Ka mundësi të urdhërojë në të keqe e të ndalojë prej të mirës për shkak të mosdijes se çka e ka lejuar, ka obliguar sheriati, e çka ka ndaluar. Atëherë, duhet që çdo thirrës për tek Allahu të ketë dituri në sheriatin e Allahut se çka është hallall e çka haram, në çka lejohet e çka nuk lejohet të bëhet ixhtihad, çka mund t'i ketë dy e më shumë kuptime e çka mund ta

ketë vetëm një kuptim. Me diturinë kuptohet njohuria e burimeve të shariatit si njohja e Librit të Allahut, sunetin e të Dërguarit të Allahut salAllahu alejhi ue sel-lem dhe burimet e tjera të shariatit. Mbi këtë bazë na del se myslimani e ka për obligim që t'i shtojë njohuritë e shariatit, me qëllim që ta njohë tematikën e thirrjes së tij dhe që ky të jetë i bazuar në fakte të forta e të qarta, në këtë mënyrë ai të mos urdhërojë, pos për atë që është e mirë dhe të mos ndalojë, pos për atë që është e pavërtetë.

Vlera e diturisë:

Vlera e diturisë dhe e atyre që e kanë atë është e njohur dhe e pakundërshtueshme. Për vlerën e diturisë kanë folur Kurani Fisnik dhe suneti i të Dërguarit të Allahut salAllahu alejhi ue sel-lem Allahu i Lartësuar ka urdhëruar furnizimin me dituri dhe shtimin e saj. I Lartësuar ka thënë: ***“Thuaj: Zoti im, më shto dituri!”***

Në sunetin e të Dërguarit salAllahu alejhi ue sel-lem ndodhet ky hadith: *“Atij që Allahu i do të mirën e bën atë që ta kuptojë thellësisht fenë e Allahut”*. Allahu i Lartësuar i ka marrë dijetarët për dëshmitarë në çështjet e dëshmuara si: dëshmia në njësinë e Allahut dhe dëshminë e tyre e ka bashkangjitur me dëshminë e Tij, por edhe me dëshminë e engjëjve. Ky është një lavdërim dhe mirësi, ngase Allahu nuk merr për dëshmitar atë që nuk është i merituar i diskredituar. Allahu i Lartësuar ka thënë: ***“Allahu e vërtetoi se nuk ka zot të vërtetë përveç Tij, e dëshmuuan edhe engjëjt e dijetarët dhe se Ai është Zbatues i drejtësisë. Nuk ka zot të vërtetë përveç Tij, Fuqplotit e të Urtit.”***

Dijetarët nuk janë të dobishëm vetëm për vetveten, por ata janë të dobishëm edhe për të tjerët, ngase ata i udhëzojnë dhe i drejtojnë njerëzit që të arrijnë deri te Krijuesi i tyre. Imam Ahmed ibn Hanbeli radijAllahu anhu ka thënë: Njerëzit janë të nevojshëm për të konsumuar ushqim dhe pije një herë apo dy herë në ditë, ndërsa për dituri kanë nevojë aq herë sa edhe marrin frymë. Andaj për shkak të gjitha këtyre të kërkuarit e diturisë është më e vlefshme se namazi nafile (namazi vullnetar). Kështu kanë thënë edhe imam Shafiu, Ebu Hanifeja, imam Maliku dhe dijetarët e tjerë myslimanë. Në sunetin e të Dërguarit salAllahu alejhi ue sel-lem ka sihariqe për dijetarët: ***“Për dijetarin kërkojnë falje tek Allahu çdokush që është në qiej dhe në tokë, Allahu i bekon dhe melaqet luten për ata që i mësojnë njerëzit për punë të mira”***. Thirrësi tek Allahu e ka për obligim që të angazhohet gjithmonë që të studiojë çështjet e fesë, që të jetë prej dijetarëve që i njeh dispozitat fetare, të jetë prej atyre që i mësojnë njerëzit vetëm mirë dhe kështu të veprojnë e të arrijnë të

jetë prej atyre që i përgëzojnë Kurani dhe hadithet e të Dërguarit salAllahu alejhi ue sel-lem.

Të kuptuarit e përpiktë të thellë

Si dije e vlefshme dhe e rrallë ndaj së cilës janë indiferentë shumica, edhe përkundër shpjegimeve kuranore dhe thirrjes për ta kërkuar këtë dije. Kjo është dituria e njohjes së rrugës për në botën tjetër, dituri e cila ndikon në zemër e preokupon atë duke e shtyrë që t'i rreket asaj rruge, e ai që e ka këtë dituri e ndien veten të huaj në këtë botë dhe se i është afruar atij udhëtimi në një vend të largët ku nuk ka kthim më në këtë botë, atij nuk i bën dobi asgjë pos devotshmërisë. Andaj, ky gjithmonë do të jetë i angazhuar për t'u pajisur me këtë furnizim (devotshmëri): *“Dhe përgatituni me furnizim (për rrugë), e furnizimi më i mirë është devotshmëria”*. Thirrësi tek Allahu duhet të jetë prej atyre që e analizojnë udhëtimin e tij të largët (për në borën tjetër), se mos vallë vendi i tij do të jetë zjarri i Xhehenemit, vend i mjerimit të madh, apo do të jetë vendi i tij xheneti-parajsa, ku do të jetë afër Krijuesit Bujar? Për të ky përfundim është i panjohur dhe se njeriu do të jetë ndërmjet frikës e shpresës, por këtu është fjala për frikën e dijetarit e jo të injorantit dhe për shpresën e punëtorit e jo të përtacit... Dituria e tillë është e paktë në mesin e njerëzve dhe në mesin studiuesve, ndërsa pa të dijetari nuk konsiderohet dijetar, edhe po qe se i ka mësuar të gjitha shpjegimet e librave, të gjitha tekstet e librave, të gjitha dispozitat e fesë dhe që ato i përsërit përgjithmonë me gjuhën e tij... Kjo dituri është ajka e diturisë dhe synimi i saj është se çdo mysliman ka nevojë për të (devotshmëri) e dijetari ka edhe më shumë nevojë për të, ndërsa thirrësi tek Allahu ka më shumë se të gjithë nevojë për të (devotshmëri)... Këtë dituri ne e emërtojmë si “Të kuptuarit e përpiktë të thellë”. Kjo është dituria të cilën e kanë njohur mirë sahabët e ndershëm, e të cilën e kanë mishëruar atë në mendjen dhe zemrën e tyre, i kanë kushtuar shumë kujdes të vepruarit me devotshmëri, duke mos lejuar që t'iu kalojë kohë në diçka tjetër pos në adhurim ndaj Allahut dhe thirrjen tek Ai, këta gjithë aktivitetin e tyre e kishin të përqendruar në adhurim, në xhihad dhe në thirrje tek Allahu deri në vdekje.

Të kuptuarit e përpiktë konsolidohet në meditimin e koncepteve kuranore

Të kuptuarit e përpiktë konsolidohet në meditimin e koncepteve kuranore, duke i srudiuar gjatë dhe duke i analizuar synimet dhe qëllimet e ajeteve. Allahu i lartësuar e ka zbritur Librin e Tij që njerëzit ta studiojnë atë dhe të meditojnë për

ajetet e tij, e jo vetëm të lexohet kalimthi pa medituar. Allahu i Lartësuar ka thënë: “(Ky është) Libër i begatshëm, Ne ta shpallëm ty këtë, që t’i studiojnë argumentet e tij dhe që të marrin mësim prej tij ata që kanë mend. A nuk e studiojnë me vëmendje Kuranin? Por jo, ata janë zemra që kanë drynat e vet.” Leximi i Kuranit duke menduar dhe duke medituar ia mundëson myslimanit ta njohë Zotin në rrugën e të Cilit thërret, ta njohë rrugën e arritjes deri tek Ai dhe se ai që i përgjigjet kësaj thirrjeje është i nderuar. Pos, kësaj myslimani arrin t’i kuptojë edhe tri gjëra të tjera që janë në të kundërtën e atyre që u përmendën më lart: ajo se në çfarë thërret shejtani dhe aleatët e tij, rrugën e arritjes deri te shejtani dhe se ai që i përgjigjet ftesës së shejtanit do të poshtërohet dhe do të dënohet.

Pa dyshim se njohja e këtyre çështjeve është e domosdoshme për thirrësin në rrugë të Allahut, ndërsa ai që vepron i bëhet sikur jeton në botën tjetër, edhe pse është në këtë botë di të dallojë të mirën prej të keqes, i bëhet e qartë e vërteta nga e pavërteta, i jepet njohuria që ta dallojë udhëzimin prej humbjes dhe që jeta e tij të jetë e mbushur me kënaqësi e rehati që kanë të bëjnë me jetën e ahiretit dhe largimin nga kënaqësitë e përkohshme të kësaj bote, e në këtë mënyrë thirrësi tek Allahu preokupohet me një çështje të caktuar, ndërsa njerëzit e tjerë me diçka krejt tjetër.

Shtyllat bazike për të kuptuarit e përpiktë - të thellë

Konceptet e të kuptuarit të përpiktë janë të bazuara në shumë shtylla, por më të rëndësishme, sipas mendimit tonë, janë dy:

E para, aftësia e të kuptuarit nga thirrësi se cili është qëllimi i tij në këtë jetë dhe pozita e tij në mesin e njerëzve;

E dyta, distancimi nga (kënaqësitë e) e jetës mashtruese dhe lidhja e tij me ahiretin. Për synimet e këtyre dy shtyllave do të flasim në vijim.

Njohja e thirrësit me qëllimin e ardhjes së tij në këtë borë dhe pozitën e tij në raport me njerëzit.

Cilat janë qëllimet e njeriut në këtë botë? Pas këtij synimi, a ka synim tjetër? Neve për këtë na është përgjigjur Kurani Fisnik, sipas të Cilit njerëzit ndahen në dy grupe.

Grupi i parë përbëhet nga njerëzit që si synim të kësaj jete e kanë konsumimin e ushqimit e të pijeve dhe të kënaqurit me kënaqësi të trupore dhe se, pos këtij, ata nuk kanë kurrfarë synimi tjetër. Këta e shfrytëzojnë jetën e kësaj bote vetëm për t'u kënaqur sa më shumë që është e mundur. Dhe, sipas mendimit të cekët e të pabazë, pas jetës së kësaj bote nuk ka jetë tjetër, pas shkatërrimit dhe inekzistencës. Këta janë krijesat më të këqija dhe më të palumtura. Allahu i Lartësuar ka thënë: ***"Ata që besuan dhe bënë vepra të mira Allahu do t'i dërgojë në Xhenete nëpër të cilat rrjedhin lumenj, e ata që nuk besuan, përjetojnë kënaqësi (në këtë jetë) dhe hanë ashtu si hanë kafshët, e vendi i tyre është zjarr."*** Këta njerëz në aspektin e konsumimit të ushqimit janë sikur shtazët, përveçse këto do të dënohen me zjarr të Xhehenemit. Ky, pra, është synimin e këtyre njerëzve dhe pozita e tyre në mesin e njerëzve. Pozita e këtyre në mesin e njerëzve është se këta i thërrasin njerëzit në humbje e devijim dhe për të shkuar në zjarr (xhehenem). Allahu i lartësuar ka thënë: ***"Ata ju ftojnë për në zjarr, e Allahu me mëshirën e vet ju fton për në xhenet, për në shpëtim dhe ua sqaron njerëzve argumentet e veta, ashtu që ata të rikujtojnë."***

Në grupin e dytë janë ata njerëz që e kanë kuptuar të vërtetën dhe cakun e kësaj jete, e kanë kuptuar se këta janë krijuar për ta adhuruar Allahun dhe se tek Ai është kthimi i tyre. Allahu i Lartësuar ka thënë: ***"Unë nuk i krijova xhinët dhe njerëzit për tjetër pos që të më adhurojnë", "O ti njeri, vërtet ti përpiqesh me një përprjekje të madhe që çon te Zoti yt, e atë (përprjekje) do ta gjesh."*** Synimi i vetëmi këtyre njerëzve është shprehja e adhurimit ndaj Allahut, si: xihadi në rrugën e Allahut, thirrja e njerëzve në fenë e Allahut, gjallërimi i tokës me vepra të mira, udhëzimi i atyre në të vërtetën dhe udhëheqja e veprimeve në këtë jetë. Këto janë qëllimet e këtyre në jetën e kësaj bote, ndërsa qëllimi tjetër është qëllimi madhështor dhe më i lartë: e ky qëllim është arritja e kënaqësisë së Allahut të Lartësuar. Allahu i Lartësuar ka thënë: ***"O ju që hesuat, aleni namazin me ruhu e sexhde dhe vetëm Zotin tuaj adhurojeni. Bëni punë të mira (të dohishme) se do të gjeni shpëtim. Luftoni me një luftë të denjë për hatër të Allahut, se Ai ju zgjodhi ju (ju përcaktoi për të luftuar për rrugën e Tij) dhe nuk ju obligoi në fe me ndonjë vështirësi, në fenë e babait tuaj, Ibrahimit Ai, edhe më parë, e edhe ky (Kuran) ju quajti myslimanë dhe për të qenë i dërguari dëshmitar juaj dhe për të qenë ju dëshmitarë ndaj njerëzve, pra faleni rregullisht namazin, jepeni zeqatin, përmbajuni me Allahun se Ai është ndihmë tari juaj. Sa mbrojtës i mirë dhe sa ndihmëtar i madh që është."*** Kjo është detyra e myslimanit dhe qëllimi i

vetëm është adhurimi i Allahut dhe xihadi në rrugën e Tij. Myslimani lufton gjithherë me nefsin-pasionin e tij, duke e udhëzuar atë në rrugë të mira dhe duke u larguar prej të këqijave; bën xihad me lapsin, gjuhën, pasurinë dhe forcën e tij, me qëllim që të ngrihet lart fjala e Allahut dhe të ndriçohet njerëzimi me dritën islame. Allahu i Lartësuar i ka zgjedhur myslimanët që ta kryejnë këtë detyrë madhështore, udhëzimi i njerëzve dhe drejtimi i tyre kah e vërteta dhe nxjerrja e tyre prej errësirës në dritë. Në këtë nuk ka hapësirë që dikush të largohet prej kësaj detyrë të ndershme dhe se kjo detyrë është nder i madh me të cilin Allahu i ka nderuar myslimanët. Jo vetëm kaq, myslimanët madje duhet ta kryejnë këtë detyrë me plot dëshirë dhe vullnet, por edhe duhet ta falënderojnë Zotin për këtë.

Largimi nga kjo jetë mashtruese dhe lidhja me botën tjetër

Nuk ka gjë më të dëmshme për zemrën se sa lidhja me këtë botë dhe dhënia përparësi kësaj bote ndaj botës tjetër dhe se kjo ndikon që myslimani të mos angazhohet për botën tjetër, ndikon që të trupi të ndiej lodhje kur të vijë puna për të vepruar në rrugën e Allahut dhe për ta kryer detyrën e thirrjes tek Allahu. Kjo zemër e sëmurë është larg asaj që të jetë në gjendje për ta kryer detyrën e thirrjes për në rrugë të Allahut. Pa dyshim, kjo botë është e krijuar si e tillë që ka mundësinë e mashtrimit. Për këtë i Dërguari i Allahut s.a.v.s, kur e përshkruan këtë botë, thorrë: *“Kjo botë është e ëmbël dhe këndshme dhe se Allahu ju ka përcaktuar juve si mëkëmbës në të, Ai ju shikon se si po veproni. Ruajuni prej dynjasë dhe ruajuni prej sprovave të grave ”*. Allahu na ka tërhequr vërejtjen që të mos mashtrohemi me këto mashtrime: ***“O ju njerëz, s’ka dyshim se premtimi i Allahut është i vërtetë; pra të mos ju mashtrojë jeta e kësaj bote dhe të mos ju mashtrojë ndaj Allahut ai i mashtruari (shejtani) ”***.

Aspekti i mashtrimit në këtë botë është se në të ka shumë bukuri dhe të mira që i lakmon njeriu me të gjitha shqisat e tij, ngase natyrshmëria e tij është që t’i japë përparësi kësaj bote ndaj çdo gjëje. Allahu i Lartësuar ka thënë: ***“Jo, nuk është ashtu! Por ju jeni që e doni të ngutshmen (dynjane). Dhe e lini pas shpine atë të artlshmen (Ahiretin) ”***. Nëse e lë shpirtin të lirë të veprojë, ai gjithmonë vjen duke e shtuar lakminë me këtë botë, derisa kjo botë do të bëhet qëllimi dhe caku final. *“Andaj, ti largohu prej atij që ia ka kthyer shpinën Kuranit dhe që nuk do tjetër veçse jetën e d'ynjasë! Ajo është e tërë dituria që kanë arritur ata ”*. Kur njeriu arrin

në këtë shkallë, atëherë ai i humb ndjenjat e pranimit dhe konsideratës dhe se atij nuk i bën dobi as këshilla e as rikujtimi dhe tjetra që kuptohet qartë është se ky njeri nuk është i denjë për t'u bërë thirrës tek Allahu.

Atëherë cila është mënyra e shërimit të zemrës prej lakmisë ndaj botës? Shërimi prej kësaj sëmundjeje është që njeriu të ketë bindjen e plotë se kjo botë është kalimtare dhe e përkohshme, ndërsa se bota tjetër është e përhershme, e që më pastaj krahasohen këto dy bota dhe në këtë mënyrë i jepet përparësi ahiretit ndaj dynjasë. Allahu i Lartësuar ka thënë: ***“Dhe çdo gjë që ju është dhënë juve është kënaqësi dhe shije e kësaj bote”, “Thuaju: Përjetimi i kësaj hote është pak, e për atë që është i devotshëm, bota tjetër është shumë më e dobishme. Nuk do tju bëhet padrejtësi as sa fija ”, “Ajo që e keni pranë vetes është e përkohshme, e ajo që është tek Allahu është e përjetshme.”*** Pra, njeriu duhet t'i rikujtojë këto dhe të bindet në të (se kjo botë është kalimtare). Mirëpo, vetëm ky rikujtim nuk mjafton dhe se duhet menduar se momenti i vdekjes mund të jetë i papritur. I Dërguari salAllahu alejhi ue sel-lem ka thënë: *“Kur të zgjohesh në mëngjes mos llogarit se do ta arrish mbrëmjen, e kur ta arrish mbrëmjen mos llogarit se do ta arrish mëngjesin...”*. “Ç’kam unë me këtë botë? Unë në këtë botë-dynja jam sikur kalorësi që është ndalur nën hijen e një lisi për të pushuar e më pas e ka braktisur këtë vend dhe ka ecur”.

Kur ndodh që shejtani të bëjë cytje tek i riu i fuqishëm dhe i shëndoshë, atëherë ky duhet ta largojë këtë cytje, duke i kujtuar shumë të rinj, të cilët janë larg uar nga kjo botë e që tash janë nën dhe. Po ashtu, kur të ndodhë që shejtani të cyt tek ai, le të shkojë në varreza dhe të shohë se sa të rinj e kanë shijuar vdekjen herët, e pastaj le të kthehet të mëhalla e tij dhe t'i numërojë sesa pleq janë në vendin e tij do të gjejë me dhjetëra. Nga e gjithë kjo kuptohet se shumë të rinj e kanë shijuar vdekjen e të paktë janë ata që e kanë arritur moshën e pleqërisë.

Andaj kur njeriu i pakëson shpresat për jetë, atëherë ai përgatitet për botën tjetër duke vepruar punë të mira, ngase nuk e di se kur e thërrasin për në botën tjetër...

Kur thirrësi mysliman shpëton prej lakmisë ndaj kësaj bote dhe e largon helmin e tillë, duke u kthyer kah ahireti, ndien vetmi të madhe në këtë botë dhe e shton veprimin e veprave që fitojnë kënaqësinë e Allahut, e më e rëndësishmja prej këtyre veprave të mira është thirrja tek Allahu dhe udhëzimi i robërve të Allahut te feja e Allahut të Lartësuar. Për zbatimin e këtyre veprave të mira, ai nuk ndien lodhje, as dhimbje, nuk lodhet në udhëtim, nuk lodhet nga pagjumësia, nuk i dhimbset asnjë angazhim e asnjë sakrificë, ngase të gjitha këto janë furnizim për

udhëtimin e gjatë deri në Ahiret. jo vetëm kaq, por ai në lodhje do të ndiejë qetësi, në dhimbje kënaqësi, në angazhimin e tij përfitim dhe në sakrificën e tij kompensim të sigurt.

Kjo çfarë po them nuk është ndonjë iluzion apo hiperbolizim, ngase ai që është larg vendlindjes dhe që ka qëndruar për një kohë të gjatë larg familjes patjetër, që i shtohet malli për familjen e tij. Ky do të ndiejë kënaqësi kur të përgatitet për t'u kthyer te familja duke qenë i përgatitur për t'u përballë me mundimet e udhëtimit, duke u lodhur dhe mbetur pa gjumë derisa të arrijë te familja...

Besimi i Thellë

E vërteta rreth besimit të thellë

Ne me besimin e thellë duam që thirrësi mysliman të jetë i bindur në fenë islame, të cilin e ka udhëzuar Allahu dhe e ka urdhëruar atë që të thërrasë në këtë fe. Kjo fe është e vërtetë, ngase Allahu ka udhëzuar në të dhe se të tjerat janë humbje dhe devijim i prerë. Allahu i Lartësuar ka thënë: ***“Thuaju: Udhëzimi i Allahut është udhëzim i drejtë”***. ***“Pas të vërtetës nuk ka tjetër pos iluzione, e si po ia ktheni shpinën (të vërtetës)?”*** Pa dyshim, kjo bindje e prerë në të vërtetën e islamit për thirrësin mysliman është si aksioma që ka të bëjë me atë se $1+1=2$, e pastaj kjo aksiomë nuk pranon kurrfarë diskutimi, polemikë apo verifikim të çështjes. Andaj, çdo përpjekje për t'u larguar nga kjo e vërtetë nënkupton ndjekjen e pasionit dhe të pavërtetës, në të cilën është devijimi dhe humbja e besimit-imanit. Allahu i Lartësuar ka thënë: ***“Thuaj: Unë jam i ndaluar të adhuroj ata që i adhuroni ju, pas Allahut! Thuaj: Unë nuk i ndjek dëshirat tuaja, pse atëherë do të isha i humbur e jo prej të udhëzuarve (në rrugë të drejtë)”***. Vërtet ky besim-iman i thellë në fenë islame është i konsoliduar në argumente të prera dhe fakte të qarta, në të cilat nuk ka kurrfarë dyshimi, edhe pse këto fakte i përgënjeshtrojnë të devijuarit, të cilët nuk e shohin të vërtetën që është zbritur prej Allahut të Lartësuar, jo pse këto argumente janë të padukshme, por për shkak të verbërisë (simbolikisht) dhe zemrave të tyre të vdekura. Andaj, thirrësi mysliman nuk mendon që të anojë kah mendimi i kotë i të devijuarve, nuk ka kurrfarë dyshimi në thirrjen e tij tek Allahu, sikurse nuk paramendohet që të bjerë në grackën e verbërimit ndaj shikimit të së vërtetës. Allahu i Lartësuar ka thënë: ***“Thuaj: Unë i përmbahem të vërtetës (që më erdhi nga Zoti im. Ju e gënjet atë, epër atë që***

nguteni ju (dënimin), nuk e bëj unë, vendimi i takon vetëm Allahut; Ai e rrëfen të vërtetën dhe Ai është më i miri i gjykatesve". Vërtet fakti i qartë në të cilin mbështet thirrësi mysliman është besimi-imani i thellë që është i mbështetur nga vetë feja islame dhe natyrshmëria e saj, e jo nga diçka jashtë saj. Për këtë besimi-imani i thellë qarkullon dhe rrjedh në jetën e njeriut sikurse gjaku që qarkullon në trup dhe nuk ka mundësi që të ndikohet, dobësohet, eliminohet nga ndonjë shkak i jashtëm, pavarësisht llojit dhe natyrshmërisë së atij shkakut të jashtëm. Pra, thirrësi mysliman nuk është prej atyre për të cilët Allahu i Lartësuar ka thënë: ***“Ka nga njerëzit që adhuron Allahun me mëdyshje (luhatshëm), nëse i vjen ndonjë e mirë ai qetësohet me të, po nëse e godet ndonjë gjë e pakëndshme, ai kthehet në fytyrën e vet të vërtetë (të mëparshme), ai i ka humbur këtë dhe jetën tjetër e ky është ai dështimi i qartë.”*** Kjo është gjendja e hipokritit, apo e besimit të dobët e të mbushur me dyshime, sikurse është shprehur Abdurrahman ibn Zejd ibn Eslem: *“Ai është hipokriti, nëse i ka punët mirë në këtë botë, ai bën adhurim, e po qe se ka telashe në këtë jetë ai nuk bën adhurim, e nëse e godet ndonjë fatkeqësi, apo ndonjë e keqe i tilli e braktis fenë dhe kthehet në ateizëm.”*

Besimi-imani i thellë i thirrësit mysliman është konstant dhe nuk luhetet pavarësisht nga sprovat me të cilat goditet, pavarësisht nga gjendja e tij e dobët, pavarësisht nga forca e ateizmit, qoftë edhe nëse ai i vetmi mbetet në tokë si besimtar. Kështu ka qenë besimi-imani i shokëve të të Dërguarit salAllahu alejhi ue sel-lem në të gjitha momentet dhe rastet, atë ditë kur kanë qenë të izoluar në Mekë dhe torturoheshin nga jobesimtarët, ditën kur kanë emigruar për në Etiopi për ta ruajtur fenë e tyre, ditën kur janë shpërngulur për në Medinë, ditën kur kanë ngadhënjyer në Bedër, ditën kur kanë pësuar disfatë në betejën e Uhudit, ditën kur u rrethuan në luftën e Hendekut. Në të gjitha këto raste imani i tyre ka qenë konstant dhe i patundur fare, duke mos u futur në zemrat e tyre asnjë grimcë e dyshimit në thirrjen në rrugën e vërtetë. Allahu i Lartësuar ka thënë: ***“Lutje e vërtetë është vetëm ajo drejtuar Atij, e ata që u luten të tjerëve pos Tij, ata nuk u përgjigjen atyre asgjë tjetër, (gjendja e tyre është) vetëm si e atij që shtrin duart (prej së largu) kah uji, që ai (uji) t’i arrijë deri në gojën e tij, por (uji) nuk do t’i arrijë (sepse uji është send i vdekur e nuk kupton për etjen e tij). E lutja e johesimtarëve (drejtuar pos Zotit) nuk është tjetër veçse deshtim (kotësi).”*** Nuk e dobëson imanin-besimin e thirrësit mysliman largimi i njerëzve nga ai dhe mospërgjigjja e tyre ndaj thirrjes së tij. Vërtet Nuhu a.s. qëndroi gjatë te populli i tij ashtu si na ka lajmëruar neve Allahu i Lartësuar: ***“Ne e dërguam Nahun te***

populli i vet, e ai kaloi ndër ata një mijë pa pesëdhjetë vjet...” , këtij të dërguari i besuan shumë pak. Po ashtu, largimi i njerëzve nga thirrësi nuk e argumenton atë se ai ka qenë joaktiv në kryerjen e detyrës së thirrjes tek Allahu, përderisa ai e ka dhënë gjithë mundin e tij. Jo angazhimi i thirrësit mund të jetë në punën e tij si thirrës e jo pse atij nuk i përgjigjet i thirruri.

Domosdojo e ekzistimit fë këtij besimi fe thirrësi mysliman

S’ka dyshim se imani-besimi i tillë duhet të jetë i ngulitur te çdo mysliman, ndërsa për thirrësin është më se i domosdoshëm, posaçërisht në kohën tonë kur është dobësuar fjala e islamit dhe është forcuar fjala e ateizmit, është dobësuar besimi te myslimanët, janë shtuar sprovimet e myslimanëve, janë shtuar sulmet e ateistëve, shtetet e ateisrëve që e mbrojnë ateizmin janë bërë të mëdha, hedhin dyshime dhe të pavërteta për fenë islame. Kësaj sprove të madhe i shtohet edhe ekzistimi i dijetarëve të këqij, të cilët e shesin fenë e tyre për të mirat e kësaj bote, të cilët fshihen prapa fjalës islame, të cilët me gjuhët e tyre shprehin islamin, ndërsa në zemrat e tyre fshehin të pavërtetën dhe devijimin e madh. Me të gjitha këto, muslimani, e posaçërisht thirrësi mysliman i sinqertë, duhet që të mos habitet nga këto sprovime e këto momente, por ai duhet të jetë i atillë që të përballet me këto dhe të japë gjithë mundin e tij për ta ngritur fjalën e Allahut dhe për ta kërkuar ilaçin e mënyrën e trajtimit të asaj që e ka goditur fenë islame dhe të mos mbeten sytë e hapur për shkak të magjepsjes ndaj jobesimtarëve dhe që të mos konsiderohen madhështore, ngase vërtet jobesimtarët janë në humbje të qartë, ndaj kanë nevojë për përmirësim dhe edukim e jo që të madhështohen e as të konsiderohen njerëz që meritojnë lavdërim. Andaj, mu për këtë thirrësi mysliman duhet ta ketë në mendjen e tij atë që transmetohet nga Buhariu dhe Muslimi nga Ebu Se’id el-Hudariju radijAllahu anhu, i cili ka thënë: Na pati folur i Dërguari i Allahut salAllahu alejhi ue sel-lem një ditë për Dexhallin, ndërsa duke folur për të na pati thënë: *“Do të vijë Dexhalli, por ai e ka të ndaluar që të hyjë në Medinë, ai do të ndalet në vend ku nuk mbin asgjë, e ky vend është afër Medinës, e një ditë do të shkojë tek ai një njeri, i cili është më i miri prej njerëzve apo njëri prej njerëzve të mirë dhe do ti thotë atij: unë dëshmoj se ti vërtet je Dexhalli për të cilin na ka folur i Dërguari i Allahut salAllahu alejhi ue sel-lem Në këtë rast Dexhalli do të thotë: Çfarë mendoni ju nëse unë e mbys këtë e më pastaj e ngjall, a do të dyshoni në këtë çështje? Ata do të thonë: jo. E ai (Dexhalli) e mbyti atë njeriun edhe e*

ngjalli. E ai njeriu i mirë tha: Pasha Zotin tash jam edhe më i bindur se ti je Dexhalli. Në këtë rast Dexhalli deshi ta mbyste atë, por më nuk mundi.” Në këtë hadith ekzistojnë shumë urtësi madhështore si: Dexhalli pretendon për vetveten se është Zot, i sprovon njerëzit me thirrjen e tij duke i pasur disa mundësi të veprimit të jashtëzakonshme, siç është mbytja e personit e më pas ngjallja e tij, e urdhëron tokën që të mbijë dhe ajo mbin, e urdhëron shiun që të bjerë dhe ai bie... E këtë do ta ndjekin një grup njerëzish që janë injorantë ndaj koncepteve dhe dritës së besimit-imanit, por ky mysliman, i cili del para Dexhallit dhe nuk ka kurrfarë dyshimi se ai është Dexhalli gënjeshtar, te ky mysliman nuk kanë kurrfarë ndikimi veprimet e jashtëzakonshme të Dexhallit e as numri i madh i pasueseve të tij dhe se asgjë nuk ndikon në krenarinë e këtij njeriu që e ka lidhur atë me islamin, ngase thirrja e Dexhallit është gënjeshtër e prerë që vjen në kundërshtim me konceptet e vërteta islame. Andaj, pavërteta nuk mund të bëhet kurrë e vërtetë, pavarësisht indikacioneve të jashtme, edhe po qe se ato janë veprime të jashtëzakonshme, sikurse nuk është e mundur kurrë që feja islame të bëhet një fe e kotë për shkak se besimtari ndodh që të largohet prej saj. Për këtë pasi që Dexhalli e mbyti atë myslimanin, atij iu shtua bindja se ai është me të vërtetën, kurse Dexhalli është një gënjeshtar i madh dhe se veprimet e tij të jashtëzakonshme janë vërtetim i asaj se çfarë ka thënë i Dërguari i Allahut salAllahu alejhi ue sel-lem dhe se tjetra është se ky mysliman është këmbëngulës në besimin e tij, edhe po qe se ai është i vetëm. Nuk ka fuqi, e as forcë e as ndihmë pos me ndihmën e Allahut të Lartësuar...

Frytet e këtij imani dhe kërkesat e tij

Në vërtetë ky besim-iman i thellë shtron kërkesa ndaj nesh dhe ka fryte të padiskutueshme, e po qe se shihet se nuk ka fryte ose ato janë të dobëta atëherë ky është argument për dobësinë e këtij besimi-imani. Pra, cilat janë këto fryte dhe kërkesat e tyre përcjellëse? Në fakt këto janë të shumta e të përmendura në Librin e Allahut dhe në sunetin e të Dërguarit të Allahut salAllahu alejhi ue sel-lem në rastet kur flitet për cilësitë e besimtarëve dhe myslimanit s'i mbetet tjetër pos që t'i lexojë këto ajete e hadithe dhe në çdo cilësi të meditojë për kuptimin e saj, e pastaj të kthehet te vetja duke vlerësuar se sa i posedon këto cilësi dhe në çfarë mase. E po qe se këto cilësi i has në veten e tij, atëherë le ta falënderojë Allahun, e nëse jo, ose nëse ato janë shumë të dobëta, atëherë le të mundohet t'i përvetësojë e ta përmirësojë imanin e tij dhe kështu ta ushqejë veten me këtë iman të veçantë. Në

këtë rast ky do të shijojë frytet e kërkuara me ndihmën e Allahut dhe ta ngjyrosë veten me ngjytën e besimtarëve që kanë besim të thellë. Mjafton që ne t'i përmendim disa nga këto fryte të begatshme të imanit të thellë dhe disa nga nevojat e domosdoshme të këtij besimi të thellë. Ne këtu do t'i përmendim ato që janë më të rëndësishme.

1. Dashuria

Dashuria e robit ndaj Krijuesit të tij dhe dashuria e Krijuesit ndaj robit të Tij janë fryt i besimit-imanit për të cilin ka sinjalizuar Allahu i Lartësuar, duke thënë: ***“Që Ai e do atë (popull) dhe ata e duan Atë (Zotin).”*** Pra, kjo është prej fryteve të besimit të thellë, por jo vetëm kaq ky është shpirti i besimit, ngase imani-besimi konsolidohet mbi bazën e njohurive bindëse ndaj Krijuesit të Madhërisëm. Ka thënë El-Haseni ai që e njeh Krijuesin e tij edhe e do Atë, sa do që të shtohet njohuria aq më shumë forcohet besimi dhe shtohet dashuria ndaj Krijuesit të Tij. Forca e njohurisë bëhet duke menduar në mënyrë të pastër rreth cilësive të Krijuesit, madhësisë së Tij dhe begative të Tij. E si begati më e madhe është udhëzimi i Tij ndaj thirrësit mysliman në besim iman, ***“e ata thonë: Falënderojmë Allahun që na udhëzoi për këtë (për iman, për punë të mira, na e hoqi zilinë na futi në xhenet), pse sikur të mos na drejtonte Allahu, ne nuk do të dinim të udhëzohemi.”*** Dashuria që ka myslimani ndaj Krijuesit të tij nxit edhe në atë që myslimani të dojë edhe të dashurin e Allahut të Lartësuar, andaj për këtë myslimani e ka obligim që ta dojë të Dërguarin e Allahut, Muhamedin s.a.v.s, ngase ky është i dashuri i Allahut, i dërguari i Tij te njerëzit, transmetues i fesë islame te njerëzit. Po ashtu, myslimani e do Kuranin dhe mësimet islame, ngase këto janë mesazhi i Allahut; i do besimtarët, ngase ata e janë adhurues të Allahut dhe të nënshtruarit e Tij, të cilët e adhurojnë Krijuesin e tyre. Dashuria e myslimanit ndaj Allahut lë gjurmë të mira dhe të këndshme në shpirtin e myslimanit, andaj gjithnjë myslimani e ndien ëmbëlsinë e këtij besimi. I Dërguari i Allahut salAllahu alejhi ue sel-lem ka thënë: ***“Tek ai që gjenden tri cilësi e ka shijuar ëmbëlsinë e besimit: që Allahu dhe i Dërguari i Tij të jenë më të dashur për të se çdo gjë tjetër, që të urrehet kthimi në moshesim, pasi që Allahu e ka udhëzuar sikurse nuk dëshiron që të hidhet në zjarr dhe që të dojë dikë vetëm për hatër të Allahut”***. Pra, dashuria e robit ndaj Krijuesit të tij i sjell këto ftyte të begatshme dhe se nuk ka mundësi të mos arrihen ato, por duket se është e

dobishme që të flitet shkurtazi rreth disa kërkesave të domosdoshme që rrjedhin nga dashuria e myslimanit që e ka ndaj Krijuesit të tij, andaj për këtë do t'i shpjegojmë disa nga këto kërkesa.

Kërkesat - detyrat që rrjedhin nga dashuria e robit ndaj Krijuesit të tij

Allahu i Lartësuar ka thënë: ***“O ju që besuat, kush largohet prej jush nga feja e vet (i bën dëm vetes), s’ka dyshim se Allahu do ta sjellë një popull që Ai e do atë (popull) dhe ata e duan Atë (Zotin), (një popull) që është modest e i butë ndaj besimtarëve, por i ashpër dhe i fortë ndaj mohuesve, që lufton në rrugën e Allahut dhe që nuk i frikësohet kërcënimit të asnjë kërcënuesi.”***, ***“Thuaj: Nëse e doni Allahun, atëherë ejani pas meje që Allahu tju dojë, t’ju falë gjynahet tuaja, se Allahu fal shumë, mëshiron shumë.”*** Andaj, kërkesat detyrat që rrjedhin nga dashuria e besimtarit që ka për Allahun, sipas dritës së këtyre dy ajeteve fisnike janë:

a. Që robi mysliman të jetë krahulur ndaj besimtarëve, i mëshirshëm, i butë dhe i urtë ndaj vëllait të vet mysliman. Thirrësi mysliman e fton vëllanë e tij mysliman në atë që është i kënaqur Allahu. Kjo lloj mëshire është përshkruar në ajetin kuranor, i cili shpjegon shembullin e cilësisë së Muhamedit salAllahu alejhi ue sellem dhe të shokëve të tij: ***“janë të mëshirshëm ndërmjet vete ”***.

b. Që myslimanët të jenë të ashpër dhe krenarë ndaj jobesimtarëve. Kjo është përmendur në ajetin: ***“Muhamedi është i dërguar i Allahut, e ata që janë me të (sahabët) janë të ashpër kundër jobesimtarëve”***. Myslimani kurrsesi nuk është i dobët, as i plogësht dhe as që ndihet i poshtëruar para jobesimtarëve, kurrë nuk ndien dobësi edhe kur nuk është prezent para jobesimtarëve, as kur është në vetmi e as në prezencë para jobesimtarëve. Gjithmonë besimtari do të jetë i fuqishëm ndaj jobesimtarëve për aq sa është i butë ndaj besimtarëve.

c. Besimtarët myslimanë luftojnë në rrugën e Allahut. Me luftën në rrugën e Allahut nënkuptohet lufta e vazhdueshme me vetveten derisa të drejtohet shpirti kah adhurimi dhe nënshtrimi ndaj Allahut. Po ashtu me këtë luftë nënkuptohet

edhe lufta kundër armikut, derisa të evitohet dhe pengohet dëmi prej armikut, ndërsa xihadi i thirrjes tek Allahu do të bëhet deri atëherë kur të plorësohet shpjegimi dhe sqarimi i rrugës së drejtë për njerëzit. Ky xihad që e bën thirrësi mysliman gjatë thirrjes së tij tek Allahu i Lartësuar bëhet duke shprehur angazhim të tërësishëm në çështjet e davetit, duke vepruar sipas mënyrave më të mira për të pasur sukses, duke i dhënë përparësi thirrjes tek Allahu ndaj të gjitha të mirave të kësaj bote. Allahu i Lartësuar ka thënë: ***“Thuaj (o i dërguar): Në qoftë se etërit tuaj, djemtë tuaj, vëllezërit tuaj, bashkëshortet tuaja, farefisi juaj, pasuria që e fituat, tregtia që frikësoheni se do të dështojë, vendbanimet me të cilat jeni të kënaqur, (të gjitha këto) janë më të dashura për ju se Allahu, se i dërguari i Tij dhe se lufta për në rrugën e Tij, atëherë pritni derisa Allahu nuk i vë në rrugën e drejtë njerëzit e prishur.”***

ç. Nuk i frikësohen myslimanët asnjë kritike a qortimi prej kujtdo qoftë, d.m.th. nuk mund t’i pengojë ata askush nga nënshtrimi i Allahut, nga thirrja për në rrugën e Allahut, nga urdhërimi në të mira dhe pengimi prej të këqijave. Pra, nga këto veprime nuk mund t’i pengojë askush nga kritikuesit dhe etiketuesit.“

d. Pasimi e të Dërguarit të Allahut s.a.v.s në të gjitha aspektet, duke zbatuar çdo urdhër të tij dhe duke u larguar nga çdo gjë që ka ndaluar ai: ***“Çka tju jupë i Dërguari, atë merreni, e çka tju ndalojë përmbajuni”***. Pra, i Dërguari i Allahut salAllahu alejhi ue sel-lem është shembulli më i mirë për thirrësin tek Allahu. Ky do të marrë shembull jetën dhe veprimet e të Dërguarit salAllahu alejhi ue sel-lem në thirrjen tek Allahu: ***“ Ju e kishit shembullin më të lartë në të Dërguarin e Allahut.”*** Gjëja më e dobishme për thirrësin tek Allahu është që të thellohet në njohjen e sunetit të Dërguarit të Allahut salAllahu alejhi ue sel-lem në thirrjen për tek Allahu, qysh prej kohës kur atë e ka dërguar Allahu e derisa ai ka shkuar tek Allahu (ka vdekur). Jeta e të Dërguarit salAllahu alejhi ue sel-lem për thirrësin mysliman është shpjegim praktik i programit hyjnor, i cili është shpjeguar me ajete kuranore. Pra, nuk ka asnjë gjendje nëpër të cilën kalon thirrësi tek Allahu e që të mos gjejë diçka të ngjashme me rastin e tij në jetën e të Dërguarit salAllahu alejhi ue sel-lem se si ka vepruar zotëria i thirrësve në rrugën e Allahut. Vërtet studimi i hollësishëm i jetës së të Dërguarit salAllahu alejhi ue sel-lem dhe duke i shtuar kësaj edhe analizimin e ajeteve kuranore e posaçërisht ajetet që flasin për thirrjen tek Allahu, në këtë rast thirrësi vepron sipas dritës së Krijuesit të tij dhe sipas shpjegimeve të qarta i bëhet e qartë se çka është e saktë dhe e vërtetë. Ajo që e ndihmon thirrësin për në rrugë të Allahut që të ndjekë të Dërguarin e Allahut salAllahu alejhi ue sel-lem është edhe rikujtimi i personalitetit të të Dërguarit dhe

që atë ta shoqërojë në aspektin e brendshëm shpirtëror, t'i rikujtojë qëndrimet e tij për rastet e ndryshme, t'i kujtojë cilësitë e tij madhështore, butësinë e tij ndaj umetit. Këto e të ngjashme ia shtojnë myslimanit dashurinë ndaj të Dërguarit salAllahu alejhi ue sel-lem dhe se sa do që të shtohet dashuria ndaj tij aq sa të shtohet edhe angazhimi për t'u lidhur me rrugën e tij dhe për ta pasuar atë.

Prej çështjeve të domosdoshme, që kanë të bëjnë me dashurinë e thirrësit mysliman ndaj Krijuesit të tij, e të cilat janë të nxjerra nga Kurani, sunneti dhe natyrshmëria e dashurisë, janë edhe:

a. Dëshira për ta përmendur Allahun e Lartësuar në çdo kohë, ku gjuha dhe zemra e thirrësit vazhdimisht do ta rikujtojnë Zotin. Ai që do diçka domosdo do ta përmendë shpesh atë, andaj nga këtu kuptohet se prej shenjave të atyre që e duan Zotin është se ata lexojnë shumë Kuranin, dhe leximi i Kuranit është qetësuesi i zemrave të tyre, shoqëruesi i tyre në vetmi dhe drita ua shndrit gjokset e tyre, madje të njëjtin efekt e ka edhe të përmendurit e Allahut në çdo kohë dhe në çdo rast, andaj për këtë është e rekomanduar që thirrësi mysliman të marrë me vete duatë e përmendjes së Allahut dhiarit, ashtu siç janë transmetuar në sunet e të Dërguarit salAllahu alejhi ue sel-lem dhe që ato t'i lexojë pas namazit të sabahut, kur të bjerë në gjumë, kur të dalë e të hyjë në shtëpi, kur të hajë dhe të pijë, kur të vishet, kur të udhëtojë, kur të jetë prezent në vendin e tij dhe kur të zgjohet në mëngjes.

b. Besimtari gjen prehje duke e lutur Allahun në vetmi, nuk ndien veten të vetmuar gjatë lutjeve ndaj Allahut, e as nuk e ndien vetën ngushtë, por përkundrazi e shfrytëzon rastin për ta lutur Allahun.

e. Ndihet i kënaqur duke iu nënshtruar Allahut dhe nuk ndien kurrfarë vështirësie, ngase ai që e do dikë, i tilli kënaqet duke i shërbyer atij dhe se angazhohet për të. Mu për këtë namazi ka qenë si qetësim shpirtëror për të Dërguarin e Allahut salAllahu alejhi ue sel-lem kur lodhej me çështjet e kësaj bote. El-Xhunejdi (Allahu e mëshiroftë) ka thënë: prej shenjave të atij që e do Allahun është angazhimi i tij në nënshtrimin në Allahun.

ç. Nuk i Vjen e keqe çdo gjë që i kalon, pos nëse nuk e rikujton Allahun dhe për çdo moment që nuk e përmend Allahun i shtohet mërzia, e po ashtu brengoSet nëse nuk është angazhuar në adhurimin ndaj Allahut.

d. I jep përparësi bërjes së asaj vepre të cilën e do Allahu dhe këtë e vepron qoftë fshehtas, qoftë haptas, ngase ai që e do dikë sinqerisht i jep përparësi gjithmonë

asaj çfarë do ai që e do dhe se nuk ndien në vete kurrfarë mundimi apo lodhjeje në këtë vetëmohim.

e. E do takimin me Allahun, ngase ai që e do dikë ka dëshirë të takohet me të, pra ky nuk e urren vdekjen, ngase ajo është çelësi i takimit dhe rruga e arritjes tek Allahu.

ë. Që hidhërohet kur nuk respektohen ndalesat e Allahut. Kështu, i Dërguari i Allahut salAllahu alejhi ue sel-lem nuk hidhërohej për veten e tij, por hidhërohej për Allahun kur ndodhte që të mos respektoheshin ndalesat e Allahut. Pra, myslimani pikëllohet kur e sheh se myslimanët nuk po e respektojnë ligjin e Allahut. Transmetohet se si njëri prej shokëve të Dërguarit salAllahu alejhi ue sel-lem mendoj që ishte Ebu Derdai kishte hyrë në shtëpinë e vetë duke qarë, ndërsa e kishin pyetur: Pse po qan? Ai ishte përgjigjur: Kam hyrë në xhami dhe kam parë se njerëzit nuk e falin namazin ashtu siç i kam parë në kohën e të Dërguarit salAllahu alejhi ue sel-lem

2. Frika

Prej fryteve të besimit të thellë dhe kërkesave që rrjedhin prej tij është edhe frika ndaj Allahut. Pa dyshim se kulmi i urtësisë është frika ndaj Allahut. Ai që e njeh Allahun i frikësohet Atij, ndërsa ai që i frikësohet Allahut nuk i frikësohet askujt prej njerëzve, por njerëzit i frikësohen atij. Si shpjegim i kësaj është se e vërteta e frikës është të ndjesh dhimbje shpirtërore për shkak të dhimbjes që do të vijë në të ardhmen. Andaj, shkak i kësaj frike është dituria se çfarë dhimbjeje do të vijë në të ardhmen, frikën ndaj Allahut e di myslimani, ngase ky e di dënimin për shkak mosnënshtrimin ndaj Allahut dhe moskryerjes së obligimeve ndaj të Madhëruarit e të Lartësuarit. Kjo frikë vjen duke u shtuar sa do që shtohen njohuritë e myslimanit ndaj madhësisë së dënimin ndaj veprimeve që janë në kundërshtim me ligjet e Allahut, ngase Allahu, edhe po qe se e shkatërron gjithë botën, nuk ka kush e pengon Atë. Ajo që më së shumti e forcon te robi frikën ndaj Allahut është studimi i ajeteve kërcënuese në Kuran dhe se kërcënimin i tillë është i saktë, i vërtetë dhe pa kurrfarë iluzioni e hiperbolizimi. Pa dyshim se robërit shpërblehen ndëshkohen sipas punëve të tyre, për të mirat apo të këqijat që i bëjnë. Andaj, kur të arrijë ky iman-besim i thellë te myslimani e ai ta kuptojë ndikimin e gjynaheve për ta marrë dënimin, përpikërinë e dhënies së llogarisë, atë se vetëm Allahu është Ai i Cili do

të kërkojë llogari dhe mosnjohja se si do të jetë përfundimi, që të gjitha këto ndikojnë që në zemër të futet frika ndaj Allahut të Lartësuar dhe që myslimani të largohet nga të gjitha ato veprime të këqija për të cilat pason ndëshkimi i dhimbshëm. E pastaj kjo frikë nuk mbetet vetëm në zemrën e myslimanit, por ajo reflektohet edhe në jetën e tij, çdo besimtar do të jetë i frikësuar sikurse duket edhe i pikëlluar, i tilli as nuk tallet, as nuk mahitet e as nuk qesh, përveç nëse buzëqesh, ngase i pikëlluari i tronditur nuk gjen rast për t'u tallur, por, edhe nëse i jepet mundësia, nuk mund të bëjë mahi. Vërtet frika ka ndikim të qartë, ngase ai që frikësohet nga diçka ikën nga ajo gjë dhe i merr masat mbrojtëse prej saj. Andaj, për këtë njeriu ikën prej luanit sulmues e zjarrit shkatërrues. Gjynahet dhe gjynahet janë akrepa, gjarpinj, mjete dëmtuese dhe shkatërruese, ndaj patjetër secili që i ka frikën Allahut duhet të ikë prej tyre dhe që t'i mundë ato duke iu nënshtruar Allahut.

Vërtet thirrësi mysliman, kur e ndien frikën ndaj Allahut, ndalet e largohet prej gjynaheve dhe e bën atë me të cilën e mbron veten e tij prej dënimit në botën tjetër (ahiret). Si çështje kryesore e mbrojtjes prej gjynaheve është devotshmëria ndaj Allahut dhe si rezultat i devotshmërisë është xihadi në rrugën e Allahut angazhimi për të thirrur tek Allahu, me frikën ndaj Allahut shtohen udhëzimi dhe mëshira nga Ai. Allahu i Lartësuar ka thënë: “Udhëzime e mëshirë për ata që kanë frikë ndaj Zotit të tyre.” Udhëzimi dhe mëshira vjen në shprehje për atë që ia ka frikën Allahut të Lartësuar e jo edhe për atë që nuk i frikësohet Atij.

3. Shpresa

Prej fryteve të besimit të thellë është edhe shpresa dhe evitimi i pesimizmit nga mëshira e Allahut. Për këtë Allahu i Lartësuar u ka premtuar robërve të Tij besimtarë shumë gjëra në Librin e Tij Fisnik dhe ua ka ndaluar atyre që të bëhen pesimistë. Andaj, atij që e ka besimin e thellë i mbetet të besojë në atë që ia ka premtuar Allahu i Fuqishëm dhe i Mëshirshëm.

Kjo shpresë bart në vete edhe realizmin e shkaqeve, ndërsa prej shkaqeve është patjetër edhe nënshtrimi respekti ndaj Allahut e prej shenjave të respektit ndaj Tij është edhe thirrja në rrugën e Allahut. Pa dyshim se shpresë e vërtetë është qetësimi i zemrës duke pritur atë që është e dashur për shpirtin, por kur merren të gjitha shkaqet. E po qe se pritet shpresohet, duke mos i marrë shkaqet, atëherë

veprimi i tillë konsiderohet mashtrim dhe kokërrashësi. Shpresa në mëshirën, përkrahjen dhe kënaqësinë e Allahut bëhet duke i kërkuar shkaqet për të cilat na ka lajmëruar Krijuesi dhe na ka premtuar arritjen e mëshirës, përkrahjes, ndihmës dhe kënaqësisë së Tij. Andaj, myslimani që e ka imanin e thellë motivohet për t'i kërkuar shkaqet me aq sa ka mundësi duke mos i lënë anash dhe duke mos i vonuar ato, ky shpreson në Allahun se Ai ka për t'ia mundësuar marrjen e shkaqeve të dhura dhe do t'ia pranojë angazhimin e tij të vazhdueshëm. Shembulli i këtij është sikur shembulli i hedhjes së farës në tokë të pjellore e që më pastaj ujitet dhe hidhet pleh dhe kështu bujku përkujdeset derisa të vijë koha e korrjes. ndërsa bujku në këtë rast shpreson se Allahu do t'ia ruajë të mbjelluart e tij nga shkatërrimi. Thirrësi mysliman gjithmonë ka shpresa tek Allahu dhe asnjëherë nuk i humb shpresat tek Ai, duke pasur besimin në atë se Allahu u ka premtuar thirrëseve aktivë ndihmë, përkrahje dhe shpërblim; pra, thirrësi është i sigurt për ndihmë dhe përkrahje nga Krijuesi i madhërishtëm.

Lidhja e ngushtë e fortë

Kuptimi i lidhjes së ngushtë dhe ndikimi i saj

Me lidhjen e fortë synohet lidhja e thirrësit mysliman me Krijuesin e tij, duke u mbështetur tek Ai në çdo çështje, duke pasur bindje se Allahu i Lartësuar është i Vetmi që krijon, që përcakton, që sjell të keqen dhe të mirën dhe se Ai është i Vetmi që vepron çfarë të dojë dhe se mjafton Allahu si mbështetës: ***“Kushi mbështetet Allahut, Ai i mjafton atij”***. Posaçërisht ai i cili mbështet Allahut për çështjet e thirrjes tek Ai, për ndihmën e Tij, për ngritjen e fjalës së Tij dhe xihadin kundër armiqve të Tij. Allahu i Lartësuar, duke treguar për Musain dhe Harunin a.s. thotë: ***“Ata të dy thanë: Zoti ynë, ne kemi frikë se do të na ndëshkojë menjëherë ose do t'i kalojë kufijtë kundër nesh. Ai (Allahu) tha: Mos u frikësoni, se Unë (me ndihmën Time) jam me ju, dëgjoj (ç'do tju thotë) dhe shoh (ç'do të bëjë me ju) ”***. Ky lloj i ndihmës dhe i përkrahjes nuk është i përcaktuar vetëm për të dërguarit e Allahut salAllahu alejhi ue sel-lem, të cilët janë mbështetur Atij në kryerjen e misionit të Tij, por kjo është që i përfshin të gjithë robërit e devotshëm e posaçërisht thirrësit tek Allahu. Allahu i Lartësuar ka thënë:

“S’ka dyshim se Allahu është me ata që janë të devotshëm (që ruhen prej të këqijave) dhe me ata që janë bamirës.”

Gjendja e thirrësit mysliman në mbështetjen e tij tek Allahu duhet të jetë sikur gjendja e foshnjës që nuk e njeh askënd pos nënës së tij, kur ka frikë e kërkon atë, është i lidhur vetëm me atë, nuk mbështet askund pos tek ajo, kur e godet diçka nuk thërret askënd tjetër pos emrit të nënës. Kjo gjendje nuk nënkupton braktisjen e marrjes së shkaqeve, por ajo që nënkuptohet është të mos mbështetemi vetëm në shkaqe, ngase Allahu i Gjithëfuqishëm është krijues i shkaqeve, andaj duhet mbështetur tek Ai edhe pse janë marrë të gjitha shkaqet.

Kjo lidhje me Krijuesin e Lartësuar e të Madhëruar vjen duke u shtuar kur thirrësi mysliman e rikujton në vete atë se krijesat nuk kanë mundësi t’i bëjnë dobi e as dëm vetes e të tjerëve, ngase të gjitha çështjet, pa asnjë përjashtim, janë në Dorë të Zotit të Gjithëfuqishëm e Krenar. Andaj, kur thirrësi mysliman i përjeton këto koncepte në mendjen zemrën e tij do të largohet në mënyrë të prerë nga mbështetja te krijesat dhe se krejtësisht do të drejtohet kah Krijuesi dhe Ndhimuesi i Vetëm Allahu xh.sh.: ***“Sepse vetëm Allahu është ndihmëtar i juaji dhe Ai është më i miri ndihmës”***. ; ***“Allahu është mbikëqyrës i atyre që besuan ”***.

Përveç asaj që thirrësi tek Allahu mbështet për çdo çështje, ai e ka besimin dhe bindjen e prerë se Allahu është Ai i Cili e ruan atë, e ndihmon atë dhe i largon të këqijat prej tij. Allahu i Lartësuar ka thënë: “Allahu i largon dëmet e idhujtarëve ndaj atyre që besuan” ; “E tashmë fala (premtimi) jonë u është dhënë më parë robërve tanë të dërguar, se ata, pa dyshim, do të jenë të ndihmuar, se ata, pa dyshim, do të jenë të ndihmuar.”

Mirëpo, nuk i lejohet thirrësit mysliman që t’ia përcaktojë Allahut kohën, mënyrën dhe formën e ndihmës kundër armiqve të Tij. Allahu i Lartësuar ka thënë: ***“Ne patjetër do të ndihmojmë të dërguarit tanë në jetën e kësaj bote, edhe ata që besuan, e edhe në ditën e prezantimit të dëshmive.”*** Ibn Kethiri për komentimin e këtij ajeti thotë: Qëllimi me ndihmën dhe ngadhënjimin ndaj atyre që i kanë munduar ata është se kjo ndihmë dhe ky ngadhënjim ka ndodhur duke qenë prezentë, ose kur nuk kanë qenë prezentë, apo edhe pas vdekjes së tyre, sikurse veproi Allahu me mbytësit e Zekerijas a.s., Jahjas a.s. dhe Shuajbit a.s. Pra, Allahu ka bërë që armiqtë e këtyre të kenë mundësi për t’i sunduar ata dhe ta derdhë

gjakun e tyre mbytësve. Hebrenjtë, të cilët deshën ta mbysin Isain a.s., Allahu bëri që të sundoheshin nga bizantinët, t'i poshtëronin dhe mundonin ata. Es'Sedi ka thënë: Nuk ka dërguar Allahu asnjëherë të dërguar e që atë e kanë mbytur, apo nuk ka dërguar ndonjë popull besimtar që ka thirrur në rrugë të vërtetën e të cilët janë mbytur e që Allahu të mos ketë dërguar dikë menjëherë në atë shekull, që u ndihmon atyre dhe që kërkon nxjerrjen e gjakut të tyre në këtë botë. Po ashtu, ky (es-Sedi) ka thënë: të dërguarit dhe besimtarët janë mbytur në këtë botë, por ata prapë kanë qenë ngadhënjimtarë. Kështu ishte puna me të Dërguarin e Allahut, të cilin Allahu e kishte urdhëruar që të emigronte, e më pastaj u kthye si çlirues dhe ngadhënjyes.

Thirrësi mysliman e ndihmon fenë e tij, duke thirrur në atë fe, kurse Allahu i Lartësuar është Ai që e ndihmon atë (thirrësin). Allahu i Lartësuar ka thënë: ***“E Allahu patjetër do ta ndihmojë atë që ndihmon rrugën e Tij”***, pra, thirrësi tek Allahu duhet të jetë tërësisht i bindur në këtë përkrahje dhe kurrsesi nuk duhet pasur dyshim në të. Kur është kthyer i Dërguari Allahut salAllahu alejhi ue sel-lem prej Taifit, banorët e të cilit e kishin refuzuar dhe e kishin kthyer atë në mënyrën më të keqe, e me të ishte Zejdi radijAllahu anhu, i Dërguari salAllahu alejhi ue sel-lem i tha Zejdit: ***“Allahu është Ai i Cili jep rrugëdalje dhe se Allahu është që e ndihmon fenë e Tij dhe të Dërguarin e Tij”***. Thirrësi nuk e humb shpresën asnjëherë tek Allahu, ngase pesimizmi është i ndaluar dhe nuk bën të qarkullojë në gjakun e atij që është i lidhur me Allahun, por pesimizmi futet në zemrat e jobesimtarëve, të cilët nuk janë të lidhur me Allahun. Allahu i Lartësuar ka thënë: ***“E mos e humbni shpresën nga mëshira e Allahut, pse vetëm populli jobesimtar e humb shpresën në Allahun ”***.

Vërtet kjo lidhje me Krijuesin e Madhërishëm është e domosdoshme për thirrësin mysliman që atij t'i lehtësohen mundimet, t'i pakësohen dhimbjet dhe e largon prej zemrës frikën ndaj njerëzve: ***“E atyre (shokëve të pejgamberit) që dikush u tha: Populli (idhujtarët) është tubuar t'ju sulmojë, pra kini frikë! Ajo vetëm ua shtoi edhe më shumë besimin e thanë: Neve na mjafton që e kemi Allahun, Ai është mbrojtësi më i mirë!”*** Po ashtu, thirrësi ndien në vete krenarinë e besimit-imanit, ngase a: është i lidhur me të Fuqishmin dhe Krenarin: ***“Ndërsa e tërë krenaria i takon Allahut, të dërguarit të Tij dhe besimtarëve, por hipokritët këtë nuk e dinë.”*** Në syrin e thirrësit nuk konsiderohet madhështore e pavërteta e as ai që e proklamoi atë, ngase e pavërteta dhe ata që e proklamojnë atë janë gjëra të nënçmuara dhe të pavlera, andaj nuk ka mundësi që këto të konsiderohen në sytë e besimtarëve si çështje madhështore.

Morali - etika e thirrësit

Etika-morali i thirrësit është etika islame

Etika-morali i thirrësit mysliman është etika islame të cilën e ka shpjeguar Allahu në Kuran, e ka sqaruar i Dërguari i Allahut salAllahu alejhi ue sel-lem në sunetin e tij dhe me këtë moral janë stolitur shokët e të Dërguarit salAllahu alejhi ue sel-lem dhe sipas tij ata edhe kanë vepruar. Kjo etikë-moral është i domosdoshëm për çdo mysliman, andaj nuk i mbetet atij tjetër pos që të veprojë sipas këtij morali dhe që ta peshojë vetveten sipas kësaj etike për ta kuptuar se çfarë ka prej këtij morali dhe çfarë ende nuk e ka arritur të përvetësojë. Për moralin islam kemi shpjeguar në kapitujt e mëhershëm, andaj nëse dëshiron ta kuptosh këtë moral kthehu dhe lexo më herët. Megjithatë, ne duam që në këtë temë të përmendin disa nga çështjet e etikës islame që kanë lidhje të ngushtë me veprimin e thirrësit dhe të cilat janë nevoja të domosdoshme për të pasur sukses të mirë dhe të pranuar në punën e vet thirrësi.

Sinqeriteti

Në Librin e Allahut të Lartësuar ka ajete të shumta, të cilat flasin për sinqeritetin dhe vlerën e tij, i urdhërojnë besimtarët që të jenë me ata që janë të sinqertë: ***“O ju që besuat, ta keni në kujdes Allahun dhe të jeni me ata të drejtit.”***

Sinqeriteti në ditën e kiametit i bën dobi robit duke e shpëtuar atë nga hidhërimi i Allahut dhe duke e futur në xhenet: ***“Allahu tha: Kjo është dita që të drejtëve u bën dobi drejtësia e tyre. Ata kanë xhenete në të cilët rrjedhin lumenj, janë përjetë të pasosur në to. Allahu është i kënaqur me ta dhe ata janë të kënaqur ndaj Tij. Ky është shpëtim i madh ”.***

Esenca e sinqeritetit është arritja e ndonjë gjëje në mënyrë të përsosur dhe krejtësisht të bashkuar, si dhe përforcimi i saj, kështu është shprehur Ibn Kajjimi në librin e tij *“Medarixhu Salihin”*. Sinqeriteti duhet të vijë në shprehje si në synim, fjalë dhe veprë. Kuptimi i sinqeritetit në synim është përsosmëria e

vendosmërisë dhe fuqia e dëshirës për të ecur rrugës deri tek Allahu dhe tejkalimi i të gjitha pengesave, Kjo realizohet duke nxituar në kryerjen e obligimeve të prera që i ka caktuar Allahu siç është xhihadi në rrugën e Tij dhe thirrja tek Allahu dhe në të njëjtën kohë pengimi i çdo penguesi apo frenuesi dhe largimi prej tyre, ngase ata janë njerëz që jetojnë në pakujdesi dhe se vetëm për këtë botë punojnë. Kjo është grada e diturisë së tyre e që në realitet kjo është injoranca dhe hamendja e tyre. Në realitet zemra e të sinqertit është shumë e ndjeshme dhe se nuk mund t'i durojë këta pengues, andaj për këtë ky nuk mund të rrijë me ta dhe as t'i shoqërojë ata. Ky i sinqertë e ka zemrën të hapur dhe i buzëqesh atij që nxiton të arrijë tek Allahu dhe që bën thirrje për tek Ai. Ndërkaq, sa i përket sinqeritetit në fjalë ajo kuptohet që gjuha të flasë të vërtetën dhe kurrsesi të mos e Hasë të pavërtetën pavarësisht se çfarë është ajo. Kurse sinqeriteti në vepra është që ato të zbatohen në pëlqim me programin e shariatit islam dhe duke ndjekur rrugën e të Dërguarit salAllahu alejhi ue sel-lem Kur ndodh që myslimani ta realizojë sinqeritetin në fjalë, qëllim dhe vepër, atëherë ky arrin në atë gradë të sinqeritetit, për të cilën Allahu i ka urdhëruar robërit e Tij dhe ka kërkuar që ata të stolisen me këtë sinqeritet. Allahu i është drejtuar të Dërguarit Fisnik, duke i thënë: ***“Dhe thuaj: Zoti im, më shpjer në një vend të mirë dhe më nxirr në mënyrë të ndershme dhe nga ana jote më dhuro fuqi ndihmuese.”*** Me shprehjen më shpjer në një vend të mirë dhe me nxirr në mënyrë të ndershme nënkupton hyrjen e myslimanit dhe daljen e tij në atë për çka është i kënaqur Allahu, d.m.th. veprat dhe braktisjet e disa veprimeve duhet të bëhen për hatër të Allahut, duke e kërkuar ndihmën e Allahut dhe duhet synuar kënaqësinë e Tij, pra qëllimi parësor të jetë vetëm Allahu: ***“Thuaj: Namazi im, kurhani im, jeta ime dhe vdekja ime janë thjesht për Allahun, Zotin e botëve.”*** Kur myslimani e arrin këtë gradë të sinqeritetit, atëherë atij nuk i mbetet ndonjë synim tjetër në këtë botë pos synimit që të arrijë kënaqësinë e Allahut, e po qe nuk e arrin këtë synim, apo nuk ka pasur mundësi ta arrijë këtë, atëherë ky nuk do më të jetojë, por e dëshiron vdekjen.

Transmetohet se Umer ibn el-Hatabi radijAllahu anhu ka thënë: ***“Sikur të mos ishin tri gjëra nuk do të kisha dashur të jetoja fare: sikur të mos ishte mundësia për të shkuar në xhihad si kalorës që lufton për hatër të Allahut, falja e namazit natën dhe qëndrimi me njerëzit që zgjedhin të flasin vetëm fjalë të mira”***. Umeri radijAllahu anhu me këto tri gjëra ka synuar: xhihadin në rrugën e Allahut, faljen e namazit dhe diturinë e dobishme. Për të gjitha këto është i kënaqur Krijuesi i Madhëruar.

Thirrësi mysliman i sinqertë e manifeston ndikimin e sinqeritetit të tij në fytyrën dhe në zërin e tij. I Dërguari s.a.v.s, kur u fliste atyre që nuk e njihnin, ata thoshin: Pasha Zotin fytyra e tij po tregon se nuk është gënjeshtar dhe zëri i tij po tregon se nuk është gënjeshtar. Pa dyshim se manifestimi i gjurmëve të sinqeritetit në fytyrën e thirrësit dhe në zërin e tij do të kenë ndikim tek ai që po i flet dhe kjo ndikon që dëgjuesi t'i pranojë fjalët e thirrësit dhe që ta respektojë atë, edhe po që se zemra e tij është kundërshtuese e madhe. Si do që të jetë çështja, hipokrizia si bazë e ka gënjeshtren. Si është e mundur që thirrësi të jetë gënjeshtar? Sipas asaj që ka thënë i Dërguari i Allahut është se gënjeshttra shpie në gjynahe, andaj si është e mundur që gjynahqari të jetë thirrës tek Allahu?

Durimi

Durimi është ndër obligimet islame dhe se konsiderohet si gjysma e besimit. Kurani Fisnik e ka përmendur këtë në më shumë se tetëdhjetë vende dhe ka urdhëruar për të bërë durim: ***“Kërkoni ndihmë (në të gjitha çështjet) me durim dhe me namaz.”***, po ashtu ka ndaluar nxitueshmërinë duke thënë: ***“Ti (Muhamed) duro, ashtu sikurse duruan të dërguarit e vendosur dhe mos kërkoni ngutjen e dënimit për ta”***; Allahu i do ata që durojnë: ***“Allahu i do durimtarët”***. Allahu është me ata që janë durimtarë: ***“Të jeni të durueshëm se Allahu është me të durueshmit.”*** Durimi përfundimin e ka të mirë: ***“:por të jeni të durueshëm, është më mirë për ju”***. Shpërblimi për durimin është shumë i madh: ***“ndërsa të durueshmëve u jepet shpërblimi i tyre pa masë”***, durimtarët janë ata që kanë dobi nga ajetet dhe këshillat: ***“se vërtet në ato (rikujtime) ka argumente për secilin që është shumë i durueshëm dhe shumë falënderues.”*** Durimi është shkak për të hyrë në Xhenet; ***“(u thonë) Selamun alejkum, me durimin tuaj gjetët shpëtimin; sa përfundim i lavdishëm është ky vend”***. Me durim dhe bindje të thellë arrihet imameti grada më e lartë e diturisë në fe: ***“Dhe prej tyre Ne bëmë prijës që me urdhrin Tonë udhëzojnë, pasi që ata (që i bëmë prijës) ishin të durueshëm dhe ndaj argumenteve Tona ishin të bindur.”*** Këto janë disa nga ajetet që flasin për durimin-sabrin. Në sunetin e të Dërguarit salAllahu alejhi ue sel-lem ka shumë hadithe që flasin për sabrin-durimin, si: ***“Askujt nuk i është dhënë diçka më e mirë se durimi”***; ***“E çuditshme është çështja e besimtarit, krejt çështja e tij është në dobi të tij, askush nuk është sikur ai, ngase kur besimtarit i vjen ndonjë e mirë ai***

falënderon Allahun, e kjo është mirë për të; ndërsa kur e godet ndonjë e keqe, duron, prandaj edhe kjo është e mirë për të”.

Shprehja sabër në kuptimin etimologjik d.m.th. izolim, pengim, ndërsa në kuptimin terminologjik të sheriatit sabri është tre llojesh: durimi në kryerjen e urdhrave të Allahut, durimi që të largohemi prej veprave që janë gjynah dhe durimi ndaj fatkeqësive e sprovave.

Sa i përket durimit-sabrit në zbatimin e urdhrave të Allahut ai realizohet duke qenë gjithmonë i nënshtruar ndaj Allahut dhe duke kryer adhurimin në mënyrë të sinqertë, ashtu siç e përcakton sheriatu islam. Ky lloj sabri ndihmon në njohjen e Allahut dhe obligimet që i kanë robërit ndaj Tij dhe kështu realizohet shpërblimi për ata që janë të nënshtruar. Ndërkaq sa i përket sabrit-durimit që të largohemi prej veprave që janë gjynah realizohet, duke ikur prej gjynaheve vazhdimisht dhe me këtë sabër-durim robi arrin të rikujtojë frikën ndaj dënimit të Allahut, dhe më e lartë se kjo është të arrihet shkalla që të turpërohemi prej Allahut dhe të largohemi prej të ndaluarave për shkak të dashurisë që kemi për të' Fryti i këtij durimi është vazhdueshmëria e imanit, përforcimi i besimit dhe shtimi i tij, ngase gjynahet e pakësojnë imanin, e dobësojnë atë, e nxin atë ose ia humb shkëlqimin atij.

Ndërsa sa i përket sabrit - durimit në fatkeqësi dhe sprova, ky lloj sabri-durimi realizohet duke braktisur hidhërimin dhe duke duruar gjërat e dhimbshme, e duke mos u ankuar te njerëzit, ngase durimi-sabri i mirë asnjëherë nuk përputhet me ankirin te krijesat, por lejon që njeriu t'i ankohet Allahut. Allahu i Lartësuar kur tregon për Jakubin a.s. thotë: ***“Ai (Jakubi) tha: Unë hidhërimin tim dhe pikëllimin tim ia parashtroj Allahut, e unë di për Allahun atë qëju nuk e dini.”*** Kur tregon për Ejubi a.s. thotë: ***“(Rikujtoje) Edhe Ejubin kur i'u drejtua Zotit të vet me lutje: Më gjeti belaja, e Ti je më Mëshiruesi ndër Mëshiruesit.”***, po ashtu në një ajet tjetër thuhet: ***“Vërtet, Ne e gjetëm atë të durueshëm. Sa rob shumë i mirë ishte ai dhe i kthyer te Zoti ”.*** Pra, ky sabër kërkon që të rikujtohen begatitë e Allahut, të Cilat nuk ka mundësi të numërohen e as të evidentohen, ky rikujtim i lehtëson dhimbjen atij që e ka goditur e keqja shembulli i tij është sikur shembulli i atij që i jep një njeriut një mijë dinarë dhe ai e humb një dinar. Po ashtu ajo që rezulton nga ky sabër është shpërblimi i madh ndaj atyre që janë durimtarë.

Durimi bëhet me ndihmën e Allahut dhe vetëm për Allahun

Të gjitha llojet e durimit-sabrit bëhen me ndihmën e Allahut d.m.th. se myslimani beson se sabri i tij është bërë me ndihmën e Allahut, pra Allahu është Ai që e jep sabrin. Allahu i Lartësuar ka thënë: ***“Pra, të jesh i durueshëm! Durimi yt është vetëm me ndihmën e Allahut.”*** Ndërkaq, durimi që duhet të bëhet vetëm për Allahun nënkupton atë që myslimani bën sabër si nënshtrim ndaj Allahut dhe për ta arritur kënaqësinë e Tij. Ajo që e motivon atë të durojë është dashuria ndaj Allahut dhe kërkimi i kënaqësisë së Tij. Ky lloji i sabrit-durimit më shumë përfshin në vete sabrin-durimin e nënshtrimit ndaj Allahut dhe sabrin-durimin për t’iu shmangur gjynaheve sesa sabrin ndaj fatkeqësive dhe sprovave. Pra, në llojin e parë të sabrit është zgjedhja, vetëmohimi dhe dashuria ndaj Allahut, ndërsa në llojin e dytë është i domosdoshëm, ngase nuk ke çfarë të bësh dhe se durimtari në këtë rast nuk ka zgjedhje, por doemos duhet duruar.

Nevoja e njeriut për durim

Sabri është një cilësi e domosdoshme për çdo njeri, ngase pa sabër njeriu nuk mund ta arrijë synimin e tij, sepse në shumë raste nuk mund të arrihet synimi, pos me mundim dhe me përkushtim të vetvetes ndaj disa çështjeve të jetës. Ai është një çështje që vlen për të gjitha çështjet e jetës, pra studenti e izolon veten për t’i përsëritur mësimet dhe e pengon veten që t’i bëjë disa kënaqësi shpirtërore me të vetmin qëllim që t’i mësojë mësimet dhe të ketë sukses në provim. Po kështu secili që ka synim për të arritur diçka. Ajo që thuhet për individ mund të thuhet edhe për shoqëritë, pra ajo shoqëri që dëshiron të arrijë ndonjë cak, duhet të bëjë sabër të madh duke u bërë ballë problemeve dhe ngarkesave. Ngadhënjimi në lufta arrihet duke i marrë shkaqet e njëri prej shkaqeve më të mëdha është sabri-durimi. Sabri-durimi është çështje e domosdoshme për çdo njeri në këtë jetë, sepse përndryshe do të jetë i brishtë dhe shpejt do të thyhet para ndodhjeve të shumta në jetë, ngase jeta është e mbushur përplot me vështirësi, mundime, Vështirësi dhe dhimbje. E nëse ndodh që njeriu të mos u rezistojë këtyre gjërave me sabër-durim, ai do të thyhet, do të dobësohet personaliteti i tij në rrugët e jetës, atij do t’i humbë guximi dhe do të largohet nga njerëzit.

Pasi që durimi-sabri është fenomen i domosdoshëm për çdo njeri që jeton dhe dëshiron të arrijë në synimin e tij , atëherë sabri-durimi për myslimanin është më shumë i domosdoshëm sesa për këdo tjetër, ngase prej myslimanit kërkohet që ta pengojnë veten nga gjynahet e në gjynahe ka kënaqësi të pasionit dhe është vështirë të ndalesh nga ai pasion, ngase për këtë është e nevojshme një dëshirë dhe vullnet i fuqishëm për të penguar veten dhe larguar atë prej gabimitgjynahut.

Gjithashtu, prej myslimanit kërkohet të bëjë vepra që janë nënshtrim ndaj Allahut, e edhe ky nënshtrim kërkon që myslimani ta pengojë veten nga disa gjëa. Ky është sabri-durimi i nënshtrimit ndaj Allahut.. Po ashtu kërkohet nga myslimani që të bëjë sabër ndaj çdo të papriture-fatkeqësie që të mos bëhet ankues i tepërt vetëm e vetëm që të mos bëjë gjynah dhe që të mos humbë shpërblimim sevapin e durimit.

Domosdoshmëria e durimit për myslimanin

Pasi që durimi është çështje e domosdoshme për çdo njeri, e posaçërisht për myslimanin, atëherë durimi për thirrësin mysliman është shumë më i domosdoshëm se për tjetrin, ngase ai punon në dy arena, në arenën e luftës me egon-vetveten duke angazhuar veten me nënshtrim ndaj Allahut dhe me largim prej gjynaheve dhe në arenën që s'ka të bëjë me vetveten, atë të thirrjes së njerëzve për tek Allahu, duke u folur njerëzve për tematikën e thirrjes për tek Allahu. Andaj për këto dy arena nevojitet një masë e madhe e sabrit-durimit. Pra, duhet të ketë sabër në këto dy arena, me qëllim që të ketë mundësi t'i tejkalojë pengesat dhe sfidat, ngase ne përballemi me këto çështje në të cilat ka mundim dhe dhimbje. E po qe se humb sabri-durimi, atëherë njeriu ndalet dhe largohet prej arenës duhet merituar kështu dënimin dhe humbjen e shpërblimit.

Sprovimi është i domosdoshëm

Sprovimi është i domosdoshëm, andaj patjetër duhet bërë sabër-durim për ta kaluar provimin me sukses. Allahu i Lartësuar ka thënë: ***“A menduan njerëzit të thonë: Ne kemi besuar, e të mos vihen në provë? Ne i sprovuam ata që ishin para tyre, ashtu që Allahu gjithqysh do t'i dallojë ata që të thanë të vërtetën e do t'i dallojë***

edhe gënjeshtarët.” ; “Allahu nuk është që t’i lërë besimtarët ashtu siç janë, pa dalluar të keqin nga i miri.” ; “ Po ju menduat se do të hyni në xhenet, pa u provuar edhe ju me shembullin e atyre që ishin para jush, të cilët i patën goditur skamjet e vuajtjet dhe qenë tronditur, saqë i dërguari thoshte, e me të edhe ata që kishin besuar: Kur do të jetë ndihma e Allahut!? Ja (u erdhi ndihma) vërtet ndihma e Allahut është afër!” Sprovimi është njëri prej ligjeve të Allahut në këtë jetë, Ai i sprovon kë do prej robërve, kur do dhe si do, me qëllim që të dalë në shesh ajo që është në shpirtat e tyre, besimi-imani apo hipokrizia. Ky sprovim mund të jetë me shumë gjëra, e në krye të këtyre sprovimeve janë obligimet e sheriatit, të cilat do të jenë provë dhe provim për robin, ngase në këtë rast përballen mes vete nënshtrimi ndaj Allahut dhe pasionet-kënaqësitë e epshit. Andaj kur i jepet përparësi nënshtrimit ndaj Allahut të Lartësuar përballë kënaqësive dhe dëshirave të epshit, në këtë rast kalohet provimi me sukses, sepse për ndryshe ndodh që të bihet në provim. Po ashtu sprovimi mund të jetë me fatkeqësi dhe tragjedi, siç janë sëmundja, humbja e krenarisë dhe shkatërrimi i pasurisë, andaj nëse myslimani bën sabër dhe i rikthehet Allahut (duke thënë ne jemi të Allahut dhe tek Ai është kthimi ynë) dhe nuk plogështohet, atëherë Allahu e shpërblen me sevapin e durimtarëve dhe se në këtë provim besimtari do të jetë prej atyre që kanë sukses, përndryshe do të jetë prej të humburve.

Sprovimi ndaj thirrësve tek Allahu

Pasi që sprovimi është njëri prej ligjeve të Allahut në këtë jetë, atëherë sprovimi ndaj thirrësve tek Allahut është njëri prej ligjeve hyjnore. Po ashtu këta sprovohen me të këqijat që ua sjellin jobesimtarët, qofshin ato të këqija fjalë, mashtrime, apo dhunë fizike. Allahu i Lartësuar ka thënë: ***“Janë përgënjeshtuar të dërguar para teje, duruan atë gënjeshtër dhe u torturuan përderisa u erdhi ndihma jonë, prandaj s’ka kush që i ndryshon(premtimet) e Allahut. E ti je i njohur me disa nga ngjarjet e të dërguarve (edhe ti do të ndihmohesh sikurse ata) ”.*** ***“Ne dimë mirë se ti ngushtohesh shpirtërisht për atë që thonë ata. Po ti madhëroje me flënderime Zotin tënd e bëhu prej atyre që luten (përulen duke u falur). Dhe adhuroje Zotin tënd deri të vijë ty e vërteta (vdekja) ”;*** ***“Ti, pra, bëj durim, sepse premtimi i Allahut është i saktë, e kurrsesi të mos luhatin ty ata që janë të dyshimtë’.*** Shprehja e ajetit “të mos luhatin” ka domethënien që ata ty, o Muhamed, do të mundohen të të nxisin të veprosht rrufeshëm duke mos bërë durim.

Thirrësve në rrugën e Allahut, jobesimtarët iu thurin kurthe, shpifin ndaj tyre trillime, i mundojnë ata me shumë mënyra dhe këtë e bëjnë për arsye se ata janë popull injorantë dhe të devijuar. Vërtet shokët e të Dërguarit salAllahu alejhi ue sel-lem në Mekë janë torturuar në mënyrat më të ashpra të torturës, por i Dërguari i Allahut salAllahu alejhi ue sel-lem i urdhëronte ata që të bëjnë sabër. I Dërguari i Allahut salAllahu alejhi ue sel-lem kur e kishte parë familjen e Jaserit, duke u torturuar u kishte thënë: *“Duroni o familja e Jasirit, ngase vendi i premtuar për ju është xheneti”*. Andaj, thirrësi mysliman e ka bërë obligim që t’i përballojë torturat dhe mundimet, duke bërë durim-sabër, ashtu si ka vepruar i Dërguari i Allahut a.s., shokët e tij fisnikë dhe të dërguarit e Allahut më herët. Pa dyshim se ky durim është ai që i bën besimtarët të vendosur dhe ua kontrollon dëshirat: ***“Përballoje me durim çdo gjë që të godet, vërtet, këto janë nga çështjet më të preferuara.”***; ***“Ju patjetër do të sprovoheni si në pasurinë tuaj, si në veten tuaj, madje do të dëgjoni ofendime të shumta prej atyre që u është dhënë libri para jush, e edhe prej idhujtarëve, por në qaftë se duroni dhe ruheni, ajo është gjëja më vendimtare”***

Të kërkuarit e sprovimit dhe evitimi i tij

Pasi që sprovimi që i godet thirrësit për tek Allahu është njëri prej ligjeve të Allahut, atëherë a duhet të nënkuptohet me këtë se thirrësi mysliman duhet të kërkojë prej Allahut që të sprovohet dhe të veprojë që të bjerë në sprovë dhe as nuk i lejohet të mbrohet prej Sprovimit? Për këtë çështje duhet shpjeguar hollësisht, ngase çështja është konfuze për shkak të keqkuptimit e jo për shkak të nijetit të keq. Për ta sqaruar këtë çështje do të përmend me sa vijon:

E para, kërkohet prej thirrësit mysliman që ta lusë Allahun t’ia mundësojë t’i zbatojë mjetet dhe mënyrat e thirrjes, ashtu si i ka shpjeguar Kurani Fisnik dhe i ka praktikuar i Dërguari i Allahut salAllahu alejhi ue sel-lem E nëse këto mjete i sjellin thirrësit ndonjë telash, i tilli duhet bërë sabër e jo të ankohet, me vendosmëri e jo me ikje.

E dyta, pasi që thirrësi mysliman ka liri që të mbrohet prej ndonjë pasoje-telashi, në këtë rast ai nuk e ka për obligim që të përballet me torturën, por ai duhet t’i

marrë masat e mundshme për t'u mbrojtur sipas rrethanave dhe gjendjes. Pra, i lejohet atij që të largohet prej torturës e të mos përballet direkt, por nganjëherë do ta ketë obligim që të largohet prej torturës dhe të mos përballet direkt me të, ngase sprovimi është i vështirë për shpirtin, andaj nuk lejohet që të kihet dëshirë që ta godasë sprovën, ngase në këtë sprovë përfundimi është i panjohur. Ndodh që myslimani ndien në vete fuqi për t'u përballur dhe se nuk frikësohet nga sprovën, por këtë ka mundësi ta bëjë duke pasur dëshirë që të arrijë shpërblimin prej Allahut, apo ndoshta ndikon cytja e shejtanit që të veprojë kështu vetëm e vetëm që të thonë njerëzit: sa i qëndrueshëm dhe sa i durueshëm ishte ai ndaj sprovës. E ndodh që kur ta godasë ndonjë telash ai nuk mund t'i përballojë sprovën dhe të bjerë prej provimit. Sikurse transmetohet se njëri kishte thënë: O Zoti im, më sprove me çfarë të duash se unë do të jem i kënaqur me caktimin Tënd dhe do të jem durimtar në atë sprovë që e cakton Ti. Allahu këtë e sprovoi duke ia pamundësuar që të urinojë, ndërsa ky filloi të bërtiste, të mallkonte e të sillej rreth e rrotull fëmijëve duke u thënë: gjuajeni xhaxhanë tuaj gënjeshtar me gurë.

E treta, myslimani nuk duhet të ekspozohet ndaj asaj sprove të cilës nuk mund t'i bëjë ballë, e që më pastaj të bjerë në provim. Përmendet në hadithin e të Dërguarit s.a.v.s: *“Nuk duhet që myslimani të poshtërojë veten e tij. Ata thanë: O i Dërguari i Allahut, si është e mundur që myslimani të poshtërojë veten e tij. Ai tha: kërkon që të sprovohet me diçka që nuk mund ta përballojë.”*

E katërta, myslimani duhet që të bëjë dua të transmetuara e me të cilat kërkohet falje prej Allahut.

Në kërkimin e faljes hyn edhe kërkesa për të shpëtuar nga sprovat dhe mundimet dhe kjo argumenton atë se shpëtimi prej sprovave e mundimeve që i bëjnë jobesimtarët është veprim i lavdëruar e jo i nënçmuar.

E pesta, në porosinë e të Dërguarit s.a.v.s, të cilën pak ditë para Vdekjes së tij ia kishte dhënë Usame ibn Zejdit që e kishte caktuar si udhëheqës i ushtrisë, e cila ishte nisur për të luftuar bizantinët, kishte thënë: *“Mos e lakmoni takimin me armikun, se ju nuk e dini se ndoshta ajo do të jetë sprovë për ju, por ju thoni: O Zoti ynë, na ndihmo neve dhe pengojë ata që të luftojnë kundër nesh.”*

Krijuesi ynë i Lartësuar dhe i Madhëruar në Kuranin Fisnik ka thënë: **“Dhe Allahu ua largoi luftën besimtarëve. Allahu është i fuqishëm, ngadhënjyes.”** Nga ky ajet kuptohet se largimi i luftës besimtarëve nga Allahu është njëra prej begative të Allahut ndaj besimtarëve. Andaj, në luftë ka dëme-pasoja, dhimbje e mundim, e sikur të ishte e kërkuar që myslimani t'i ekspozohet sprovimeve dhe vuajtjeve, atëherë nuk do të ishte nevoja që Allahu ta largojë luftën prej besimtarëve.

E gjashta, torturat që i bëjnë jobesimtarët besimtarëve nuk janë të kërkuara kurrsesi, por jo vetëm kaq ngase torturat e tilla janë gjynahe të jobesimtarëve, ato janë mundim për ata që e ndjekin të vërtetën, andaj si mund të lejojë një mysliman që ta dorëzojë veten para atij që e është në rrugë të gabuar dhe të poshtërohet para tij? Kini kujdes, Vallë a nuk është ky dorëzim si ndihmë që të bëhet ajo vepër që shkakton hidhërimin e Allahut dhe hedhja e vetes në shkatërrim e nënçmim? Që të gjitha këto nuk lejohen.

E shtata, Allahu atij që është i detyruar me dhunë i ka lejuar që ta shprehë mohimin e Allahut vetëm e vetëm që ta shpëtojë jetën nga shkatërrimi dhe tortutimi. Pra, kjo argumenton atë se lejohet pengimi i torturës dhe që myslimani nuk duhet të ndihmojë që të vihet deri te torturimi.

E teta, kur Halid ibn Velidi radijAllahu anhu dhe ushtarët myslimanë, të cilët ishin me të, ishin larguar nga beteja e Mu'tetes dhe kishin hyrë në Medinë, atëherë njerëzit filluan të hidhnin baltë mbi ushtinë dhe u thoshin atyre: O ju që keni ikur, keni ikur prej rrugës së Allahut, ndërsa i Dërguari i Allahut salAllahu alejhi ue sellem thoshte: **“Këta nuk janë që kanë ikur, sepse ata do të rikthehen nëse do Allahu i Lartësuar”**. Ajo që argumentohet me këtë ndodhi është se Halid ibn Velidi dhe myslimanët, të cilët ishin me të, kanë ikur nga beteja me qëllim që të shpëtojnë nga mundimet dhe torturat. Pra, këta myslimanët e Medinës i qortuan dhe i cilësuan si njerëz që kishin ikur prej luftës, ndërsa zotëria i të diturve, i Dërguari Allahut s.a.v.s, i kishte shikuar këta me një sy tjetër, duke e kuptuar se ikja e tyre prej betejës ishte një lloj i fitores së suksesshme për shkak se ata kishin shpëtuar prej mbytjes, torturimeve dhe zënies rob nga ana e politeistëve, andaj ikja e tyre ka qenë një mënyrë e veprimit, sikurse ndodh të ndërrohet strategjia e luftës. Kjo e argumenton atë se largimi i Sprovimit dhe telasheve është çështje e kërkuar po që se myslimani ka mundësi ta pengojë atë, ndërsa dorëzimi i myslimanit para torturave dhe mundimeve, duke pasur mundësi të shpëtimit, është çështje e qortuar dhe kurrsesi s'është vepër e lejuar.

E nënta, myslimanët kanë emigruar prej Mekës në Etiopi për shkak të tyre dhe shpëtimit prej mundimeve e torturave të kurejshëve. Kjo argumenton faktin se lejohet evitimi i torturave dhe mosdorëzimi ndaj tyre me argumentin se këtë po e bën për hatër të Allahut. Arsyeja e kësaj është se shpirti i myslimanit nuk është pronë e tij, por ajo është pronë e Allahut, andaj nuk lejohet shkatërrimi i tij nëse nga kjo gjë nuk ka dobi feja islame dhe nuk është e dobishme ajo që të thonë njerëzit: ah, sa i vendosur që ka qenë ky thirrësi dhe se si iu ka përballuar mundimeve-torturave për hatër të Allahut. Jo vetëm kaq, por ky veprim mund të bjerë edhe në kategorinë e veprimit që bëhet sa për sy e faqe dhe për të fituar famë të njerëzit, ndërsa ky veprim nuk lejohet.

E dhjeta, vërtet i Dërguari i Allahut salAllahu alejhi ue sel-lem nuk ka parë kurrfarë të keqe që xhaxhai i tij, Ebu Talibi, e mbronte atë prej torturave të popullit të tij kurejshëve, edhe pse ai ishte në fenë e tyre. Pasi që vdiq Hatixheja radijAllahu anhu dhe xhaxhai i të Dërguarit s.a.v.s, Ebu Talibi, po në të njëjtin vit, atëherë atë vit e emërtuan si “Viti i pikëllimit”. I Dërguari i Allahut salAllahu alejhi ue sel-lem ka thënë: *“Kurejshët nuk kanë mundur të më bëjnë asnjë të keqe derisa ishte gjallë Ebu Talibi”*. Pra, i Dërguari i Allahut salAllahu alejhi ue sel-lem nuk e ka pasur dikë tjetër prej të afërmeve e xhaxhallarëve që ta mbronte dhe ta përkrahte, pos Ebu Talibit.

Pasi që i Dërguari i Allahut salAllahu alejhi ue sel-lem ishte kthyer prej Taifit dhe ishte vendosur në shpellën Hira, e kishte dërguar një njëri prej fisit Huza tek El-Mut’im ibn Adiji që ta strehojë dhe t’i ofrojë mbrojtje derisa ta kryejë mesazhin e Zotit të tij. E ky i ofroi mbrojtje, ndërsa i Dërguari i Allahut salAllahu alejhi ue sel-lem hyri në Mekë dhe Hyri të ftonte në rrugën e Allahut.

Ajo që argumentohet nga këto transmetime është se i Dërguari i Allahut a.s. ka pranuar që të jetë nën mbrojtjen e xhaxhait të tij Ebu Talibit dhe largimin e torturave me anë të tij. Po ashtu, hyrja e të Dërguarit të Allahut s.a.v.s, nën mbrojtjen e El-Muti’mit, argumenton se lejohet të pengohet mundimi dhe torturimi nga thirrësi në rrugën e Allahut, edhe nëse ai mbrohen nga ndonjë politeisr dhe nuk është e rekomanduar që myslimani t’iu dorëzohet jobesimtarëve për t’u munduar. Kështu kanë vepruar edhe shokët e të Dërguarit s.a.v.s, të cilët ishin shpërngulur për në Etiopi e që më pas ishin kthyer në Mekë: *“Asnjëri prej tyre nuk kishte hyrë në Mekë ndryshe, pos nën mbrojtjen e dikujt, ose në mënyrë të fshehtë”*.

Thirrësi mysliman duhet doemos ta dijë faktin se duhet angazhuar për ta penguar apo larguar nga torturimi i vetes, ngase me këtë synohet që të përgatitet hapësira e përshtatshme për të thirrur në rrugë për tek Allahu. Ajo që e bën të qartë këtë është biografia e të Dërguarit të Allahut s.a.v.s, ku thuhet se ai dilte në kohën e haxhit dhe takohet me banorët e fiseve të ndryshme, i thërriste ata në fenë islame dhe u thoshte: *“Kush është ai njeri që e merr mbi vete barrën të më dërgojë të populli i tij dhe të më mbrojë prej tyre derisa ta transmetoj mesazhin e Zotit tim, ngase kurejshët më kanë penguar që ta transmetoj mesazhin e Zotit tim ”*.

Konspekt rreth asaj se a duhet të kërkohet prova dhe mbrojtja prej saj

Nga i gjithë ky shpjegim që e kam ofruar, tekstet që i kam përmendur prej Kuranit Fisnik dhe sunetit të të Dërguarit s.a.v.s, ndodhitë e mëhershme historike të biografisë së të Dërguarit salAllahu alejhi ue sel-lem dhe të shokëve të tij fisnikë, e të cilët janë njohësit më të mirë të shariatit islam, na del në pah në mënyrë shumë të qartë se së pari torturat dhe mundimet, të cilat e godasin thirrësin myslimanë janë sikurse sëmundjet dhe fatkeqësitë që e prekin njeriun, andaj ashtu sikundër nuk i do këto (sëmundjet, fatkeqësitë etj.) dhe nuk ka dëshirë që ta godasin shpirtin e tij, pra ky, në të njëjtën mënyrë, nuk duhet të dëshirojë që ta godasin prova e mundime gjatë thirrjes tek Allahu nga ana e jobesimtarëve dhe se nuk duhet kërkuar sprovimin e dëmin për veten e tij.

Së dyti, po qe se ekzistojnë mundësitë që të ketë pasoja dhe torturime gjatë thirrjes tek Allahu, nuk duhet ndalur nga të bërët thirrje në rrugën e Allahut, por thirrësi nuk duhet të lutet që të ketë mundime për veten e tij. Mirëpo, ky duhet të punojë që të mos bjerë në torturë dhe mundim, e nëse has në këto, atëherë do të përballet me to, duke i përdorur të gjitha mjetet legale, ashtu si janë përmendur në Kuranin Fisnik dhe sunetin e të Dërguarit salAllahu alejhi ue sel-lem

Së treti, kut ndodh që ta godasë ndonjë telash apo torturë thirrësin mysliman, edhe përkundër asaj se ai u është përmbajtur rregullave dhe metodave legjitime në thirrjen tek Allahu, atëherë ky e ka për obligim që të kërkojë ndihmë prej Allahut, duke bërë sabër-durim në mënyrën më të mirë dhe duhet ta dijë se të gjitha çështjet

janë në Dorën e Allahut të Lartësuar dhe se ndodh ajo që do Allahu, e çka nuk do nuk ndodh dhe se nuk ka fuqi tjetër pos fuqisë së Allahut.

Mëshira

Prej etikës-moralit të domosdoshëm për thirrësin është edhe mëshira dhe para ta shpjegoj rëndësinë e mëshirës që duhet ta ketë thirrësi për në rrugë të Allahut do të përmend disa nga hadithet e të Dërguarit salAllahu alejhi ue sel-lem që flasin për mëshirën ;

I Dërguari salAllahu alejhi ue sel-lem ka thënë: *“Nuh do të mëshirohet (nga Allahu) ai që nuk është i mëshirshëm ndaj njerëzve”, “Nuk largohet mëshira pos nga ai që është zemërgur-keqbërës ”; “Të mëshirshmit i mëshiron Allahu i Lartësuar, mëshirojeni atë që është në tokë, ju mëshiron Ai që është në qiell”;* “I Dërguari i Allahut salAllahu alejhi ue sel-lem i kishte puthur Hasanin dhe Husejnin radijAllahu anhumas, ndërsa aty ishte i pranishëm edhe El-Akre’u ibn Habisi, i cili i kishte thënë të Dërguarit salAllahu alejhi ue sel-lem Unë i kam dhjetë fëmijë e asnjërin prej tyre nuk e kam puthur. I Dërguari i Allahut salAllahu alejhi ue sel-lem e shikoi atë dhe i tha: *“Ai që nuk është i mëshirshëm nuk do të mëshirohet (nga Allahu) ”;* *‘Një grua ka hyrë në zjarr të xhehenemit për shkak të një maceje të cilën e kishte lidhur, nuk e kishte ushqyer dhe nuk e kishte lënë të ushqehet me gjallesat e tokës ’,*

Prej cilësive morale të të Dërguarit salAllahu alejhi ue sel-lem ishin mëshira dhe butësia e tij ndaj umetit të tij. Allahu i Lartësuar ka thënë: ***“Ju erdhi i dërguar nga lloji juaj, atij i vjen rëndë për vuajtjet tuaja, sepse është lakmues i rrugës së drejtë për ju, është i ndjeshëm dhe i mëshirshëm për besimtarët ”*** Butësia e të Dërguarit salAllahu alejhi ue sel-lem shprehej duke u angazhuar që umetin e tij ta shpëtojë nga zjarri i Xhehenemit dhe këtë e ka shpjeguar ai në mënyrë shumë të qartë, duke thënë: *“Shembulli im dhe shembulli i umetit tim është sikur shembulli i njeriut, i cili ka ndezur një zjarr në të cilin futen gjallesat dhe fluturat (duke menduar se në të është shpëtimi), kurse unë ju kap juve për jakët e rrobave tuaja (që të mos futeni në atë zjarr), por ju vazhdimisht vërsuleni për të rënë në të (nga lakmia duke mos ditur se çfarë po ndodh) ”*

Domosdoshmëria e ekzistimit të mëshirës fe thirrësi

Vërtet thirrësi patjetër duhet të ketë zemër që shpreh mëshirë dhe butësi ndaj njerëzve, që ka vullnet për t'u bërë mirë atyre dhe për t'i këshilluar ata. Prej butësisë së thirrësit ndaj umetit është thirrja e tyre në fenë islame, ngase në këtë thirrje është shpëtimi i tyre nga zjarri i Xhehenemit dhe arritja e kënaqësisë së Allahut të Lartësuar. Thirrësi e dëshiron për umetin atë që e do për veten e tij, e ajo që më së shumti do për veten e tij është imani-besirni dhe udhëzimi e që edhe këtë e do për umetin. Prindi, nga butësia dhe mëshira që ka ndaj fëmijëve të tij, angazhohet që të largojë prej tyre çdo gjë shkatërruese dhe në këtë aspekt ai edhe lodhet. Andaj, a ka shkatërrim më të madh se sa devijimi nga rruga e Allahut dhe kundërshtimi i Tij? E thirrësi me thirrjen e tij angazhohet që t'i shpëtojë gjynahqarët nga shkatërrimi dhe humbja e qartë.

Thirrësi i mëshirshëm nuk ndalet prej thirrjes së tij tek Allahu, nuk lodhet nga kundërshtimet dhe refuzimet e të tjerëve, ngase ai e di rrezikun dhe përfundimin e dhimbshëm të gjynahqarëve dhe se kundërshtimi i këtyre kundërshtarëve është për shkak të injorancës së tyre. Andaj, mu për këtë thirrësi për tek Allahu vazhdimisht angazhohet për t'i bindur dhe udhëzuar njerëzit për tek e vërteta. Kemi përmendur më lart mëshirën e të Dërguarit salAllahu alejhi ue sel-lem dhe se si e ka sjellë shembullin e tij dhe të umetit. Kështu, që të gjithë të Dërguarit e Allahut salAllahu alejhi ue sel-lem ishin të mëshirshëm ndaj atyre ku ishin të dërguar dhe frikësoheshin për dënimin që do t'i godasë ata që kundërshtonin. Allahu i Lartësuar, duke treguar ndodhinë e Nuhut a.s., ka thënë: ***“Ne e patëm dërguar Nuhun te populli i vet, ndërsa ai tha: O populli im, adhurojeni Allahun, nuk keni zot tjetër pos Tij. Unë kam fikë për dënimin tuaj në një ditë të madhe.”***, ***“(Nuhu) Tha: O populli im, unë nuk kam kurrfarë humbjeje, por unë jam i dërguar prej Zotit të botëve! Unë jua kumtoj shpalljet e Zotit tim, ju këshilloj dhe unë di nga Zoti im çka ju nuk dini! A mos u çuditët që shpallja ju erdhi nga Zoti juaj përmes (gjuhës së) një njeriu nga mesi juaj, për t'jua tërhequr vërejtjen që të ruheni dhe ashtu të shpëtoni.”***

Përgjigjja e Nuhut a.s. është e mbushur përplot mëshirë dhe butësi dhe se nuk është hidhëruar nga fjalët e popullit të tij, ngase e ka ditur se ata po veprojnë ashtu për shkak të injorancës. Andaj, thirrësi i mëshirshëm mysliiman nuk duhet të hidhërohet me të tjerët. Po kështu ishte edhe sjellja-etika e të Dërguarit tonë, Muhamedit s.a.v.s, i cili nuk hidhërohej për shkak të tjerëve, por hidhërohej kur

nuk i respektonin ligjet e Allahut. Më pastaj përgjigjja e Nuhut a.s. erdhi përplot me këshillë për popullin e tij, me gjithë fjalët e tyre të kota ky ua shpjegon atyre se është i Dërguar prej Zotit të botëve, me qëllim që ata ta dinë se ajo për të cilën i informon ata është e vërtetë dhe se doemos duhet pranuar atë. Në pranimin e kësaj të vërtete ka mëshirë për ta. Si argument për gjithë këtë është se zemra e këtij të Dërguari a.s. ka qenë përplot mëshirë ndaj popullit të tij.

Mëshira ia lehtëson thirrësit t'i tejkalojë ato që i pëson prej injorantëve

Mëshira ia lehtëson thirrësit që t'i tejkalojë ato që i pëson prej injorantëve dhe atyre që janë të pakujdesshëm, ngase ai i shikon ata prej një pozite lart nga pozita e imanit të tij dhe lidhjes së tij me Zotin e tij. Ky i shikon ata sikur njeriu që i shikon të vegjlit që kalojnë kohën e tyre kot, ngase ata nuk kanë aftësi për t'i kuptuar gjërat që u sjellin dobi atyre. Andaj, për këtë nuk duhet befasuar thirrësi kur gjatë këshillimit të tij has në kundërshtime dhe në mundime e torturime, sikundër vepron fëmija kur e këshillon apo e largon nga diçka, si p.sh. e këshillon të mos e prekë zjarrin apo diçka tjetër të dhimbshme, ai bërtet, hidhërohet bile edhe shkakton ndonjë dëm. Thirrësi nuk do të befasohet me kundërshtimin e tyre, sikurse thashë dhe se për këtë ai vazhdimisht do t'i thërrasë ata tek Allahu, do t'i përballojë torturat e tyre dhe i fton ata në udhëzim. Kështu, ishte i Dërguari i Allahut s.a.v.s, i cili vazhdimisht i thërriste kurejshët për në fenë e Allahut dhe i përballonte torturat e tyre, duke thënë: *“O Zoti im, udhëzoje popullin tim se ata nuk dinë. Vërtet njeriu i cili ka zemër të mëshirshme nuk ia merr për të madhe fëmijës kur ai e kundërshton këshillën për shkak se është injorant dhe se ai që ka zemrën e mëshirshme nuk ia merr për të keqe veprimin e tij.”* Allahu i Lartësuar ka thënë: ***“Ti (Muhamed) merre të lehtë, urdhëro për mirë dhe hiq prej të padijshmëve”***

Fryfi i mëshirës ëshfë falja

Derisa thirrësi mysliman e shikon me mëshirë dhe butësi ata që i thërret dhe i fal ata. Allahu i Lartësuar ka thënë: ***“Ti (Muhamed) merre të lehtë, urdhëro për mirë dhe hiq prej të padijshmëve.”*** Pasi që kjo është gjendja e thirrësit mysliman

ndaj atyre që i thërret dhe i duron torturat e tyre, atëhetë falja dhe toleranca ndaj atyre që i ka shokë do të jetë shumë më e madhe. Allahu i Lartësuar ka thënë: “Andaj ti falua atyre dhe kërko ndjesë për ta, e konsultohu me ta në të gjitha çështjet.”

Vrazhdësia shkakton largimin e njerëzve

Thirrësi, i cili është i pamëshirë dhe zemërgur nuk do të ketë sukses në punën e tij dhe se njerëzit nuk do ta pranojnë atë edhe nëse atë që e thotë është e vërtetë. Kjo është natyrshmëria e njerëzve, të cilët ikin prej atij që është shumë i vrazhdë, nuk e pranojnë fjalën e tij, ngase për t’u pranuar fjala e këshilluesit duhet që zemra e të këshilluarit të pranojë atë që thotë këshilluesi, andaj ky pranim nuk mund të arrihet me vrazhdësi. Allahu i Lartësuar ka thënë: ***“Ti ishe i butë ndaj atyre, ngase Allahu të dhuroi mëshirë, e sikur të ishe i vrazhdë e zemërfortë ata do të largoheshin prej teje”***. Kur kjo mund t’i ndodhej të Dërguarit të Allahut s.a.v.s, pra po të ishte i vrazhdë njerëzit do të iknin prej tij, edhe pse i Dërguari nuk flet me hamendje, por flet vetëm të vërtetën, atëherë si është e mundur ta paramendosh se nuk do të largohen njerëzit nga thirrësi, i cili është i ashpër dhe i vrazhdë?

Le t’ia kenë frikën Krijuesit të tyre thirrësit tek Allahu, le të jenë të mëshirshëm dhe të butë, ngase po qe se nuk janë të mëshirshëm sa që të arrijnë t’i përfitojnë zemrat e njerëzve, atëherë ata nuk mund të konsiderohen si të veçantë në fenë islame, ngase etika e tyre është e keqe, i kanë zemrat e vrazhda e të ashpra dhe fjalët ofenduese. E po qe se këta dështojnë nga ajo që të jenë të mëshirshëm dhe të edukuar me etikë islame, atëherë më së miri për ta dhe për thirrjen në islam është që ta braktisin këtë detyrë thirrjen në islam dhe të largohen për ta shëruar veten nga vrazhdësia dhe ashpërsia.

Modestia

Mendjemadhësia është marrëzi dhe injorancë

Mendjemadhësia është marrëzi dhe injorancë dhe argument i prerë për injorancën e mendjemadhit ndaj Krijuesit të tij dhe vetë vetes. Sikur ai ta njihnte Krijuesin e tij do ta dinte se krenaria i përket vetëm Allahut të Lartësuar. I Dërguari i Allahut salAllahu alejhi ue sel-lem ka thënë: Allahu i Madhërishëm ka thënë: “Krenaria dhe mendjemadhësia më takojnë Mua, e kush më kundërvihet mua në këto dyja, atë do ta dënoj”. Sikur ta njohë mendjemadhi vetveten e tij i cili është krijuar prej Spermës së ndyrë dhe se do të përfundojë si i kalbur do të turpërohej prej vetvetes dhe nuk do të bëhej mendjemadh. Përmendet në librin “el-Ihjau” se Muhamed ibn el-Husejn ibn Alij j ka thënë: Nuk hyn në zemrën e njeriut mendjemadhësia asgjë përveçse në atë masë të tillit do t’i pakësohet të menduarit e tij, qoftë pak apo shumë.

Ndëshkimi i mendjemëdhenjve

Nga ndëshkimet që e godasin mendjemadhin është që ai të jetë i privuar nga këshillat dhe të mirat e argumenteve të Allahut, ngase mendjemadhësia pengon arritjen tek e Vërteta dhe Allahu e vulos zemrën e tij dhe e largon nga pranimi i argumenteve të Tij . Si përfundim i gjithë kësaj është dështimi, plogështia, hidhërimi i Allahut të Lartësuar, futja në xhehenem, si të poshtëruar dhe humbja e të gjitha të mirave që do t’i përjetojnë ata që janë modestë ndaj Allahut të Lartësuar. Për këtë ka folur Kurani Fisnik dhe suneti i të Dërguarit të Allahut salAllahu alejhi ue sel-lem Allahu i Lartësuar ka thënë: **“Unë do t’i zmbraps nga argumentet e Mia ata që pa pasur të drejtë bëjnë kryelartësi në tokë” ; “Po kështu Allahu vulos çdo zemër të arogantit, të zullumqarit. ”; “Ata (të dërguarit) e kërkuan ndihmën, ndërsa çdo kryelartë idhnak pësoi dështim. ”; “dhe se Ai nuk i do arrogantët” ; “Zoti juaj ka thënë“Më thirni Mua, Unë ju përgjigjem, e ata që nga mendjemadhësia i shmangen adhurimit ndaj Meje, do të hyjnë të nënçmuar në xhehenem” ; “Atë vend të pëttjetshëm (xhenetin) ua**

kemi përcaktuar atyre që nuk duan as mendjemadhësi e as ngatërresë në tokë, e përfundimi këndshëm u takon atyre që i frikësohen Allahut. ”

Në sunetin e të Dërguarit salAllahu alejhi ue sel-lem është transmetuar se: “Njeriu vazhdimisht do të bëjë mendjemadhësi derisa të shkruhet tek Allahu si mendjemadh dhe se atë e godet dënimi i njëjtë me dënimin e mendjemëdhenjve”; “Nuk do të hyjë në xhenet ai që ka një grimcë të mendjemadhësisë”; “A t’ju informoj juve se kush është banor i xhehenemit: i tillë është çdo arrogant dhe mendjemadh ”.

Ndalimi i mendjemadhësisë

“Të gjitha tekstet (ajetet dhe hadithet) që i kemi përmendur në vete përmbajnë ndalesën nga mendjemadhësia dhe po ashtu ka ajete të tjera që, në mënyrë të qartë, e ndalojnë mendjemadhësinë: ***“Dhe mos e shtrembëro fytyrën tënde prej njerëzve, mos ec nëpër tokë kryelartë, sepse Allahu nuk e do asnjë mendjemadh e që shumë lavdërohet. ”***

E vërteta e mendjemadhësisë

Në hadithin që e transmeton Muslimi në sahihun e tij thekson: “*Mendjemadhësia është refuzimi i të vërtetës dhe nënçmimi i njerëzve*”. E Vërteta e mendjemadhësisë është konsiderimi i vetes si madhështor dhe nënçmimi i të tjerëve, ngase mendjemadhësia e shpie në nënçmim dhe në shkatërrim.

Mendjemadhi është ai që e refuzon të vërtetën dhe nuk e pranon atë. Allahu i Lartësuar ka thënë: ***“Që mohuan argumentet e Zotit të tyre, kundërshtuan të dërguarin e Tij, shkuan pas urdhrin të çdo kryelarti kundërshtar. ”*** Mendjemadhi nuk e pranon gabimin e tij, mangësinë e tij dhe veprën e tij të keqe për shkak se atij i duket vetja shumë i mirë. Në hadithin e të Dërguarit salAllahu alejhi ue sel-lem theksohet: “*Tri gëra shkatërrojnë: koprracia, ndjekja e hamendjes dhe mendjemadhësia*”.

Mendjemadhi i nënçmon njerëzit dhe se i konsideron ata si të nivelit më të ulët se ai, andaj ata nuk i pyet kur nuk di, nuk pranon mësimin e atij që di, nuk e pranon këshillën e këshilluesit, ngase, sipas këtij, njerëzit e tjerë për të janë të nivelit të ulët dhe se ata duhet ta falënderojnë atë. Mendjemadhi refuzon që të ulet me njerëzit dhe të bisedojë me ta dhe se ky mendon se do të shpëtojë, ndërsa tjerët do të shkatërrohen etj.

Shkak i mendjemadhësisë

Si shkak i mendjemadhësisë është se njeriut i duket vetja që është më i miri në dituri, në pasuri, në prestigj, në pozitë, në pushtet dhe shumë çështje të tjera për të cilat i duket vetja shumë i mirë, duke harruar atë se Allahu i Lartësuar është Ai i Cili ia ka dhuruar këto begati me të cilat mburret ai, e po qe se do Allahu ato mund t'ia marrë. Andaj, kjo mburrje e nxit mendjemadhin që të jetë kryelartë, të konsiderojë veten më të mirë se të tjerët dhe t'i nënçmojë të tjerët.

Trajtimi i mendjemadhësisë

Trajtimi i kësaj sëmundje shkatërruese dhe të vështirë-mendjemadhësisë si dhe përfitimi i modestisë bëhet me njohuri të bindshme nga mendjemadhi, i cili duhet t'i njohë Krijuesin e tij dhe vetveten. Mendjemadhi duhet ta dijë se krenaria i përket vetëm Allahut dhe kurrsesi nuk i lejohet asnjë njeriu t'i lejojë vetes që të ketë ndonjë grimcë të mendjemadhësisë në zemrën e tij, ngase mendjemadhësia është një virus shumë i rrezikshëm që e shuan dritën e besimit dhe i shkatërron veprat. Mendjemadhi duhet që ta njohë zanafillën e krijimit të tij, i cili është krijuar prej spermës së ndyrë dhe si përfundim është kalbja e trupit të tij dhe se çdo gjë që zotëron prej pasurisë, prestigjit dhe pushtetit është dhuratë prej Allahut, të cilat po qe se do Allahu mund t'ia marrë të gjitha e që pas kësaj ai të mbe' tet pa asgjë. Kështu, pra, mendjemadhi, duke i analizuar shkaqet e mburrjes së tij dhe të mendjemadhësisë, ai hap pas hapi, e eviton atë (mendjemadhësinë). Dija që e posedon njeriu për gjërat është shumë më e vogël sesa padituria e tij: ***“E juve ju është dhënë fort pak dije”*** dhe se mbi çdo të ditur ka më të ditur: ***“e mbi secilin***

të dijshtëm ka edhe më të dijshtëm” atëherë pse duhet të ketë mburrje dhe mendjemadhësi? Dituria e vërtetë është ajo që si fryt e ka njohjen e Zotit të Madhërishëm dhe që e pengon njeriun që të zhytet me punë të ulëta, siç janë mendjemadhësia dhe, pos kësaj, kjo dituri e nxit njeriun të zbukurohet me vepra të larta, siç është modestia. Adhurimi të cilin e bën mendjemadhi dhe devotshmëria nuk mund të jenë shkak që ai të mburret c të shprehë mendjemadhësi ndaj Allahut dhe ndaj krijesave të Tij. Ku ta dijë ky i mjerë se ndoshta adhurimi i tij është i pranuar dhe se ai është prej njerëzve të mirë tek Allahu dhe se përfundimi i tij është i panjohur, se lavdërimi i vetës është i ndaluar: **“Pra mos e lavdëroni veten, se Ai e di kush është më i ruajtur.”** Adhurimi është një obligim i robit ndaj Allahut, andaj nuk ka të drejtë robi që të bëhet mendjemadh ndaj të tjerëve për shkak se po e kryen adhurimin ndaj Allahut, ngase Allahu është Ai i Cili i ka mundësuar që ta adhurojë Atë dhe që të jetë i udhëzuar: **“e ata thonë: Falënderojmë Allahun që na udhëzoi për këtë (për iman, përpunë të mira, na e hoqi zilinë, na futi në xhenet), pse sikur të mos na drejtonte Allahu, ne nuk do të dinim të udhëzohemi”.** Cila është ajo devotshmëri, e cila nuk e pengon personin nga mendjemadhësia, nuk e pengon nga futja në punë të ulëta, nga ajo punë që djallin e ka nxjerrë nga mëshira e Krijuesit dhe është bërë mallkuar deri në ditën e kiametit? Dita kur shejtani nuk i kishte rënë në sexhde Ademit nga mendjemadhësia dhe krenaria që kishte ndaj vetes, ku i cili kishte thënë: **“Unë jam më i vlefshëm se ai”.** Kështu, pra, kur flitet duke u mburrur pët pasuri, pushtet, prestigj, për forcën e përkrahjes së ithtarëve, për mburrjen me prejardhje e të ngjashme, e që të gjitha këto janë cytjë të shejtanit të mallkuar. Pasuri është që shkon e vjen, pushteti nuk është i përgjithmonshëm dhe njëjtë është edhe çështja me presrigjin. Po ashtu, forca e përkrahjes së ithtarëve nuk bën kurrfarë dobia tek Allahu, Allahu i Lartësuar ka thënë: **“E edhe në ditën e Hunejnit, kur juve ju mahniti numri i madh, i cili nuk ju vlejti asgjë”.** Mburrja në gjenealogji është mburrje në eshtra të kalbur, por edhe nëse janë gjallë nuk ka kurrfarë dobi nëse fëmija i keq i ka prindërit e mirë! Allahu i Lartësuar thotë: **“Nuhu e luti Zotin e vet, duke i thënë: O Zoti im, djali im është i familjes sime, e premtimi Yt është i saktë, ndërsa Ti jë më i drejti i të drejrvë! (Zoti) Tha: O Nuh, ai (djali) nuk ishte nga familja jote (për të cilën të premtova se do t’i shpëtoj), ai ishte punëkeq, e ti mos më kërko Mua atë që nuk di, Unë të këshilloj që të mos bëhesh nga injorantët! (Nuhu) Tha: Zoti im, unë mbështetem në mbrojtjen Tënde që të (mos) kërkoj prej Teje atë për çka nuk kam njohuri, e në qoftë se nuk më fal mua dhe nuk më mëshiron Ti, do të jem i humbur!”**

Pasi që kemi shpjeguar shkaqet, efektet dhe ndikimet e mendjemadhësisë, na është bërë neve e qartë se çka është modestia. Pra, modestia është e kundërta e mendjemadhësisë, është fryti i njohjes së Allahut dhe e vetes dhe se kurrsesi nuk lejon që njeriu të bëhet mendjemadh. Njeriu që e njeh Krijuesin e tij dhe veten e tij ai gjithmonë do të jetë modest. Mbi bazën e kësaj na del se mendjemadhi nuk e njeh Krijuesin e tij, ndërsa ai që është modest e njeh Krijuesin e tij, ndërsa kur mendjemadhi i nënçmon njerëzit dhe i sheh ata si miza dhe robët, modesti e mendon mirë fjalën e Ebu Beker Sidikit radijAllahu anhu, i cili ka thënë: *“Mos ta nënçmojë askush dikë prej myslimanëve, ngase ai që është i vogël në mesin e myslimanëve, ai është i madh tek Allahu”*. Kur mendjemadhi nuk dëshiron që të ulet dhe të qëndrojë me njerëzit e mirë, me të varfrit dhe të dobëtit përkundër asaj se mendjemadhi nuk ka kurrfarë vlere, ndërsa modesti e mendon mirë fjalën e Allahut të Lartësuar: *“Përkufizojë veten tënde me ata që e lusin Zotin e tyre mëngjes e mbrëmje, e që kanë për qëllim kënaqësinë (razinë) e Tij dhe mos i hiq sytë e tu prej tyre”* Komentuesit e Kuranit përmendin shkakun e zbritjes së këtij ajeti i cili është: Kurejshët i kishin thënë të Dërguarit të Allahut salAllahu alejhi ue sel-lem Ne nuk jemi të kënaqur që të jemi ndjekës të këtyre myslimanëve të dobët siç janë: Suhejbi, Amari, Bilali dhe Hababi, largoji ata prej teje dhe mos i lejo ata në tubimin tend, ne do të vijmë te ti, e kur të dalim ne prej tubimit tënd, atëherë nëse do lejoji të qëndrojnë me ty. Andaj, Allahu e zbriti këtë ajet, ku në pjesën e fundit të këtij ajeti përmend cilësitë e këtyre mendjemadhënjve, duke thënë: *“Dhe mos iu bind atij që ia kemi shmangur zemrën e tij prej përkujtimit ndaj Nesh dhe i është dhënë epshit të vet, pse puna e tij ka mbaruar”*. Ai që është modest e mendon mirë kuptimin e ajetit: *“E të jesh i butë ndaj besimtarëve që të pranuan ty”*. Pasi që mendjemadhi e mohon të vërtetën dhe e refuzon atë, myslimani modest e mendon mirë fjalën e një njeriu modest e të devotshëm El-Fudajl ibn I’jadit (Allahu e mëshiroftë), i cili kur është pyetur për modestinë është përgjigjur duke thënë: Modesti është të nënshtrohesh përballë të vërtetës dhe ta pranosh atë, edhe nëse atë e ke dëgjuar prej atij që është më injoranti prej njerëzve.

Nevoja e thirrësit për modesti

Thirrësi për tek Allahu ka më së shumti nevojë për modesti, ngase ai përzihet me njerëzit duke i ftuar ata tek e vërteta (feja islame) dhe në etikën-moralin islam, andaj si është e mundur që ky të mos jetë modest, kur dihet se modestia është baza e moralit islam? Prej natyrshmërisë që Allahu i ka krijuar njerëzit është edhe ajo që ata të mos e pranojnë fjalën e atij që e zgjat shumë, që i nënçmon ata dhe që manifeston mendjemadhësi ndaj tyre, edhe po që se atë që e thotë është e Vërtetë dhe e sinqertë. Kështu, pra, natyrshmëria e njerëzve është që të ikin prej atij që është mendjemadh dhe të mos i dëgjojnë fare fjalën, këshillën dhe udhëzimin e tij. Fjala e mendjemadhit nuk arrin askund, por jo vetëm kaq, ngase ajo mund të jetë edhe shkak i urrejtjes të së vërtetës nga ana e tjetrit. Andaj, thirrësi mysliman e ka për detyrë që ta mendojë mirë këtë çështje, t’ia ketë frikën Allahut-Krijuesit të Tij e të mos bëhet shkak që njerëzit të ikin prej thirrjes së Allahut. Këtu do të shtojmë edhe diçka tjetër që është shumë më rëndësi dhe që ka lidhje të drejtpërdrejtë me këtë tematikë, e ajo është se në natyrën e njerëzve është që nuk e duan atë që flet së tepërmi për veten e tij, që lavdëron veten, që thotë unë, unë. Mu për këtë thirrësi mysliman duhet të ketë kujdes nga sjellja e tillë që tregon për vlerën e tij të lartë, nuk bën të thotë se unë jam shumë i ditur, kam shumë njohuri dhe jam shumë elokuent. Thirrësi duhet ta dijë atë se të gjitha këto mirësi janë begati që i ka dhënë Allahu i Lartësuar atij, andaj le t’u flasë njerëzve me bindjen se e gjithë kjo është prej mirësive të Allahut dhe se kur njerëzit ta kuptojnë këtë, atëherë pa dyshim se ata i hapin zemrat për ta dëgjuar, apo të paktën nuk i mbyllin zemrat e tyre kur ai flet. Kështu, do të ketë mundësi që fjalët e tij të mira të kenë ndikim të dobishëm me ndihmën e Allahut dhe se Allahu është Ai nga i Cili kërkohet ndihmë.

Modestia madhështore është nënshtrimi ndaj atij që Ligjdhënësi ka urdhëruar për ta respektuar dhe për ta dëgjuar, siç është prijësi dhe nëpunësit e tij, e që ndaj kësaj modestie nganjëherë thirrësi është i pakujdesshëm, por ajo është shumë e dobishme dhe shumë e domosdoshme për thirrësin. Ndaj kësaj modestie kurrësi nuk lejohet kundërshtimi, apo largimi nga prijësi duke u arsyetuar me komente të pabaza, ngase ato komente që nxisin kundërshtimin janë inspirime të shejtanit të mallkuar, si në rastin kur thotë: Ky prijës apo mësues nuk është i mirë për ta kryer detyrën e tij, nuk është i përshtatshëm, është ende i ri, unë jam më i ditur se ai dhe se ky mësues nuk bën të japë mësim e të ngjashme. Andaj, thirrësi duhet ta rikujtojë mirë rastin kur i Dërguari i Allahut salAllahu alejhi ue sel-lem e kishte caktuar si prijës të ushtrisë Zejdin, i cili ishte i ri, megjithëse në mesin e ushtrisë kishte sahabë të njohur prej ensarëve e muhaxhirëve të moshuar. Autori i librit “Imta’ul Esm’ai ” këtë ndodhi e paraqet kështu: “Pastaj i Dërguari i Allahut e thirri

Usame ibn Zejdin (ishte dita e martë muaji Safer) dhe i tha: *“O Usameh, vazhdoje rrugën në emër të Allahut deri te vendi ku është vrrarë babai yt dhe aty ndale ushtrinë se unë të kam caktuar si komandanti ushtrisë...”* Kur vjen dita e mërkurë i Dërguari i Allahut salAllahu alejhi ue sel-lem ishte i sëmurë, kishte marramendje dhe temperaturë, ndërsa ditën e enjte ia dha flamurin Usames, duke i thënë: *“O Usameh, lufto në rugë të Allahut dhe për hatër të Tij dhe në begatin e Tij, luftojeni atë, i cili e ka mohuar Zotin, luftoni por mos tradhtoni, mos mbytni fëmijë, gra dhe mos lakmoni takimin me armikun, ngase ju nuk e dini që kjo betejë mund të jetë sprovë për ju, por ju duhet të thoni: O Zoti ynë Ti na mjafton neve kundër tyre, na ruaj neve prej tyre. Nëse ju i takoni ata, ata do të bërtasin e do të klithin, ju do të jeni të qetë dhe do të heshtni, mos u grindni mes vete që të dobësoheni dhe ta humbni fuqinë ushtarake. Gjithashtu thoni: O Zoti ynë, ne jemi robërit e Tu, na ndihmo neve dhe pengoj ata, sepse Ti i mund ata. Po ashtu dijeni se xheneti është nën tehun e shpatave.”* Pastaj autori i librit “Imta'ul Isma'i” përmend atë se disa nga njerëzit filluan të Hasin për zgjedhjen e Usames si komandant i ushtrisë, duke konsideruar se ai është ende i ri, se nuk ka përvojë luftarake dhe se kjo ushtri ka në radhët e saj shumë muhaxhirë e ensarë, ndërsa Umeri radijAllahu anhu iu kundërvu këtyre zërave dhe më pastaj e informoi edhe të Dërguarin e Allahut salAllahu alejhi ue sel-lem për këtë. Mirëpo, i Dërguari i Allahut s.a.v.s, në këtë rast ishte hidhëruar shumë dhe e kishte vënë kapuçin e tij në kokë e më pastaj kishte hipur lart në minber, e kishte falënderuar Zotin e pastaj kishte thënë: *“O ju njerëz, çfarë është çështja e bisedës suaj mes vete për atë se e kam caktuar Usamen si komandant? Pasha Allahun, nëse nënçmoni komandën e Usames, dijeni se kemi përbuzur udhëheqjen e babait të tij më parë. Pasha Allahun, ky Usamja është i krijuar Për të (për udhëheqje), sikurse ka qenë babai i tij i krijuar për udhëheqës ushtarak”.* Në ndodhinë e Usames janë përmendur shumë mësimë, këshilla e dispozita. Në fund duhet ditur se thirrësi mysliman e shton modestinë ndaj Allahut të Lartësuar sa herë që thirrja e tij ka më shumë sukses dhe e ndihmon atë Allahu kundër armiqve të fesë. Kështu, pra, i Dërguari i Allahut s.a.v.s, kur hyri në Mekë si çlirues e mbante kokën ulur për shkak të modestisë ndaj Allahut dhe duke e ditur se kjo fitore është arritur me mirësinë e Allahut të Lartësuar.

Përzierja me njerëzit dhe izolimi prej tyre

Cili veprim është më i mirë përzierja me njerëzit apo izolimi prej tyre?

A thua cili veprim është më i mirë për myslimanin përzierja me njerëzit apo izolimi prej tyre? Disa kanë thënë se izolimi prej njerëzve është më i mirë, ndërsa shumica e dijetarëve janë të mendimit se përzierja me njerëzit është vepër më e mirë. Mirëpo, si më e saktë është ajo që thuhet se më mirë për myslimanin është që ta bëjë atë që është më e dashur për Allahun e Lartësuar në rrethana të caktuara, pra kur ndodh që përzierja është më e dashur për Allahun, duke i shikuar myslimani rrethanat, atëherë është më mirë që të përzihet me ta, e po qe se ndodh që myslimani e sheh se tek Allahu është më e dashur që ai të izolohehet, atëherë izolimi për të është më i dashur te Ai.

Përzierja me njerëzit është veprim i domosdoshëm

Përzierja me njerëzit është veprim i domosdoshëm, ngase në natyrën e njeriut është që të jetë social dhe se ai nuk mund të jetojë i vetëm, e po qe se ndodh diçka e tillë është rast i rrallë dhe se shumica e njerëzve nuk mund të jetojnë të vetmuar. Pra, kjo ka të bëjë me jetën e kësaj bote dhe nevojat e saj, ndërsa e njëjta gjë vlen edhe për çështjet fetare, ngase disa prej obligimeve dhe rekomandimeve islame nuk mund të kryhen, pos duke u përzier dhe duke bashkëpunuar me njerëzit, si p.sh. namazi i xhumasë, namazi i bajramit, përcjellja e xhenazes, vizita të sëmurit, mësimi dhe shpjegimi i çështjeve të fesë. Pra, zbatimi i të gjitha këtyre kërkon përzierjen me njerëzit në mënyrë të domosdoshme.

Përzierja me njerëzit është veprim i domosdoshëm për fhirrësin

Thirrja tek Allahu është ndër obligimet e fesë islame dhe se si mjet i thirrjes është përzierja me njerëzit, andaj për këtë patjetër përzierja me njerëzit është e domosdoshme dhe obligimi nuk kryhet pa të. Realiteti është se natyrshmëria e fesë islame kërkon përzierje me të tjerët. Nuk kuptohet ajo se feja islame kërkon që njeriu të veprojë vetëm për veten, por myslimani punon edhe për të tjerët. I

Dërguari i Allahut s.a.v.s, që nga koha kur Allahu e nderoi atë me pejgamberilëk, e ka urdhëruar atë që ta transmetojë fenë, ndërsa ai ka jetuar në mesin e njerëzve dhe është përzier me ta duke i ftuar tek Allahu dhe duke ua tërhequr vërejtjen ndaj gabimeve që i bëjnë. Kështu kanë vepruar edhe shokët e ndershëm të të Dërguarit s.a.v.s, të cilët janë përzier me njerëzit dhe e kanë përhapur udhëzimin, diturinë dhe fenë në mesin e tyre e që i kishin mësuar prej të Dërguarit salAllahu alejhi ue sel-lem Transmetohet nga disa tabi'inë, të cilët e kanë rekomanduar izolimin prej njerëzve dhe e kanë urryer përzierjen me njerëzit, se ky veprim (rekomandimi i izolimit nga njerëzit) është bërë në rrethana të veçanta, por kjo nuk do të thotë se kjo është rregull që duhet ta pasojnë myslimanët, ngase thirrja tek Allahu është obligim i prerë dhe i iigjësuar në sheriatin islam, andaj përzierja me njerëzit është ndër hapat e parë të thirrjes tek Allahu. Mirëpo, jo vetëm kaq, në kohën tonë është më se e domosdoshme përzierja me njerëzit, madje më shumë se në kohët e kaluara për shkak se njerëzve u janë mbuluar mendjet e tyre nga të katër anët vetëm e vetëm që të mos mund ta shohin dritën e së vërtetës dhe të arrijnë t'i kenë lidhjet ashtu si duhet me Krijuesin. Andaj kjo situatë bën që çdo mysliman të kontribuojë në thirrjen tek Allahu me aq mundësi që ka dhe se e gjithë kjo kërkon doemos përzierjen me njerëzit, vetëm e vetëm që ata t'i thërrasë tek Allahu.

Limitet e përzierjes së obliguar me njerëzit

Përzierja me njerëzit është e obliguar atëherë kur është e domosdoshme për t'u realizuar thirrja tek Allahu, apo edhe atëherë kur duhet kryet obligimet-farzet e tjera të fesë islame. E kur nuk është fjala për këto shkaqe, atëherë përzierja me njerëzit e merr normën e veprës së lejuar (mubah), ose të veprës së urryer (mekruh), apo edhe normën e veprës së ndaluar (haram). Përzierja me njerëzit është e lejuar kur qëllimi është artitja-pëfitimi i ndonjërit prej interesave të kësaj bote, ndërsa përzierja me njerëzit është urryer (mekruh) kur thirrësi e ka për qëllim ndonjë vepër të keqe, duke i lënë anash të mirat e botës tjetër. Andaj, bazuar në këtë shpresohet nga thirrësi që përzierja me njerëzit të jetë krejtësisht me motivin për thirrje tek Allahu. Kështu, kur ta vizitojë ndonjë person, apo të njoftohet me të, apo ta bëjë mik, apo ta shoqërojë, apo të Vëllazërohet me të, apo të futet në ndonjë tubim, apo t'iu flasë njerëzve e të ngjashme, ky krejt këtë do ta bëjë për shkak dëshirës së thirrjes tek Allahu.

Dashuria për hatër të Allahut dhe urrejtja për hatër të Allahut

Thirrësi në përzierjen e tij me njerëzit e konsolidon lidhjen e tij me ta mbi parimet e dashurisë për hatër të Allahut dhe urrejtjes për hatër të Allahut. Qëllimi me këtë fjali është se myslimani nuk e do askënd për diçka pos për shkak se ai person i nënshtrohet Allahut, nxiton dhe e bën atë që është në kënaqësinë Krijuesit. Dhe tjetra është se nuk e urren askënd, pos atë që i kundërshton urdhrat e Allahut dhe se do që të shtohet dashuria e myslimanit ndaj Allahut. Kjo që po e themi nuk është ndonjë iluzion apo hiperbolë, se vërtet ai që do dikë, ai i do edhe ata që e duan atë, e ai që e do dikë angazhohet që t'i shërbejë atij dhe ta respektojë atë. Pasi kjo është një çështje e njohur në mesin e njerëzve, atëherë çështja e dashurisë së myslimanit ndaj Krijuesit të tij dhe ndikimi i kësaj dashurie është i madh tek ata që e duan Allahun. Andaj, kut ndodh që tek një person të bashkohen disa vepra të mira dhe disa të këqija, atëherë myslimani do ta dojë atë për shkak të veprave të mira dhe do ta urrejë për shkak të veprave të këqija.

Ato që i zgjedh thirrësi për t'i shoqëruar

Përderisa thirrësi e do dikë për hatër të Allahut dhe e urren dikë për hatër të Allahut, atëherë është më se e qartë se ai do t'i zgjedhë si shokë ata që janë të devotshëm ndaj Allahut e që i kryejnë obligimet ndaj Allahut të Lartësuar. Këta, pra, janë shokët më të mirë, vëllezërit më të mirë, me të cilët e forcon shoqërinë me ta, krenohet dhe përkujdeset për ta dhe në të njëjtën kohë refuzon të shoqërohet me ata që e kundërshtojnë Allahun dhe bëjnë gjynahe. Allahu i Lartësuar ka thënë: ***“Andaj, ti largohu prej atij që ia ka kthyer shpinën Kuranit dhe që nuk do tjetër vetëm jetën e dynjasë”***. Pra, thirrësi refuzon të shoqërohet me gjynahqarët dhe kundërshtarët, por vazhdimisht i thërret tek Allahu dhe lutet që ata të udhëzohen, lutet për mëshirë ndaj tyre dhe kthim kah rruga e vërtetë.

Sjellja e thirrësit me atë që e shoqëron dhe atë që nuk e shoqëron

Thirrësi i njeh të drejtat dhe obligimet e shoqërimit dhe se e ndien në vete atë se duhet t'i kryejë këto obligime të drejta siç janë: të solidarizohet me ta, që t'iu ndihmojë atyre kur kanë nevojë, të mos Hasë për të metat e tyre, ngase asnjëri nuk është pa të meta, përveç nëse detyrohet për ta urdhëruar në të mira dhe penguar nga të këqijat, i duron të këqijat e tyre, i pranon arsyetimet e tyre, besimtari fisnik i mendon të mirat e vëllait të tij, ndërsa hipokriti i mendon të këqijat e vëllit të tij. Abdullah ibn el-Mubareki (Allahu e mëshiroftë) ka thënë: *“Besimtari i kërkon arsyetimet, ndërsa hipokriti kërkon të metat”*.

Sa i përket sjelljes së thirrësit me atë që nuk e shoqëron për shkak të gjynahut dhe kundërshtimit të tij ndaj Allahut, është sjellje e besimtarit dhe se me ta nuk përplaset: *“E kur atyre me fjalë u drejtohen injorantët, ata thonë: Paqe!”*, por ky i këshillon ata. Nganjëherë, detyrohet t'i braktisë ata dhe t'i bojkotojë kur gabimi apo gjynahu i tyre është se duhet braktisur ata dhe duhet bojkotuar. Si p.sh., kur ndodh që ata ftojnë në ndonjë risi-bidat në fe, apo bëjnë përçarje në mesin e myslimanëve, apo thurin kurthe për myslimanët, apo bëjnë diçka që i dëmton myslimanët, apo angazhohen që t'iu bëjnë zullum atyre. Pra, në këtë gjendje, dhe pas gjithë këshillave që u bëhen atyre, thirrësi detyrohet ta braktisë këtë shoqëri dhe t'i bojkotojë ata duke mos u folur me qëllim të pengimit të tyre nga tirania, mashtrimi, armiqësia dhe përhapja e bidateve-risive në fe, ashtu që njerëzit t'i kuptojnë se kush janë ata dhe të ruhen prej tyre. Jo vetëm kaq, por thirrësi këtyre personave as që do t'ua kthejë selamin kur ata ta përshëndesin me selam, me qëllim të pengimit të tyre prej të keqes dhe të nxjerrjes në shesh të asaj me të cilën nuk është dakord në veprimin e tyre. Imam Gazaliu e arsyeton moskthimin e selamit ndaj tyre, kur dihet se kthimi i selamit është obligim, duke thënë kështu: *“Kthimi i selamit, edhe pse është obligim, në disa raste nuk zbatohet, si në rastin kur njeriu është në banjë dhe kur është duke e kryer nevojën fiziologjike, ndërsa kur kemi të bëjmë me tërheqjen e vërejtjes ndaj një veprimi të keq është shumë më i rëndësishëm (pra në këtë rast nuk kthehet selami)”*⁷⁵⁸. *Këtë kuptim e ka shprehur edhe dijetari madh islam Ibn Tejmije (Allahu e mëshiroftë)”*.

Izolimi i thirrësi

Pasi që përzierja me njerëzit është njëra prej mjeteve parësore të thirrjes tek Allahu, por kur e vëren thirrësi se nuk po ka efekt përzierja e tillë, atëherë ky ka

nevojë për një izolim prej njerëzve dhe për vetmi. Sikurse është shprehur Ibn Tejmije (Allahu e mëshiroftë): “*Robi doemos ka nevojë për disa kohë që të jetë në vetmi, si: duke bërë dua, duke rikujtuar Zotin, duke falur namaz, duke medituar, duke bërë llogari për veprimet e tij dhe duke e pastruar zemrën* ”. Nga ky lloj i izolimit-veçimit duhet të kihet parasysh dy çështje.

E para, që ky izolim-veçim të bëhet në kohët kur rekomandohet me Sheriat veçimi, e i cili izolim është lloj adhurimi në vete, si p.sh. itikafi në muajin e Ramazanit, falja e namazit të natës, të qëndruarit në xhami për ta pritur ardhjen e kohës së namazit. Vërtet në këto kohë, në të cilat bëhet adhurim ndaj Allahut dhe rikujtohet Ai, izolimi i tillë është legal sipas shariatit, edhe pse koha e këtij izolimi është e shkurtër, por ndikimi është shumë i madh.

E dyta, kur ndodh që thirrësi ka nevojë për një veçim-izolim më të gjatë sesa ai i llojit të parë, sikurse f.v. të veçohet në shtëpinë e tij për disa ditë pasi që e sheh të arsyeshme që këtë veçim, të qetësohet, të bëjë një rekreacion, të bëjë llogaritjen e veprimeve të tij, t’i korrigojë gabimet etj . Në këtë lloj të veçimit nuk ka kurrfarë të keqeje, me kusht që ky veçim të synojë përgatitjen për të bërë më shumë thirrje tek Allahu. Kjo është e ngjashme sikur luftëtari i cili largohet prej arenës së luftës për ta mprehur shpatën, për t’i dhënë tagji kalit, apo të ta rregulluar shtizën, apo për ta mjekuar plagën, ndërsa zemrën e ka të lidhur me xhihadin dhe se synimi i tij është që të kthehet sa më shpejt në betejë. Andaj, ky, në të dyja rastet, është në xhihad, ngase veprat çmohen sipas nijetit-qëilimit. Allahu është i Vetmi nga i Cili kërkohet ndihmë.

Pos këtij lloji të veçimit-izolimit të thirrësit ka edhe një lloj tjetër të izolimit, kur thittësi qëndron në mesin e atyre që janë prezentë vetëm fizikisht, ndërsa me mendja nuk është te ata. Ky lloj i izolimit është i nevojshëm sa herë që ai është i detyruar të gjendet në mesin e njerëzve të këqij, apo në tubimin e njerëzve që përgojnë dhe flasin kot, por që nuk mund të largohet prej atyre. Pra, nuk ka mundësi ta ndryshojë këtë të keqe, fizikisht është aty, por me shpirt nuk është në mesin e tyre.

Ekziston edhe lloji i tretë i izolimit-veçimit të thirrësit, e ky izolim është largimi prej jobesimtarëve dhe orientimi kah të tjerët. Kur thirrësi e vëren se munda i tij është i kotë, apo se nuk ka kurrfarë dobie, e sheh se momentalisht ka fare pak mundësi t’i përgjigjen atij, apo e vëren se torturës së tyre nuk mund t’i përballojë, orientohet kah të tjerët për t’i thirrur ata tek Allahu i Lartësuar. Arsyeja e kësaj është se angazhimi i thirrësit është i përkufizuar dhe se koha e tij është po ashtu e

përkufizuar, andaj kur e sheh se dikush nuk po i përgjigjet ftesës së tij, ai orientohet nga të tjerët, duke u veçuar prej të parëve, por jo vetëm kaq, ngase ka mundësi nganjëherë të veçohet edhe prej të gjithëve për një kohë. Kjo vërtetohet me fjalën e Allahut të Lartësuar kur flet për historikun e Ibrahimit a.s.: ***“Unë po largohem prej jush dhe prej asaj që e adhuroni ju pos Allahut.”*** Po ashtu, kjo vërtetohet edhe me fjalën e Allahut të Lartësuar, kur e tregon historikun e të Dërguarit Musa a.s.: ***“E nëse nuk më besoni, atëherë m’u hiqni (më lini të lirë).”*** Gjithashtu, fjala e Allahut të lartësuar, kur e tregon ndodhinë e banorëve të shpellës: ***“Derisa jeni izoluar prej tyre dhe prej asaj që adhurojnë ata, pos Allahut, atëherë strehohuni në shpellë, e Zoti juaj ju dhuron nga mëshira e tij e gjerë dhe ju lehtëson në çështjen tuaj atë që është në dobinë tuaj ”.*** Allahu i Lartësuar dhe i Madhëruar e di më së miri.

Pjesa e tretë

I thirruri në fenë e Allahut

Definicioni i të thirrurit në fenë e Allahut, të drejtat dhe obligimet e tij

Kush është i thirruri në fenë e Allahut?

Çdo njeri, pavarësisht se kush është ai, është i thirrur në fenë e Allahut, ngase feja islame është një mesazh i përhershëm i Allahut të cilin e dërgoi me anë të Muhamedit a.s. te të gjithë njerëzit. Allahu i Lartësuar ka thënë: ***“Thuaj (Muhamed): O ju njerëz! Unë jam i dërguari i Allahut te të gjithë ju“; “Ne nuk të dërguam ty ndryshe veçse për të gjithë njerëzit, sihariqtar dhe tërheqës i vërejtjes, por shumica e njerëzve nuk e dinë. ”*** Në këtë përgjithësim hyjnë të gjithë njerëzit, pa kurrfarë përjashtimi, d.m.th. çdo njeri është i ftuar në fenë islame, është i obliguar që ta pranojë atë thirrje, por që është në moshën madhore dhe i aftë psikikisht, pavarësisht nga raca, ngjyra, profesioni, regjioni dhe gjinia, pavarësisht nëse është mashkull apo femër, apo edhe dallime të tjera ndërmjet njerëzve. Për këtë, ata që e kanë besuar fenë e Muhamedit a.s kanë qenë arabë si Ebu Bekri, etiopas, siç ka qenë Bilali, bizantinë siç ka qenë Suhejbi, persianë siç ka qenë Selmani, femër siç ka qenë Hatixheja, fëmijë siç ka qenë Aliu, pasanik siç ka qenë Uthmani dhe i varfër siç ka qenë Amari (Allahu qofte i kenaqur prej tyre)

Duke u bazuar në këtë, na del se thirrja tek Allahu është universale, ajo i përfshin të gjithë njerëzit e nuk është thirrje e drejtuar ndonjë race të caktuar, ndonjë kategori të caktuar të njerëzve, apo e ndonjë grupi të caktuar. Andaj, për këtë, Kurani Fisnik u drejtohet njerëzve, në mënyrë të përgjithshme, duke thënë: ***“O njerëz, adhurojeni Zotin tuaj”;*** ***“O bijtë e Ademit, vishuni bukur për çdo namaz (lutje).”*** Thirrësi duhet ta kuptojë universalitetin e thirrjes tek Allahu dhe të angazhohet që ajo të arrijë të çdo njëri. Kjo nuk vijë në kundërshtim me atë se në fillim duhet të thirren të afërmit e më pastaj ata që janë më larg dhe se çdo njeri e

ka të drejtën që t'i arrijë thirrja për tek Allahu. I largëti nuk është më prioritar se i afërmi, por të afërmit është më lehtë t'i bëhet thirrja dhe, pasi ky ta pranojë islamin, do t'i lehtësojë më pastaj thirrësit që t'i ftojë të largët. Mu për këtë Kurani Fisnik ka tërhequr vërejtjen, duke thënë: ***“Dhe tërhiqja vërejtjen farefisit tënd më të afërt”***. Pra, në këtë ajet urdhri i është drejtuar në mënyrë të veçantë të Dërguarit të Allahut s.a.v.s, por që ky urdhër i përfshin të gjithë thirrësit tek Allahu, andaj këta duhet t'ua tërheqin vërejtjen të afërmeve të tyre, duke filluar nga anëtarët e familjes, të afërmit dhe ata që i njohin. Jo vetëm kaq, por thirrja e familjes së ngushtë dhe e anëtareve të tjerë të familjes është më shumë e obliguar se ndaj të tjerëve, ngase, po qe se thirrësi është i zoti i shtëpisë, atëherë ai është edhe përgjegjës për familjen e tij: ***“Secili prej jush është bari dhe përgjegjës për kopenë e tij”***. Kjo përgjegjësi përfshin përgjegjësinë e furnizimit material, siç janë ushqimi, pija, vendbanimi e të ngjashme, sikurse në këtë përgjegjësi përfshihen edhe çështjet fetare dhe mësimi i atyre çështjeve që janë të domosdoshme në fenë islame dhe thirrja e tyre në to. Allahu i Lartësuar, duke lavdëruar njërin prej të dërguarve të Tij, ka thënë: ***“Ai e urdhëronte familjen e vet për faljen e namazit”*** Po ashtu Allahu i Lartësuar ka thënë: ***“O ju që besuat, ruajeni veten dhe familjen tuaj prej një zjarri”*** Mbrojtja e tyre prej zjarrit të Xhehenemit bëhet duke i ftuar në fenë islame dhe në nënshtrimin ndaj urdhrave të Allahut e në braktisjen e çdo gjëje që ka ndaluar Ai.

Të drejtat e personit Të thirrur në fenë e Allahut

Si e drejtë e të thirrurit në fenë e Allahut është që të shkohet tek ai dhe të ftohet në fenë e Allahut, d.m.th. thirrësi duhet të shkojë tek i thirruri dhe ta thërrasë atë në fenë e Allahut të Lartësuar, e jo që thirrësi të qëndrojë në shtëpinë e tij dhe të presë që njerëzit të vijnë tek ai. Ja, pra, kështu ka vepruar i Dërguari ynë, Muhamedi s.a.v.s, i cili shkonte nëpër tubimet e kurejshëve, duke i ftuar ata në fenë e Allahut; po ashtu, dilte nëpër fise, duke hyrë nëpër shtëpitë e tyre e duke i ftuar në fenë e Allahut. Madje, i thërriste njerëzit në fenë e Allahut edhe në kohën e haxhit, kur vinin shumë njerëz, ai shkonte tek ata për t'i ftuar në fenë e Allahut dhe për t'u takuar me ta Mekë, me të vetmin qëllim që t'i thërrasë për në fenë e Allahut. Në jetëshkrimin që i Ibn Hishami ia kushton të Dërguarit salAllahu alejhi ue sel-lem përmendet: “I Dërguari i Allahut s.a.v.s, në kohët e festave, shkonte dhe i takonte fiset e ndryshme arabe për t'i ftuar në fenë e Allahut, i informonte ata se ai është i

Dërguar prej Allahut dhe kërkonte prej tyre që t'i besojnë atij si i Dërguar e të mos e pengojnë derisa të shpjegojë atë që i ka zbritur prej Allahut. Ndalej nëpër shtëpitë e fiseve arabe, duke u thënë: *“O bijtë e filanit, unë jam i Dërguar i Allahut te ju; Ai ju urdhëron që ta adhuron Allahun, të mos ia shoqëroni askënd si rival, që të hiqni dorë nga adhurimi i idhujve, që të besoni se unë jam i Dërguar i Allahut dhe të mos më pengoni që ta shpjegoj atë që e ka shpallur Allahu tek unë...”* I Dërguari i Allahut s.a.v.s, sa herë që dëgjonte se dikush prej arabëve me autoritet kishte ardhur në Mekë shkonte medoemos ta ftonte atë në fenë e Allahut dhe t'ia prezantonte atë që i është shpallur.” I Dërguari i Allahut salAllahu alejhi ue sel-lem nuk ishte ndalur vetëm në Mekë të ftonte për në fenë e Allahut, por ai kishte dalë edhe jashtë saj duke shkuar edhe në Taif për t'i thirrur banorët e atij vendi. Pasi e përfundoi punën e thirrjes në Taif, ai u ndal te disa prijës të fisit Thekif, bisedoi me ta dhe i ftoi në fenë e Allahut...

Ne mund të pyesim këtu: Pse tek ai që thirret duhet të shkohet e jo ai të vijë ai tek thirrësi? Përgjigjja për këtë është në disa aspekte:

Aspekti i parë, pa dyshim se detyrë e të Dërguarit të Allahut salAllahu alejhi ue sel-lem ishte shpjegimi-komunikimi i asaj që i shpallej. Allahu i Lartësuar ka thënë: ***“O, ti i dërguar, komunikojë atë që t'u zbrit prej Zotit tënd”***; ***“I dërguari ka obligim vetëm komunikimin e qartë”***. Ky komunikim kërkon doemos që i Dërguari i Allahut salAllahu alejhi ue sel-lem të shkojë deri te vendi ku dëshiron të komunikojë për shkak se ka mundësi që të mos arrijë komunikata deri atje, apo ndoshta mund të arrijë deri atje në mënyrë të pasaktë, apo ndoshta ka arritur në formën e saktë, por nuk është ekzekutuar në praktikë. Andaj, për shkak të këtyre mundësive që të mos arrihet komunikimi ashtu si duhet i Dërguari i Allahut salAllahu alejhi ue sel-lem ka shkuar në vendin e njerëzve për t'u komunikuar atyre direkt thirrjen tek Allahu.

Aspekti i dytë, butësia e të Dërguarit salAllahu alejhi ue sel-lem ndaj robërve të Allahut dhe lakmia e tij që ata të udhëzohen ka bërë që i Dërguari salAllahu alejhi ue sel-lem të shkojë te njerëzit për t'i ftuar tek Allahu.

Aspekti i tretë, ai që është larg islamit, zemra e tij është e sëmurë, e ata që i kanë zemrat të sëmura nuk e njohin sëmundjen e tyre, as që e kuptojnë atë dhe as që ndiejnë nevojë për trajtim, andaj patjetër duhet që për sëmundjen e tyre t'i informojnë të dërguarit e Allahut. Tjetra është se të dërguarit e Allahut nuk presin që këta njerëz të vijnë te ta, por ata (të dërguarit e Allahut) shkojnë tek ata dhe i informojnë njerëzit se zemrat e tyre janë të sëmura dhe se kanë nevojë për trajtim,

ngase prej simptomave të sëmundjes së tyre është kundërshtimi i thirrjes islame dhe mosshkuarja tek ai që thërret në fenë islame.

Thirrësi mysliman e ka për obligim ta ndjekë si model të Dërguarin e Allahut s.a.v.s, duke shkuar te njerëzit në vendet e tyre të tubimit, me qëllim që t'ua komunikonte fenë islame dhe t'i thërriste ata në fenë e Allahut. Ah, sa mirë do të ishte sikur të shpërndaheshin thirrësit myslimanë nëpër fshatra e lagje dhe secili të shpjegojë islamit në ndonjë vend. Në këtë aspekt imam el-Gazaliu thotë: “Secili dijetar është përgjegjës për një regjion, vend, lagje apo xhami që t'ua mësojë banorëve të atij vendi fenë e tyre (fenë islame), të bëjë të qartë atyre atë që është e dëmshme e çka është e dobishme për ta, ajo që i bën të palumtur ata dhe ajo që i bën të lumtur. Nuk duhet thirrësi të pret që ta pyesin atë njerëzit, por ata duhet t'i ftojnë njerëzit në fenë e Allahut, ngase ata janë trashëgimtarët e të dërguarve të Allahut, e dihet fare mirë se të dërguarit e Allahut nuk i kanë lënë njerëzit në injorancën e tyre, por i ka thirrur njerëzit në fenë e Allahut në çdo tubim, u kanë shkuar nëpër shtëpitë e tyre, duke i ftuar një nga një në fenë e Allahut dhe i kanë udhëzuar ata. Ky veprim është farzi ajn-obligim i individual që e përshin çdo dijetar dhe çdo prijës e ka për obligim të caktojë nga një dijetar për çdo fshat e vendbanim me qëllim që t'ua mësojë njerëzve fenë e tyre (fenë islame), ngase njerëzit që të gjithë lindin të paditur dhe se patjetër duhet komunikuar atyre thirrjen në fenë e Allahut”.

Nuk duhet injoruar asnjë njeri

Nuk i lejohet asnjë thirrësi që ta minimizojë çështjen e cilitdo njeri apo ta injorojë duke mos e thirrur atë në fenë islame, ngase e drejtë e çdo njeriut është që të thirret në fenë e Allahut. Mund të ndodhë që personi, të cilin e konsideron thirrësi si të pavlerë, të ketë peshë të madhe tek Allahu dhe për shërbimin e tij ndaj fesë islame dhe të thirrjes në atë fe. Kështu, i Dërguari i Allahut salAllahu alejhi ue sel-lem e ftonte çdo njeri që e takonte në fenë islame, apo edhe shkonte tek ai për ta ftuar në fenë e Allahut. Përmendet në historinë e jetës së të Dërguarit salAllahu alejhi ue sel-lem se pasi që ky u kishte bërë ftesë për në fenë e Allahut fiseve arabe që kishin ardhur në sezonin e haxhit kjo ishte ndodhur tre vjet para emigrimit në Medinë e që askush nuk i ishte përgjigjur atij. Mirëpo, gjatë kthimit e kishte takuar një delegacion prej gjashtë vetave nga fisi Hazrexh te vendi i quajtur Akabe në

Mina e të cilët ishin duke i rruar flokët. Në këtë rast i Dërguari i Allahut salAllahu alejhi ue sel-lem u ul në mesin e tyre dhe i ftoi në fenë islame duke ua lexuar disa ajete prej Kuranit. Këta iu përgjigjen thirrjes së Allahut dhe të Dërguarit të tij, u bënë besimtarë, e më pastaj u kthyen te populli i tyre në Medinë dhe ua përmendën atyre të Dërguarin e Allahut s.a.v.s, e thirrën popullin e tyre në fenë islame dhe kështu u përhap islame te të gjithë, ku nuk mbeti asnjë shtëpi ku nuk përmendej i Dërguari i Allahut salAllahu alejhi ue sel-lem Pra, i Dërguari i Allahut salAllahu alejhi ue sel-lem nuk e minimizoi rëndësinë e këtyre gjashtë vetave që ishin duke i rruar kokat e tyre dhe pasi që atij nuk i ishte përgjigjur asnjëri nga fiset që kishin ardhur në Mekë dhe as që tha në shpirtin e tij fisnik: çfarë shprese mund të kihet prej këtyre që po e rruajnë kokën. Këta gjashtë veta ishin thirrësit e parë në islam në mesin e medinasve, andaj thirrësi e ka për detyrë që ta ndjekë udhëzimin e të Dërguarit s.a.v.s, i cili nuk e ka injoruar askënd në aspektin e thirrjes në islam, ngase mund të ketë dobi të shumta prej këtij personi që tash nuk po e thërret në fenë islame.

Obligimet e të thirrurit në fenë e Allahut

Pasi që e drejtë e të thirrurit në fenë e Allahut është që të shkohet tek ai dhe të ftohet në islam dhe që të mos injorohet e të minimizohet roli i tij, atëherë ky e ka si obligim që t'i përgjigjet thirrjes islame për tek Allahu, ngase ky po thirret në të mirën dhe të vërtetën dhe se po kërkohet që t'i përgjigjet thirrjes së Krijuesit te Tij. Për të shpjeguar atë se thirrësi nuk duhet të bjerë pesimizëm, por gjithmonë para vetes do të ketë optimizëm, ne konkludojmë kështu: vërtet njerëzit nuk janë të barabartë në përgjigjen ndaj të Vërtetës dhe në pranimin e thirrjes së Allahut. Ka prej njerëzve që e pranojnë menjëherë dhe shumë shpejt thirrjen. Po ashtu, ka prej tyre që shumë ngadalë e pranojnë thirrjen dhe se ka që janë as të shpejtë e as të ngadalshëm në pranimin e thirrjes. Pra, ka prej njerëzve që besojnë menjëherë pa kurrfarë kundërshtimi, pra mezi pret të dëgjojë thirrjen ftesën dhe të besojë. Si shembull për këtë mund të përmendim besimin e Ebu Beker Sidikit radijAllahu anhu dhe besimin e magjistarëve në kohën e Musait a.s. Sa i përket çështjes së besimit të Ebu Bekrit radijAllahu anhu, ne na ka informuar i Dërguari Fisnik s.a.v.s, kur ka thënë: *“Nuk e kam ftuar dikë në’ islam e që të mos ketë kundërshtuar e diskutuar përveç Ebu Bekër ibn Ebi Kuhafete, i cili ka besuar menjëherë; pasi ia kam parashtruar ftesën për në islam ”*. Ndërsa sa i përket imanit të magjistarëve të

kohës së Musait a.s. është fjala për ata magjistarë, të cilët kishin ardhur në kohën e faraonit për t'ia hedhur poshtë mrekullinë e Musait a.s. Allahu i Lartësuar na ka informuar për besimin e këtyre magjistarëve duke thënë: ***“Atëherë edhe Musai e hodhi shkopin e vet, i cili menjëherë gëlltiste gjithë çka kishin improvizuar ata. Atëherë magjistarët ranë në sexhde (u përulën Zotit të Musait e të Harunit! Ai (faraoni) tha: I besuat atij, para se tju lejoja unë?! S’ka dyshim se ai (Musai) është prijësi juaj që jua mësoi juve magjinë, e keni për ta marrë vesh më vonë. Unë do t’jua shkurtoj (do t’jua pres) duart dhe këmbët tuaja të anës së kundërt dhe që të gjithëve do tju gozhdoj. Ata (magjistarët) thanë: S’ka rëndësi, ne i kthehemi Zotit tonë. Meqë ne jemi besimtarët e parë, shpresojmë se Zoti ynë do të na falë gjynahet tona!”*** Këta magjistarë kishin ardhur për ta ndihmuar në mashtrimin-gënjeshtren e faraonit dhe mosbesimin e tij dhe që t’i rezistojnë thirrjes së Musait, të Dërguarit të Allahut, por pasi që e panë mrekullinë (muxhizen) e kuptuan sa ajo nuk është magji të cilën e kanë mësuar ata, por ajo vërtet është prej Allahut dhe argument për vërtetësinë e shpalljes së Musait a.s. Unë them se ata pasi e panë këtë (muxhizen) besuan menjëherë dhe e shpallën haptas besimin e tyre, andaj kjo argumenton për besimin e madh që kishin ata dhe fuqinë e dritës së besimit të tyre që kishte hyrë në zemrat e tyre. Pos kësaj, këta e hedhin poshtë çdo të pavërtetë duke e shprehur këtë me gjuhët e tyre, duke thënë: ***“E thanë: Ne i besuam Zotit të botëve, Zotit të Musait e të Harunit!”*** Kur iu kërcënohet atyre i mallkuari (faraoni) ata i përgjigjen duke i thënë: ***“S’ka rëndësi”***, kjo d.m.th. nuk ka kurrfarë rëndësi se çfarë na pret neve prej dënimit të kësaj bote, ngase dënimi në këtë botë është i shkurtër, andaj ne do të durojmë atë dhe më pas do të takojmë Allahun, Zotin tonë si besimtarë, duke shpresuar dhe duke dëshiruar që ne të na falen gjynahet e mëhershme, ngase ne kemi nxituar të besojmë menjëherë kur na u paraqit mrekullia e Musait a.s.

Këta dy shembujt tregojnë pranimin e shpejtë të ftesës për në fenë e Allahut që ekziston te disa njerëz. Ndërkaq, sa u përket shembujve për përgjigjen e ngadalshme ndaj ftesës për të besuar Allahun janë të shumta, por ne do të ndalem në disa prej tyre, si: ne na ka treguar Allahu ndodhinë e popullit të Nuhut a.s., ku Nuhu a.s. qëndroi në mesin e tyre, duke i ftuar në fenë e Allahut një mijë pa pesëdhjetë Vjet (950 Vjet) dhe se gjatë gjithë kësaj kohe besuan shumë pak, ashtu siç e përshkruan Kurani Fisnik. Ebu Sufjani dhe disa të tjerë nuk besuan fenë islame e as të Dërguarin e Allahut, Muhamedin s.a.v.s, derisa u çlirua Meka dhe pas armiqësisë e luftimit të të Dërguarit vazhdimisht njëzet Vjet. Po ashtu ka të

tjerë që nuk i përgjigjen ftesës për në fenë e Allahut dhe kështu Vdesin jobesimtarë. Allahu na ruajt prej këtij mashtrimi.

Prej obligimeve që ka i thirruri, pasi që atë e ka udhëzuar Allahu në fenë islame, është që ai t'i kryejë obligimet e fesë islame, që jetën e tij ta konsolidojë mbi parimet e programit islam, ta adhurojë Allahun, siç ka urdhëruar Ai, dhe ashtu si e ka shpjeguar në Kuranin e Tij dhe ashtu si e ka shpjeguar me gjuhën e të Dërguarit të Tij, me qëllim që në islamin e tij të mos ketë asnjë grimcë të hipokrizisë, duke thënë se ai është prej myslimanëve, por në fakt ai nuk i zbaton obligimet islame.

Kategoritë e të thirrurve në fenë e Allahut

Hyrje

Në çdo shoqëri gjenden prijës, të cilët e kanë forcën ekzekutive në duart e tyre. Këta janë kategoria e parë e të thirrurve në fenë e Allahut dhe Kuranin Fisnik përmenden me shprehjen “paria-الملا”. Pas këtyre janë kategoria e tjetër: masa e gjërë e popullit. Pra, këta janë kategoria e dytë e të thirrurve në fenë e Allahut, e kur këta t’i përgjigjen ftesës për në fenë e Allahut dhe që imani-besimi të futet në zemrat e tyre, atëherë besimtarët do të jenë të fuqishëm dhe se shoqëria e tillë do të jetë shoqëri islamë. Mirëpo, nga mesi i kësaj shoqërie mund të paraqitet një kategori e tretë e njerëzve, të cilët formalisht e shprehin islamin, por në fakt e fshehin mosbesimin në zemrat e tyre, e këta janë mynafikët-hipokritët. Po ashtu në mesin e myslimanëve mund të ketë besimtarë që e kanë besimin të dobët dhe që lehtë mund të bien në gjynahe, e kjo kategori e të thirrurve në fenë e Allahut njihen si gjynahqarë. Andaj, patjetër duhet t’i shpjegojmë të gjitha këto kategori në mënyrë të hollësishme, në kapitujt vijues.

Paria

Definicioni i parisë

Kurani Fisnik e përdor shprehjen (الملا) në tregimet e të dërguarve të Allahut dhe çfarë ka të bëjë me popujt e tyre. Më këtë shprehje komentuesit e Kuranit thonë se nënkuptohen prijësit dhe udhëheqësit e popullit-paria. Pra, paria e njerëzve janë ata persona të cilët nga shoqëria konsiderohen se kanë të drejtë për ta udhëhequr dhe për ta drejtuar shoqërinë. Andaj, përdorimi i kësaj shprehjeje në Kuranin Fisnik ka për qëllim të tregojë realitetin faktik të parisë e jo që me këtë shprehje i përmend

ata që meritojnë që të jenë pari e njerëzve. Në të njëjtën mënyrë e gjejmë edhe në mesazhet e të Dërguarit salAllahu alejhi ue sel-lem drejtuar prijëseve të Persisë, Bizantit dhe Egjiptit. Në disa mesazhe të të Dërguarit salAllahu alejhi ue sel-lem e shohin se qëndron shprehja: drejtuar prijësit të madh të bizantinëve, Pra, përdorimi i kësaj shprehjeje është si shpjegim i realitetit faktik, ngase ai te bizantinët është i madh, e me këtë nuk është qëllimi që të shpjegohet nëse e meriton ky të përshkruhet me këtë cilësi.

Paria dhe thirrja në fenë e Allahut

Përshkrimi i parive në të shumtën e rasteve bëhet duke treguar se ata e kanë kundërshtuar thirrjen në fenë e Allahut, i kanë bërë rezistencë thirrjes së të dërguarve fisnikë tek Allahu i Lartësuar dhe se ata kanë vepruar në mënyrë të gabuar duke e kundërshtuar thirrjen tek Allahu, duke bërë trillime e përgënjeshtime kundër të dërguarve të Allahut të Lartësuar. Këtë e argumenton fjala e Krijuesit tonë të Madhëruar: ***“Ne nuk dërguam në asnjë vendbanim ndonjë nga të dërguarit e që pasanikët e tij të mos i thoshin: Ne nuk i besojmë asaj me çka jeni dërguar, Ata thoshin: Ne kemi më shumë pasuri e fëmijë, e ne nuk do të jemi të ndëshkuar”***. Me këtë ajet fisnik Allahu i Lartësuar e ka informuar të Dërguarin e Tij, Muhamedin salAllahu alejhi ue sel-lem, si lloj relaksimi për atë se çdo të dërguar që e ka dërguar Ai tek një popull paria e atij populli i kanë thënë se nuk i besojnë dhe nuk e ndjekin. Allahu i Lartësuar, kur flet për ndodhinë e Nuhut a.s., thotë: ***“Ne e patem dërguar Nuhun te populli i vet, e ai tha: O populli im, adhurojeni Allahun, nuk keni zot tjetër pos Tij. Unë kam frikë për dënimin tuaj në një ditë të madhe! Paria nga populli i tij tha: Ne po të shohim (në këtë që na thërret) plotësisht të humbur”*** Paria e popullit të Nuhut a.s. kanë qenë ata që e kanë penguar thirrjen e Allahut dhe pos kësaj këta peygamberit të tyre ia kanë përshkruar humbjen e qartë, andaj ky veprim është njëri ndër zullumet më të mëdha dhe pengesat në rrugën e Allahut, duke e cilësuar të vërtetën që e ka sjellë Nuhu a.s. si devijim. Mirëpo, kjo është logjika e parisë (së popullit të Nuhut a.s.) dhe gjithashtu ky ishte qëndrimi i parisë së kurejshëve ndaj thirrjes së Muhamedit salAllahu alejhi ue sel-lem, e të cilët i kanë bërë rezistencë kësaj thirrjeje të begatshme, e kanë torturuar të Dërguarin e Allahut salAllahu alejhi ue sel-lem, e kanë akuzuar për gënjeshtër dhe kanë bërë komplot ndaj tij. Allahu i Lartësuar ka thënë: ***“Ata (idhujtarët) habiten, ngasë u erdhi peygamberi***

nga mesi i tyre, e mosbesimtarët thanë: Ky është magjistar, rrenës. A mendon ai t'i bëjë zotat Një Zot? Vërtet, kjo është gjë shumë e çuditshme! Paria nga mesi i tyre shkoi duke i thënë njëri-tjetrit: vazhdoni të jeni të qëndrueshëm në adhurimin e zotave tuaj, sepse kjo është një gjë e kurdisur. Ne nuk kemi dëgjuar diçka të këtillë në popullin (në fenë) e fundit; kjo nuk është tjetër, pos një trillim“ Me parinë në ajet synohen udhëheqësit e kurejshëve, të cilët i thoshin popullit të tyre: Vazhdoni në fenë tuaj dhe mos iu përgjigjini thirrjes së Muhamedit salAllahu alejhi ue sel-lem që të besoni në një Zot.

Në biografinë e jetës së të Dërguarit salAllahu alejhi ue sel-lem përmenden shumë qëndrime të parisë kurjeshite dhe të fiseve të tjera ndaj thirrjes në fenë e Allahut, e të cilën ftesë ua ka komunikuar i Dërguari Allahut salAllahu alejhi ue sel-lem Prej këtyre mund ta përmendim atë që e ka përmendur Ibn Hishami në librin e tij *“Siretu Ibn Hisham”* se si i Dërguari salAllahu alejhi ue sel-lem shkonte nëpër fiset arabe dhe i ftonte ata për në fenë e Allahut, ndërsa Ebu Lehebi, i cili ishte prej parisë kurejshe ecte prapa tij duke u thënë njerëzve: *“... mos iu nënshtroni atij dhe mos e dëgjoni atë.”* Po ashtu, kur i Dërguari salAllahu alejhi ue sel-lem kishte shkuar në Taif, ishin tubuar paria e atij vendi dhe ishin sjellë me të Dërguarin salAllahu alejhi ue sel-lem në mënyrën më të keqe, por ata nuk ishin ndalur vetëm me kaq, ngase i kishin nxitur mendjelehtët dhe robërit e tyre që ta shajnë atë (Muhamedin s.a.v.s), t'i bërtasin atij në atë mënyrë derisa janë tubuar që të gjithë njerëzit?

Shkaqet e armiqësisë së parisë ndaj thirrjes në fenë e Allahut

Duke i analizuar ajetet kuranore, të cilat shpjegojnë çështjen e parisë së popujve na del në pah se shkaqet e armiqësisë së parisë ndaj të dërguarve të Allahut dhe refuzimit të thirrjes së tyre. Andaj, njëri prej shkaqeve me të rëndësishëm është mendjemadhësia, e cila është futur në shpirtin e parisë dhe dashuria për të pasur pushtet e prestigj. Pos këtyre, si shkak me rëndësi është edhe injoranca që ekzistonte tek ata... Prandaj, ne do të flasim për secilin shkak duke e argumentuar me ajete dhe me hadithe.

Shkaku i parë - mendjemadhësia

Mendjemadhësia është njëra prej cilësive të nënçmuara dhe sëmundjeve të mëdha që ngulitet në shpirt dhe gjurmët e së cilës manifestohen në forma e mënyra të ndryshme, siç është verbëria përballë të vërtetës, në të shumtën e rasteve, eventualisht mund të shihet e vërteta, por që mendjemadhësia nuk lejon që ajo të pranohet sikurse pengon t'iu pranohet vlera atyre që kanë vlerë. Po ashtu, mendjemadhi pengohet nga mendjemadhësia që ta shohë të vërtetën për shkak se e vlerëson vetveten si më të mirë se njerëzit e tjerë dhe, për këtë shkak, largohet prej tyre e nuk ka dëshirë që ta ndjekë ndonjërin prej tyre. Nganjëherë ndodh që të bashkohet zilia me mendjemadhësinë dhe kështu edhe më tepër shtohet ndikimi i tyre i keq, mohimi i të vërtetës dhe luftimi i atyre që kanë të drejtë dhe që e vërteta është me ta.

Prej ajeteve që e argumentojnë cilësinë e mendjemadhësisë së parisë dhe ato çfarë rezultojnë prej të këqijave të saj janë:

1. ***“Dhe, edhe pse bindshëm të besueshëm në to (se ishin nga Zoti), i mohuan në mënyrë të padrejtë e me mendjemadhësi, pra shikoje se çfarë ishte fundi i shkatërrimtarëve”***. Faraoni dhe populli i tij e mohuan pejgamberinë e Musait a.s. edhe pse ata ishin të bindur se ishte ai i dërguar prej Zotit. Shkak që këta ta mohojnë pejgamberinë e Musait a.s. ishte mendjemadhësia dhe padrejtësia e tyre.

2. ***“Ne e patëm dërguar Nuhun te populli i vet, e ai tha: O populli im, adhurojeni Allahun, nuk kemi zot tjetër pos Tij. Unë kam frikë për dënimin tuaj në një ditë të madhe! Paria nga populli i tij tha: Ne po të shohim (në këtë që na thërret) plotësisht të humbur”*** Paria e këtij populli në vend që të shohin të vërtetën që ua solli Nuhu a.s., atë e konsideruan si devijim, dritën që e solli ky i Dërguar ata e konsideruan si errësirë, e pos kësaj pretenduan se ky është një devijim dhe humbje e qartë. Në realitet ky është një argument për verbërinë e tyre dhe mosinteresimin për të vërtetën nga ana e tyre, e cila verbëri i solli ata që të pretendojnë diçka të tillë dhe, pos kësaj, kjo i solli në shkatërrimin e tyre. Allahu i Lartësuar, kur informon për përfundimin e tyre, thotë: ***“Ndërsa ata që i përgënjeshtroan faktet tona i fundosëm. Vërtet, ata ishin popull i verbër”***.

3. Allahu i Lartësuar, kur flet për popullin Ad dhe atë se çfarë i kanë thënë ata të dërguari të Allahut Hudit a.s., thotë: ***“Paria që nuk besoi nga populli i tij tha: Ne po të shohim mendjelehtë dhe të konsiderojmë vërtet rrenacak.”*** Paria e popullit Ad e konsideronin të Dërguarin e Allahut si mendjelehtë, e sikur ata të shikonin ashtu si duhet do ta kuptonin se ajo në të cilën po ftoheshin ishte e vërteta e qartë.

4. Ajo çfarë ka sqaruar Allahu i Lartësuar për parinë e kurejshëve, se si ata e kanë cilësuar thirrjen e të Dërguarit salAllahu alejhi ue sel-lem me rrenë dhe trillim. Allahu i Lartësuar ka thënë: ***“Ne nuk kemi dëgjuar diçka të këtillë në popullin (në fenë) e fundit; kjo nuk është tjetër pos një trillim.”*** Si është e mundur që ata ta cilësojnë të Dërguarin e Allahut si magjistar dhe të çmendur, Allahu i turpëroftë ata.

5. Allahu i Lartësuar, kur tregon për parinë popullit të Nuhut a.s., thotë: ***“Paria që nuk besoi nga populli i tij tha: Ne nuk të shohim ndryshe vetëm si njeri, ne nuk po shohim se të pasoi kush, përveç atyre që janë më të poshtrit e më mendjelehtë nga mesi ynë dhe ne nuk shohim se ju keni ndonjë vlerë mbi ne, përkundrazi, ne ju konsiderojmë gënjeshtarë”*** Paria e popullit të Nuhut a.s. i thoshin Nuhut a.s.: Nuk po shohim që ty po të ndjekë dikush, pos të dobëtit e popullit të varfrit, të dobëtit dhe të nënçmuarit dhe se nuk po të ndjekë askush prej prijësve dhe udhëheqësve, atëherë pse të bëhemi ne me ty dhe me ata që të ndjekin ty? E pastaj vazhdojnë e thonë këta që po të ndjekin ty prej të nënçmuarve po të ndjekin pa e përdorur mendjen fare, pa i shikuar gjerat, pa i analizuar çështjet, ngase ata janë prej mendjelehtëve dhe të nënçmuarve e nuk janë prej prijësve dhe atyre që kanë prestigj e famë. Po ashtu, paria thonë se nuk po shohin tek i Dërguari i Allahut dhe ithtarët e tij diçka të vlefshme e në fund e përfundojnë duke thënë se të gjithë këta janë gënjeshtarë. E gjithë kjo është si rezultat i mendjemadhësisë së tyre dhe se për shkak të këtij fenomeni e kundërshtojnë dhe e mohojnë të vërtetën, duke argumentuar se ata që po e ndjekin të Dërguarin janë mendjelehtë dhe të nënçmuar. Ata kanë harruar se e vërteta mbetet e vërtetë, pavarësisht se a e ndjekin atë të varfrit apo të dobëtit, prijësit apo udhëheqësit dhe se ata që e ndjekin të vërtetën janë me prestigj, edhe në qoftë se janë të varfër, ndërsa mendjelehtë dhe të nënçmuar janë ata që e kundërshtojnë të vërtetën, edhe nëse ata në sytë e njerëzve janë njerëz me prestigj.

6. Allahu i Lartësuar ka thënë: ***“Më pas Ne e dërguam Musain dhe vëllanë e tij Harunin me mrekulli dhe argumentet tona të qarta te faraoni dhe rrethi i tij, po ata u treguan kryelartë, sepse ishin popull mendjemadh. Dhe thanë: Si t’u***

besojmë dy njerëzve që janë si ne, kur populli i tyre është në shërbimin tonë? Kështu, ata i përgënjeshtroan që të dy, andaj, me të drejtë i shkatërruam”.

Faraoni dhe paria e tij nga mendjemadhësia nuk e ndoqën të vërtetën dhe e mohuan atë dhe nga injoranca e tyre, ata mundoheshin ta arsyetonin veprimin e tyre. Faraoni është ai që nga mendjemadhësia e tij madje pretendoi për veten se është zot. Allahu i Lartësuar për këtë ka thënë: ***“E faraoni tha: O ju pari, unë nuk njoh ndonjë zot tjetër për ju pos meje; “E u tha: Unë jam zoti juaj më i lartë”***

7. Në jetëshkrimin e të Dërguarit salAllahu alejhi ue sel-lem rrëfëhet se si paria e kurejshëve i kanë thënë të Dërguarit salAllahu alejhi ue sel-lemz Ne nuk jemi të pajtimit që të jemi bashkë me këta-me të dobëtit prej myslimanëve, siç ishin: Suhejbi, Amari, Bilali, Hababi, andaj largoji ata prej teje dhe mos qëndro me ta derisa ne të jemi me ty dhe të dëgjojmë prej teje atë që ke për ta thënë, e pastaj, kur të dalim ne prej teje, ti nëse do bashkohu me ta. Mu për këtë Allahu zbriti këtë ajet: ***“Përkufizojë veten tënde me ata që lusin Zotin e tyre mëngjes e mbrëmje, e që kanë për qëllim kënaqësinë (razinë) e Tij dhe mos i hiq sytë e tu prej tyre e të kërkosh bukurinë e kësaj bote... ”***, ndërsa për këta mendjemëdhenj, të cilët kërkuan nga i Dërguari i Allahut salAllahu alejhi ue sel-lem atë që kërkuan, Allahu i Lartësuar tha: ***“Dhe mos iu bind atij që ia kemi shmangur zemrën e tij prej rikujtimit ndaj Nesh dhe që i është dhënë epshit të vet, sepse puna e tij ka mbaruar. ”***

8. Për ata, të cilët u paraqitën mendjemëdhenj ndaj mesazhit islam dhe besimit se Muhamedi salAllahu alejhi ue sel-lem është i Dërguar, Allahu i lartësuar ka thënë: ***“Pastaj thanë: Përse të mos i ketë zbritur ky Kuran një njeriu të madh nga dy qytete? A thua ata e përcaktojnë mëshirën (pejgamberinë) e Zotit tënd? Ne e kemi përcaktuar ndër ta gjendjen e jetës në këtë botë... ”***

Kuptimi i këtij ajeti fisnik është se vërtet ata që e kundërshtuan Kuranin Fisnik, u shprehën si mendjemëdhenj ndaj besimit se Muhamedi salAllahu alejhi ue sel-lem është i Dërguar i Allahut, duke thënë: E përse të mos ketë zbritur Kurani te ndonjë njeri i madh prej tyre dhe në njërin prej dy qyteteve: Mekë dhe Taif. Transmetohet nga Ibn Abasi se qëllimi i tyre me njeriun e madh ishte që t’ia zbriste ndonjërit prej autokratëve të kurjeshëve.800 Ata e konsideronin veten e tyre të mëdhenj dhe e minimizonin pozitën e të Dërguarit salAllahu alejhi ue sel-lem, duke menduar se ai nuk është i aftë ta pranojë mesazhin hyjnor dhe se ata, apo dikush tjetër prej prijësve, është meritator në pranimin e mesazhit hyjnor dhe të zbritjes së shpalljes. Mirëpo, Allahu i Lartësuar iu kundërvu fjalëve të tyre, duke u thënë se çështja e

tillë është në Dorë të Allahut dhe se Ai ka thënë se e di më së miri kujt t'ia zbresë mesazhin e Tij.

Shkaku i dytë - dashuria ndaj pushtetit dhe famës

Paria e popullit e duan pushtetin, prestigjin dhe sundimin ndaj njerëzve. Për këtë ata e kundërshtojnë çdo thirrje që mund t'ua marrë pozitën në mesin e njerëzve dhe që ata t'i bëjë sikur masa e përgjithshme e njerëzve. Ata mendojnë se pranimi i thirrjes për në fenë e Allahut ua merr atyre prestigjin dhe pushtetin, andaj armiqësinë e tyre. Ajetet, të cilat argumentojnë për faktin se paria e duan pushtetin dhe prestigjin dhe se ky është njëri prej shkaqeve që ata e kanë refuzuar thirrjen e vërtetën thirrjen në fenë e Allahut të Lartësuar. Këto ajete janë si vijon:

1. Për ndodhinë e Nuhut a.s. Allahu i Lartësuar ka thënë: ***“E paria e atij populli që nuk besuan thanë: Ky nuk është tjetër pos njeri sikurse edhe ju, po dëshiron të jetë më i lartë se ju. Po të dëshironte Allahu do të dërgonte melaqe; ne një gjë të tillë nuk e kemi dëgjuar as nga të parët tanë!”***

Paria për ta mbrojtur pushtetin e tyre ndaj njerëzve dhe sundimin e tyre i thonë popullit të tyre: Vërtet Nuhu me thirrjen e tij dëshiron të jetë më i lartë se ju, d.m.th. të jetë prijës i juaj dhe sundues juaji. Paria, me këtë pretendim, duan që t'i largojnë njerëzit nga Nuhu a.s. me qëllim që atyre t'iu mbetet pushteti dhe udhëheqja ndaj popullit të tyre. Realiteti është se të dërguarit e Allahut nuk duan kurrfarë lartësie në këtë tokë, nuk duan telashe e as pushtet, por ata, me thirrjen e tyre të natyrshme, arrijnë të bëhen prijës të njerëzve dhe të kenë pushtet ndaj tyre, por jo si pushteti i parisë që sillen me mendjemadhësi ndaj Allahut.

2. Allahu i Lartësuar për faraonin dhe parinë e tij ka thënë: ***“E paria e atij populli që nuk besuan thanë: Ky nuk është tjetër pos njeri, sikurse edhe ju, po dëshiron të jetë më i lartë se ju. Po të dëshironte Allahu do të dërgonte melaqe; në një gjë të tillë nuk e kemi dëgjuar as nga të parët tanë! E kur u erdhi atyre e vërteta e sigurt nga Ne, ata thanë: Kjo nuk është tjetër pos magji e qartë. Musai tha: A të vërtetës i thoni magji? A magji është kjo? Magjistaret nuk shpëtojnë? Ata thanë: Mos erdhe të na largosh nga ajo (feja) që e gjetëm te prindërit tanë, për t'ju mbetur juve dyve madhështia në tokë? Po ne nuk ju besojmë juve dyve”.***

Faraoni dhe paria e tij u bënë arrogantë ndaj atyre që e ndjekin të vërtetën, ata ishin popull kriminel e që më pastaj e arsyetuan arrogancën e tyre ndaj kundërshtimit të Vërtetës duke pretenduar se Musai dhe Haruni duan që t'i largojnë ata nga feja e baballarëve të tyre dhe se ata dy duan ta kenë pushtetin dhe sundimin e tokës.. Shkaqet e refuzimit të thirrjes së vërtetë nga ana e faraonit dhe parisë së tij është mendjemadhësia dhe dashuria ndaj pushtetit dhe lartësimit në tokë, andaj për këtë ata i kanë akuzuar Musain dhe Harunin se e duan pushtetin, ngase faraoni mendon se qëllimi i të dyve është arritja e pushtetit apo thirrja e atyre dyve anon kah ajo që të arrihet pushteti dhe sundimi ndaj njerëzve.

3. Allahu i Lartësuar për parinë kurejshite ka thënë: ***“Paria nga mesi i tyre shkoi duke i thënë njëri-tjetrit: Vazhdoni të jeni të qëndrueshëm në adhurimin e zotave tuaj, sepse kjo është një gjë e kurdisur.”*** Kjo është një pjesë e asaj çfarë janë shprehur paria e kurjeshëve. Sipas komentimit të Kurtubiut, me shprehjen e ajetit ***“sepse kjo është një gjë e kurdisur”***, synohet tërheqja e vërejtjes se kinse Muhamedi salAllahu alejhi ue sel-lem po dëshiron, me atë që po thotë, të bëhet sundues yni e ne të jemi ndjekësit e tij dhe që të na udhëheqë neve, andaj kini kujdes e mos e dëgjoni atë“.

Në tefsirin e Ibn Kethirit kuptimi i pjesës së ***ajetit “pse kjo është një gjë e kurdisur ”*** është kështu: Ka thënë Ibn Xheriri për kuptimin e këtij ajeti: vërtet paria thanë se ky Muhamedi, i cili po na thërret në monoteizëm, ai më këtë dëshiron-synon arritjen pozitës dhe prestigjit dhe që ju të jeni ndjekësit e tij, e që ne nuk i përgjigjemi atij.⁸⁰⁵ Kuptimi i gjithë kësaj është se paria kurejshëve nga lakmia që kishin për pushtet dhe prestigj, e refuzuan thirrjen islame për shkak se ata mendonin se do t’iu humbë pushteti atyre mbi njerëzit.

Shkaku i tretë - injoranca

Paria janë të përmbysur në injorancë dhe nuk e vërejnë injorancën e tyre, duke e mohuar Zotin e vet dhe duke e refuzuar thirrjen e Tij fisnike, të cilën ua kanë shpallur të dërguarit e Tij njerëzve dhe pos kësaj këta e kanë cilësuar këtë thirrje si devijim dhe i kanë akuzuar për mendjehetësi dhe naivitet komunikuesit e asaj thirrje e që këta ishin të Dërguarit e Allahut të Lartësuar. I nxitnin mendjehetësi

kundër të dërguarve, u përgatitnin mashtrime atyre, i largonin prej thirrjes së tyre dhe thoshin se si shenjë e përgënjeshtimit të të Dërguarit është se ai është prej llojit njerëzor dhe se paria janë më meritore për të pranuar mesazhin hyjnor, ngase ata janë paria që kanë më së shumti pasuri dhe pushtet dhe se te dërguarit e Allahut, sipas tyre, dëshirojnë t'i largojnë nga feja baballarëve të tyre dhe t'ua sjellin një fe të re për të cilën nuk kanë dëgjuar më herët. Po ashtu, paria talleshin dhe i përbuznin besimtarët duke pretenduar se ata (besimtarët) nuk kuptojnë e nuk dinë dhe mu për këtë e ndjekin thirrjen në fenë e Allahut dhe thirrjen e të Dërguarve të Allahut, pa menduar e pa analizuar se çfarë janë duke bërë. Ndërkaq, paria nuk veprojnë sikur ata, ngase këta janë në gjendje për t'i kuptuar çfarë veprojnë.

Paria i konsideronin të Dërguarit e Allahut si të çoroditur në tokë, ndërsa veten e konsideronin si njerëz të dobishëm, të cilët e mbrojnë fenë e njerëzve dhe të drejtat e tyre.. Andaj në emër të gjithë kësaj këta do t'i luftojnë të Dërguarit e Allahut thirrësit në fenë e Allahut. Këto janë disa nga gjurmët e injorancës dhe marrëzisë së parisë, për të cilat na ka informuar Allahu në shumë ajete kuranore dhe se injoranca e marrëzia janë prej shkaqeve të devijimit të tyre dhe mosudhëzimit nga Allahu i Lartësuar. Prej ajeteve që flasin për injorancën e parisë mund të përmendim:

1. Allahu i lartësuar për popullin e Nuhut a.s. ka thënë: ***"Paria që nuk besoi nga populli i tij tha: Ne nuk të shohim ndryshe vetëm si njeri, sikurse edhe ne, ne nuk po shohim se të pasoi ndokush, përveç atyre që janë më të poshtrit e më mendjelehtët nga mesi ynë dhe ne nuk shohim se ju keni ndonjë vlerë mbi ne, përkundrazi ne ju konsiderojmë gënjeshtarë!"*** Kjo ka ndodhur për shkak të injorancës së tyre, duke i thënë të Dërguarit të tyre, Nuhut a.s.: Ti nuk je melaqe, por je njeri, e si është e mundur të të vijë shpallja ty, e neve jo? PaStaj ne nuk po shohim se po të ndjekë pos atyre që janë mendjelehtë dhe se nuk po të ndjekin njerëzit që kanë famë e pushtet prej nesh. E gjithë kjo është për shkak të injorancës së tyre, sepse përndryshe po të kishin pak mendje do ta kuptonin se është e domosdoshme që i Dërguari i Allahut të jetë prej njerëzve me të vetmin qëllim që ai të ketë mundësi t'iu flasë atyre dhe që ata ta kuptojnë atë. Po ashtu, po të kishin mendje ata do ta kuptonin se varfëria dhe dobësia nuk kanë kurrfarë lidhshmërie me çështjet e fesë dhe se të dobëtit e të varfrit që e ndjekin të vërtetën demonstrojnë aftësinë e lartë të të kuptuarit.

2. Allahu i Lartësuar, kur flet për popullin Themud dhe atë se çfarë ata i kanë dhënë të Dërguarit të Tij, Salihut a.s., ka thënë: ***“Krerët kryelartë nga populli i tij u thanë atyre që ishin më të dobët e që kishin besuar: A e dini se, me të vërtetë, Salihu është i dërguar nga Zoti i tij? Ata thanë: Vërtet, ne jemi besimtarë të asaj me çka është dërguar. Ata kryelartët thanë: Ne jemi mohues (jobesimtarë) të asaj që ju i besuat”***. Paria e popullit Themud ishin këmbëngulës në injorancën dhe mohimin e tyre ndaj peygamberisë të Salihut a.s. dhe se këta u parashtronin pyetje besimtarëve aso pyetje të arrogantëve dhe mendjemëdhenjve e nuk parashtronin pyetje të atij që është i interesuar për të pyetur dhe të atij që është modest.

3. Allahu i Lartësuar ka thënë: ***“Ja pra, Ne nuk kemi dërguar para teje peygamber në ndonjë vendbanim, që të mos i ketë thënë paria e begatshme e tij: Ne i gjetëm të parët tanë në këtë fe dhe ne jemi të orientuar gjurmëve të tyre”*** Pra, përgjigjja e parisë ndaj thirrjes së të dërguarve të Allahut ishte se ata i kanë gjetur baballarët e tyre në atë fe, se ata janë të orientuar gjurmëve të tyre dhe se nuk largohen nga feja e baballarëve për shkak të injorancës së tyre. Vërtet e kota nuk ndiqet dhe se e vërteta është më meritore që të ndiqet. Andaj, imitimi i kotë dhe i përbuzur ndaj fesë së baballarëve është njëri prej shkaqeve të kundërshtimit të së vërtetës. Allahu i Lartësuar për këtë imitim të përbuzur ka thënë: ***“E kur u thuhet atyre (idhujtarëve): Pranojeni atë që Allahu e shpalli! Ata thonë: Jo, ne ndjekim atë rrugë në të cilën i gjetëm prindërit tanë! Edhe sikur prindërit e tyre të mos kenë kuptuar dhe të mos jenë udhëzuar në rrugën e drejtë (ata do t’i pasonin)?”***

4. Allahu i Lartësuar ka thënë: ***“Të parët nga populli i faraonit thanë: A do ta lejosh Musain dhe popullin e tij të bëjë përçarje në tokë dhe të braktisin ty dhe zotat e tu? Ai (faraoni) tha: Do t’ua mbysim djemtë e do t’i lëmë të gjallë gratë e tyre për shërbim, ne jemi dominues mbi ta”***. Paria e popullit të faraonit e konsideronin Musain të Dërguarin e Allahut dhe ata besimtarë që e ndiqnin atë si çoroditës në tokë dhe po ashtu e nxitnin faraonin që t’iu bëjë rezistencë atyre dhe që t’i eliminojë ata krejtësisht nga jeta e kësaj bote. Vërtet injoranca e tyre, mendjemadhësia dhe dashuria për famë-prestigj ka bërë që ata ta konsiderojnë Musain a.s. si çoroditës në tokë.

Paria janë pari në çdo vend dhe në çdo kohë

Paria me cilësitë dhe moralin-etikën të cilën e ka shpjeguar Kurani Fisnik gjenden në çdo shoqëri, në çdo kohë dhe në çdo vend, andaj për këtë, në të shumtën e rasteve, ata janë pengues çdo thirrjes për në fenë e Allahut, e luftojnë atë për shkak të mendjemadhësisë së tyre që i ka mbuluar shpirtat e tyre, për shkak të dashurisë së pushtetit ndaj njerëzve dhe për shkak të frikës se mos kjo thirrje reformuese po ua merr me forcë pushtetin dhe pozitën e tyre që e kanë në shoqëri. Ajo që argumentohet është se paria, në çdo kohë dhe çdo vend, është kundërshtarë e çdo thirrjeje të dobishme, e cila do reforma dhe ofrim të njerëzve të Krijuesi i tyre. Pa dyshim se monvet të cilat e nxisin parinë për të luftuar të Dërguarit e Allahut dhe thirrjen e tyre janë të njëjta me ato të parive të popujve të mëhershëm. Këto motive të njëjta gjenden në shpirtin e mendjemëdhënjeve prej parisë dhe se mendjemadhësia varet në shpirtin e sëmurë. Po ashtu lakmia për pushtet dhe presrigj është e rrënjësuar në shpirtin, por këto shuhet me ndihmën e imanin besimit. E edhe injoranca i përfshin këta shpirtin të cilët me askë e duan lartësimin në tokë dhe jetën e shfrenuar. Kur ndodh që në shpirtin e këtyre prijëseve, arrogantëve dhe njerëzve që kanë famë të futet baza e imanit-besimit, nuk do t'i pengojë nga kundërshtimi i rrugës së Allahut dhe luftimi i thirrëseve për në rrugën e Allahut për shkak se imani i tyre është aq i dobët sa që nuk mund të ndikojë fare tek ata. Komentuesit e Kuranit kanë tërhequr vërejtjen për atë se paria gjithmonë janë në kundërshtim me thirrjen për në fenë e Allahut. Në tefsirin e Ibn Kethirit për ajetin *kuranor* “***Paria nga populli i tij tha; Ne po të shohim (në këtë që na thërret) plotësisht të humbur***“, kjo pra është gjendja e gjynahqarëve të cilët i shohin njerëzit e mirë si të devijuar“. Po ashtu, në një vend tjetër po në këtë tefsir, gjejmë këtë koment: Në shumicën e rasteve ndodh që të vërtetën e ndjekin njerëzit e dobët, ndërsa në të shumtën e rasteve prijësit dhe udhëheqësit e kundërshtojnë të vërtetën”. Një koment të ngjashëm me këtë e hasim edhe në tefsirin e Kurtubiut.

Masa e gjerë e popullit

Përkufizimi se kush është masa e gjerë e popullit

Me masën e gjerë të popullit nënkuptohen shumica dërrmuese e njerëzve përveç parisë liderëve të njerëzve, për të cilët kemi folur pak më herët dhe kemi thënë sa ata janë të paktë. Ndërkaq, masa e gjerë e popullit janë në përgjithësi pj« esa e dërrmuese e shoqërisë dhe se zakonisht këta janë të sunduar apo të udhëhequr nga paria e tyre. Pastaj, masa dërrmuese e popullit, në shumicën e rasteve, është e përbërë prej të dobëtëve, të varfërve dhe e njerëzve me zanate të ndryshme.

Masa e gjërë e popullit e pranon thirrjen për në fenë e Allahut më shpejtë se të tjerët

Masa e gjërë e popullit e pranon thirrjen për në fenë e Allahut më shpejt se sa të tjerët dhe se këta janë ithtarët e të dërguarve të Allahut ,iu besojnë atyre para të gjith të tjetëve . Sikurse i kathë Herakli Ebu Sufjanit , kur ishin takuar në Sham, pasi që Herakli kishte dëgjuar për paraqitjen të Dërguarit në Mekë,ndërsa në këtë rast Herakli e pyeti duke i thënë:Atë (Muhamedin) po e ndjekin paria e Mekës apo njerëzit e dobët? Ebu Sufjani iu përgjigj duke i thënë: të dobëtit. Herakli tha: ata janë që i ndjekin të dërguarit e Allahut.⁸¹⁵ Në realitet ithtarët e të dërguarve të Allahut janë masa e rëndomtë e popullsisë dhe se ne kemi përmendur gjatë shpjegimit për parinë e popullit, se si ata ia janë drejtuar Nuhut a.s.: ***“Paria që nuk besoi nga populli i tij tha: Ne nuk të shohim ndryshe vetëm si njeri, sikurse edhe ne, ne nuk po shohim se të pasoi kush, përveç atyre që janë më të poshtrit e më mendjehletit nga mesi ynë dhe ne nuk shohim se ju keni ndonjë vlerë mbi ne, përkundrazi, ne ju konsiderojmë gënjeshtar.”*** Po ashtu kemi përmendur atë se si i është drejtuar paria popullit Themud të Dërguarit të Allahut Salihut a.s.: ***“Krerët kryelartë nga populli i tij u thanë atyre që ishin më të dobët e që kishin besuar: “A e dini se, me të vërtetë,Salihu është i dërguar nga Zoti i tij?. Ata thanë: Vërtet, ne jemi besimtarë të asaj me çka është dërguar.”*** Po ashtu ndjekësit e të Dërguarit tonë Muhamedit s.a.v.s, që të gjithë, ishin prej të dobëtëve të Mekës dhe se për këtë ata ishin torturuar shumë prej politeistëve⁸¹⁸.Masa e rëndomtë e popullit në çdo kohë e pranojnë më së shpejti të vërtetën. Ibn Kethirin, në Tefsirin e tij, ka thënë: ***“Realisht në shumicën e rasteve e vërteta ndiqet prej të dobëtëve.”***

Arsyeja e pranimit të së vërtetës në mënyrë të shpejtë nga masa e rëndomtë e popullit

Arsyja përse masa e rëndomtë e popullit e pranojnë më shpejtë të vërtetën është se ata nuk kanë pengesa në pranimin e të vërtetës, sikurse kanë paria e popullit, siç janë: etja për pushtet dhe sundim dhe mendjemadhësia duke mos pranuar ndjekjen e tjetrit. Këtë lloj të arsyesimit e përmend edhe Kurtubiu në tefsirin e tij. Në realitet dashuria ndaj pushtetit dhe thellimi në luks e gjëra të ngjashme me to, në të shumtën e rasteve i kanë paritë e popullit, e që të gjitha këto janë pengesë e pranimit të së vërtetës dhe se tjetra është se në zemrat e tyre ka pengesë që nuk mund ta pranojnë të vërtetën, se në sytë e tyre ka perde që nuk mund ta shohin të vërtetën. Andaj, të gjitha këto nxisin në kundërshtimin e të vërtetës, ngase janë injorantë ndaj saj dhe se kanë lakmi që t'i ruajn pozitativat e tyre, sikundër kemi përmendur më herët.

Mundësia që masa e rëndomtë të ndikohen nga paria

Megjithëse masa e rëndomtë e popullit janë të gatshëm për të pranuar më shpejt thirrjen islame sesa të tjerët dhe se rastet e volitshme për arritjen e imanit para tyre janë shumta dhe se natyrshmëria e tyre është e pastër ekziston mundësia që kjo masë e rëndomtë të ndikohet prej parisë dhe mashtrimeve të tyre. Sikurse ka ndodhur me popullin e faraonit, të cilët kanë ecur pas mashtrimeve dhe devijimeve të parisë së tyre dhe njëkohësisht i kanë ndihmuar ata. Allahu i Lartësuar ka thënë për këta: ***“Dhe ashtu ai e frikësoi popullin e vet, e ata e respektuan, por ata ishin vërtet popull i shkatërruar.”*** Në tefsirin e Ibn Kethirit qëndron se faraoni ia ka pushtuar mendjen masës së rëndomtë dhe më pas i ka ftuar në humbje dhe se ata i janë përgjigjur? “ Është krejtësisht e qartë se sprovimi që ia ka bërë faraoni popullit të tij ka qenë shumë i madh, ngase ai ka pasur pushtet, sundim, përkrahës dhe pasuri dhe pos kësaj populli kanë qenë naivë, kështu ata kanë rënë në këtë sprovim dhe në këto gënjeshtër e të cilat i ka përdorur për t’iu kundërvënë thirrjes së Musait a.s.: ***“Te faraoni dhe rrethi i tij, e ata iu bindën urdhrat të faraonit, por urdhëri i faraonit nuk ishte mençuri ”.***

Allahu i Lartësuar, kur flet për devijimin që ua ka bërë paria të dobëtëve dhe masës së rëndomtë, thotë: ***“E sikur t’i shihje zullumqarët kur para Zotit të tyre të ndalen, kthejnë fjalën (fyese) njëri-tjetrit, atyre që ishin pari u thonë: Sikur të mos ishit ju, ne do të kishim qenë besimtarë! E ata që ishin pari, atyre që kishin qenë të dobët u thonë: A ne ju penguan prej udhëzimit të drejtë pasi që ju pati ardhur juve? jo, por ju vetë ishit kriminelë! E ata që kishin qenë të shtypër atyre që ishin krerë u thoshin; jo, por përdredhja juaj natë e ditë (na largoi prej besimit), kur ju na thërrisnit të mos e besojmë Allahun dhe t’i bëjmë Atij shokë. E kur e shohin dënimin, e fshehin dëshpërimin e vet dhe Ne u vëmë prangat në qafat e atyre që nuk besuan. Ata nuk dënohen për tjetër por për atë që punuan ”.***

Në këto ajete fisnike informon Allahu i Lartësuar për tiraninë e skajshme të jobesimtarëve, në kokëfortësinë e tyre dhe në vazhdimësinë e tyre në mosbesimin ndaj Kuranit dhe në atë çfarë lajmëron ai. E pastaj Allahu informon për gjendjen në ditën e kiametit të cilët do të qëndrojnë para Krijuesit të tyre, duke i folur njëri-tjetrit me sharje, qortim dhe armiqësi pasi që ata ishin ndihmës të njëri-tjetrit në jetën e kësaj bote. Nga këto polemika dhe kundërshtime në çështjen e qortimit të njëri-tjetrit, fjala e atyre që kanë qenë të dobët në këtë botë dhe që i kanë ndjekur mendjemëdhenjtë-arrogantët e të cilit ishin udhëheqësit dhe prijësit e tyre. ***“Sikur të mos ishit ju, ne do të kishim qenë besimtarë”.*** d.m.th. sikur të mos ishit ju që të na pengoni neve nga rruga e drejtë, ne do t’i ndiqnim të dërguarit dhe do t’i besonim asaj që kanë sjellë ata nga Allahu. Në këtë rast prijësit e këtyre u thonë atyre: ***“A ne ju penguan prej udhëzimit të drejtë pasi që ju pati ardhur juve?”***, d.m.th. ajo që ne kemi bërë ishte se vetëm ju kemi ftuar juve dhe ju na keni ndjekur pa kurrfarë argumenti dhe i keni kundërshtuar argumentet e qarta që i kanë sjellë të dërguarit, ndërsa këtë e keni bërë vetëm për shkak se keni ndjekur epshin tuaj dhe keni vepruar sipas lirisë që keni pasur; ne nuk ju kemi premtuar asgjë juve, eju keni bërë krim pse na keni ndjekur neve. Të dobët, në këtë rast është fjala për masën e rëndomtë prej jobesimtarëve, i thonë parisë së tyre që janë arrogantë jobesimtarë: ***“Jo, por dredhia juaj natë e ditë (na largoi prej besimit) ”*** d.m.th. ju ishit ata që na bënit dredhi neve natë e ditë, na keni mashtruar me gjëra të kota dhe se ju na keni informuar se ajo është e vërtetë, ndërsa sipas jush thirrjet e të dërguarve ishin të rrejshme dhe se ju na keni urdhëruar që ta mohojmë Allahun dhe që Atij t’ia përshkruajmë dikë si rival. Pos kësaj, ju me thirrjen tuaj në mohim neve na e keni zbukuruar të pavërtetën dhe kështu ne ju keni ndjekur dhe jemi bërë jobesimtarë. Më pastaj Allahu i Lartësuar na tregon se si ata e fshehin pendimin derisa ata të shohin dënimin, e pasi e shohin dënimin, atëherë e shfaqin pendimin si prijësit ashtu edhe ithtarët e tyre. Mirëpo, pendimi për të kaluarën

atyre nuk u bën kurrfarë vlere dhe kështu mbi qafat e tyre vendosen prangat e dënimit për shkak të veprave dhe mohimit të tyre. Pra, ka dënim si për prijësit, ashtu edhe për ithtarët e tyre.

Përse masa e rëndomtë ndikohen prej parisë

Ne themi se masa e rëndomtë më së shumti i përgjigjet ftesë: për në fenë e Allahut, por ka mundësi që këta të ndikohen nga paria. Atëherë, pse është ky ndikim për në mosbesim kur e vërteta është e qartë dhe nuk ka kurrfarë pengesash për t'iu përgjigjur thirrjes së vërtetë? Përgjigjja për këtë është për disa shkaqe:

E para, frika. Pa dyshim se paria jobesimtare, kur i ka në duar pushtetin, forcën dhe pasurinë ka mundësi që ta frikësojë masën e rëndomtë, duke e kërcënuar se nëse dalin prej mosbesimit do të dënohen. Kjo frikë shkakton hutim në vendimet dhe preokupimet e shumicës së masës së rëndomtë duke kërkuar shpëtim nga torturat. Allahu i Lartësuar ka thënë: ***“Duke pasur fikë nga faraoni dhe nga rrethi i tij se do t’i torturojnë; Musait nuk i besoi kush pos një pjese e pasardhësve të popullit të tij. Vërtet, faraoni ishte mbizotërues në tokë dhe ai ishte prej shkatërimtarëve.”*** Frika ishte prej dhunës që ushtronin faraoni dhe paria e tij për ta penguar shumicën e masës së rëndomtë që të besojnë në Allahun, përveç një pakice që kishin besuar. Kjo kishte ndodhur sepse shumica e masës frikësoheshin prej torturave të faraonit, ndërsa pakica nuk u janë frikësuar kërcënimeve të faraonit dhe, pos kësaj, këta e kanë shprehur haptas besimin e tyre e pa kurrfarë frike, sikurse ka ndodhur me magjistarët e kohës së Musait a.s., të cilët e kanë shprehur haptas besimin në thirrjen e Musait a.s. dhe kurrsesi nuk janë trembur nga kërcënimet e faraonit se do t’i gozhdojë dhe t’i mbysë duke i thënë atij: ***“Ata (magjistarët) thanë: S’ka rëndësi, ne i kthehemi Zotit tonë. Meqë ne jemi besimtarët e parë, shpresojmë se Zoti ynë do të na i falë gjynahet tona!”*** Sikurse ndodhi me banorët e Uhdudit, të cilët kanë besuar, edhe përkundër asaj që ishin të kërcënuar me dënim të ashpër, por ata që kanë besuar kanë qenë pakicë, ndërsa shumica janë ndikuar prej parisë për shkak të frikës që kanë që mos besojnë dhe kështu kjo frikë ka zgjatur një kohë derisa ata vetë janë adaptuar në mosbesim. Gjithashtu faktin se shumica e masës së rëndomtë pengohen që ta ndjekin rrugën e vërtetë e shohim edhe tek ajeti kuranor: ***“E ato ishin (gjurmë të gënjeshtarëve të***

fisit) Adët që mohuan argumentet e Zotit të tyre, kundërshtuan të dërguarin e Tij, shkuan pas urdhrit të çdo kryelarti kundërshtar ”.

E dyta, lakmia ndaj pasurisë dhe gjërave të përkohshme të kësaj bote, ngase paria i posedonin të gjitha këto dhe u ofronin masës së rëndomtë me qëllim që më pastaj ata t'i ndjekin edhe në gjëra të pavërteta dhe në të njëjtën kohë të jenë të kënaqur me udhëheqjen e tyre. Për këtë jep sinjale të qarta fjala e Allahut të Lartësuar, që shpjegon çështjen e popullit të Nuhut a.s. Krijuesi ynë i Madhërisëm ka thënë: ***“Nuhu tha: “Zoti im, ata më kundërshtuan, ata shkuan pas atyre (pasanikëve), të cilëve pasuria dhe fëmijët e tyre vetëm sa ua shtuan dëshpërimin “*** Ata janë që i ndoqën prijësit e tyre dhe parinë e tyre ngase ata kishin pushtet dhe pasuri, e që ndjekësit e tyre shpresonin se do të marrin diçka nga pasuria e tyre. Allahu i Lartësuar, kur e tregon ndodhinë e faraonit, thotë: ***“Ndërsa, faraoni thirri popullin e vet e tha: O popull imi, a nuk është i imi pushteti i Egjiptit (i Misirit) dhe i këtyre lumenjve që rrjedhin nën pallatin tim, a nuk po shihni?”***, pra nga ky ajet po kuptohet se faraoni po u ofron masës së rëndomtë të njerëzve pasuri dhe gjëra tjera vetëm e vetëm që ata ta ndjekin të pavërtetën. Në hisrorinë e të Dërguarit salAllahu alejhi ue sel-lem përmendet se si paria e kurejshëve i ka ofruar të Dërguarit të Allahut a.s. pasuri të shumtë, vetëm që të braktisë thirrjen e tij. Kjo argumenton se paria iu ofrojnë njerëzve pasuri ose ua marrin atë vetëm e vetëm që t'i pengojnë ata nga thirrja e fesë së Allahut të Lartësuar dhe të Madhëruar.

E treta, dyshimet. Paria nuk mjaftohet vetëm përdorimin e forcës, dhunës dhe futjes së frikës vetëm e vetëm që të pengojnë vazhdimësinë e thirrjes islame, por ata sjellin edhe dyshime të shumta ndaj thirrjes islame, si e akuzojnë thirrësin tek Allahu si person i çmendur, i devijuar dhe mendjelehtë. Ne i kemi përmendur më herët disa ajete kuranore që flasin për këtë veprim të parisë, si ajetet që flasin për parinë e popullit të Nuhut a.s., Hudit a.s. etj. Allahu i Lartësuar për atë qëi thotë paria e popullit Nuhut a.s. thotë: ***“Paria nga populli i tij tha: Ne po të shohim (në këtë që na thërret) plotësisht të humbur!”*** Atë se çfarë i thotë paria e popullit Hudit a.s. Allahu i Lartësuar përmend kështu: ***“Paria që nuk besoi nga populli i tij tha: Ne po të shohim mendjelehtë dhe të konsiderojmë vërtet rrenacak!”*** Prej dyshimesh që sjellin të tillët është edhe fjala e tyre që thoshin se i Dërguari është njeri sikurse edhe ne dhe se, sipas pretendimit të tyre, i Dërguari i Allahut nuk duhet të jetë prej njerëzve: ***“Paria që nuk besoi nga populli i tij tha: Ne nuk të shohim ndryshe vetëm si njeri ”.*** Prej dyshimeve është edhe ajo se paria i kundërvihet thirrjes islame se kinse ata duan ta ruajnë besimin njerëzve, interesat e tyre dhe që të largojnë të këqijat prej tyre. Allahu i Lartësuar, për këtë lloj dyshimi

të hershëm, përmend se është te paria e çdo kohe. Allahu i Lartësuar ka thënë: ***“Faraoni tha: Më lini mua ta mbys Musain, e ai le ta thërrasë Zotin e vet, pse unë kam frikë se po ua ndryshon fenë tuaj, ose po nxit trazira në tokë!”*** Ashtu si ka thënë faraoni janë shprehur edhe paria e kurejshëve duke thënë se i Dërguari (s.a.v.s) me thirrjen e tij synon që të shkatërrojë besimin e njerëzve, t’i injorojë zotët e tyre, andaj për këta arsye ato po i rezistojnë atij. Po ashtu prej dyshimeve të tyre që i kanë sjellë është se ata janë më meritore dhe më të mirë se thirrësi, edhe po qe se ai është i Dërguar, ngase ata kanë pasuri të shumta, prestigj dhe pushtet. Allahu i Lartësuar ka thënë: ***“Ndërsa, faraoni thirri popullin e vet e tha: O popull imi, a nuk është imi pushteti i Egjiptit (i Misirit) dhe i këtyre lumenjve që rrjedhin nën pallatin tim, a nuk po shihni? Pra, unë jam më i mirë se ky quar që mezi flet!”*** Faraoni mburret me sundimin, pushtetin, forcën dhe pasurinë e tij, andaj me këto u krijon hamendje njerëzve të rëndomtë se ai është më meritore për të thirrur në të vërtetën sesa Musai a.s, i cili nuk posedon asgjë dhe se ai nuk është i aftë që të flasë si duhet dhe thuajse mezi flet. Allahu i Lartësuar ka thënë: ***“Ne nuk dërguam në asnjë vendbanim ndonjërin nga peygamberët e që pasanikët e tij të mos i thoshin: Ne nuk besojmë asaj me çka jeni dërguar. Ata thoshin: Ne kemi më shumë pasuri e fëmijë; e ne nuk do të jemi të ndëshkuar”***. Këta argumentojnë veprimin e tyre me atë se Allahu u ka dhënë atyre pasuri dhe fëmijë dhe se të tillët janë të shpëtuar prej dënimit të xhehenemit. Mirëpo, këta janë injorantë ndaj ligjit të Allahut i Cili ijep pasuri dhe të mira të kësaj jete atij që e do Ai dhe atij që nuk e do. Andaj, pasuria nuk është argument se personi është i mirë dhe se Allahu është i kënaqur me të. Pra, këto dyshime të rrejshme ndikojnë në masën e rëndomtë, ngase kush i dëgjon dhe u bindet atyre ai devijon dhe se paria këto dyshime u ofrojnë njerëzve në metodë të butë, duke ua zbukuruar atyre të pavërtetën. Pos kësaj, paria e nxisin masën e rëndomtë në atë që ata të lakmojmë apo të shpresojnë në pasurinë e tyre dhe, në të njëjtën kohë, ata të kenë frikë prej forcës së tyre. Njeriu e do këtë jetë dhe kënaqësitë e saj dhe i frikësohet torturave e privimeve. Andaj, të gjitha këto dyshime do të bashkohen në ndjenjat e njeriut dhe kështu këto të kenë ndikim të shumica e njerëzve dhe se nga këto dyshime shpëtojnë shumë pak. Me të gjitha këto mbetet që shumica e ithtarëve të të dërguarve të Allahut janë prej masës së gjerë të popullit e jo prej parisë së tyre.

Mynafikët (hipokritët)

Përkufizimi i mynafikut-hipokritit

Mynafik-hipokrit në terminologjinë e sheriatit islam është ai person që në anën e jashtme shpreh diçka tjetër nga ajo që fsheh në zemrën e tij. Andaj, ai që e fsheh mosbesimin në zemrën e tij konsiderohet mynafik i kulluar dhe se dispozita e sheriatit ndaj tij në botën tjetër është ajo se ai konsiderohet jobesimtar dhe këtij i shtohet edhe më tepër dënimi për shkak se i ka mashtruar besimtarët me manifestimin e islamit në mënyrë të rrejshme. Allahu i Lartësuar ka thënë: **“S’ka dyshim, mynafikët do të jene në shtresën më të ulët (në fund) të zjarrit”**. E kur ndodh që personi fsheh në vete ndonjë veprim që është gjynah ndaj Allahut por që nuk ka të bëjë me mosbesimin, atëherë ky person ka një degë-cilësi të hipokrizisë apo më shumë se një degë. Ndërsa ajo që duam ne të flasim në këtë studim është mynafiku i kulluar, i cili në vete e fsheh mosbesimin e tij duke mohuar Allahun dhe përgënjeshtuar Librin e Tij dhe të Dërguarin e Tij. Me të gjitha këto, ne do t’i përmendim disa nga cilësitë e këtyre mynafikëve me të vetmin qëllim që myslimani të marrë mësim, ngase ai mund të ketë ndonjë cilësi të mynafikëve e se nuk e vëren dhe se mund të jetë e mundur që myslimani të jetë mysliman duke pasur ndonjë degë-cilësi të hipokrizisë.

Ku gjendet mynafiku?

Sa herë që ngadhënjën thirrja tek Allahu në shoqërinë jobesimtarë, që fjala e Allahut të ngrihet lart, që njerëzit të hyjnë grupe-grupe në fenë e Allahut, të çrrënjoset forca e mosbesimit, të shkatërrohet pushteti i jobesimtarëve dhe që forca të jetë në duart e myslimanëve, atëherë në këtë mes të shoqërisë mund të gjenden mynafikët, të cilët nuk besojnë bashkë me besimtarët dhe se nuk e shprehin mosbesimin e tyre haptas nga frika e fuqisë që kanë myslimanët, andaj e fshehin mosbesimin dhe e shpallin haptas islamin e tyre. Bazuar mbi këtë, na del se hipokrazia nuk gjendet aty ku sundon dhe ka pushtet mosbesimi, ngase aty nuk ka frikë për ta shprehur mosbesimin dhe kundërshtimin ndaj fesë islame. Andaj, mu

për këtë në mesin e myslimanëve sa ishin në Mekë ende pa u shpërngulur në Medinë nuk kishte mynafikë, ngase myslimanët ishin me numër të paktë dhe të pafuqishëm dhe se pushtetin-sundimin e kishin jobesimtarët kurejshitë. Mirëpo, pas shpërnguljes së të Dërguarit salAllahu alejhi ue sel-lem dhe myslimanëve në Medinë dhe pasi myslimanët u bënë të fuqishëm e pasi kishin pushtet, feja islame u përhap në Medinë, atëherë u manifestua fenomeni i hipokrizisë dhe paraqitja e mynafikëve.

Themelet e hipokrizisë

Themelet e hipokrizisë janë: mosbesimi dhe frika. Sa i përket mosbesimit është ajo që e fsheh në vete mynafiku, ndërsa sa i përket frikës këtë mynafiku e shpreh haptas. Andaj, mu për këtë, mynafiku është frikacak, ka shpirt të dobët, di mirë të bëjë kurthe e mashtrime, vepron gjithmonë në fshehtësi dhe kur takohet me besimtarët paraqitet kinse është besimtar: ***“E kur i takojnë ata që besuan thonë: Ne kemi besuar!” Por kur veçohen me djajtë (parinë) e vet u thonë: ‘ Ne jemi me ju, ne vetëm jemi tallur (me besimtarët)’***. Këta për shkak të frikës së tyre thonë: Ne vërtet jemi besimtarë ndërsa kur mbesin vetëm me shokët e tyre mynafikë e gënjeshtarë thonë ne po tallemi me besimtarët kur ne po u themi atyre se edhe ne jemi besimtarë.

Mynafiku është më i keq se jobesimtari

Mynafiku është më i dëmshëm dhe më i keq se jobesimtari, ngase është i barabartë me jobesimtarin në mosbesim, kurse dallohet prej tij duke bërë mashtrime (shprehur formalisht besimin) dhe se ky ka mundësi të futet në radhët e myslimaneve, duke qenë shumë i dëmshëm dhe duke mos u ruajtur prej tij vetëm se pak. Ndërsa me jobesimtarin është e kundërta, ngase jobesimtari është i haptë në mosbesimin e tij dhe nuk mund ti mashtroje muslimanët për shkak se ai dihet haptas që është jobesimtar.

Shenjat e hipokrizisë

Pasi që hipokrizia konsolidohet mbi bazën e mosbesimit të fshehur, atëherë baza e kësaj është fshehja e asaj çfarë ka në zemër (mosbesimin) dhe se mënyra e njohjes së mynafikut është manifestimi i shenjave të hipokrizisë. Andaj, këto manifestohen këto shenja, atëherë myslimanët ruhen prej tij dhe të këqijave të tij, pavarësisht se ai a është prej mynafikëve që e fsheh mosbesimin apo është prej atyre mynafikëve që i ka disa nga cilësitë e hipokrizisë, por nuk e mohon Allahun dhe të Dërguarin e Tij. Mirëpo, paraqitja e disa cilësive të hipokrizisë të personit shkakton atë që ndaj tij sikur që vepohet ndaj mynafikut me aq sa manifeston a në vete cilësitë e hipokrizisë, pavarësisht se kjo hipokrizi është ndaj besimit në Allahun dhe të Dërguarin e Tij apo hipokrizia është në çështje të tjera e jo në aspektin e besimit.

Shenjat e mynafikut shpjegohen në Librin e Allahut dhe në sunetin e të Dërguarit të Tij, e nuk mund të njihen ato ashtu si i shpjegojnë njerëzit, ngase njerëzit disa nga këto cilësi i konsiderojnë si çështje të domosdoshme në mirësjellje dhe gjëra të etikës së mirë. Andaj, të gjitha këto arsytetime ndaj cilësive të hipokrizisë nuk ndryshojnë asgjë në realitet, ngase çështja gjykohet sipas veprimeve e jo sipas emërimit dhe se e vërteta e ndonjë gjëje mbetet ajo që është, pavarësisht se si njerëzit e emërtojnë. Atëherë cilat janë cilësitë dhe shenjat e mynafikut?

Shenjat dhe cilësitë e mynafikut

1. Zemra e sëmurë. Allahu i Lartësuar ka thënë: ***“Në zemrat e tyre kanë sëmurje, e Allahu u shton sëmundje edhe më shumë; e për shkak se ata përgënjeshtrojnë, pësojnë dënim të dhembshëm”***. Sëmurja e zemrës është ajo që e bën mynafikun të mos e shikojë të vërtetën ashtu siç është, apo e shikon ndryshe dhe se kjo e bën atë që ta urrejë të vërtetën e dobishme dhe ta dojë të pavërtetën e dëmshme. Ai, i cili ka zemër të sëmurë, bën më shumë dëm se ia që e ka zemrën të shëndoshë, ajo më e pakta është se tek ai ka ndikim epshi-pasioni i tij. Allahu i Lartësuar ka thënë: ***“Andaj mos u llastoni në të folur e të lakmojë ai që ka sëmundje në zemrën e tij, po folni fjalë të matura.”*** Llastimi në të folur ndikon menjëherë tek ai që ka zemër të prishur të sëmurë, ndërsa ai që ka zemër të shëndoshë, edhe po që se ndonjë femër 1 ekspozohet ai nuk e kthen shikimin kah ajo. Ndodhia e Jusufit a.s.

për këtë çështje është e njohur. Po ashtu është çështja me përballjen me dyshimet që shfaqen para atij që ka zemër të sëmurë, ku dyshimi më i vogël ndikon tek ai që të ankohet dhe sprovimi më i vogël bën që ai të rrëshqasë nga e vërteta. Allahu i Lartësuar ka thënë: **“E për ta bërë atë (dyshim) që shejtani e hedh si provë për ata që në zemrat e tyre që kanë dyshim (mynafikët) dhe për ata që i kanë zemrat e shtangëta”**. Mynafiku e ka hisen më të madhe në Sëmurjen e zemrës nëse është ai mynafik i kulluar, ndërsa nëse është person që i ka disa cilësi të mynafikut por që beson Allahun, ky ka më pak hise në Sëmurjen e zemrës.

2. Shkaktimi i trazirave në tokë. Allahu i Lartësuar ka thënë: **“E kur atyre u thuhet: Mos e prishni rendin në tokë! Ata thonë: Ne jemi vetëm përmirësues (paqësues)! Vini re, ata në të vërtetë janë shkatërruesit, por nuk e kuptojnë”**. Ata janë që e prishin rendin, por nuk e kuptojnë, ata janë shkaktues të trazirave, por e llogarisin veten e tyre si përmirësues. Si shkaktim i trazirave është vetë mosbesimi, si me fjalë dhe me vepër e bërja e gjynaheve dhe urdhërimi për zbatimin e tyre. Vërtet ai që kundërshton Allahun në tokë apo urdhëron që të kundërshtohet Ai, atëherë ai është që shkakton trazira në tokë, ngase përmirësimi në tokë bëhet duke iu nënshtruar Allahut, ndërsa shkaktimi i trazirave bëhet duke e kundërshtuar Allahun. Shkatërrimi që bëjnë mynafikët është mosbesimi, dyshimi, përgënjeshtrimi, angazhimi për të mashtruar Allahun dhe të Dërguarin e Tij e bcsimrarët, lidhja miqësore e tyre me armiqtë e fesë dhe lufta e tyre që bëjnë ndaj të dashurve të Allahut dhe thirtëseve në fenë e Allahut, e shumë veprime të tjera të cilat kuptohen nga cilësitë e tyre.

3. Akuzimi i besimtareve me naivitet-mendjelehtësi. Allahu i lartësuar ka thënë: **“Dhe kur atyre u thuhet: besoni, sikurse besuan njerëzit, ata thonë: A të besojmë ashtu sikurse besuan mendjelehtit? Në të vërtetë, ata, dhe mu ata janë mendjelehtit, por nuk e dinë”**. Mendjelehtë konsiderohet injoranti, icili ka mendim të dobët dhe aftësi të pakta ndaj asaj që është e dobishme dhe asaj se çfarë është : dëmshme. Mirëpo, realiteti është ashtu si na ka informuar Allahu i Lartësuar se mendjelehtë janë vetë mynafikët dhe naiviteti është i përilmfizuar në vetë ata dhe ata që u ngjajnë atyre nga jobesimtarët. E si injorancë e plorë e tyre është ajo se nuk e kuptojnë se tek ata ekziston devijimi dhe injoranca.

4. Armiqësia e tepruar dhe krenaria me bërjen e gjynahut. Allahu i Lartësuar ka thënë: **“Ka ndonjë nga njerëzit që fjala e tij të mahnit, por vetëm në këtë botë (meqë në botën tjetër gjykon Ai që i di të fshehtat) dhe për atë që ka në zemrën e tij, e paraqet Allahun dëshmues, e në realitet ai është kundërshtari më i rreptë .**

E posa te kthehet ai në tokë, vepron të bëjë shkatërrim në të, të asgjësojë të korrat (mbjelljet) dhe gjallesat. E Allahu nuk e do çrregullimin (fesadin). Dhe kur i thuhet atij: kije frikë Allahun! atë e kap eufori per punë gjynahu. Shtrat i shëmtuar është ai që i takon atij (xhehenemi) ”.Mynafiku Het fjalë të bukura, e shpreh atë se është në fenë islame dhe e paraqet Allahun si dëshmitar ndaj besimtarëve se atë që e ka në zemër e shpreh edhe me gjuhë. Pra, ky është kundërshtari më i rreptë ngase ai rren, falsifikon të vërtetën, bën trillime dhe gjynahe të mëdha. Transmetohet në hadith të saktë se si i Dërguari i Allahut s.a.v.s, ka thënë: *“Shenjat e mynafikut janë tri: kur flet gënjen, kur premtion tradhton dhe kur përleshet i kalon kufijtë”*. Mynafiku si qëllim parësor e ka shkatërrimin e trazirave në tokë dhe shkatërrimin e gjithë asaj që është e dobishme për njerëzit, si p.sh. të asgjësojë të mbjellat dhe gjallesat. Ndërkaq kur i thuhet atij: *Kijë frikë Allahun dhe braktise atë të keqe që je duke e bërë dhe kthehu në atë që është e vërtetë, ky në këtë rast e refuzon dhe e kaplon hidhërimi për shkak të gjynaheve që i ka bërë.*

5. Lojaliteti ndaj jobesimtarëve dhe pusia ndaj besimtarëve. Allahu i Lartësuar ka thënë: ***“Ti(Muhamed) lajmëroji mynafikët se, me të vërtetë, ata kanë një dënim të dhembshëm. Janë ata që, edhe përkundër besimtarëve, i miqësojnë jobesimtarët. Vallë, a mos kërkojnë fuqi te ta ?S'ka Dyshim ,e tërë fuqia i takon Allahut .Ata janë që presin se ç'po ju ngjet juve. Nëse me ndihmën e Allahut ngadhënjoni ata thonë: A nuk ishim me ju ?E nëse jobesimtarëve u takon ndonjë fitim ,ata thonë: A nuk mbizotëruam ne mbi ju (por nuk deshtëm të mposhtim)dhe penguan prej jush besimtarët !Allahu do të gjykojë mes jush ditën e gjykimit. Allahu kurrsesi nuk ua mundëson jobesimtarëve mbizotërimin të plotë mbi besimtarët?”*** Mynafiku është ai që miqësohet me jobesimtarët, i ndihmon ata dhe i do ata dhe kur rri vetëm me ta u thotë atyre: Unë jam me ju, e që në fakt ai është prej radhëve të tyre. Prej cilësive të mynafikëve është se ata presin shkatërrimin e shtetit të myslimanëve dhe ngadhënjimin e shtetit në jobesimtarëve, e po qe se ndodh që myslimanët të ngadhënjëjnë, atëherë mynafikët u thonë atyre (myslimanëve) a nuk ishim edhe neve me ju. E nëse ndodh që jobesimtarët ngadhënjën ndaj myslimanëve, atëherë u thonë atyre (jobesimtarëve) a nuk u kemi ndihmuar juve fshehtas. Mynafikët u bëjnë lajka jobesimtarëve dhe myslimanëve edhe pse ata realisht i duan dhe anojnë kah jobesimtarët, por nuk duan ta shprehin haptas mosbesimin dhe angazhimin e tyre për t'i luftuar myslimanët.

6. Mashtrimi, veprimi sa për sy e faqe dhe përtacia në kryerjen e adhurimeve. Allahu i Lartësuar ka thënë: ***“Mynafikët përpigën të mashtrojnë Allahun (duke u paraqitur rrejshëm si besimtarë), por Allau mbizotëron dinakëritë e tyre. Ata edhe ku falen , me përtaci dhe vetëm sa për tu dukur te njerëzit dhe fare pak e përmendin Allahun.”*** Pra, njëra prej cilësive të mynafikëve është edhe ajo se ata mundohen ta mashtrojnë Allahun dhe njerëzit. Sa i përket angazhimit për ta mashtruar Allahun e Lartësuar bëhet nga bindja e tyre se ata po konsiderohen të njëjtë me njerëzit sipas dispozitave të shariatit islam. Ata mendojnë se i njëjti vendim për ta tek Allahu në ditën e kiametit dhe se ata mundohen që çështjen e tyre ta mbajnë fshehtë ndaj Allahut sikur që e mbajnë të fshehtë prej njerëzve. Kjo është një injorancë e madhe, ngase Allahut të Lartësuar nuk mund t'i fshihet asgjë në tokë e as në qiej. Po ashtu si cilësi e mynafikëve është edhe ajo se atyre u vjen shumë rëndë kur duhet i kryejnë adhurimet, ata kur ngrihen për ta falur namazin ngrihen me përtaci, ata nuk e duan namazin dhe as që duan ta kryen atë, por ata e kryen sa për sy e faqe para njerëzve dhe mu për këtë këta shumë pak e përmendin Allahun. Në hadith theksohet se i Dërguari i Allahut a.s. ka thënë: ***“Ky është namazi i mynafikut. Ky është namazi i mynafikut. Ky është namazi i mynafikut. Ai ulet dhe e pret që dielli të jetë mes brinjëve të djallit (afër perëndimit) dhe falet shumë shpjet. Ky nuk e përmend Allahun veçse pak.”***

7. Mynafikët janë të hutuar, këta nuk janë as me besimtarët e as me jobesimtarët.

Këta dëshirojnë që të gjykohen nga djalli. Allahu i Lartësuar ka thënë: ***“Ai i vure re ata që mendojnë se besuan atë që të zbriti dhe atë që zbriti para teje ,se si dëshirojnë që mes tyre të gjykojë djalli ,e duke qenë se janë të urdhëruar që të mos e besojnë atë. E shejtani deshiron t'i humbë në pafundësi. Kur u thuhet atyre :Ejani (për të gjykuar) tek ajo që zbriti Allahu dhe tek i dërguari! i sheh se si dyfytirëshit ta kthejnë shpinën. E si do të jetë (gjendja e tyre) kur t'i godasë ndonjë e keqe, e shkaktuar nga vetë duart e tyre ,e pastaj vijnë te ti(për t'u arsyetuar) dhe betohen në Allahun: Ne nuk patëm tjetër qëllim, vetëm afrim e pajtim (e jo refuzimin e gjykimit Tënd). Ata janë për të cilët e di Allahu çka mbajnë në zemrat e tyre .Por, ti hiqur tyre, tërhiqur vërejtjen (për hipokrizi) dhe thuaju fjalë që lënë përshtypje në veten e tyre.”*** Prej cilësive të mynafikëve është që ata pretendojnë se besojnë në atë që është zbritur prej Allahut tek i Dërguari i Allahut Muhamedi salAllahu alejhi ue sel-lem dhe në që u është zbritur të dërguarve të Allahut para Muhamedit salAllahu alejhi ue sel-lem dhe se më këtë pretendim ata vetë me guhët e tyre shprehen se dëshirojnë që ata t'i gjykojë djalli, e i cili gjykim është i papranuahëm. Allahu i Lartësuar i ka urdhëruar ata që të

distancohen prej atij gjykimi, ndërsa shejtani dëshiron që t'i devijojë ata duke i motivuar ata që të marrin si gjykues dikë tjetër pos Librit të Allahut dhe Syneit të Dërguarit salAllahu alejhi ue sel-lem Atëherë si do të jetë gjendja e tyre kur ata t'i godasë ndonjë fatkeqësi për shkak të hipokrizisë së tyre dhe kundërshtimit të tyre ndaj urdhrave të Allahut. Më pastaj mynafikët kanë ardhur tek i Dërguari i Allahut dhe i janë betuar në Allahun se ata me kërkesën që të gjykohen nga shejtani kanë pasur për qëllim bamirësinë, mirësjelljen dhe lajkatimin ndaj jobesimtarëve. Vërtet, këta që mundohen ta devijojnë fenë e Allahut dhe shariatit e Tij, e Allahu e di se çfarë ka në zemrat e tyre prej hipokrizisë. Tërhiqur prej tyre, d.m.th. atyre nuk u bën dobi ajo çfarë ata kanë në zemrat e tyre dhe dije se ata në zemra kanë hipokrizi, andaj këshilloji ata në mënyrë shumë të qartë dhe të rrjedhshme.

8. Të shkaktuarit probleme ndërmjet besimtarëve. Allahu i Lartësuar ka thënë: ***“Edhe sikur të dilnin me ju, ata nuk do tju shtonin tjetër pos ngatërresës dhe shumë shpejt do ta përçanin mesin tuaj, duke kërkuar që tju turbullojnë. E ndër ju ka të tillë që i dëgjojnë ata. Allahu i di shumë mirë hipokritët”***. Mynafikët dëshirojnë që t'i dobësojnë myslimanët dhe t'i përçajnë ata mes vete. Ky ajet fisnik i ka shpjeguar qartë këto koncepte dhe tipare të tjera të mynafikëve. Myslmanët nganjëherë pikëllohen kur shohin se disa prej njerëzve nuki bashkëngjiten atyre dhe nuk punojnë me ta duke menduar se ata janë prej grupit të tyre dhe se ata do t'iu sjellin dobi atyre. Mirëpo, Allahu e di të kundërtën se nëse ata (mynafikët) dalin me myslimanët nuk u sjellin atyre tjetër pos telashe e shkatërrim, d.m.th. këta do t'iu shkaktojnë myslimanëve telashe duke bartur fjalë dhe nxitur mospajtime në mesin e myslimanëve. Ka në mesin e myslimanëve që i dëgjojnë fjalët e tyre (mynafikëve), kërkojnë këshilla prej tyre dhe në këtë mënyrë arrijnë të fusin të keqen në mesin e besimtarëve”

9. Rrena, frika dhe urrejtja e myslimanëve. Allahu i lartësuar ka thënë: ***“Ata betohen në Allahun se vërtet janë si ju, por ata nuk janë me ju, ata janë popull që frikohet. Sikur të gjenin ndonjë vendshtrehim, ndonjë shpellë a ndonjë vrimë, ata do të shkonin aty me vrapim.”*** Prej cilësive të mynafikut është rrena dhe betimi për të. Në hadithin e të Dërguarit salAllahu alejhi ue sel-lem qëndron kështu: ***“Shenjat e mynafikut janë tri: kur flet gënjen, kur premtion nuk e zbaton premtimin dhe kur i besohet diçka mashtron”***; ndërsa në një transmetim citohet: ***“kur përleshet i tejkalon kufijtë”***. Në ajetin fisnik tregohet se si mynafikët janë ata që betohen në Allahun se janë myslimanë, por realiteti është krejtësisht ndryshe, ngase ata janë njerëz që shkaktojnë përçarje dhe frika se mos po hetohen i motivon që të gënjejnë, andaj kanë frikë se mos po zbulohet mosbesimi i tyre e që më pastaj

ata të pësojnë dënimin prej muslimamëve. Ata janë që i urrejnë myslimanët, nuk duan që të shoqërohen me ta, nuk kanë dëshirë që t'i shohin ata, ata janë gjithmonë të pikëlluar e të brengosur sa herë që shohin se feja islame dhe myslimanët po ngadhënjëjnë dhe përparojnë. Andaj, mu për këtë ata kur shohin diç të mirë tek myslimanët pikëllohen sa që nëse e gjejnë ndonjë vendstrehim, apo ndonjë fortifikatë, apo ndonjë shpellë, apo ndonjë vrimë nxitojnë që aty të futen me të vetmin qëllim që të mos jenë në mesin e myslimanëve dhe mos të shohin përparimin e tyre.

10. U gjejnë të meta atyre që janë në rrugë të drejtë, nëse u jepet ndonjë dhuratë janë të kënaqur e nëse nuk u jepet hidhërohen shumë. Allahu i lartësuar ka thënë: ***“Ka prej tyre që do të bëjnë vërejtje në ndarjen e lëmoshës, nëse u jepet nga ajo, ata mbesin të kënaqur, e nëse nuk u jepet, ata hidhërohen”***. Pra, prej cilësive të mynaiikëve është edhe akuzimi i atyre që janë të drejtë se ata nuk po veprojnë me drejtësi, kjo është ngase mynafikët nuk e duan të vërtetën dhe drejtësinë, ata janë të kënaqur kur u konvenon dhe hidhërohen kur nuk u konvenon, nëse u jep diçka për çfarë kanë dëshirë janë të kënaqur, e nëse nuk u jep ata hidhërohen dhe i akuzojnë të drejtë se po bëjnë padrejtësi dhe zullum. Kështu ata ishin sjellë me të Dërguarin e Allahut salAllahu alejhi ue sel-lem, e që për këtë na ka informuar ky ajet fisnik. Ka pasur prej munaHkëve që i kanë bërë vërejtje të Dërguarit të Allahut salAllahu alejhi ue sel-lem në ndarjen e lëmoshës, d.m.th. në dhënien e zekatit, që nëse u jepej atyre ata ishin të kënaqur dhe heshtnin, e nëse nuk u jepej ata hidhëroheshin. Kjo është gjendja e mynafikëve në çdo kohë, d.m.th. janë të kënaqur me personin, i cili u jep atë që kanë shpresuar ta marrin, ndërsa hidhërohen me atë që nuk u jep atë që kanë shpresuar. Pra, këta janë të atillë që janë të kënaqur apo të hidhëruar, sipas asaj që e shohin ata e nuk shikojnë këtë bazë të vërtetës dhe drejtësisë.

11. Urdhërimi në të këqija dhe ndalimin prej të mirave. Allahu i lartësuar ka thënë: ***“Hipokritët dhe hipokritet janë si njëri-tjetri; urdhërojnë për të keqen e ndalojnë nga e mira dhe shtrëngojnë duart e tyre. Harruan Allahun (nuk i binden), prandaj Ai i harroi (nga mëshira). Nuk ka dyshim, hipokritët janë ata të prishurit”***. Prej cilësive të mynaiikëve është edhe ajo se ata urdhërojnë në të këqija dhe pengojnë prej punëve të mira, ngase shpirti i tyre është i sëmurë dhe se nuk ka mundësi që të shohin të mirat që i bëjnë njerëzit. Ata duan që të përhapet e dëmsbmja dhe e keqja në mesin e njerëzve, kjo është ajo çfarë dëshiron shpirti i tyre, çfarë i nxit zilia e tyre dhe mllefi i tyre ndaj atyre që janë të drejtë. Pos kësaj, këta duan që edhe njerëzit tjerë t'iu bashkëngjiten atyre në veprat e këqija, d.m.th. të kenë cilësi të njëjtë e që kjo cilësi është shumë e keqe. Këta nuk e japin pasurinë

e tyre aty ku do Allahu, këta janë koprracë në shpërndarjen e pasurisë, në bërjen e punëve të mira dhe në urdhërimin e udhëzimin në punë të mira.

12. Mashtrimi dhe moszbatimi i premtimit. Allahu i Lartësuar ka thënë: ***“E prej tyre (hipokritëve) pati sish që ia patën dhënë besën Allahut që: Nëse na jep (Allahu) nga mirësia e Tij, ne do të ndajmë lëmoshë dhe do të bëhemi prej punëmbarëve”.*** Kur ia dha (Allahu) nga të mirat e Veta, ata bënë koprraci me atë (që u dha), e thyen besën dhe u zbrapsën nga respekti ndaj Allahut. Dhe për shkak se e thyen besën që ia patën dhënë Allahut dhe për shkak të asaj se gënjenin, Allahu ua ngjeshi hipokrizinë në zemrat e tyre deri në ditën që e takojnë Atë.” Prej cilësive të mynafikëve është se ata mashtrojnë dhe nuk e zbatojnë premtimin e dhënë, bile këta nuk e mbajnë premtimin kur i japin atë Allahut, edhe përkundër besimtarit i cili e mban fjalën, nuk mashtron, nuk tradhton, e kryen premtimin që u ka dhënë njerëzve dhe Allahut të Lartësuar. Ky ajet fisnik e shpjegon qartë atë se mynafikët janë ata që ia kanë dhënë besën Allahut të Lartësuar, që nëse Ai u jep pasuri nga mirësitë e Tij, ata do të jenë që do të japin lëmoshë nga pasuria e tyre dhe se do të jenë prej njerëzve punëmbarë. Këta as nuk e kryen premtimin e dhënë dhe as nuk u treguan të sinqertë në atë që pretendonin, por te ta u rrënjos hipokrizia deri në ditën kur të takohen me Allahun e Lartësuar deri në ditën e kiametit.

13. I nënçmojnë besimtarët, tallen me ta dhe nuk janë të kënaqur me ta për asgjë. Allahu i Lartësuar ka thënë: ***“Ata (hipokrite) që i përqeshin besimtarët, që me vullnetin e vet japin lëmoshë, i përqeshin edhe ata që nuk kanë më shumë se çka është e domosdoshme për jetesën e tyre, e njëkohësisht tallen me ta, Allahu u dha shpërblimin e talljeve të tyre - dënimin më të rëndë.”*** Prej cilësive të mynafikëve është se ata gjithmonë i akuzojnë besimtarët dhe se kurrë nuk janë të kënaqur me atë që bej në ata. Nëse ndodh që ndonjëri prej besimtarëve të japë lëmoshë pasuri të shumtë, atëherë ata (mynafikët) do të thonë se ai e ka dhënë pasurinë sa për sy e faqe të njerëzimit, e po qe se ndodh që të japë pak pasuri, ngase nuk ka më tepër, atëherë ata (mynalikët) thonë se Allahu nuk ka nevojë për këtë sadaka. Ara, pos që i akuzojnë besimtarët, edhe tallen dhe i përqeshin besimtarët.

14. Këshillojnë njëri-tjetrin që të braktisin xhihadin. Allahu i lartësuar ka thënë: ***“Ata (hipokritë) që mbetën (pa shkuar në luftë), u gëzuan për mospjesëmarrjen e tyre me të Dërguarin e Allahut dhe nuk dëshiruan që të luftonin me pasurinë dhe veten e tyre në rrugën e Allahut dhe thanë: Mos dilni (në luftë) në vapë”***

Thuaju: Zjarri i xhehenemit e ka vapën edhe më të fortë nëse janë që kuptojnë!”

Prej cilësive të mynafikëve mosnjohja dhe injoranca, duke e braktisur besimin në Allahun dhe duke u gëzuar për shkak të mosshkuarjes në xhihad dhe pos kësaj i këshillojnë mynafikët e tjerë që të mos shkojnë në xhihad për shkak se në të ka mundim të madh, sikurse është temperatura e lartë-vapa. E ky mynalik harron se zjarri i Xhehenemit e ka vapën më të fortë, andaj cili i mençur do të vepronte në atë mënyrë që të mos shpëtojë nga zjarri Xhehenemit.

15. U sjellin dëm besimtarëve duke qenë të mbuluar në maskën e tyre dhe duke vepruar haptas punë legale. Allahu i Lartësuar ka thënë: ***“(Nga hipokritët më të shëmtuarit janë) Edhe ata që ndërtuan xhami sherri, mosbesimi e përçarjeje mes besimtarëve dhe ftuan në pritje (solemne) atë që më parë kishte luftuar kundër Allahut dhe të Dërguarit të Tij. Ata do të betohen: Ne nuk kemi pasur tjetër qëllim, vetëm për të mirë! Por Allahu dëshmoi se ata vërtet janë rrenacakë. Ti mos u fal aty kurrë? Një xhami, e cila që prej ditës së parë është themeluar në respekt ndaj Allahut (pa hile), është më e drejtë të falesh në të, aty ka burra që dëshirojnë të pastrohen mirë, e Allahu i do të pastrit”*** Ajeti sinjalizon për disa veprime të mynafikëve në kohën e të Dërguarit salAllahu alejhi ue sel-lem Ata kishin ndërtuar një xhami të njohur si “mesxhidu dirar xhami sherri” me qëllim që t’u bëjnë dëm banoreve të Kubasë e të cilët ishin besimtarë. Këta (mynafikët) e kishin mohuar të Dërguarin e Allahut dhe e kishin pritur në mënyrë solemne atë që e kishte luftuar Allahun dhe të Dërguarin e Tij para ndërtimit të xhamisë së sherrit (mesxhidu dirarit). Ky ishte edhe qëllimi i tyre me ndërtimin e kësaj xhamie, edhe nëse betohen ata janë gënjeshtarë se kinse kanë dëshiruar mirë për myslimanët në ndërtimin e asaj xhamie që në të të falet i sëmuri dhe ai që ka nevojë. Allahu dëshmon se ata po gënjejnë në betimin e tyre. Për çështjen e kësaj xhamie të sherrit Allahu i Lartësuar e urdhëroi të Dërguarin e Tij Muhamedin salAllahu alejhi ue sel-lem që ta shkatërrojë atë dhe që të mos falet në të. E pa dyshim është ajo se xhamia e Kubasë është ndërtuar mbi bazat e devotshmërisë dhe kënaqësisë së Allahut, andaj ajo është xhamia meritore që myslimanët të falen në të dhe të tubohen në të për të mira. “Koncepti i kësaj “xhamie” ende vazhdon edhe sot duke marrë forma të ndryshme që përshtaten e me metodat bashkëkohore, uke e shfrytëzuar armiqtë e islamit për qëllimet e tyre të këqija. Në anën e jashtme shihet se ka aktivitete islame, kurse në anën e brendshme ajo është në dëm të islamit, apo për të deformuar islamin, apo për t’u maskuar në të apo edhe për ta tretur fenë. Po ashtu, i shfrytëzojnë sloganet e pastra “xhamitë” duke ngritur lart simbolin e fesë, ndërsa në anë brendshme është për qëllim akuzimi i fesë... Andaj, mu për këto

arsye, duhet të dihet se ka shumë “xhami” që e luajnë rolin e xhamisë së sherrit (mesxhidu dirarit), e për ne le të jetë shembull rasti i xhamisë së sherrit që ishte në kohën e të Dërguarit salAllahu alejhi ue sel-lem..

Gjynahqarët

Përkufizimi i gjynahqarëve

Me gjynahqarët si kategori e njerëzve që duhet të thirren në fenë e Allahut ne i nënkuptojmë ata individë të cilët kanë besuar duke konfirmuar se Allahu është i Vetmi që meriton adhurimin dhe se nuk ka zot tjetër pos Tij, se Muhamedi është i Dërguari i Allahut, por këta individë nuk i kryejnë disa nga obligimet e kësaj dëshmie (shehadetit). Këta i braktisin disa prej urdhrave të Allahut dhe i thyejnë disa ndalesa të Tij. Ka prej tyre që bëjnë shumë gjynahe, por ka prej tyre që bëjnë pak gjynahe dhe ka prej tyre që janë mes tyre, ndërsa këta të fundit janë kategori të shumta që vetëm Allahu i Lartësuar mundet t’i evidentojë.

Myslimani nuk është i mbrojtur nga gjynahu

Myslimani nuk është i mbrojtur nga gjynahu, andaj mu për këtë në hadith thuhet: *“Të gjithë bijtë e Ademit janë gjynahqarë dhe më i miri prej gjynahqarëve është ai që pendohet”*. Arsyesimi i kësaj është se shpirti i njeriut është i krijuar i tillë me mundësi gabimi, sikundër është i gatshëm të ruhet prej gabimit. Andaj, prej myslimanit kërkohet që të angazhohet në nënshtrim ndaj Allahut dhe të largohet nga veprimi që vjen në kundërshtim me Të. Allahu i lartësuar ka thënë: ***“Pasha njeriun dhe Atë që e krijoi atë, dhe ia mësoi se cilat janë të këqijat dhe të mirat e tij. Pra, ka shpëtuar ai që e pastroi vetveten. E ka dështuar ai që e poshtëroi vetveten.”*** Pra, kur ndodh që myslimani bën gjynah ai duhet të nxitojë që të pendohet, ta shkulë nga vetja gjynahun dhe t’i kërkojë falje Krijuesit të tij.

Shkaqet e bërjes së gjynahut

Nganjëherë ndodh që të sillet në mendje kjo pyetje: pse myslimani të mos i respektojë urdhrat e sheriatit islam, kur ai beson në Allahun, në të Dërguarin e Tij dhe në Ditën e Fundit, pasi që ka besim se gjynahu e bën atë të meritojë hidhërimin dhe dënirn prej Allahut të Lartësuar? Si përgjigje për këtë është kjo: Pa dyshim, se besimi-imani mund të dobësohet në zemrën e myslimanit dhe të ngadhënjejë epshi e që në këtë mënyrë të pranojë nxitjen e djallit, kështu pastaj të bëjë gjynah. Vërtet dënimi ndaj gjynaheve është i premtuar që do të ndodhë në botën tjetër dhe se kënaqësitë e kësaj bote që janë të ndaluara janë prezente tash, andaj natyrshmëria e shpirtit që të bjerë nën ndikim e asaj që është prezent e jo nën ndikimin e asaj që nuk është prezent edhe nëse përfundimi i asaj që është prezent është i hidhur, e përfundimi i asaj që nuk është prezent është i ëmbël. Prandaj, prej kësaj natyrshmërie asgjë nuk mund ta pengojë shpirtin pos besimit-imanit të fortë. Allahu i lartësuar ka thënë: ***“Po ju po i jepni përparësi jetës së kësaj bote”*** Njeriu nga natyrshmëria e tij u jep përparësi ënaqësive të kësaj jete edhe nëse ato janë shumë më me pak vlerë sesa kënaqësitë e botës tjetër, andaj sa ta ketë iman-in-besimin e dobët aq më shumë nxiton nga jeta: kësaj bote dhe më lehtë futet në gjynahe. E posaçërisht gabon njeriu, duke pasur shpresë se ende do të jetë gjallë dhe do të ketë kohë për pendim dhe e qetëson veten duke pasur shpresë në faljen e Allahut të Lartësuar.

Injoranca e gjynahqarit

Pa dyshim se gjynahqari është injorant, po të mos kishte injorancë ai nuk do të bënte gjynah ndaj Allahut të lartësuar. Allahu i lartësuar ka thënë: ***“Pendim i pranueshëm tek Allahu është vetëm ai i atyre që e bëjnë të keqen me mosdije shpejt pendohen; të tillëve Allahu ua pranon pendimin, sepse Allahu është më i dijsmi, më i urti.”*** Muxhahidi dhe disa nga dijetarët kanë thënë: secili që bën gjynah ndaj Allahut, qoftë pa dashje, qoftë me dashje, ai është injorant, derisa të largohet prej gjynahut. Transmeton Katadeja nga Ebu el-Alijjeti, i cili kishte treguar se shokët e të Dërguarit salAllahu alejhi ue sel-lem thoshin: çdo gjynah që e bën robi është për shkak se ai është injorant ndaj asaj çfarë bën. Gjithashtu, transmetohet nga Muxhahidi, i cili ka thënë: secili që bën ndonjë gjynah ndaj

Allahut është injorant në atë që e bën. Transmetohet nga Ibn Abasi radijAllahu anhu se ka thënë: prej injorancës së njeriut është edhe ajo, kur ai vepron diçka të keqe (gjynah).

Një aspekt i injorancës së gjynahqarit është ajo se ai nuk e njeh vlerën e Krijuesit të tij, nuk e njeh faktin se ai e ka obligim që t'i nënshtrohet Krijuesit dhe Madhështisë së Tij dhe nuk e njeh përsosmërinë e begative të Tij, nuk e njeh faktin se Atij nuk mund t'i fshihet asgjë nga punët që i bëjnë krijesat e Tij dhe të gjitha krijesat do të shpërblehen, apo të ndëshkohen për punët e tyre. Po ashtu, si injorancë e gjynahqarit është edhe fakti se ai nuk i di dëmet që i sjellin gjynahet. Andaj, ai (gjynahqari) duhet të ikë prej gjynaheve, sikurse ikën prej gjarpërinjve e akrepave as nuk i prek ata e as nuk i vendos në trupin e tij, por nga injoranca që ka gjynahqari ai i pranon ata (gjarpinjtë-gjynahet) dhe i prek ata drejtpërsëdrejti. Si injorancë e gjynahqarit është edhe ajo, kur ai i jep përparësi jetës së kësaj bote ndaj jetës së ahiretit, e që dihet fare mirë se të mirat e kësaj jete, në krahasim me të mirat e ahiretit, janë sikur futja e gishtave në ujë të detit, d.m.th. sa mund të marrin një gishtat nga deti, aq janë të mirat e kësaj bote në krahasim me ato të ahiretit. Prej injorancës së gjynahqarit është edhe ajo se ai bazohet në shpresat e tij të gjata se ka për të jetuar edhe një kohë, andaj edhe për këtë ai e vonon pendimin, e nuk e di se vdekja është më afër njeriut se këpucët e tij dhe se momenti i vdekjes nuk i kërkon leje atij, kur t'i afrohet. Prej injorancës së gjynahqarit është edhe ajo se ai lodhet shumë dhe i braktis shumë kënaqësi të kësaj bote, me qëllim që të arrijë pasuri, sikur të mendojë do të angazhohej për të punuar për borën tjerër. A nuk e sheh se studenti e izolon veten në shtëpinë tij duke lexuar e duke mësuar me ditë e me javë, me qëllim që të ketë sukses në provim edhe pse disa nga kënaqësitë i braktis. Tregtari sa udhëtimet e gjata i bën dhe largohet prej familjes së tij, duke iu nënshtruar shumë rreziqeve vetëm e vetëm që të arrijë të fitojë pasuri. E përse as të mos punojë për botën tjetër, sikurse punon në këto raste. E më pastaj, vallë a nuk është kjo injorancë e gjynahqarit, ngase ai kur dëgjon fjalën e mjekut se nëse ai ha apo pi këtë e këtë mund të vdesë ose të jetë në rrezik të madh në këtë rast ai do t'i respektojë këshillat e mjekut dhe do të largohet nga ato që i ka ndaluar ai. Ky vepron kështu, edhe pse ka mundësi që mjeku ta ketë mendimin të gabuar. Pasi që neve na ka informuar i Dërguari i Allahut salAllahu alejhi ue sel-lem për kërcënimet dhe dënimet e Allahut për atë që nuk i respekton kufijtë e Allahut, e që ky lajm është i sigurt dhe nuk ka kurrfarë dyshimin në të. Atëherë pse nuk e respekton fjalën e të Dërguarit s.a.v.s, ndërsa ljalën e mjekut e respekton, kështu nuk do të vepronte po të mos ishte injorant ndaj gjithë kësaj? Po ashtu si injorancë

e gjynahqarit është edhe ajo se ai mbështet në faljen e Allahut dhe mëshirën e Tij, duke harrur se mëshira Allahu është afër bamirësve, se njerëzit që e njohin Allahun veprojnë, me gjithë mundin e tyre për ta fituar kënaqësinë e Allahut, por prapëseprapë zemrat e tyre kanë frikë se Allahu nuk i pranon veprat e tyre, prandaj ai që shpreson vërtet në mëshirën e Allahut i merr të gjitha masat duhura dhe më pastaj pret mëshirën prej Allahut të Gjithëdijshtëm. Kjo është e njëjtë me atë që e lëvtron tokën duke e hedhur farën në të, e pastaj angazhohet rreth sa duke e ujitur dhe punuar atë, e në shpreson që Allahu do ta ruajë atë nga çdo shkatërrim. Ndërsa mendjelehti imas ftuar është ai që e lë tokën të palëvmar e të mbushur me gjemba e drurë dhe nuk e hedh farën në të, duke shpresuar që Allahu të bëjë që toka e tij të japë prodhime.

Mbrojtja prej gjynaheve

Shërimi nga bërja e gjynahut apo nga animi në të është një tematikë që, edhe nëse kemi dhënë ndonjë sinjal më herët për këtë ne do të flasim nëse do Allahu në pjesën e katërt të këtij libri që merr në shqyrtim metodat e thirrjes islame. Mjafton që ne këtu të themi se mbrojtja është më e mirë se sa kurimi i sëmundjes. Sikurse kanë thënë: duhet ruajtur prej sëmundjeve të trupit ashtu si duhet ruajtur edhe prej sëmundjeve të shpirtit, e gjynahet janë shkak i sëmundjes së zemrës (shpirtit), atëherë si do të realizohet mbrojtja prej gjynaheve? Çdo shpirt-njeri është i gatshëm për të bërë gjynahe: ***“Pasha njeriun dhe Atë që e krijoi atë dhe ia mësoi se cilat janë të këqijat dhe të mirat”*** Shpirti i njeriut i bart në vete mikrobet që shkaktojnë bërjen e gjynaheve dhe se këto mikrobe do të jenë të dobëta nëse shpirti-zemra është e mbushur me iman-besim. Andaj, kurdo që imani të dobësohet, mikrobet gjallërohen dhe shumohen duke nxitur në gjynahe. Kjo është e njëjtë sikur mikrobet në organizmin e trupit. Klima më e përshtatshme për aktivizimin e mikrobeve që ndikojnë në bërjen e gjynaheve është shikimi, prekja, dëgjimi, ushqimet dhe leximet (e gjërave të këqija). Çdokush është i rrezikuar nga këto sulme, e këto kur e sulmojnë epushin, atëherë ato të motivojnë ty për të bërë gjynah dhe që ta harrosh përmendjen e Allahut. Po ashtu njëra prej ambienteve të përshtatshme për zhvillimin e mikrobeve që motivojnë për gjynahe janë: gratë e zhveshura lakuriq gjysmëlakuriq, këngët me tekste vulgare, përzierja në mes meshkujve dhe femrave që kanë të drejtë martesë mes vete, frekuentimi i vendeve të njerëzve të pacipë, dëgjimi i fjalëve që nxisin vetëm për jetën e kësaj bote. Që të

gjitha këto, e të ngjashme me to, e forcojnë mikrobin e gjynahut në atë mënyrë sa që ai të jetë mbizotërues, pasi që ishte i dobët dhe, në këtë mënyrë, arrin të nxisë bërjen e gjynahut. Ndërkaq, klima e përshtatshme për të dobësuar mikrobet e gjynahut është çdo gjë e forcon besimin dhe diturinë e vërtetë në Allahun dhe Ditën e Fundit dhe çdo gjë që ta bëjë të qartë rrugën për në botën tjetër-ahiret. Prandaj, shoqërimi yt me njerëzit e mirë e punëtorë, të cilët punojnë për fenë islame dhe të cilët thërrasin për në fenë e Allahut janë elementi më i fortë për të mbrojtur ty dhe besimin tënd dhe tjetra, këta ndihmojnë në dobësimin e këtyre mikrobeve të gjynaheve. E në fund, si mbrojtje prej gjynaheve është ajo që myslimani të mos i minimizojë gjynahet sa do që të jenë të vogla ato, ngase dihet se grumbulli 1 drurëve mund të jetë bërë, edhe nëse fillimi ishte nga dy sish. Po ashtu, myslimani duhet që të mos e ekspozojë veten para atyre gjërave që e dobësojnë imanin e tij dhe në të njëjtën kohë e forcojnë mikrobin e gjynahut, duke u mbështetur në atë se ai e ka imanin e fortë. Pra nuk është e logjikshme që njeriu ta ekspozojë veten e tij përballë virusit të tuberkulozit dhe të shkojë tek ata që janë të sëmurë nga tuberkulozi me bindjen se ai e ka trup të shëndoshë.

Qëndrimi i thirrësit ndaj gjynahqarëve

Thirrësi duhet t'i shikojë gjynahqarët me syrin e dhimbjes dhe mëshirës, ai i shikon ata sikur qëndrojnë në buzë të një humnere të thellë e të errët. Ka frikë për ta se mos ata do të bien në atë greminë, andaj ky angazhohet për t'i shpëtuar ata nga ky shkatërrim. Prandaj për shkak të këtij synimi duhet të mos merret me gabimet që bëjnë gjynahqarët ndaj tij, të mos i qortoje ata dhe të mos i nënçmoje ata duke u mburrur ndaj tyre se ky është person që i nënshtrohet Allahut, por ajo që duhet të bëjë është që ndaj gabimeve që ata i bëjnë ndaj ligjeve të Allahu të reagojë në mënyrë shumë të prerë. Transmetohet nga Aishja radijAllahu anhu se ka thënë: "Asnjëherë i Dërguari i Allahut nuk është hakmarrë për shkak se dikush ka gabuar ndaj tij, përveçse ka reaguar ndaj atij që nuk i ka respektuar ligjet e Allahut. Andaj, kur nuk janë respektuar ligjet e Allahut ai ka reaguar në mënyrë të prerë". Prej rasteve të mosrespektimit të ligjeve të Allahut, e për të cilat ka të drejtë të hidhërohet myslimani, është kur gjynahqarët e luftojnë thirrjen për në fenë e Allahut, pengojnë këtë thirrje, u sjell telashe dhe tortura thirrëseve myslimanë sa që i pengojnë që ata ta kryejnë misionin e tyre-thirrjen në fenë e Allahut. Në këto raste e të ngjashme me to i lejohet thirrësit që të veprojë në atë mënyrë që këta

gjynahqarë t'i pengojë që të mos i sjellin dëm thirrjes islame dhe thirrësve në bazë të limiteve që i lejon sheriatu islam. Pra, thirrësi nuk bën që në këtë rast t'i kalojë kufijtë e caktuar, por duhet të veprojë me metodat dhe mjetet që janë më të lehta për ta penguar dëmin prej tyre duke pasur në vete dëshirën e plotë për t'i udhëzuar dhe për t'i përmirësuar ata.

Burimet e metodikave të thirrjes dhe mjetet e saj

-nevoja jonë për to

Numri i shumtë i burimeve

Si burime të metodave dhe të mjeteve të thirrjes janë: Kurani Fisnik, suneti i të Dërguarit s.a.v.s, jeta e gjeneratës së parë (selefi salihu), deduksionet juridike të juristëve myslimanë dhe eksperiencat. Për të gjitha këto do të flasim në mënyrë koncize dhe secilin burim do ta përkufizojmë.

Burimi i parë - Kurani Fisnik

Në Kuranin Fisnik ka shumë ajete, që kanë të bëjnë me ndodhitë e të dërguarve fisnikë dhe atë që ka ndodhur me popujt e tyre.

Shpalljet e Allahut të Lartësuar, që ua bënte të dërguarve fisnikë janë përmbyllur me zorërinë tonë Muhamedin salAllahu alejhi ue sel-lem Nga këto ajete fisnike rezultojnë bazat e metodave dhe mjeteve të thirrjes islame, e të cilat duhet t'i kuptojë myslimani, sikurse i kupton edhe çështjet e tjera fetare. Kjo ngase Allahu i Lartësuar, në tregimet e që na i ka treguar ka pasur për qëllim të vetëm që ne të marrim mësim dhe që të furnizohemi me konceptet që na duhen për thirrjen tek Allahu i lartësuar e që t'i përmbahemi atij programi. Krijuesi ynë i Lartësuar dhe i Madhëruar thotë: ***“Të gjitha këto që t'i rrëfyem nga lajmet e pejgamberëve janë që ta forcojnë zemrën tënde dhe në to të kanë ardhur e vërteta e këshilla, si dhe përkujtime për besimtarët.”*** Ibn Kethiri, për komentimin e këtij ajeti, ka thënë: ***“Çdo tregim që ta kemi treguar ty prej tregimeve të të dërguarve të mëhershëm, që***

ishin para teje baskë me popujt e tyre dhe se si kanë rrjedhur polemikat e mospajtimit dhe gjithçka që kanë përjetuar të Dërguarit prej përgënjeshtimeve e torturave dhe se si Allahu i ka ndihmuar aleatët e Tij besimtarë dhe i ka poshtëruar armiqtë e Tij jobesimtarë. Të gjitha këto janë për të forcuar Ne zemrën tende, o Muhamed, d.m.th. që zemra jote të jetë e njejtë sikur e vëllezërve të të dërguarve”

Pa dyshim se myslimanët e ndjekin të Dërguarin e tyre salAllahu alejhi ue sel-lem dhe po ashtu marrin shembull edhe prej ndodhjeve të të dërguarve rreth çështjeve të thirrjes tek Allahu. Allahu i Lartësuar ka thënë: **“Në tregimet e tyre (të dërguarve dhe të Jusufit me vëllezër) pati mësim e përvojë për të zotët e mendjes. Ai (Kurani) nuk është bisedë e trilluar, por vërtetues i asaj që ishte më parë (librave të shejntë) dhe sqarues i çdo sendi, e edhe udhërrëfyes e mëshirë për nje popull që beson.”** Në tregimet e popujve dhe të dërguarve të mëhershëm mësim dhe këshilla për ata që janë të zotët e mendjes dhe në të njëjtën kohë janë udhëzim dhe mëshirë për besimtarët që e besojnë Allahun dhe të Dërguarin e Tij. Allahu i lartësuar ka thënë: **“Ata (të dërguarit e përmendur) ishin që Allahu i vuri në rrugë të drejtë, andaj ti merri shembull në udhëzim.”** Ky ajet fisnik jep sinjal të qartë se duhet doemos të ndiqet programi i të Dërguarve të Allahut gjatë misionit të thirrjes.

Burimi i dytë - suneti i të Dërguarit salAllahu alejhi ue sel-lem

Në sunetin e të Dërguarit salAllahu alejhi ue sel-lem ka hadithe të shumta, të cilat kanë të bëjnë me çështjet e thirrjes dhe mjetet e saj. Po ashtu jeta e të Dërguarit salAllahu alejhi ue sel-lem.. si në Mekë ashtu edhe në Medinë dhe mënyra e ballafaqimit me shumë sfida, që të gjitha këto na japin njohuri rreth metodave dhe mjeteve të thirrjes, kjo është ngase i Dërguari i Allahut salAllahu alejhi ue sel-lem ka kaluar nëpër situata dhe rrethana të ndryshme e në të cilat rrethana mund të kalojë çdo thirrës në çdo kohë dhe çdo vend. Andaj, nuk ka asnjë rrethanë në të cilën mund të gjendet thirrësi e që ajo rrethanë të mos jetë e ngjashme apo e afërt me atë që i ka ndodhur të Dërguarit të Allahut salAllahu alejhi ue sel-lem Për këtë thirrësi nga biografia e jetës së të Dërguarit savs. mund të bëjë zgjidhje të saktë dhe qëndrim të shëndoshë, nëse ky i kupton konceptet e jetës së të Dërguarit salAllahu alejhi ue sel-lem Mund të jetë prej urtësive të Allahut që të përcaktojë të

ndodhë me të Dërguarin e Tij nëpër rrethana të tilla, me qëllim që thirrësit myslimanë të marrin mësim se si të veprojnë dhe se si të bëjnë zgjidhje në ndjekjen e jetës së të Dërguarit salAllahu alejhi ue sel-lem

Jeta e të Dërguarit salAllahu alejhi ue sel-lem dhe direktivat e tij fisnike janë zbatimi praktik i asaj që e ka urdhëruar Allahu të Dërguarin e Tij në çështjet e thirrjes islame dhe në kryerjen e misionit islam. Andaj, nuk i lejohet thirrësit që të jetë indiferent ndaj jetës së të Dërguarit salAllahu alejhi ue sel-lem

Burimi i tretë - jeta e gjeneratës së parë (selefi salihut)

Në jetën e gjeneratës së parë (selefi salihut) prej sahabëve dhe tabi'inëve ka ndodhi që janë shumë të rëndësishme për çështjet e thirrjes, nga të cilat ndodhi mund të përfitojnë shumë thirrësit myslimanë. Arsyeja e kësaj është se gjenerata e parë (selefi salihu) i kanë ditur më mirë çështjet e fesë sesa të tjerët dhe më së miri e kanë kuptuar konceptin e thirrjes islame.

Burimi i katërt - deduksioni i juristëve myslimanë

Juristët myslimanë janë të interesuar për deduktimin e dispozitave të sheriatit nga burimet e sheriatit për çështjet që kanë të bëjnë me anën praktike. Prej këtyre dispozitave të dedukuara nga ana e juristëve myslimanë janë edhe dispozitat që kanë të bëjnë me çështjet e thirrjes tek Allahu, si p.sh. dispozitat që kanë të bëjnë me institucionin e urdhërimit në të mira dhe pengimit prej të këqijave, dispozitat që kanë të bëjnë me xhihadin dhe inspektimin e veprimeve të njerëzve. Juristët myslimanë për këto dispozita kanë caktuar kapituj të veçantë në librat e tyre të jurisprudencës islame. Vendimet që i kanë marrë rreth çështjeve të thirrjes tek Allahu janë të njëjta me ixhtihadet e tjera dhe se prej këtyre vendimeve ka veprime që duhet doemos të zbatohen, por ka edhe të atilla që rekomandohen të zbatohen, ngase mjetet dhe metodat e thirrjes islame janë prej çështjeve të fesë sikurse janë edhe dispozitat që kanë të bëjnë me adhurimet dhe marrëdhëniet reciproke ndërmjet njerëzve.

Burimi i pestë - eksperiencat

Eksperiencia është mësues i mirë i njeriut, e posaçërisht kur ka të bëjë me atë që ka punë me njerëzit, andaj thirrësi ka eksperiencia të shumta në fushën e thirrjes tek Allahu dhe se këto eksperiencia janë rezultat i punës së tij që ka të bëjë drejtpërdrejt me njerëzit dhe me mjetet e thirrjes, duke i zbatuar ato sipas asaj se si i ka kuptuar burimet e përmendura më herët. Vërtet, zbatimi i ndonjë çështjeje mund të jetë gabim, por mësim që në të ardhmen të mos veprohet njësoj përsëri, pra ndonjëherë për gabimin mund të paguhet shumë, por ajo që mësohet nga eksperiencia mund të jetë shumë me e vlefshme sesa çmimi që është paguar, kuptohet kur vërtet ka dobi nga eksperiencia. Kjo është ajo që shpresohet ta bëjë besimtari, ngase besimtari nuk bën të lejojë që të kafshohet dy herë nga i njëjti strofull (i gjarprit)... Sikurse thirrësi ka dobi nga eksperiencia e tij personale, ai po ashtu ka dobi dhe përfitim edhe nga eksperiencia e thirrësve të tjerë në fushën e metodave dhe mjeteve të thirrjes. Arsyeja e gjithë kësaj është se urtësia është gjë e humbur e besimtarit, andaj ai duhet ta marrë atë pavarësisht se prej cilit burim del...

Domosdoja e përmbajtjes së programit të saktë në përdorimin e mjeteve dhe të metodave të thirrjes

Programi i saktë në përdorimin e mjeteve dhe metodave të thirrjes është ai që nxirret nga burimet të cilat i shpjegojmë më lart, andaj përmbajtja e këtij programi është domosdoshmëri që duhet ta respektojë çdo thirrës dhe se një veprim të tillë ia obligon feja islame. Myslimani e ka për obligim që t'i përmbahet asaj që e ka përcaktuar feja, andaj e njëjtë është edhe përmbajtja e këtij programi të saktë, i cili e afron atë më afër synimit dhe qëllimit, edhe po qe se kjo zgjat për një kohë. Ndërkaq, programet e tjera, pos këtij programi, janë të gabuara dhe se e largojnë thirrësin larg cakut e synimit të kërkuar. Prej thirrësit kërkohet që të angazhohet në nënshtrimin ndaj Allahut, në ndjekjen e asaj që është e saktë dhe që të mos bëjë ndonjë gabim e gjynah. Pra, ajo që kërkohet prej thirrësit është që ai t'i përmbahet programit të saktë të cilin e gjejmë në burimet e thirrjes. Prandaj, kur thirrësi e

zbaton atë që kërkohet prej tij, ai më nuk është përgjegjës për rezultatin e punës së tij në aspektin e arritjes së qëllimit të tij, ngase Allahu i Lartësuar ka thënë: **“Andaj, sa të keni mundësi ruajuni prej dënimit të Allahut”**. Ajo për të Cilën do të merret në përgjegjësi njeriu është nëse i ka kryer obligimet e tij? Prandaj, kur thirrësi arrin ta kuptojë këtë ashtu si duhet, atëherë ai nuk largohet nga ky program i saktë për shkak se ballafaqohet me vështirësi, apo për shkak se po e zgjat shumë, apo për shkak se nuk po e pranojnë njerëzit thirrjen e tij, apo për shkak se po i ngutet thirrësit që të arrijë synimin për shkak se ai i ka qëllimet e mira dhe të sinqerta si në detyrë, si në xhihad dhe në rënien e tij si dëshmor në rrugën e Allahut, ngase veprimi i gabuar nuk mund të shndërrohet në të saktë për shkak të qëllimeve të sinqerta të mira dhe se caku nuk mund të arrihet vetëm duke ecur me dëshirë që të arrijë te caku i kërkuar. Si argumentim për atë që po themi mjafton fakti se dispozitat e sheriatit nuk kanë zbritur të gjitha menjëherë por gradualisht, se thirrja islame nuk ka ecur mbi bazën e dëshirave dhe lakmive të të sinqertëve, të cilët nxitojnë për të arritur qëllimin e duhur. Lufta nuk u legalizua derisa ishin myslimanët në Mekë, ku i Dërguari salAllahu alejhi ue sel-lem atyre që kërkonin sa më shpjet që t'u lejohej lufta u përgjigjej duke u thënë: duroni. Paqja e Hudejbisë nuk ishte e pranuar prej shumë zemrave të myslimanëve, edhe pse ata ishin të sinqertë në besimin e tyre dhe ishin të përgatitur për luftë dhe vdekje në rrugën e Allahut, por i Dërguari salAllahu alejhi ue sel-lem ishte i kënaqur me paqen e arritur në Hudejbi. Theksohet kështu, ngase çështja nuk është punë gatishmërie që ka njeriu për të vdekur, apo për shkak se është i sinqertë, por çështja është respektimi dhe përmbajtja ndaj programit të saktë, i cili është i vetmi që mund të dërgojë te caku i kërkuar. Andaj, mu për këtë Kurani e përshkruan këtë marrëveshje për paqe si fitore e qartë. Thirrësi nuk bën të ndikohet prej ndjenjave dhe qëllimeve të tij të sinqerta në shërbimin e tij ndaj islamit kur të përcaktoj metodën dhe mjetin e thirrjes, andaj mu për këtë ai duhet të mendoj mirë dhe saktë për zbatimin e mënyrave dhe mjeteve sipas dritës së burimeve të thirrjes, të cilat i kemi përmendur më lart. Vërtet vendosmëria, ndjenjat dhe dëshira e mirë për punë duhet doemos të orientohen që të gjitha në zbatimin e metodave dhe mjeteve të sakta e kurrsesi të orientohen kah metodat dhe mjetet e dyshimta dhe larg çdo polemike shterpe.

Pasojat e mosrespektimit të programit të saktë

Mosrespektimi i programit të saktë në metodën dhe mjetin e thirrjes çon deri në dështim dhe mosarritje të caku i duhur, edhe po qe se ai i cili nuk e respekton programin e saktë mendon se i është afruar, apo e ka arritur synimin e duhur edhe po qe se realisht e arrin cakun, ai shpejt do të largohet nga ai veprim dhe mënyrë e veprimit. Pavarësisht prej kësaj, mosrespektimi i programit të saktë në shumicën e herëve u sjell të këqija atyre që veprojnë në këtë mënyrë (nuk e respektojnë programin e saktë) dhe humbje e mundit kot dhe shpejt, kjo është njëjtë sikur ai që e ngre një ndërtesë pa themele të forta, apo me material jo të mirë. Pra, ndërtesa e këtij personi ka mundësi të shkatërrohet dhe të shembet mbi banoret e saj. Pasojat e këtij veprimi janë shumë reale, edhe po qe se thirrësi e ka qëllimin të mirë, ngase rezultatet që arrihen në këtë jetë varen prej shkaqeve e veprimeve e jo sipas qëllimeve dhe synimeve të njerëzve.. Si shembull për këtë që themi, apo si argument është se prej programit të thirrjes së saktë është mirësjellja dhe butësia, ngase po qe se thirrësi është i ashpër dhe i vrazhdë mund të jetë shkak që njerëzit të largohen prej tij, edhe pse thirrja e tij është e vërtetë dhe se është i sinqertë në punën e tij. Prandaj, ky nuk mund të jetë më i mirë sesa i Dërguari i Allahut, të cilit Allahu i Lartësuar i ka folur: ***“Ti ishe i butë ndaj atyre, ngase Allahu të dhuroi mëshirë, e sikur të ishe i vrazhdë e zemërfortë, ata do largoheshin prej teje”***. Në fund, mosrespektimi i programit të saktë mund të jetë ndër gjynahet që i bën thirrësi, ngase programi i saktë për thirrjen islame është prej çështjeve të fesë e kundërshtimi i dispozitave të fesë në thirrjen islame konsiderohet gjynah dhe për këtë do të pyetet myslimani.

Vështirësitë në zbatimin e programit të saktë

E vërteta është se zbatimi i programit të saktë nuk është çështje e lehtë, ngase ky program kërkon nga thirrësi që ai t’i njohë konceptet e programit të saktë dhe që ato koncepte t’i ketë gjithmonë parasysh në atë mënyrë që ajo që kërkohet të zbatohet, të jetë e lehtë për të. E më pastaj ky duhet të zbatohet në praktikë atë që e ka kuptuar prej këtyre koncepteve edhe në çështjet që janë imëta e të cilat çështje janë të shumta sa që është vështirë të evidentohen. Tjetra është se këto çështje të imëta përzihen mes vete sa që mund të jenë kontrast mes vete. Po ashtu, konceptet

e programit të saktë janë të shumta sa që thirrësi mund t'i harrojë konceptet e programit të saktë dhe pos kësaj është shumë vështirë të deduktohet ndonjë koncept i ri prej të gjitha këtyre koncepteve të shumta. Shembulli i thirrësit në këtë pozitë është i ngjashëm me atë të komandantit të ushtrisë, i cili i njeh të gjitha taktikat ushtarake në mënyrë shumë precize, por vetëm kjo nuk i mjafton në aspektin praktik, ngase ai duhet të ketë zgjuarsin dhe forcë që të dijë t'i përdorë njohuritë e marra sipas programit të saktë ndaj gjendjes me të cilën po përballet. Aspekti praktik i koncepteve të mësuara është shumë më i vështirë për thirrësin sesa për komandantin e ushtrisë, ngase komandanti para vetes ka ushtrinë, e cila e dëgjon atë duke zbatuar gjithë atë që ai i urdhëron, ndërsa thirrësi përballet me njerëzit që janë injorantë dhe kundërshtarë të Krijuesit, të cilët janë larg prej të vërtetës, të dhënë pas kësaj bote dhe kundërshtarë të thirrësit, apo më e pakta ata nuk janë të interesuar për atë të mirë në të cilën i fton thirrësi dhe konsiderojnë se nuk kanë nevojë për të. Unë shtoj edhe atë se gjendja dhe hamendja e njerëzve është e llojllojshme, sëmundjet e tyre shpirtërore janë të shumta, andaj të gjitha këto bëjnë që detyra e thirrësit në zbatimin praktik të asaj që ka mësuar është e vështirë dhe fare nuk është e lehtë. Edhe përkundër të gjitha këtyre mundimeve, ai i tejkalon këto vështirësi me aq sa ka mundësi. Për këtë do të shpjegojmë në rreshtat vijues.

Lehtësimi i zbatimit të programit të saktë

Disa çështje e mundësojnë lehtësimin e zbatimit të programit të saktë.

1. Kuptimi i mirë dhe i përpiktë i koncepteve të programit të saktë duke i analizuar dhe studiuar hollësisht dhe në mënyrë shumë të qetë të gjitha konceptet e ardhura nga burimet që i kemi përmendur më lart, në mënyrë që ky kuptim i përpiktë të jetë në mendjen e tij sikur gjaku që lëviz nëpër trup. Prandaj, për këtë nuk i lejohet thirrësit që të mërzhitet prej leximit dhe rileximit të burimeve të thirrjes në mënyrë shumë serioze dhe të përpiktë.

2. Devotshmëria ndaj Allahut, ngase frika ndaj Allahut e ndriçon zemrën e myslimanit, duke forcuar aftësinë e të kuptuarit dhe medituarit për ta kuptuar të vërtetën në mënyrë të qartë dhe që t'i njohë mjetet dhe metodat e sakta e të përshtatshme për rrethanat dhe njerëzit me të cilët ballafaqohet. Po ashtu më lart kemi përmendur se nuk mjafton që thirrësi t'i njohë mjetet dhe metodat e thirrjes

në mënyrë të përgjithshme, apo edhe në mënyrë të hollësishme, por ai e ka obligim të dijë t'i përdorë ato në aspektin praktik varësisht prej personit apo rrethanave me të cilat përballet. Ka shumë raste kur kundërshtohen arsyetimet e praktikimit të ndonjë mjeti të veçantë me rrethanën e veçantë apo personin e veçantë. Prandaj, thirrësi duhet të jetë shumë i kujdesshëm me qëllim që të përdorë mjetin e duhur apo të vijë në përfundim të deduktimit të ndonjë mjeti të ri prej :ë gjitha mjeteve që janë prezente duke përdorur analogjinë dhe mënyrat e deduktimit. Allahu i Lartësuar ka thënë: ***“O ju që besuat, nëse keni frikë Allahun, Ai do të vërë udhëzim (në zemrat tuaja) për ju, do t'jua mbulojë të këqijat, do t'jua falë gjynahet. Allahu është dhurues i madh.”*** Si koment për këtë ajet është kjo: *“Ai do të vërë udhëzim (në zemrat tuaja) për ju”, d.m.th. ai jua bën të qartë dallimin ndërmjet të vërtetës dhe të pavërtetës. Vërtet, ai që ia ka frikën Allahut, duke i zbatuar urdhrat e Tij dhe duke i braktisur ndalesat e Tij për atë se e dallon të vërtetën prej të pavërtetës. Prandaj, ky është shkak që atë ta ndihmojë Allahu, që ai të shpëtojë dhe të dalë prej çështjeve të kësaj bote dhe që të jetë i lumtur në ditën e kiametit.”* Allahu i Lartësuar ka thënë: ***“Kijeni frikë Allahun, se Allahu ju dhuron dituri (të jashtëzakonshme) ”.*** Ibn Kethiri për komentimin e pjesës së ajetit ***“Kijeni frikë Allahun se Allahu ju dhuron dituri (të jashtëzakonshme), ”*** thotë të njëjtin koment që e përmendëm për ajetin: ***“O ju që besuat, nëse e keni frikë Allahun, Ai do të vërë udhëzim (në zemrat tuaja) për ju ”.***

3. Që thirrësi të mbështetet vazhdimisht tek Allahu i Lartësuar dhe të kërkojë prej Tij që Ai ta mësojë atë. Imam Ibn Tejmije (Allahu e mëshiroftë) dilte në shkretëtirë e vendoste mollëzën e faqes së tij dhe thoshte: “O Mësuesi i Ibrahimit, më mëso”, këtë veprim e kishte përsëritur disa herë, sipas asaj që tregonte nxënësi i tij Ibn Kajjimi (Allahu e mëshiroftë).

4. Që thirrësi ta pastrojë zemrën prej viruseve - sëmundjeve të hipokrizisë në tërësi. Ky pastrim i zemrës manifestohet duke shprehur sinqeritetin ndaj Allahut Zotit të gjitha botëve, duke mos mbetur asgjë prej cilësive të hipokrizisë në llogari të programit të saktë të thirrjes. Nganjëherë ndodh që thirrësi të devijojë nga programi i saktë kur e dëgjon zhurmën e njerëzve, apo dëshirën e shokëve të tij që të bëjë lehtësime në konceptet e programit të saktë. Prandaj, ajo që i ndihmon atij që të jetë vendosur dhe i pathyeshëm në zbatimin e programit të saktë është sinqeriteti i plotë, i cili e eviton prej thirrësit çdo gjë që mund ta nxisë atë që të dalë prej programit të saktë. Pa dyshim të qenët i sinqertë është çështje e vështirë, ngase viruset-sëmundja e hipokrizisë janë të fshehtë e të cilët mund t'i ketë thirrësi pa i vërejtur fare, njëjtë sikur i shëndoshi që mund të ketë viruse e ndonjë

sëmundje, por që nuk i vëren ato, andaj mu për këtë mund të posedojë sëmundje që ndikojnë në dobësimin e thirrësit e që ai më pasraj të dalë jashtë programit të saktë. Nga Allahu i Lartësuar kërkohmë ndihmë.

Metodat e thirrjes

Hyrje

Metodat e suksesshme të thirrjes janë ato që veprojnë për ta përcaktuar sëmundjen e të thirrurve, njohjen e ilaçit dhe largimin e dyshimeve, të cilat pengojnë që i thirrun ta shohë sëmundjen dhe ta ndiejë atë. Po ashtu, këto metoda duhet ta nxisin atë që ta përdorë ilaçin e duhur dhe ta frikësojnë atë që ai më pastaj ta braktisë atë sëmundje. E më pastaj këto metoda të ndikojnë tek ata që i përgjigjen thirrjes duke i edukuar dhe duke i mësuar ata me qëllim që ata të jenë imunë kundër sëmundjes së tyre të vjetër. Të gjitha këto do t'i shpjegojmë në pjesët vijues.

Sëmundja dhe ilaçi

Përcaktimi i rrënjëve të sëmundjes dhe i ilaçit

Vërtet mjeku në fillim e përcakton sëmundjen e pastaj e përshkuan ilaçin. Pra, kjo është metoda e saktë e trajtimit. Thirrësi tek Allahu i lartësuar është mjeki shpirtrave, andaj ai duhet të ndjekë të njëjtën metodë gjatë trajtimit të shpirtrave, duke përcaktuar në fillim sëmundjen e më pastaj duke përcaktuar ilaçin e duhur, e kurrsesi nuk lejohet që ai vetëm ta kundërshtojë sëmundjen me qëllim që ajo të shërohet duke mos u angazhuar në zbulimin e shkakut të sëmundjes. Prandaj, cila është gjeneza e sëmundjes së njerëzve dhe cila është esenca e ilaçit?

Gjeneza e sëmundjes së njerëzve dhe baza e ilaçit të tyre

Gjeneza e sëmundjes së njerëzve, si në të kaluarën dhe në të tashmen është injoranca e tyre ndaj Krijuesit, mohimi i Tij, refuzimi i adhurimit të Tij në mënyrë të tërësishme, moszbatimi i programit të cilin e ka sjellë Muhamedi salAllahu

alejhi ue sel-lem prej Zotit të tij, mashtrimi i tyre me të mirat e kësaj bate, indiferenca e tyre ndaj botës tjetër dhe mohimi i ekzistimit të saj. Pra, këto janë themelet e sëmundjes, ato që të gjitha bashkohen në mohimin e Allahut dhe në dobësimin e imanit-besimit, sikurse këtë dobësi të besimit e hasim te myslimanët. Kur ekziston baza e sëmundjes me të gjitha elementet e saj, atëherë ary gjinden të gjitha llojet e të këqijave, e po qe se janë disa nga elementet e sëmundjes, atëherë aty gjenden disa prej llojeve të këqijave.

Ndërkaq, baza e ilaçit për shërimin e kësaj sëmundje është imani-besimi në Allahu që është Zor i vetëm që meriton adhurimin dhe se nuk ka rival dhe largimi nga adhurimi i djajve, të drejtuarit kah Allahu dhe mosdhënia e tepërt ndaj kësaj dynjaje. Allahu i Lartësuar kur tregon për Nuhun a.s. thotë: ***“Ne e patëm dërguar Nuhun te populli i vet, ndërsa ai tha: O populli im, adhurojeni Allahun, nuk keni zot tjetër pos Tij. Unë kam frikë për dënimin tuaj në një ditë të madhe!”*** Po kështu, zotëria ynë, Muhamedi salAllahu alejhi ue sel-lem, kur prijësit kurejshë kishin ardhur të xhaxhai i tij për ta pyetur se çfarë kërkon prej tyre Muhamedi salAllahu alejhi ue sel-lem, i Dërguari salAllahu alejhi ue sel-lem u kishte thënë: ***“Kërkon që të thoni: nuk ka zot tjetër pos Allahut dhe të largoheni prej asaj që ju adhuroni”***. Kështu kanë thënë të gjithë të Dërguarit pa asnjë përjashtim. Allahu i Lartësuar ka thënë: ***“Ne dërguam në çdo popull të dërguar që t’u thonë: Adhurojeni vetëm Allahun, e largojuni djajve (adhurimit të tyre)!”***

Pohimi-theksimi i koncepteve të besimit islam

Pasi që neve na është bërë e qartë gjeneza e sëmundjes dhe ajo e ilaçit, atëherë thirrësit mysliman i bëhet obligim që në thirrjen e tij të bëjë pohimin-theksimin e koncepteve të besimit islam. Ky është ilaçi për shërimin e sëmundjes të cilën tashmë e kemi shpjeguar, duke theksuar besimin në Allahun si Zot i vetëm, besimin në Muhamedin se është i Dërguar dhe Lajmëtar prej Allahut, besimin në ringjalljen pas vdekjes me shpirt e trup dhe domosdoshmërinë e veprimit të punëve të mira më qëllim të shpëtimit prej dënimit të botës tjetër.

Besimi islam dhe manifestimi i koncepteve, bazave dhe i gjithë atyre që i përfshin ky besim janë themeli i thirrjes së thirrësit, e të cilat koncepte duhet theksuar gjithmonë dhe asnjëherë nuk duhet treguar indiferent ndaj tyre. Vërtet, kjo

është baza e thirrjes së thirrësit pa i përmendur edhe çështjet dytësore të thirrjes. Prandaj, kur ndodh që kjo bazë (besimi islam) të konsolidohet dhe t'i përgjigjen ata që thirren në atë besim, pasi që e kishin mohuar atë, atëherë i lehtësohet thirrësit që t'ua shpjegojë atyre konceptet islame dhe çështjet dytësore të fesë. Ndërkaq, kur ndodh që të refuzohet baza e thirrjes (besimi islam), në atë moment janë refuzuar edhe të gjitha çështjet dytësore të fesë. Pa dyshim sa gjatë periudhës mekase ajetet që kanë zbaritur kanë rrahur tematika që kanë shpjeguar bazat dhe konceptet e besimit, si p.sh. besimi në Allahun, në ditën e llogarisë, në shpërblimin me xhenet dhe ndëshkimin me xhehenem, domosdoshmërinë e besimit në shpalljen e të Dërguarit salAllahu alejhi ue sel-lem dhe në kryerjen e veprave legale të mira. Për këtë Allahu i lartësuar ka thënë: ***“Thuaj: A pos Allahut, krijues i qiejve dhe i tokës, që ushqen të tjerët, ndërsa vetë nuk ushqehet, të pranoj Zot tjetër? Thuaj: Unë jam i urdhëruar të jem i pari që bindem dhe (urdhërohem): të mos bëhem kurrsesi nga idhujtarët. Thuaj: Vërtet, unë i frikësohem dënimit të ditës së madhe, nëse nuk i përulem Zotit tim. Kush mënjanohet atë ditë nga ai (dënimi), atë Ai e ka mëshiruar dhe ai është shpëtimit i qartë. Nëse Allahu të godet me ndonjë të keqe, ska kush që ta largojë atë pos Tij, e nëse të dhuron ndonjë të mirë, duhet ditur se Ai është i gjithëfuqishëm për çdo send.”*** ; ***“O ju njerëz, nëse dyshoni për ringjalljen, atëherë (mendoni krijimin tuaj që) Ne ju krijuam prej dheu, pastaj prej uji, pastaj prej një gjaku të ngjizur; pastaj prej një kafshate mishi, që është krijesë e formuluar ose e paformuluar, në mënyrë që t'ju sqarojmë. Ndërkaq atë që e dëshirojmë Ne, e përqendrojmë në mitër deri në një afat të caktuar, e mandej ju nxjerrim foshnje dhe ashtu të arrini pjekurinë tuaj. Ka dikush prej jush që vdes herët, e dikush të jetojë deri në pleqëri të thellë, në mënyrë që të mos dijë asgjë nga dija që ka pasur. E ti e sheh tokën e tharë -të vdekur, e kur Ne ia lëshojmë asaj ujin ajo gjallërohet, shtohet dhe nga të gjitha llojet rrit bimë të këndshme. Këtë (e themi për ta ditur) se Allahu është Ai i Vërteti dhe se Ai i ringjall të vdekurit dhe Ai ka fuqi për çdo send. Dhe nuk ka dyshim se kiameti do të vijë patjetër dhe se Allahu me siguri do t'i ngjallë ata të varrezave (të vdekurit)”***; ***“Kush bën vepër të mirë, qoftë mashkull ose femër, e duke qenë besimtar, Ne do t'i japim atij një jetë të mirë (në këtë botë), e (në botën tjetër) do t'ju japim shpërblimin më të mirë për veprat e tyre”***

Ky është programi kuranor në kristalizimin e besimit islam deri në emigrimin në Medinë, ajetet që zbritnin në periudhën mekase sqaronin çështjet e besimit islam, si p.sh. besimi në Allahun dhe në Ditën e Fundit. Theksimi i besimit islam është një program i shëndoshë sikurse kemi thënë më herët, andaj thirrësi e ka për

obligimi që të theksojë çështjen e besimit kur ta shohë se myslimanët janë të dobët në besimin e tyre dhe kur ta shohë se besimi i tyre është dobësuar, duke i kundërshtuar urdhrat e Ligjdhënësit, duke i konsideruar si mbingarkesë obligimet fetare dhe duke u futur në shumë çështje që i shpijnë ata në devijim dhe humbje. Bile, ky program duhet doemos të zbatohet edhe ndaj atyre myslimanëve, të cilët nuk kanë manifestuar ndonjë kundërshtim ndaj ligjeve të Allahut, ngase ky theksim i koncepteve të besimit islam dhe rikujtimi i tyre i mbron ata nga devijimi dhe arroganca.

Kundërshtimi dhe reagimi ndaj kundërshtimit

Dikush mund të na kundërshtojë për atë se në thirrjen e të dërguarve që ua kanë bërë popujve të tyre shihet se ata kanë reaguuar për disa veprime të këqija të popujve të tyre. Sikundër ishte rasti me ndodhinë e Lutit a.s. dhe Shuajbit a.s. Atëherë, si mund të thuhet se duhet të theksohen konceptet e besimit islam në fillim, e pastaj nëse këto i pranojnë, thirrësi duhet të kërkojë prej tyre zbatimin çështjeve dytësore? Përgjigjja për këtë është se kristalizimi-mbjellja e besimit nënkupton atë se çështjet e besimit duhet të jenë në vend të parë dhe që ato kurrë të mos harrohen, e disa vepra të rrezikshme që janë në shoqëri lidhen me konceptet e besimit, ngase disa nga ato vepra ndikojnë që të kundërshtohet Allahu i Lartësuar. Ky, pra, është qëllimi i asaj që kemi thënë se duhet doemos të kristalizohet çështja e besimit-akides dhe se me këtë nuk synohet që thirrësi të jetë indiferent ndaj të këqijave të rrezikshme që janë në shoqëri. Këtë e argumenton ajo që është përmendur në Kuran për rastin e Lutit a.s.: ***“Populli i Lutit të dërguarit i konsideroi gënjeshtarë. Kur vëllai i tyre, Luti, u tha: A nuk i frikësoheni (Allahut)? Unë jam i dërguari i juaj, jam i besueshëm! Pra, kijeni frikë (dënimin) Allahun dhe më dëgjoni! Unë nuk kërkoj për këtë ndonjë shpërblim prej jush, shpërblimi im është te Zoti i botëve. (Të mjerët ju) A shkoni pas meshkujve të kësaj bote. E gratë tuaja i lini anash, të cilat Zoti juaj i krijoi për ju! Por ju jeni një popull që kalon çdo kufi!”***

Luti a.s. kishte filluar me ta duke i urdhëruar që vetëm Allahut t’ia kenë frikën, i informoi ata se ai është i Dërguar i Allahut dhe se e kanë për obligim që ta ndjekin të Dërguarin në atë që ai i informon ata, siç është adhurimi që duhet t’i bëhet vetëm

Allahut, e pastaj ua shpjegoi atyre disa veprime të tyre të këqija që ishin në kundërshtim me urdhrin e Allahut.

Allahu i Lartësuar për ndodhinë e Shuajbit a.s. thotë: ***“E në Medjen (dërguam) vëllanë e tyre Shuajbin. Ai tha: O populli im, adhurojeni Allahun(Një), ju nuk keni Zot tjetër pos Tij. Juve ju erdhi mrekullia nga Zati juaj. Zbatojeni drejt matjen dhe peshojën, e mos u bëni padrejtësi njerëzve në sendet e tyre dhe mos bëni ç'rregullime në tokë pas përmirësimit të saj. Këto janë më të dobishme për ju, nëse jeni besimtarë”***.

Shuajbi a.s. në fillim ua shpjegoi se vetëm Allahut duhet t'i bëjnë adhurim, pastaj u shpjegoi se atë që e sjell prej Allahut është e vërteta e qartë, e cila kërkon që doemos të qenët të besueshëm në peshojë dhe në masë dhe se nuk duhet bërë dëmzullum njerëzve e as që duhet shkaktuar trazira në tokë, ngase kjo është më mirë për ta, nëse ata janë që e besojnë Allahun dhe të Dërguarin e Tij.

Pra, Luti a.s. dhe Shuajbi a.s. ua ka shpjeguar popujve të tyre se nuk ka Zot tjetër pos Allahut, e më pastaj ua kanë përmendur disa nga pasojat e kundërshtimit të Allahut, siç ishte veprimi i ndyrë i popullit të Lutit - homoseksualizmi (marrëdhëniet seksuale mashkull me mashkull) dhe veprimi i popullit të Shuajbit, të cilët mashtronin popullin në peshojë. Mu për këtë në Mekë kanë zbritur ajete që e trajtojnë çështjen e atyre që mashtrojnë në peshojë. Allahu i lartësuar ka thënë: ***“Të mjerët ata që mangët masin e peshojnë. Ata, që kur matin prej njerëzve, për vete e plotësojnë, e kur u matin të tjerëve ose u peshojnë, u lënë mangët. A nuk e dinë të tillët se kanë për t'u ringjallur? Në një ditë të madhe, në ditën kur njerëzit ngrihen (prej varrezave) për të dalë para Zotit të botëve.”***

Ndalesa e mashtrimit në peshojë me bazat e besimit është lidhur me Ditën e Gjykimit kur njerëzit ngrihen (prej varrezave) për të dalë para Zotit të botëve.

Largimi i thirrësit prej programit të saktë

Nganjëherë mund të ndodhë që thirrësi të largohet prej programit të saktë, duke mos u preokupuar për çështjet e besimit, vepron ashtu siç dëshirojnë njerëzit duke mos i obliguar ata me asgjë, si p.sh. trajtimi i çështjeve politike dhe shtjellimi i çështjeve larg koncepteve të besimit islam. Të gjitha këto thirrësi i bën me qëllim

që t'i kënaqë dëshirat e njerëzve dhe pasionin e tij. Ky është një program i gabuar, ngase thirrësi, në këtë rast, nuk u sjell asgjë të re njerëzve që ata nuk e njohin, por ata diskutojnë për atë çfarë thotë ai dhe çfarë pretendon. Në këtë rast thirrësi është larguar nga baza e sëmundjes dhe e ilaçit, d.m.th. është larguar nga besimi islam dhe domosdoshmëria e futjes së koncepteve të tij thellë në shpirtat e njerëzve. Prandaj, si rezultat i gjithë kësaj është se baza e sëmundjes dhe e ecjes në ndërtesë është sipërfaqësore dhe pa themel.

Çështjet universale e jo çështjet e pjesshme

Vazhdimisht baza e çështjes dhe kulmi i saj është theksimi i bazës-gjenezës së sëmundjes dhe ilaçit, andaj thirrësi e ka për obligim që të mos harxhojë mundin e tij në çështjet e pjesshme, edhe nëse në to ka pengesa për mbjelljen e koncepteve të besimit islam në shpirtin e njerëzve dhe në thirrjen e tij tek Allahu. Argumenti ynë për këtë çështje është se i Dërguari i Allahut salAllahu alejhi ue sel-lem i shihte idhujt, të cilët e ndotnin shtëpinë e Allahut (Qabenë), ndërsa i Dërguari i Allahut salAllahu alejhi ue sel-lem nuk e kishte ngritur dorën për t'i shkatërruar ata dhe as që i kishte urdhëruar shokët e tij që t'i thyenin ata, e sikur të dëshironte do të urdhëronte, e sikur të urdhëronte, atëherë myslimanët do ta zbatonin urdhrin. Mirëpo, i Dërguari i Allahut salAllahu alejhi ue sel-lem nuk kishte bërë asgjë për shkatërrimin e tyre, ngase atëherë nuk ishte çështja që të thyhen idhujt, por ishte me rëndësi që të thyhen drynat e zemrave, me qëllim që të kuptohej e vërteta, e më pastaj do të vinte dita kur do të thyheshin këta idhuj nga goditjet e myslimanëve. Pra, kjo ka ndodhur (thyerja e idhujve) në ditën e çlirimit të Mekës, ku vetë i Dërguari salAllahu alejhi ue sel-lem kishte dhënë shenjë kah idhujt me shkopin e tij duke thënë: ***“Vërtet, ka ardhur e vërteta dhe është shkatërruar e pavërteta dhe se pa dyshim e pavërteta ka qenë e shkatërruar”***, i hodhën idhujt në tokë të thyer e të shkatëruar.

Evitimi i dyshimeve

Esenca e dyshimeve?

Me dyshimin e kemi fjalën për atë që sjell dyshim në sinqeritetin e thirrësit dhe në të vërtetën e asaj për të cilën fton, duke penguar që të shihet e vërteta dhe përgjigjja ndaj saj, apo së paku të vonojë përgjigjen ndaj thirrjes islame. Në shumicën e rasteve dyshimi lidhet me traditat e trashëguara, apo për ndonjë interes, apo për pushtet të kësaj jete, apo për shkak të fanatizmit injorant. Prandaj, dyshimi për shkak të këtyre çështjeve ndikon në shpirtrat e dobët, e të cilët janë të lidhur me këto gjëra dhe të cilat janë si shkak dhe argument që t'i kundërvihen të vërtetës dhe t'i luftojnë thirrësit që ftojnë në fenë e Allahut të Lartësuar.

Burimi i dyshimeve

Në të shumtën e rasteve, paria janë ata që fusin dyshime, ua zbukurojnë ato njerëzve, i përhapin ato në mesin e njerëzve, ua përsërisin ato atyre që i dëgjojnë derisa të arrijnë që të ndikojnë te njerëzit mendje ngushtë dhe tek masa e rëndomtë e popullit. Paria janë ata që i përsërisin shpesh këto dyshime, e pastaj mundohen t'i paraqesin si të sakta e t'i shpjegojnë kinse janë të vërteta të pamohueshme dhe kështu pastaj ata fillojnë t'i mbrojnë ato e ta kundërshtojnë të vërtetën dhe ata që e ndjekin atë. Prej parisë ka që qeshen dhe tallen duke arritur ta realizojn atë që duan.

Nuk ka shpëtim prej dyshimeve dhe as që mund të ndryshohen ato

Le ta dijë thirrësi se ndikimi i dyshimeve, në aspektin e thirrjes tek Allahu, është çështje e vjetër, ligj i Allahut i zbatuar prej robërve, fenomen i trashëguar prej njerëzve mashtrues, andaj nuk befasohet prej tyre thirrësi e as që e ndien veten

ngushtë për to. Dyshimet në bazë nuk ndryshojnë, por ka mundësi të ndryshojë metoda dhe mënyra e tyre. Allahu i Lartësuar, kur i flet të Dërguarit të Tij Muhamedit s.a.v.s, i thotë kështu: ***“Ty nuk po të thuhet tjetër përveç asaj që u është thënë të dërguarve para teje. Vërtet, Zoti yt është ai që fal, po është edhe Ai që ndëshkon rëndë”***. Ajo që u është thënë të dërguarve fisnikë është e pavërteta e që për njerëzit ka qenë prej dyshimeve. Allahu i Lartësuar ka thënë: ***“Ja, ashtu pra, edhe atyre që ishin më parë nuk u erdhi i dërguar e që nuk i thanë: Është magjistar ose është i çmendur! A mos porositen njëri-tjetrin me këtë? Jo, por ata janë popull renegat.”*** Popujt para kurejshëve i akuzonin të dërguarit e Allahut si magjistarë dhe të çmendur, ndërsa po kështu kanë vepruar edhe kurejshët me qëllim që t’i largojnë njerëzit nga Muhamedi salAllahu alejhi ue sel-lem dhe nga thirrja e tij.

Kur thirrësi ta kuptojë këtë realitet dhe ta analizojë mirë, nga ai largohen befasia, hidhërimi dhe pezmi në rastet kur akuzohet rrejshëm dhe kur të hidhen dyshime rreth thirrjes së tij, ngase ai nuk mund të jetë më i mirë se të dërguarit e Allahut, as më i qartë në shpjegim se ata, e as më i sinqertë se ata, e as më i përkrahur prej Allahut se sa ata. Prandaj, me të gjitha këto që u përmenden prapëseprapë ithtarët e së pavërtetës kanë pasur ndikim me dyshimet e tyre, sikurse na ka treguar Allahu për ndodhitë e tyre. Pastaj, vërtet thirrësi, kur e kupton këtë realitet dhe e di se sa mund të ndikojë kjo në devijimin e njeriut sa që atë (njeriun) e bëjnë të atillë që ai t’i kundërshtojë të dërguarit e Allahut, të cilët duan ta shërojnë atë prej sëmundjeve dhe të shpëtojnë nga zjarri i Xhehenemit e ta fusin në xhenet. Në fund, njohja e këtyre çështjeve është e domosdoshme për çdo mysliman pa përjashtime, me qëllim që ai të dijë ta dallojë të keqen prej të mirës dhe që të mos ndikohet nga këto dyshime, të mos shkojë prapa tyre e që më pas të bëhen- pa e kuptuar se kush janë bërë-0 bashkë me armiqtë kundër thirrësve që ftojnë për në fenë e Allahut të Lartësuar.

Llojet e dyshimeve

Dyshimet janë të llojllojshme, prej tyre ka që ndërlidhen me thirrësin, ka që kanë të bëjnë me tematikën e thirrjes dhe ka që kanë të bëjnë me ata që ftohen të thirren në fenë e Allahut.

Ato dyshime që kanë të bëjnë me thirrësin realizohen duke cenuar personalitetin, biografinë dhe etikën e thirrësit dhe duke bërë trillime ndaj tij. Po ashtu këto dyshime bëhen edhe në atë mënyrë duke u cilësuar thirrësi si mendjelehtë, injorantë, i devijuar, i çmendur, trillues e shumë gjëra të tjera, me të cilat synohet që të largohen njerëzit prej tij dhe që të mos i besojnë atij.

Ato dyshime që kanë të bëjnë me vetë tematikën e thirrjes, realizohet duke duke akuzuar tematikën e thirrjes se kinse ajo është që po sjell risi, largim nga ato që janë adaptuar njerëzit dhe nga traditat e tyre të trashëguara. Prandaj, edhe me këtë si synim parësor është largimi i njerëzve nga thirrja tek Allahu dhe pengimi i tyre nga rruga e Tij.

Ato dyshime që kanë të bëjnë me të ftuarit në rrugën e Allahut manifestohen në atë mënyrë duke shprehur haptas se ata duan të mirën e tyre, fenë e tyre e të etërve, ruajtjen e begative të tyre dhe jetën e tyre të qetë. Edhe me këtë synohet që të nxiten njerëzit kundër thirrësve që ftojnë për në rrugën e Allahut të Lartësuar.

Qëndrimi i thirrësit ndaj këtyre qëndrimeve

Thirrësi përballë këtyre dyshimeve është i detyruar që ato t'i refuzojë, të paraqesë dobësinë dhe pavërtetësinë e tyre, ngase ato janë pengesa që pengojnë shikimin e të vërtetës për ata që janë të pafuqishëm në përceptimin e të vërtetës. Të tillat dyshime e pengojnë ndjesinë e sëmundjes dhe nevojën për shërim-ilaç. Evitimi i dyshimeve bëhet duke përdorur argumente të qarta dhe të shpjeguara në mënyrën më të mirë të shpjegimit, duke pasur edukatë gjatë diskutimit dhe duke folur fjalë të buta, pa u provokuar thirrësi prej gënjeshtreve të trillueseve dhe që të mos hidhërohet për shkak të tyre, e më pastaj të flasë edhe atë që nuk lejohet. Ne e dimë se kjo është një çështje e vështirë për vetë thirrësin, por ai patjetër duhet të veprojë kështu, se nuk ka rrugëdalje tjetër dhe se kjo do të jetë e lehtë, nëse do Allahu duke kërkuar mbështetje tek Allahu dhe duke ditur se do të shpërblehet tek Allahu për çdo mundim. Vërtet detyra e thirrësit është që t'i evitojë dhe t'i mënjanojë dyshimet është e ngjashme me atë të një mjeku të ditur e këshillues i butë, i cili nuk provokohet nga zhurma e të sëmurëve dhe mungesa e dëshirës që ta shohin atë, jo vetëm kaq, por atë s'e pengon sharja dhe ofendimi i pandërprerë gjatë trajtimit të sëmurëve, ngase ai e di se këto çështje janë disa nga simptomat e

të sëmurëve. Mjeku në këtë rast dëshiron shërimin e të sëmurëve, e jo hakmarrje ndaj tyre.

Metodën e mirë për evitimin e dyshimeve thirrësi e kupton prej tregimeve dhe qëndrimeve të të Dërguarve të Allahut ndaj dyshimeve që i kanë manifestuar trilluesit. Për këtë do t'i shkruajmë disa rreshta me qëllimi të shpjegimit të kësaj çështje si vijon.

Shembuj për kundërshtimin e dyshimeve të ithtarëve të pavërtetës dhe reagimi ndaj tyre

Shpifja kundër thirrëseve

Paria dhe ithtarët e tyre kanë dëshirë që t'i largojnë njerëzit prej thirrëseve që Ftojnë në fenë e Allahut, duke bërë shpifje ndaj personalitetit, besnikërisë dhe mendimeve të tyre. Kështu kanë vepruar ata që ishin më herët ndaj të dërguarve të Allahut duke i akuzuar ata se janë magjistarë, të çmendur dhe të devijuar. Allahu i Lartësuar ka thënë: ***“Ja ashtu pra, edhe atyre që ishin më parë nuk u erdhi i dërguar e që nuk i thanë: Është magjistar ose është i çmendur! A mos e porositën njëri tjetrin me këtë? Jo, por ata janë popull renegat”***. Politeistët arabë për të Dërguarin tonë Muhamedin salAllahu alejhi ue sel-lem kanë thënë: ***“Ata (idhujtarët) habiten, ngase u erdhi pejgamberi nga mesi i tyre, kurse mosbesimtarët thanë: Ky është magjistarë, rrenës.”*** Të dërguarit e Allahut ishin ata që reagonin ndaj këtyre trillimeve dhe i evitonin të gjitha dyshimet që lindnin prej tyre, duke i mohuar ato për veten e tyre në mënyrën dhe metodën më të lartë dhe të mirë të mundshme dhe duke u sjellë me butësi ndaj këtyre trillueseve. Allahu i Lartësuar përmend trillimet që i kanë bërë populli i Nuhit dhe mënyrë e reagimit të Nuhit a.s. ndaj tyre: ***“Paria nga popullit tij tha: Ne po të shohim (në këtë që na thërret) plotësisht të humbur! (Nuhu) Tha: O populli im, unë nuk kam kurrfarë humbjeje, por une jam i dërguar prej Zotit të botëve! Unë jua kumtoj juve shpalljet e Zotit tim, ju këshilloj dhe unë di nga Zoti im çka ju nuk dini! A mos u çuditët që shpallja ju erdhi nga Zoti juaj përmes (gjuhës së) një njeriu nga mesi juaj, për tjua tërhequr vërejtjen që të ruheni dhe ashtu të shpëtoni!”***

Ajo që duhet të potencohet gjatë reagimit të Nuhut a.s. është se ai, duke biseduar me ta, u drejtohet atyre me shprehjen “O populli im”, ngase këta janë populli i tij dhe se ai nuk disrancohet nga ajo se edhe ai u përket atyre. Kështu është shprehur Nuhu a.s. vetëm e vetëm që ta këtë më lehtë për të penguar këmbëngulësinë e popullit të tij në të pavërtetën, e më pastaj ai u ka shpjeguar atyre atë se ai nuk është njeri i devijuar, sikurse pretendojnë ata, ngase ata e përgënjeshtrojnë apo e injoronin, prandaj prej tyre kërkonte që ata të largoheshin nga përgënjeshtrimi dhe injorimi që ia bënin atij, e më pastaj ai ua shpjegonte realitetin e çështjes së tij, duke i informuar ata se ai është i Dërguari i Allahut dhe se të dërguarit e Allahut janë të sinqertë në atë që e thonë dhe e transmetojnë prej Allahut të Lartësuar. E pastaj ua shpjegon atyre se ajo që dëshiron ai është transmetimi i mesazhit të Allahut, i këshillon ata dhe ua do të mirën atyre dhe se ai i di gjërat prej Allahut që ata nuk i dinë dhe se e drejta e këshilluesit është që ai të dëgjohet e të respektohet. E mandej ua shpjegon atyre se nuk ka arsye që ata të çuditen për shkak se Allahu i Lartësuar e ka shpallur mesazhin e Tij te një njeri prej mesit të tyre e të cilin e njohin dhe se ky ua tërheq vërejtjen për përfundimin e tyre, i fton ata që t’ia kenë frikën Zotit- Krijuesit të tyre e që ndoshta ata do t’i përfshijë mëshira e Allahut si në këtë botë ashtu edhe në botën tjetër.

Me të njëjtën metodë shumë efektive ka reaguar edhe Hudi a.s. ndaj trillimeve dhe dyshimeve që ia kanë shprehur populli i tij. Allahu i Lartësuar ka thënë: ***“Edhe te (populli) Adi (dërguam) vëllanë e tyre Hudin, ndërsa ai tha: O populli im, adhurojeni (një Zot) Allahun, ju nuk keni zot pos Tij, a nuk po frikësoheni?! Paria që nuk besoi nga populli i tij tha: Ne po të shohim mendjelehtë dhe të konsiderojmë vërtet rrenacak.! Tha (Hudi): O populli im, nuk jam mendjelehtë (nuk kam të meta mendore), por unë jam i dërguar prej Zotit të botëve. (Jam i dërguar) Që t’jua komunikoj shpalljet e Zotit tim dhe unë jam këshillues besnik për ju. A mos ju erdhi çudi që ju erdhi shpallja nga Zoti juaj përmes një njeriu nga mesi juaj, e për t’jua tërhequr vërejtjen”***.

Shkaktimi i trazirave në tokë dhe të kërkuarit pushtet ndaj njerëzve

Prej dyshimeve të tyre që i hedhin ndaj thirrësit është edhe ajo se thirrësi dëshiron pushtet në tokë ndaj njerëzve, t’ua ndërrojë atyre besimin dhe traditat trashëguara, se ajo që sjellin ata është një risi e dëmshme, një thirrje që shkakton përçarje të

atillë, e cila më herët nuk është dëgjuar dhe se kjo thirrje sjell trazira në tokë, andaj duhet rezistuar ndaj thirrësit e thirrjes së tij dhe se duhet penguar vazhdimësinë e thirrjes së tij. Allahu i Lartësuar, kur e tregon ndodhinë e popullit të Nuhut a.s., ndodhinë e popullit Ad dhe Themud dhe atë se çfarë u kanë thënë ata të dërguarve të Allahut dhe se si u janë përgjigjur atyre, si kanë shpifur ndaj tyre dyshime të rrejshme: ***“...Ata thanë: ju nuk jeni tjetër pos njerëz siç jemi edhe ne, ju dëshironi të na pengoni nga ajo që adhuronin prindërit tanë, pra na sillni ndonjë argument të qartë! Të dërguarit e tyre u thanë: Ne nuk jemi tjetër veçse njerëz si edhe ju, por Allahu i jep dhuratë kujt të dojë nga robërit e vet. Neve nuk na takon t’jua sjellim ndonjë argument, vetëm me dëshirën e Allahut, pra besimtarët le t’i mhështeten vetëm Allahut”.***; ***“E kur u lexoheshin atyre ajetet tona të qarta, ata thoshin: Ky nuk është tjetër vetëm se njeri, i cili dëshiron tju shmangë nga ajo që adhuronin prindërit tuaj dhe thoshin: Ky (Kurani) nuk është tjetër veçse gënjeshtër e trilluar! Madje, ata që nuk besuan të vërtetën, pasi ajo u erdhi, i thanë: Kjo (Muhamed, feja islame, Kurani) nuk është tjetër veçse magji e qartë!”*** Paria fusin te njerëzit dyshimin se duhet lakmuar në imitim e fesë së etërve dhe se të Dërguarit e Allahut duan që ata t’i largojnë prej fesë së tyre. Allahu i Lartësuar për popullin Nuhut a.s. thotë: ***“E paria e atij populli që nuk besuan thanë: Ky nuk është tjetër pos njeri sikurse edhe ju, po dëshiron të jetë më i lartë se ju. Po të dëshironte Allahu do të dërgonte melaqe; ne një gjë të tillë nuk e kemi degjuar as nga të parët tanë!”*** Populli i Nuhut a.s. pretendonin se Nuhu a.s. dëshironte të arrinte pozitë të lartë, pushtet ndaj tyre dhe të vlerësonte lart veten e tij me ftesën e tij. Kjo ishte ngase ithtarët e të pavërtetës i vlerësonin ithtarët e të vërtetës me peshojën e tyre të gjymtë, duke llogaritur atë se thirrësit në fenë e Allahut e kanë të njëjtin qëllim, sikurse e kanë edhe ithtarët e të pavërtetës, duke kërkuar lartësim në tokë dhe pushtet ndaj njerëzve. Faraoni dhe paria e tij i kishin thënë Musait a.s.: ***“Ata thanë: Mos erdhe të na largosh nga ajo (feja) që e gjetëm te prindërit tanë, për tju mbetur juve dyve madhështia në tokë? Po ne nuk ju besojmë juve dyve.”*** Më pastaj populli i Nuhut argumenton mospranimin e Nuhut si të Dërguar të Allahut për shkak se ai është njeri sikurse ata, andaj sikur të donte Allahu që të shpallte diçka këtë do ta shpallte me anë të melaqeve. Të njëjtin dyshim e kanë përhapur edhe fisi kurejsh. Allahu i Lartësuar ka thënë: ***“E pastaj thanë: Pse të mos i zbresë atij(Muhamedit) një melaqe (të na thotë për Muhamedin se është i dërguar). E sikur të zbritnim Ne një melaqe, çështja do të merrte fund duke mos u dhënë atyre afat. Sikur ta bënim Ne atë (të dërguarin) melaqe, atë do ta bënim (në formë) njeriu e do t’ua perzienim (ngatërronim) atyre atë që i perzien ata vetes së tyre. ”*** D.m.th. sikur Allahu ta

zbriste të dërguarin melaqe, atë do ta bënte në formën e njeriut derisa ta kryente misionin, por edhe në këtë rast ata do ta shpalosnin të njëjtin dyshim.

Allahu i Lartësuar, kur e tregon ndodhinë e Musait a.s., thotë: ***“Të parët nga populli i faraonit thanë: A do ta lejosh Musain dhe popullin e tij të bëjë përçarje në tokë dhe të braktisin ty dhe zotat e tu? Ai (faraoni) tha: Do t’ua mbysim djemtë e do t’i lëmë të gjalla gratë e tyre për shërbim, ne jemi dominues mbi ta. Popullit të vet Musai i tha: Kërkoni ndihmë prej Allahut dhe kini durim. S’ka dyshim se toka është e Allahut, ia lë në trashëgim atij që do nga robërit e tij, e ardhmja e lumtur është për të devotshmit”.***

Paria e nxit popullin e faraonit kundër Musait a.s. duke propaganduar se Musai dëshiron trazira në tokë, andaj nuk duhet të lejuar atë që ta vazhdojë thirrjen e tij. Gjithashtu, ata kanë dashur që me këtë dyshim të kotë ta arsyetojnë dënimin që duhet dhënë Musait dhe besimtarëve që e ndjekin atë e, në të njëjtën kohë, të kenë përkrahje nga ithtarët e tyre të devijuar. Tjetra është se ky pretendim i tyre ka bërë që faraoni të vendoste për t’i mbytur ithtarët e Musait, i cili u thoshte ithtarëve të tij besimtarë që të kërkojnë ndihmë prej Allahut duke duruar dhe se përfundimi i të devotshmëve gjithmonë është përfundim i mirë. Ndërsa përgjigjen e Musait a.s. dhënë faraonit për dyshimet që kishin trilluar ata kundër tij i ka shpjeguar Allahu i Lartësuar në disa ajete tjera, si: ***“Musai tha: O faraon, s’ka dyshim, unë jam i dërguar prej Zotit të botëve. është dinjitet për mua ta them për Allahun vetëm të vërtetën. Unë ju kam ardhur me argumente nga Zoti juaj...”***

Allahu i Lartësuar ka thënë: ***“Ja, pra, Ne kemi dërguar para teje pejgamber në ndonjë vendbanim, që të mos i ketë thënë paria pasanike e tij: Ne i gjetëm të parët tanë në këtë fe dhe ne jemi të orientuar gjurmëve të tyre. Ai tha: A edhe nëse ju kam sjellë rrugë më të mirë nga ajo në të cilën i gjetët të parët tuaj? Ata thanë: Ne nuk i besojmë asaj me çka ju jeni dërguar!”*** Paria i nxisnin njerëzit që të imitojnë besimin e të parëve të tyre dhe, pos kësaj, kërkonin që t’i bëhej rezistencë thirrjes që fton për tek Allahu i Lartësuar. Ndërkaq, të Dërguarit e Allahut reagojnë ndaj tyre me një logjikë të shëndoshë: ***“A edhe nëse ju kam sjellë rrugë më të mirë nga ajo në të cilën i gjetët të parët tuaj?”*** D.m.th. e vërteta është obligim që të ndiqet, edhe po qe se ajo vjen në kundërshtim me të parët e tyre dhe se e vërteta është ajo që jua kam sjellë prej Zotit tuaj, andaj shikojeni dhe krahasojeni me atë që e keni në mesin tuaj, atëherë do t’ju bëhet e qartë se ajo që po ju them është e saktë. E nga ky reagim, ithtarët e të pavërtetës nuk kanë çfarë të thonë, pos që deklarohen se e mohojnë atë që u është sjellë atyre.

Akuzimi i thirrëseve se kinse thirrja e tyre është e lidhur me mitologjitë e mëhershme

Prej metodave të atyre që shpifin të pavërteta dhe sjellin dyshime për thirrësin është edhe supozimi i tyre se thirrësi në fenë e Allahut është i lidhur me njerëz të caktuar, të cilit i ndihmojnë për ta zbatuar thirrjen e tij dhe se thirrja e tij nuk ka kurrfarë lidhjeje me fenë dhe Allahun, por thirrja e tij është e lidhur me legjendat e hershme dhe se me këtë synon të arrijë atë që e dëshirojnë ata që e kanë ndihmuar. Allahu i Lartësuar na tregon se edhe kurejshët kanë bërë shpifje të tilla rreth thirrjes islame dhe të Dërguarit të Allahut salAllahu alejhi ue sel-lem: ***“Dhe ata që nuk besuan, thanë: Ky (Kurani) nuk është tjetër vetëm se një gënjeshtër, që e trilloi ai (Muhamedi), të cilit i ndihmuar edhe njerëz të tjerë. Pra, ata (idhujtarët) bënë shtrembërim e shpifje. Edhe thanë: (për Kuranin) janë legjenda të të parëve, që ai (Muhamedi) kërkoi t'i shkruheshin ato, e t'i lexoheshin mëngjes e mbrëmje ”***

Thirrësi është një njeri i pafamë

Prej dyshimeve të tyre është edhe ajo se sipas tyre thirrësi është një njeri i pafamë dhe krejtësisht i parëndësishëm, nuk është prej atyre që janë shumë të arsimuar, nuk është as prej të pasurve të njohur, nuk ka pozitë e as famë në mesin e shoqërisë. Ata në këtë mënyrë e radhitin veten ndër ata që janë më meritore për çdo të mirë dhe për çdo ftesë për përmirësim, andaj sikur thirrësi vërtet të thërrasë në diçka që është e mirë dhe e vërtetë, patjetër ai do të ishte prej njerëzve që kanë famë në shoqëri. Allahu i Lartësuar tregon atë se çfarë i kanë thënë politeistët arabë zotërisë tonë Muhamedit salAllahu alejhi ue sel-lem: ***“Pastaj thanë: Përse të mos i ketë zbritur ky Kuran një njeriu të madh nga dy qytete? A thua ata e përcaktojnë mëshirën (pejgamberinë) e Zotit tënd? Ne kemi përcaktuar ndër ta gjendjen e jetës në këtë botë; Ne kemi dalluar disa në shkallë më të lartë se të tjerët, që të shfrytëzojnë njëri-tjetrin për shërbime. E mëshira (caktimi për pejgamber) e Zotit tënd është shumë më e dobishme se ajo që ata grumbullojnë.”*** Allahu më së miri e di se kujt t'ia zbresë shpalljen, ngase Ai është më i dituri dhe

më i urti. Allahu i Lartësuar ka thënë: ***“Ata thoshin: Ne kemi më shumë pasuri e fëmijë, e ne nuk do të jemi të ndëshkuar. Thuaj: Allahu ia shumon begatinë atij që do, e edhe ia pakëson, por shumica e njerëzve nuk e dinë. Nuk është as pasuria juaj, e as fëmijët tuaj ajo që ju afron pranë Nesh, është vetëm besimi dhe veprat e mira; të tillët shpërblehen shumëfish për atë që vepruan dhe ata janë në dhoma të larta të shpëtuar. Ndërkaq, ata që përpiqen t’i mposhtin argumentet Tona, të tillët janë të dënuar.”*** Ithtarët e të pavërtetës mundohen të mbrohen me atë se kanë shumë pasuri, kanë shumë fëmijë dhe shumë ndihmës se ata janë më meritore për të ftuar në atë që është e mirë dhe se për këtë ata janë të shpëtuar prej dënimit. Mirëpo, Kurani i Madhërisëm ua shpjegon atyre faktin se Allahu i jep furnizim kujt të dojë dhe se nuk i jep për ndonjë urtësi të madhe dhe se pasuria e fëmijët nuk e afrojnë njeriun tek Allahu, por veprat e mira janë ato që e afrojnë njeriun tek Allahu i Lartësuar.

Ithtarët e thirrësit janë njerëz po famë

Prej dyshimeve që i shprehin rreth thirrjes është edhe ajo se ithtarët e thirrësit janë njerëz pa famë, të varfër, injorantë, punëtor të zanateve të nënçmuara, dritëshkurtër dhe se thirrësit dhe ithtarët e tyre nuk meritojnë që t’i udhëzojnë njerëzit në punë të mira e në udhëzim dhe se gjithë këtë e meritojnë vetëm paria, se këta janë meritore për t’i ftuar njerëzit në punë të mira dhe se këta nuk mund të jenë ithtarë të thirrësit të fesë së Allahut, ngase janë njerëz të meditimit e të rezonimit për dallim nga të varfrit, të cilët i ndjekin thirrësit e fesë pa kurrfarë analize e argumenti. Allahu i Lartësuar për popullin e Nuhut a.s. tregon: ***“Paria që nuk besoi nga populli i tij tha: Ne nuk të shohim ndryshe veçse si njeri, sikurse edhe ne nuk po shohim se të pasoi kush, përveç atyre që janë më të poshtrit e më mendjelehtit nga mesi ynë dhe ne nuk shohim se ju keni ndonjë vlerë mbi ne; përkundrazi, ne ju konsiderojmë gënjeshtarë!”*** Ashtu siç tregon Allahu, Nuhu a.s. iu përgjigj atyre duke u thënë kështu: ***“(Nuhu) Tha: O populli im, më thoni nëse unë jam i mbështetur në argument të qartë nga Zoti im dhe Ai më dha mëshirë nga ana e Tij, e juve ju janë fshehur ato (argumentet ngase jeni dhënë pas kësaj jete), a mos do tju detyrojmë për to (pranimin e tyre), kur ju jeni urrejtës të tyre! O populli im, unë për këtë nuk kërkoj prej jush ndonjë pasuri, shperblimi im është vetëm tek Allahu. Dhe unë kurrsesi nuk i largoj ata që besuan, ata janë afër Zotit të tyre; por unë ju shoh si popull që nuk dini e nuk kuptoni. O populli im, a***

nuk po mendoni se nëse unë i përzë ata, kush do të më mbrojë mua nga Allahu (dënimi i Tij)? Unë nuk ju them juve se tek unë janë depot e Allahut, as nuk ju them se unë e di të fshehtë, as nuk ju them se unë jam engjëll as nuk u them atyre që sytë tuaj i nënçmojnë, se Allahu nuk u dhuroi atyre të mira. Allahu e di më së miri se çfarë ka në shpirtrat e tyre, sepse atëherë unë konsiderohem zullumqar.”

Nuhu a.s. ua shpjegon atyre, duke u bazuar në argumentin që ia ka sjellë Zoti në mënyrë shumë të qartë se vërtet ai është i dërguar i Allahut. Kur kjo çështje për ju është e paqartë dhe se ju nuk jeni udhëzuar dhe keni nxituar për ta përgënjeshtuar atë, atëherë si t’ju detyrojmë juve që ta pranoni thirrjen islame. Prandaj, çështja e pranimit të thirrjes islame është se ajo duhet pranohet pa presion, ngase në fe janë ndaluar presioni dhe dhuna. Ndërkaq, sa u përket ithtarëve të Nuhut a.s., e të cilët ishin të varfër dhe të dobët. Nuhu a.s. thotë se ai është i dërguar i Allahut dhe sei ai i thërret njerëzit për ta adhuruar vetëm Allahun, nuk ka dallim në thirrjen ndërmjet atij që ka famë dhe atij që nuk ka {amë, nuk ka dallim ndërmjet të pasurit dhe të varfrit. Pra, që të gjithë ata janë meritore që të ftohen, andaj kush i është përgjigjur atij, ai e ka pranuar atë dhe kurrsesi nuk mund t’i përzërë nga tubimi i tij pse ata janë të varfër e të dobët, ndërsa ata që kanë famë refuzojnë që të rrinë në një mexhlis me njerëzit që janë të dobët. Po ashtu, nuki lejohet atij që t’iu thotë atyre se nuk kanë shpërblim për veprat e tyre, sepse ata kanë besuar në shpalljen e Allahut, e Allahu e di më së miri se çfarë ka në shpirtrat e tyre.

Realiteti është se ithtarët e të pavërtetës - e veçanërisht paria e tyre - ndihen ngushtë kur në mesin e tyre janë të varfrit e të dobëtit dhe se ata nuk duan që të jenë bashkë me ta si ithtarë të thirrësve që ftojnë për në fenë e Allahut, prandaj për këtë kërkojnë që prej mexhlisit të tyre të largohen të dobëtit dhe të varfrit. Në të njëjtën mënyrë kanë vepruar edhe kurejshët, këta kishin kërkuar prej të Dërguarit të Allahut që t’i përzërë të dobëtit dhe varfrit nga mexhlisi i tij. Allahu e zbriti këtë ajet: **“Përkufizojë veten tënde me ata që lusin Zotin e tyre mëngjes e mbrëmje, e që kanë për qëllim kënaqësinë (razinë) e Tij dhe mos i hiq sytë e tu prej tyre e ta kërkosh bukurinë e kësaj bote dhe mos iu bind atij që ia kemi larguar zemrën prej përkujtimit ndaj Nesh dhe i është dhënë epshit të vet, sepse puna e tij ka mbaruar”**. Nuk lejohet të ndiqen ata që pasojnë hamendjen dhe zemrat e të cilëve janë indiferente ndaj përmendjes së Allahut, e të cilët kërkojnë që të largohen prej mexhlisit besimtarët e sinqertë, por që janë të varfër dhe të dobët.

Këto janë disa prej dyshimeve që i parashtrojnë ithtarët e të pavërtetës, rastin e të cilëve e ka përmendur Allahu i Lartësuar në tregimin e të dërguarve në Kuranin Madhështor. Të gjitha këto bashkohen në një e kjo është; akuzimi i thirrësit dhe thirrjes dhe në të njëjtën kohë është edhe nxitja e mendjelehtëve dhe e masës së rëndomtë për ta luftuar thirrjen islame me qëllim që t'i mbetet rruga e hapur për parinë jobesimtare që ata të qëndrojnë në mendimet e tyre të pavërteta dhe të në njëjtën kohë t'i sundojnë njerëzit.

Largimi i thirrësit prej dyshimeve

Pasi që ithtarët e të pavërtetës parashtrojnë dyshime dhe bëjnë trillime të rrejshme për thirrjen islame dhe kundër thirrësit, thirrësi e ka për obligim që të largohet prej të gjitha vendeve të dyshimta, me qëllim që të mos iu japë mundësi trilluesve që të shpifin diçka për të. Kurani Fisnik e vërteton atë se doemos duhet larguar prej vendeve ku mund t'iu jepet hapësirë trillueseve që të shprehin ndonjë trillim dhe dyshim. Prej argumenteve kuranore lidhur me këtë materie janë:

1. Të gjithë të dërguarit e Allahut u thonë popujve të tyre: ne nuk duam pagesë për thirrjen tonë, nuk duam as shpërblim, ngase shpërblimi ynë është vetëm prej Allahut. Allahu i lartësuar tregon se Nuhu a.s. i ka thënë popullit të tij: ***“O populli im, unë për këtë nuk kërkoj prej jush ndonjë pasuri, shpërblimi im është vetëm tek All-llahu. Dhe unë kurrsesi nuk i largoj ata që besuan, ata janë afër Zotit të tyre; por unë ju shoh si popull që nuk dini e nuk kuptoni”*** Po ashtu Allahu i Lartësuar tregon se si Muhamedi salAllahu alejhi ue sel-lem i ka thënë popullit të tij: “Thuaj: “Unë nuk kërkoja prej jush ndonjë shpërblim, nëse kam kërkuar; ai le t’ju mbetet juve, shpërblimi im është vetëm prej Allahut”.⁹⁰⁸ Ajo që argumentohet prej këtij ajeti, i atij që u përmend më herët dhe i ajeteve të tjera të ngjashme me të është se, sikur të dërguarit e Allahut të kërkonin pasuri apo shpërblim për thirrjen e tyre, atëherë ithtarët e të pavërtetës do të kapeshin për këtë dhe kështu do t’i pengonin nga thirrja në fenë e Allahut dhe nga thirrësit duke thënë se vërtet këta janë ata që po kërkojnë pasuri...

2. Allahu i Lartësuar ka thënë: ***“Ti (Muhamed) nuk ishe që lexon ndonjë libër para këtij, e as që shkruaje me dorën tënde të djathtë; pse atëherë do të dyshonin ata të prishurit.”*** Ajo që argumentohet me këtë ajet është se Allahu i Lartësuar e kishte larguar të Dërguarin e Tij salAllahu alejhi ue sel-lem nga mësimi i shkrimit

dhe leximit me qëllim që ta mbrojë atë nga trillimet e njerëzve të prishur, të cilët pretendojnë se atë që po e sjell ai (Muhamedi a.s.) është rezultat i asaj që kanë mësuar prej librave të vjetër fetarë dhe kopjim prej tyre. Po ashtu, mund të thuhet se thirrësi ka mundësi t'i braktisë disa punë të dobishme vetëm e vetëm që ta mbrohet prej dyshimeve të pavërteta, prandaj, pa dyshim, mësimi i shkrim leximit është i dobishëm, por mbrojtja prej dyshimit të kotë është më shumë e dobishme, andaj për këtë i jepet përparësi mbrojtjes prej të keqes ndaj bërjes së një veprë që është e dobishme.

3. Allahu i Lartësuar ka thënë: “*Thuaj: Sikur të kishte dashur Allahu, unë nuk do t’jua kisha lexuar juve atë, as ju kisha njoftuar me të. Unë para tij kam jetuar një kohë në mesin tuaj (as nuk kam ditur, as nuk kam lexuar), a nuk mendoni?*”

Ajo që argumentohet me këtë ajet është se të Dërguarit të Allahut, Muhamedit a.s., nuk i ka ardhur shpallje para se t'i mbushte dyzet vjet, e kjo është bërë me të vetmin qëllim që të mbrohet nga dyshimet dhe fjalët që i shprehin ithtarët e të pavërtetës. I Dërguari i Allahut të Lartësuar ka qëndruar një kohë të gjatë në mesin e popullit, e kanë sprovuar atë, e kanë njohur biografinë e tij të bukur, moralin e tij të lartë, besnikërinë e tij, sinqeritetin e tij dhe se nuk është e logjikshme që ai, pas kësaj moshe të madhe, të shpifë gënjeshtër se si po i vjen shpallja prej Allahut. Pasi që çështja është e tillë dhe se sinqeriteti i tij është i haptë, andaj pretendimi i jobesimtarëve se ai është magjistar, apo i çmendur apo gënjeshtar është një pretendim i kotë dhe dyshim i hedhur poshtë. Këtu mund të themi atë që kemi thënë më herët se mbrojtja prej dyshimit i paraprin bërjes së ndonjë veprë që është e dobishme, andaj për këtë të Dërguarit salAllahu alejhi ue sel-lem i kaloi pjesa më e madhe e jetës derisa i erdhi shpallja. Pa dyshim, se po t'i vinte shpallja para moshës dyzetvjeçare do të kishte mundësi që të bënte më shumë thirrje tek Allahu, por urtësia e Allahut është ajo që Ai ka dashur që të mos të vijë shpallja para të dyzetave, edhe pse disa të mira mund të kalojnë për shkak të vonesës së shpalljes. Kjo është bërë me qëllim që të mbrohet prej dyshimeve dhe trillimeve që i bëjnë ithtarët e të pavërtetës, sikurse është shpjeguar qartë në ajetin Esnik Kështu, thirrësi, i cili është jurist i shariatit, e ka për obligim që t'i braktisë disa punë të dobishme me të vetmin qëllim që t'i mënjanojë dyshimet e trillueseve dhe t'i largojë dëmet që mund të shkaktohen nga këto dyshime. Shkak i gjithë kësaj është fakti se kur dyshimi përhapet në mesin e njerëzve patjetër do të lërë gjurmë tek ata, e posaçërisht tek ata që janë të dobët në besim dhe injorantë, kurse tjetra është se pasi të përhapen dyshimet është shumë vështirë të eliminohen pasojat e tyre. Pra, çdo gjëje që e pengon paraqitjen e dyshimeve thirrësi duhet t'i kushtojë vëmendje,

t'i bëjë ato gjëra për t'i penguar dyshimet, edhe nëse disa punë të mira i braktis vetëm për këtë arsye. Rregulli i sheriatit thotë: “Pengimi i të këqijave është më parësor sesa bërja e veprave të mira”. Pra, duhet bërë ndërmjet dy të këqijave ajo që është më pak e dëmshme.

4. Allahu i Lartësuar ka thënë për të Dërguarin tonë fisnik-Muhamedin s.a.v.s *“Ne as nuk ia mësuam atij (Muhamedit) poezinë, e as që i takon ajo atij, ai (Kurani) nuk është tjetër veçse këshillë dhe Kuran i qarte.”* Allahu i Lartësuar e ka penguar të Dërguarin e Tij që të mësojë poezinë dhe thurjen e saj, me të vetmin qëllim që trilluesit të mos e marrin si shkas për të sajuar dyshime rreth shpalljes së Kuranit.

Realiteti faktik është se thirrësit në fenë e Allahut kanë më shumë nevojë se të tjerët që të largohen prej shumë gjërave të lejuara, me anë të të cilave trilluesit mund të thurin dyshime të kota me të cilat ndikojnë që të pengohet nga rruga e Allahut. Po ashtu, duhet kushtuar kujdes asaj që duhet doemos të bëhet nëpërmjet të cilës largohet dyshimi dhe se kjo është një mënyrë e thirrjes, edhe nëse mendon se kjo është një dyshim. Pra, ky është një veprim shumë i përpiktë që, në të shumtën e rasteve, bëhet gabim dhe se kjo ka nevojë për një shpjegim të hollësishëm. Këtu mjafton ta themi edhe këtë: I jepet mundësia thirrësit që të braktisë diçka të lejuar e që ka të bëjë posaçërisht me të, vetëm e vetëm që ta evitojë dyshimin, e që kjo braktisje e veprimit nganjëherë mund të jetë i obliguar (vaxhib) e nganjëherë i rekomanduar (mendub). Ndërkaq, thirrësit nuk i jepet hapësira që ta braktisë atë që ka të bëjë me vetë thirrjen, apo që ka të bëjë me vetë programin dhe mënyrën e thirrjes. Pra, si shembull për këtë, po përmendim: Nuk lejohet që të braktiset thirrja e prijësit me argumentin se me këtë veprim po largohet evitohet dyshimi se njerëzit do të thonë se thirrësi është bërë mik i prijësit apo lajkatar i tij.

Inkurajimi për vepra të mira dhe kërcënimi prej veprave të këqija (Et-Tergibu ve Terhibu)

Kupfimi i shprehjeve terhib dhe terhib

Me shprehjen ***tergib*** ne kemi për qëllim çdo gjë që e inkurajon në thirrurin që t'i përgjigjet thirrjes islame, ta pranojë të vërtetën dhe tëj etë këmbëngulës tërësisht në të. Nderkaq, me shprehjen ***terhib*** e kemi fjalën për çdo gjë që e frikëson dhe ia tërheq vërejtjen të thirrurit që të mos bëhet prej atyre që e refuzojnë të vërtetën, apo të mos bëhet prej atyre që nuk janë stabil pasi ta pranojnë atë. Duhet pasur parasysh faktin se Kurani Fisnik është përplot ajete, me të cilat i inkurajon njerëzit për ta pranuar thirrjen islame dhe ajete që ua tërheqin vërejtjen atyre që të mos e refuzojnë atë. Ajetet që e argumentojnë rëndësinë e kësaj metode të thirrjes islame janë ajetet që e kanë formën e argumentimit të prerë, d.m.th. këtu është fjala për ***tergibin*** dhe ***terhibin*** në thirrjen islame dhe që thirrësi mysliman kurrsesi të mos tregojë neglizhencë ndaj kësaj thirrjeje.

Me çka duhet realizuar metodën e terhibit dhe terhibit?

Në esencë terhibi është ai me të cilin arrihet kënaqësia e Allahut, mëshira e Tij dhe shpërblimi në botën tjetër. Nderkaq, baza e terhibit është të frikësuarit e njeriut nga hidhërimi i Allahut dhe dënimi i Tij në botën tjetër. Ky, pra, është programi i të dërguarve të Allahut ashtu si e kanë shpjeguar Kurani Fisnik dhe suneti i të Dërguarit salAllahu alejhi ue sel-lem

Prej ajeteve që përmendin këtë metodë të thirrjes janë këto:

1. Përmendet në Kuran se Nuhu a.s. ka thënë: ***“A mos u çuditët që shpallja ju erdhi nga Zoti juaj përmes (gjuhës së) një njeriu nga mesi juaj, për t'jua tërhequr vërejtjen që të ruheni dhe ashtu të shpëtoni!”***

2. Po ashtu përmendet se Nuhu a.s. ka thënë: ***“Ne e dërguam Nuhun te populli i vet (dhe i thamë): Tërhiqja vërejtjen popullit tënd para se ata t'i godas dënimi i rëndë! Ai tha: O populli im, unë jam i dërguar te ju, jam i qartë. Adhurojeni***

Allahun, kini frikë prej Tij dhe më dëgjoni. Ai ju fal nga gjynahet tuaja dhe jua vazhdon jetën deri në një afat të caktuar (pa ju dënuar), e kur të vijë afati i caktuar prej Allahut ai nuk shtyhet për më vonë nëse jeni që e dini”

3. Allahu i Lartësuar për Dërguarin e Tij, Muhamedin s.a.v.s, përmend në Kuran: ***“Atëherë, pranojeni Allahun, të Dërguarin e Tij dhe dritën që e zbritëm Ne. Allahu është i njoftuar për atë që bëni. Ditën e kiametit, kur Ai ju tubon, ajo është ditë e mashtrimit (ditën e kiametit duket se kush është mashtruar). Kush beson Allahun dhe bën vepra të mira. Ai ia shlyen të kqijat e tij dhe atë e fut në xhenete, nëpër të cilat rrjedhin lumenj aty do të jenë përgjithmonë, e ai është shpëtimi i madh.”***

4. ***“Ata që besuan dhe bënë vepra të mira Allahu do t'i shtjerë në xhenete nëpër të cilat rrjedhin lumenj, e ata që nuk besuan. përjetojnë kënaqësi (në këtë jetë) dhe hanë ashtu si hanë kafshët, e vendi i tyre është zjarri.”***

5. Në sunetin e të Dërguarit salAllahu alejhi ue sel-lem theksohet se si i Dërguari Allahut ua kishte premtuar xhenetin atyre që ia kishin dhënë besën, siç ishte rasti me besatimin e parë të dhënë në Akabe: ***“Nëse e zbatoni premtimin e dhënë, atëherë juve ju takon xheneti”***. I Dërguari i Allahut salAllahu alejhi ue sel-lem kur kishte kaluar pranë familjes së Jasirit , e të cilët ishin duke u dënuar për shkak se e kishin pranuar fenë islame, u kishte thënë atyre: ***“Duroni, familja e Jasirit, se ju është premtuar xheneti ”***.

Pasi që si bazë e tergitit dhe e terhibit është shpërblimi në botën tjetër, atëherë lejohet që t'i tregohen të mirat që e presin të thirrurin, po qe se i përgjigjet thirrjes islame dhe në të njëjtën kohë të këqijat që e godasin, nëse ai e refuzon këtë thirrje. Prandaj, thirrësi e ka për obligim që të jetë syçelë gjithmonë në zbatimin e ***tergibit*** dhe ***terhibit***, duke kujtuar shpërblimin në botën tjetër. Prej argumenteve që lejojnë përdorimin e kësaj metode të thirrjes janë këto:

1-Allahu i lartësuar ka thënë: ***“Atyre nga mesi juaj të cilët besuan dhe bënë vepra të mira, Allahu u premtoi se do t'i bëjë zotërues në atë tokë ashtu si i pati bërë zotërues ata që ishin para tyre dhe fenë, të cilën Ai e pëlqeu për ta , do ta forcojë, e në vend të frikës Ai do tju dhurojë siguri...”***

2- Allahu i Lartësuar, kur e tregon ndodhinë e popullit të Nuhut a.s. tregon se si Nuhu a.s. i ka thënë popullit të tij: ***“Unë ju thashë: Kërkoni falje Zotit tuaj, se Ai***

vërtet fal shumë; Ai ju lëshon nga qielli shi me bollëk, ju shumon pasurinë dhe fëmijët ju bën të keni kopshte dhe ju jep lumenj”.

3- Prijësit kurejsh kishin kërkuar nga xhaxhai i të Dërguarit Ebu Talibi që të bisedonin për çështjen e të Dërguarit të Allahut dhe se kishin kërkuar prej tij që ai të mos i pengonte ata, me kusht që edhe ata mos e pengonin atë. Ebu Talibi kishte kërkuar që të vinte tek ai Muhamedi a.s., e kur kishte shkuar te xhaxhai, Ebu Talibi i kishte thënë: O biri i vëllait tim, këta janë prijësit e popullit tënd, janë tubuar që ty të të japin diçka dhe të marrin diçka prej teje. I Dërguari i Allahut salAllahu alejhi ue sel-lem tha: *“O xhaxha ma jepni vetëm një fjalë do të keni mundësi t'i sundoni arabët dhe të huajt”*. Ebu Xhehli tha: Po të pastë baba, jo një fjalë por dhjetë fjalë. I Dërguari i Allahut salAllahu alejhi ue sel-lem tha: *“Të thoni se nuk ka zot tjetër pos Allahut dhe të hiqni dorë nga adhurimi i idhujve”*

Disa nga mënyrat e tergibit dhe terhibit (inkurajimit dhe kërcënimit)

Prej mënyrave të tergibit dhe terhibit është ajo që t'i përmendet popullit se çfarë begatish kanë ata dhe se për shkak të tyre duhet që t'i nënshtrohen Allahut, ngase Ai është që ua ka dhuruar ato begati. Dhe pos kësaj atyre duhet tërhequr vërejtjen se, nëse nuk i përgjigjen thirrjes islame dhe e mohojnë Allahun, atyre do t'iu largohen begatitë dhe do t'i godasë dënimi. Janë të shumta ajetet e Kuranit që e shpjegojnë këtë mënyrë të tergibit dhe terhibit:

1-Përmendet në Kuran se Hudi a.s. i ka thënë popullit të tij: ***“A mos ju erdhi çudi që ju erdhi shpallja nga Zoti juaj për mes një njeriu nga mesi juaj, e për t'jua tërhequr vërejtjen. Rikujtojeni kur Ai ju bëri sundues pas popullit të Nuhut dhe jua shtoi fuqinë fizike. Rikujtojini të mirat e Allahut që të gjeni shpëtim.”***

2- Po ashtu Allahu i lartësuar e përmend atë që ka thënë Hudi a.s.: ***“Pra kijeni frikë Allahun dhe më dëgjoni mua! Ju pajisi me mjete gjallërimi e me djem.Me kopshte e me burime uji. Vërtet unë i frikësohem dënimit tuaj në një ditë të madhe.”***

3-Allahu i Lartësuar e përmend atë që ia ka thënë Salihu a.s. popullit të tij: ***“Rikujtojeni kur Ai ju bëri sundues pas Adit, ju vendosi në tokë e ju në rrafshin***

e saj ndërtoni pallate, kurse në kodrina ngrini shtëpi, rikujtoni të mirat e Allahut e mos u bëni shkatërrues në tokë ”.

4-Allahu i Lartësuar për çështjen e kurejshëve thotë: ***“Për hatër të garantimit që e gëzojnë kurejshët! Garantimin e udhëtimit të tyre të lirë dimrit dhe verës! Pra le ta adhurojnë Zotin e kësaj shtëpie, i Cili i ushqe pas urisë dhe i siguroi prej çdo frike.”***

Domosdoshmëria e përdorimit të tergibit dhe terhibit

Pasi që njeriu jeton në këtë botë, i ndien dhe i sheh mashtrimet e kësaj bote, të cilat e bëjnë që ai të lidhet me jetën e kësaj bote duke e harruar ahiretin, prandaj patjetër duhet larguar të thirrurit nga këto gjëra që e largojnë atë prej përkushtimit ndaj botës tjetër, e kjo nuk mund të bëhet me një hap, por duhet të thirrurit gradualisht, duke i shpjeguar rëndësinë dhe vlerën e begative të xhenetit. Këtë e ka shpjeguar shumë qartë Kurani Fisnik në mënyrën më të mirë, në atë mënyrë sa ky shpjegim e bën myslimanin e mençur që t’i japë përparësi jetës së ahiretit ndaj kësaj jete. Mirëpo, jo vetëm kaq, ky shpjegim e nxit edhe jomyslimanin që të mendojë për këto fakte të vërteta për ta peshuar vlerën e kësaj bote me atë të ahiretit, e që ka mundësi që ky shpjegim ta tërheqë këtë në besim kur e kupton saktësinë e këtij shpjegimi dhe përshkrimi se sa vlerë ka kjo botë.

Prej ajeteve kuranore që flasin për këtë çështje janë: ***“Shembulli i jetës së kësaj bote është si i një shiu të cilin e kemi zbritur nga qielli, e me anën e të cilit gërshetohen bimët e tokës (mbijnë dhe shpeshetohen të gjitha llojet) prej nga hanë njerëzit e kafshët deri kur toka ta ket marë stolinë e vet dhe të jetë zbukuruar (me bimë ,e pemë e behar), ndërsa banorët e saj të mendojnë se janë të zotët e saj, e asaj i vjen urdhëri Ynë, natën ose ditën, Ne e bëjmë atë (të mbjellat) të korrur sikurse të mos ekzistonte dje. Kështu Ne ua sqarojmë faktet njerëzve që mendojnë.”*** ;Ju njerëz dijeni se jeta e kësaj bote nuk është tjetër vetëm se lojë, kalim kohe në argëtim, stoli, krenari mes jush dhe përpjekje në shtimin e pasurisë dhe të fëmijëve, e që është si shembull i një shiu prej të cilit bima i habit bujqit, e pastaj ajo thahet dhe e sheh atë të verdhë, mandej bëhet e thyer, e llomitur, e në botën tjetër është dënimi i rëndë, po edhe falje gjunahesh dhe dhurim i kënaqësisë nga Allahu ; pra jeta e kësaj bote nuk është veçse përjetim mashtrues.”

Në sunetin e të Dërguarit salAllahu alejhi ue sel-lem tërhiqet vërejtja që të mos i jepet përparësi kësaj bote ndaj botës tjetër dhe shpjegohet vlera e ahiretit në krahasim me këtë botë. Prej haditheve që flasin për këtë çështje janë: *“Vërtët kjo botë është e ëmbël e joshëse dhe se Allahu jua bën juve të mundshme që ta shrfytëzoni atë dhe se Ai ju shikon se çfarë veproni. Prandaj ruajuni prej kësaj bote ruajuni (sprovave) të grave”*. I Dërguari salAllahu alejhi ue sel-lem thoshte: *“O Zoti im, nuk ka jetë tjetër pos jetës se ahiretit.”* Po ashtu, kur e ka shpjeguar i Dërguari salAllahu alejhi ue sel-lem vlerën e kësaj bote në krahasim me ahiretin, ka thënë: *“Kjo dynja në krahasim me ahiretin është sikur shembulli i ndonjërit prej jush që e fut gishtin në det dhe më pastaj e shikon sesa ujë ka nxjerë.”*

Edukimi dhe mësimi

Kur arrihet që thirrja të pranohet, pra i thirruri e pranon thirrjen islame, kjo do të thotë se atë e ka udhëzuar Allahu dhe ia ka hapur gjoksin që ta pranojë islamin. Në këtë rast është obligim për thirrësin që të angazhohet ta bëjë të thirrurin që të jetë imun ndaj sëmundjes së hershme, t'ia shpjegojë rregullat e fesë, t'ia vërtetojë atij, ndërsa këtë duhet ta bëjë duke ia mësuar parimet e fesë, konceptet dhe mendimet e fesë. Nuk i lejohet thirrësit që të mos u kushtojë kujdes atyre që sapo kanë hyrë në fenë islame, duke u nisur nga fakti se ata e kanë pranuar islamin dhe janë futur në radhën e myslimanëve, ngase ka mundësi që tek ata ende të gjenden simptoma të sëmundjes së hershme, d.m.th. simptomat e politeizmit me të gjitha llojet e tij, kurse simptomat e tilla ndikojnë që të dezertohet nga feja islame dhe të ecjes në rrugë të gabuar duke menduar se janë të udhëzuar.

Në sunetin e të Dërguarit salAllahu alejhi ue sel-lem ka shumë raste që argumentojnë se ky program është i drejtë në thirrjen tek Allahu, e ky program është të dhënë mësim atij që e ka pranuar fenë islame. Është vërtetuar se në sunetin e të Dërguarit se kur e kishte pranuar fenë islame Umejr ibn Vehab, në këtë rast i Dërguari salAllahu alejhi ue sel-lem u kishte thënë shokëve të tij: *“Mësojeni vëllaut tuaj fejen dhe lexojeni atij Kuranin”*. Me këtë transmetim shihet se është e domosdoshme që të mësohet ai që e pranon islamin dhe këtij t'ia mësojë konceptet

e fesë islame apo disa prej tyre, këto t'ua mësojë edhe myslimanëve të tjerë të rinj. Po ashtu, transmetohet në sunetin se si i Dërguari salAllahu alejhi ue sel-lem e kishte dërguar Mus'ab ibn Umejrin që t'ua mësonte myslimanëve të Medinës Kuranin .Kështu kishte vepruar Mus'abi që ua kishte mësuar Kuranin, i kishte ftuar të gjithë në islam sa që nuk ka mbetur asnjë shtëpi myslimanëve ensarë pa e pranuar fenë islame. Kur e pranoi fenë islame fisi Ebul Mustalik, i Dërguari salAllahu alejhi ue sel-lem kishte dërguar tek ata një misionar që t'ua mësonte atyre çështjet e fesë islame.

Se i Dërguari salAllahu alejhi ue sel-lem ka lakmuar që t'ua mësojë njerëzve çështjet e fesë islame argument është transmetim i Ebu Rufate Temim ibn Usjed radijAllahu anhu Ky tregon: Isha ndalur tek i Dërguari salAllahu alejhi ue sel-lem, i cili ishte duke mbajtur fjalim. kurse une i thashë: O i Dërguari i Allahut, ka ardhur një njeri i panjohur që të pyesë për fenë e tij, sepse ai nuk di asgë për fenë e tij. Në këtë rast i Dërguari salAllahu alejhi ue sel-lem u kthye kah unë duke e lënë fjalimin e tij dhe ai filloi të ma mësonte mua atë që ia kishte mësuar Allahu e pastaj e vazhdoi fjalimin e tij.

Sikur të mos ishte mësimi i njerëzve ndër çështjet e domosdoshme, i Dërguari salAllahu alejhi ue sel-lem nuk do ta ndërpriste fjalimine hytbes dhe të zbriste për ta mësuar pyetësin.

Thirrësit tek Allahu e kanë për obligim që t'ua mësojnë njerëzve dispozitat e fesë islame e t'ua definojnë atyre kufijtë e Allahut dhe se këta nuk duhet të ndalen vetëm me ta, të sillen butë dhe t'ua përmendin disa fjalë të vërteta. Vërtet feja islme është ajo që i përgjigjet çdo kohe e çdo vendi dhe se këto njohuri të përgjithshme nuk mjaftojnë, por patjetër duhet t'i njohë hollësisht dispozitat aq sa të ketë mundësi. Pa dyshun se parhapja e koncepteve islame është obligim për çdo mushman, i cili ka njohuri dhe se ketij nuk i lejohet t'i fshehë njohuritë që i ka, e posaçërisht nuk ben t'i fsheh njohuritë kur ndodh që të përhapen injoranca dhe risitë. Ibn Kethiri radijAllahu anhu ka thënë: *“Dijetarët e kanë për obligim që t'i shpalosin dhe ti shpjegojnë kuptimet e fjalës së Allahut dhe që t'ua mësojnë të tjerëve këto njohuri. Siç Allahu i lartësuar ka thënë: “Dhe kur Allahu mori zotimin nga ata të cilëve u ishte dhënë libri që gjithqysh t'ua publikonin njerëzve, e të mos e fshehin, ata e lanë pas dore atë për pak send të kesaj jete; pra bënë punë të keqe.”* Më pastaj, vazhdon Ibn Kethiri (Allahu e mëshiroftë) duke thënë: *Ne e kemi për obligim o ju myslimanë që të përfundojmë atë për të cilën ia kemi dhënë besën Allahut dhe të diskutojmë për çështjen tonë duke e*

*mësuar Librin e Allahut të zbritur te ne dhe po ashtu t'ua shpjegojmë edhe të tjerëve. Pa dyshim se ky obligim për thirrësit është obligim, ngase ata duhet t'i thërrasin njerëzit në fenë e Allahut mbi bazën e argumenteve dhe të diturisë. Po ashtu, duhet t'ua shpjegojnë të tjerëve, në menyre të qartë, duke mos u kursyer në shpjegimin e çështjeve të fesë dhe kurrsesi nuk bën ta fshehin diturinë. Për këtë Allahu i Lartësuar thotë: **“Ata, të cilët fshehin argumentet dhe faktet që Ne i shpallëm, e pasi që ato ua sqaruar njerëzve në librin, të tillët i mallkon Allahu, i mallkojnë edhe ata që mallkojnë. Përveç atyre që pendohen, që përmirësohen dhe që u shpjegojnë njerëzve (të vërtetën), të tillëve ua pranojë pendimin, se Unë e pranojë shumë pendimin, jam mëshirues.”***

Edukimi bashkë me mësimin

Nuk është e mjaftueshme që thirësi musliman vetëm t'ia mësojë çështjet e fesë atij që ka hyrë në islam, por duhet bartë tek i thirruri anën praktike të mësimave dhe ta edukojë sjelljen e tij. Kjo është ajo çfarë dëshirojmë me fjalën tonë; edukimi bashkë me diturinë... Kështu ka qenë programi i myslimanëve të parë, Abdullah ibn Mes'udi radijAllahu anhu ka thënë: kur ndonjëri prej nesh mësonte dhjetë ajete, ai u mësonte kuptimin e tyre dhe i zbatonte ato në praktikë. Abdurahman es-Selemiju ka thënë: Na kanë treguar neve am që na lexonin Kuranin se ata kishin kërkuar prej të Dërguarit salAllahu alejhi ue sel-lem që ai t'ua lexonte atyre Kuranin. Mirëpo ata kur i mësonin dhjetë ajete apo i praktikonin në vepër dhe në njëkohësisht i mësonin Kuranin dhe veprimin sipas tij.

Domosdoshmëria e edukimit sipas koncepteve islame

Edukimi i myslimanit sipas koncepteve islame dhe veprimi në sjellje sipas këtyre koncepteve është çështje e domosdoshme nga e cila nuk mund të largohet myslimani. Po ashtu thirësi e ka për obligim që të kujdeset për edukimin e tjetrit

me konceptet islame. Vërtet vetëm të mësuarit e koncepteve islame, nëse nuk ndikojnë ato në zemrën dhe në sjelljen e myslimanit, nuk ka kurrfarë dobie për përmirësimin dhe edukimin e tij. Kjo ëhtë e ngjashme sikur dikush i mëson programet e edukimit fizik të trupit, i rikujton ato kur të pyetet, i përsërit në vete, por pa i zbatuar fare në praktikë, pra nga kjo nuk ka përfitim shëndetësor e as fizik. Pra, kështu është çështja edhe me myslimanin, i cili i mëson konceptet islame por nuk e edukon veten me to. Përveç kësaj, ai që mëson por nuk e praktikon atë mësimin, më së shumti ka mundësi të dështojë në rast të sprovimit. Allahu i Lartësuar ka thënë: ***“Ka nga njerëzit dikush që e adhuron Allahun me mëdyshje (luhatshëm); nëse i vjen ndonjë e mirë ai qetësohet me të, por nëse e godet ndonjë e pakëndshme, ai kthehet në fytyrën e vet të vërtetë (të mëparshme), ai ka humbur këtë jetë dhe jetën e tjetër, e ky është ai dështimi i qartë.”*** Mu për këtë arsye etapa mekase veçohet me edukimin e njerëzve mbi konceptet islame dhe njohjen e bazave madhështorë të islamit, e mbi të cilat konsolidohet besimi islam dhe se me këtë edukim të thellë e të prerë janë pastruar shpirtrat e muslimnëve fisnikë dhe u janë mbushur ato me faktet islame, ashtu që ata janë bërë zanafilla e parë e islamit dhe batalioni ngadhënyës. Pos kësaj ky edukim ua ka mundësuar të përballojnë shumë gjëra, të cilat nuk do t'i kishin përballuar të tjerët, veçse për hatër të Allahut, përkrahjes së fesë dhe përhapjes së saj në gjithë horizontin.

Rrugët e edukimit

Prej rrugëve dhe bazave të edukimit del se myslimani duhet t'i respektojë qëllimet më të larta, që në to ta kalojë gjithë jetën duke i ndjekur hap pas hapi. Qëllimi më i lartë është arritja e kënaqësisë së Allahut të Lartësuar duke e përmendur atë dhe duke kënaqur në adhurimin ndaj Tij. Ky është qëllimi më i lartë dhe se nga ky qëllim nuk duhet të ngurrojnë ata që e kërkojnë këtë e pos kësaj nuk duhet pasur zili e mëri ndaj atyre që e kërkojnë këtë, po përkundrazi, dashuri dhe konkurrim për të arritur deri tek ky cak final. Ky qëllimi lartë nuk mund të arrihet me iluzione dhe përtaci, si p. sh. ai që dëshiron të arrijë në Mekë patjetër duhet të vendosë për të udhëtuar, që të largohet prej të afërmeve dhe prej familjes dhe të furnizohet me atë që i duhet për udhëtim. Mirëpo, në këtë rast furnizimi më i mirë është devotshmëria dhe që jeta e myslimanit të jetë krejtësisht e përcaktuar për të arritur kënaqësinë e Zotit të të gjitha botëve. Allahu i Lartësuar ka thënë: ***“Thuaj: Namazi im, kurhani im, jeta ime dhe vdekja ime janë thjeshtë për Allahun, Zotin***

e botëve". I Dërguari i Allahut gjithmonë ua rikujtonte myslimanëve këto koncepte, këtë qëllim të lartë dhe atë se si duhet të pajisen me furnizimin më të mirë, e kjo është devotshmëria. Jo vetëm kaq, por fjalimi i parë që e ka mbajtur i Dërguari i Allahut salAllahu alejhi ue sel-lem në Medinë ka qenë nxitja për devotshmëri ndaj Allahut dhe veprimi për ta fituar ahiretin.

Mjetet e edukimit

Njëri prej mjeteve ndikuese të edukimit është lidhja me Librin e Allahut të Madhërishëm duke e lexuar, duke studiuar, duke kuptuar atë dhe duke i hapur dritaret e zemrës ndaj këtij Kurani Madhështor. Që më dritën e tij myslimani të largojë nga vetja errësirën që është tek ai dhe që më të gjallërojë jetën e vërtetë, ngase Kurani ashtu si e përrshkruan Allahu i Lartësuar se ky është dritë, udhëzim, shërim dhe shpirt. Andaj me këtë dritë nuk mund të ketë errësirë, nuk mund të ketë udhëzim me dyshim, shërim me sëmundje e as jetë me vdekje. Allahu i Lartësuar ka thënë: ***“Elif, Lam, Mim. Ky është libri që nuk ka dyshim në të (sepse është prej Allahut) është udhëzues për ata që janë të devotshëm.”*** ; ***“Ne të shpallëm Kuranin që është shërim dhe mëshirë për besimtarët.”*** ; ***“Po kështu me urdhrin tonë Ne të shpallëm edhe ty shpirtin (Kuranin).”***

Po kështu duhet që gjithmonë të jenë lidhjet me vetë biografinë e të Dërguarit s.a.v.s, me biografinë e shokëve të tij të ndershëm e që në këtë mënyrë myslimani të jetojë në programin dhe mënyrën se si ka jetuar i Dërguari i Allahut a.s. dhe sesi kanë jetuar shokët e të Dërguarit salAllahu alejhi ue sel-lem... Pa dyshim se thirrësi e ka për obligim që t'i ndihmojë ata që e pranojnë thirrjen islame në aspektin e edukimit në atë mënyrë që edhe këta të bëhen prej thirrësve në fenë e Allahut dhe se feja islame ka nevojë që të ketë sa më shumë thirrës që e kuptojnë fenë e Allahut.